

1. Zbulime të Mahnitshme në Tokën e Shenjtë



Ndonëse Lindja e Mesme ka rezerva të mëdha nafte dhe spikat si një rajon mjaft i nxehtë politik, në të ekziston një shumëllojshmëri qytetërimesh, që për mijëvjeçarë të tërë kanë jetuar në krah të njëritjetrit, “si një zinxhir perlash”. Shumë dritë është hedhur për historinë, pasurinë, magjinë e tërheqjen e këtij rajoni. Edhe arkeologët janë joshur nga këta shekuj qytetërimi, shumë më parë, se sa vetë Napoleoni të shpinte shkencëtarët e studiuesit e vet në Egjipt më 1798-ën. Guri i Rosetës (The Rossetta Stone), shkruar në greqisht, hieroglifet dhe shkrimet demotike (që në fund arritën të deshifrohen nga Zhan Shampojon), ishin disa nga zbulimet e hershme dhe të mrekullueshme që duheshin bërë.

Arkeologët kanë rrëmuar edhe përmes pluhurit e gërmadhave që rrënojat e qyteteve e qytetërimeve mbartin mbi vete për disa mijëra vjeçarë. Nga qytetërimet e varrosura ata kanë zbuluar gurë, dorëshkrime, artikuj arti e qeramike, mbishkrime, e kështu me radhë. Shumica e tyre kanë zbuluar një pasuri të tërë faktesh që pohojnë besimin e u japin sërish shpresë mijëra, madje miliona njerëzve, ende të trysnuar e të mëdyshur. Le t’i eksplorojmë ato më poshtë:

Egjipti

Në Aswan, 1000 km në jug të Kajros, lumi Nil ndalet e vazhdon rrjedhën e vet përgjatë ishujve Elefantinë e Kitshener. I pari u zaptua në shekujt V dhe III p.e.s. nga një koloni hebrenjsh. Këtu janë zbuluar disa papirusë me dorëshkrime interesante teksa një arkeolog, duke kërkuar bashkë me të tjerët dëshmi të periudhës persiane, shkeli rastësisht mbi disa krokodilë të balsamosur me shkrime të moçme. Lëkura e regjur shpërtheu dhe nënshkrime të fshehura papirusesh, të cilat shpejt u bënë të disponueshme për të gjithë botën e mahnitur nga habia. Ato iu dhanë historianëve dhe arkeologëve dëshmi dhe data për mbretërimin e mbretërve persë, dhe fakte përfundimtare për erën Persiane të sundimit të botës, që nuk njiheshin përpara këtij zbulimi.

Pellgu ujqor i Aswan-it siguron ujin për vaditje dhe është burim kryesor i elektricitetit për Egjiptin. Liqeni i Nasser-it, që është formuar pas këtij pellgu, mbulon të gjithë zonën, ku patën qenë ndërtuar tempujt e faraonit Ramses II në Abu Simbel. Gjithsesi, falë ndihmës së Unesco-s, këto monumente të rralla të antikitetit, janë të ruajtura në një shesh rreth 100 metra të lartë. Gati 200 km në jug të Aswanit gjenden tempujt e Luksorit dhe Kernakut. Shumë mbretër të moçëm egjiptianë kanë jetuar brenda tyre, dhe kur vdisnin, i kalonin nëpërmjet lumit, e i varrosnin me rradhë prapa vargut të maleve Tebiane, në Luginën e Mbretërve. Set I, Tutankhameni, Amenhotepi III e disa Ramsesë janë varrosur në këtë luginë. Mbretëresha Hatshepsut, e cila ishte bashkë-rregjente gjatë kohës së lindjes së Moisiut, u varros përballë këtij vargmali, në Luginën e vogël të Mbretëreshave.

Tashmë ne e dimë se Egjipti ishte një mbretëri madhështore që siguronte ushqim, në kohë urie, për pjesën më të madhe të Lindjes së Mesme. Ai të rrënoqeth me një kulturë ende të pakapërcyer dhe me pasuritë e tij, që ishin zilia e të gjithë kombeve fqinjë me të. Kur faraonët sundonin botën dhe fuqia e Egjiptit ish e lakmuar nga çdo komb, profetët e Shkrimeve të Shenjta, spikasnin me një sërë profecish. Shkrimet e Shenjta shpallin që më parë me anë të

profecive të veta, mençurinë e Perëndisë së Qiejve, që në mënyrë të çuditshme qenë të gjitha tërësisht të përpikta. Vëreni se si Isaia, një profet i cili ka jetuar 700 vjet përpara Krishtit, shkruan në një pergamenë mbi Perëndinë e Qiejve:

“Kujtoni gjërat e shkruara, të shumë kohe më parë; Unë jam Zoti e mbi mua s’ ka asnjë tjetër; Unë jam Zoti e s’ është askush si unë. Unë njoh gjithçka, nga fillimi deri në fund, që nga kohët e moçme; njoh edhe gjithçka që do të vijë. Unë them se qëllimi im s’ do të shuhet kurrë, e se unë do të bëj gjithçka që ai të përmbushet. Unë jam Zoti e s’ ka tjetër, si unë”. (Isaia 46:9. 10)

Vërehet se Shkrimet e Shenjta shpallin se Zoti është i aftë të deklarojë gjithçka nga fillimi gjer në fund. Ekzistojnë me qindra profeci në Shkrimin e Shenjtë që mbrrijnë gjer në ndodhi, të cilat zgjasin me shekuj të tërë, që prej kohës së profetëve e që e zbulojnë të ardhmen me shumë përpikmëri. Për ta ilustruar këtë gjë, le të shikojmë se çfarë kanë thënë profetët mbi tokën e Egjiptit.

1 . Jo më asnjë princ nga toka e Egjiptit

Ndryshimet e mëdha mbrritën, edhe për vetë faraonët. Tek Ezekiel 30:13 thuhet se: “nuk do të kishte më asnjë princ nga toka e Egjiptit”. Kur u shkrua kjo profeci dukej sikur Egjipti ishte i destinuar për një të ardhme të lavdishme e të përjetshme. Mirëpo Zoti e sheh të ardhmen shumë më qartësisht se një njeri mortor. Që prej vitit 332, p.e.s. e deri në kohët e sotme, Egjipti ka pasur një vijimësi mbretërisht që janë përzgjedhur nga rraca të ndryshme nga ajo egjiptiane. Mbreti i fundit, mbreti Faruk, ishte një shqiptar. Afërsisht 300 vjet përpara se të niste përmbushja e kësaj profecie, një gjë të tillë e kish profetizuar profeti Ezekiel.

2 . Shkatërrimi i idhujve të Memfisit

Në Saqqara gjenden rrënojat e qytetit antik të Memfisit. Te Ezekieli 30:13-16, përmendet se: “ Idhujt e Memfisit (Noph) do të shkatërrohen”. Egjipti kishte më shumë se dy mijë perëndi dhe Memfisi qe një qytet shumë i madh, ku qenë ndërtuar shumica e përmendoreve të tyre. Memfisi është përshkruar edhe si “Londra e kohëve të vjetra”. A. M. Edwards, një egjiptolog i njohur shkruan: “Ja, se ç’ mbeti nga Memfisi, më i moçmi i të gjitha qytetete: një pirg me mbeturina, një duzinë e ca statuja të copëtuara dhe një emër. Vështirë ta besoj kush, që këtu, në këtë skërkë, dikur pat lulëzuar një qytet, apo të kuptojë se si ai mund të jetë shuar kaq kryekëputësisht”.

Çdokush mund t’i imagjinojë ata njerëz tallës e përqeshës, atëherë kur profeti foli për parashikimet e tij të guximshme. Por faktet mbeten, qyteti i madh i Memfisit nuk është më dhe ndërtimi i statujave të idhujve ka rreshtur. Kanë mbetur vetëm pak rrënoja!

3 . Zhdukja e kallamave të papiruseve

Egjipti kaloi edhe përmes një periudhe krimi e pornografie. Kallamat e papiruseve u përdorën për përgatitjen e dorëshkrimeve. Nëpërmjet materialeve të përfunduara, shkrime imorale dhe të padenja u kaluan nga një brez në tjetrin. Por një profeci vendimtare u shfaq rreth vitit 700 p.e.s. nga pena e Isaías. Në kapitullin 19:7 ai thotë: “Kallamat e papiruseve nëpër përrenj ... do të fishken dhe kalben. Kur ndodhi diçka e tillë, pornografia u pakësua. Në Egjiptin e sotëm rriten shumë pak papiruse në krahasim me bollëkun që ekzistonte në kohën e Isaías. Rrëketë e lumenjtë 2700 vjet më parë qenë të mbushura plot me këta kallamë, veçanërisht në rajonin e deltës së Nilit. Foshnja Moisi u fsheh në disa prej tyre. Ekziston një numër i madh i këtyre kallamave të rritura në një pellg uji, të përgatitur posaçërisht për to perballë Muzeut të Kajros. Arsyeja

kryesore është mangësia e kësaj bime në Egjiptin e sotëm. Bibla tha se: “Ato nuk do të rriten më”, (shiko Isaia 19). Papiruset sot rriten në vende të tjera të Lindjes së Mesme, por shumë pak prej tyre gjenden në Egjipt.

4 . Përrenjtë do të thahen

Në kohën, kur u shkruajt profecia e papiruseve, sipas zbulimeve arkeologjike ekzistonin shumë rrëke dhe kanale lundruese. Por në të njëjtin tekst përmendet se këta përrenj do të thahen. Madje, dhe detajet më të imta të kësaj profecie, janë përmbushur. Të gjitha rrjedhat që derdhen në Nil, veçanërisht ato në jug, përrreth Tebës, (Lukсорit), kanë shumë kohë që janë tharë, e vetëm ca rrëfime të shkurtra kanë mbetur për ekzistencën e tyre. Pamja më e bukur e këtyre kanaleve, sot mund të shihet veç lart, nga ajri.

Në muret e tempullit të Karnakut, prapa statujës së Amenofisit IV, gjendet një relief i qartë i mbretëreshës Hatshepsut. Ajo është mbretëresha që, besohet, të ketë shpëtuar Moisiun, duke e fshehur në një kaçube kallamesh papirusi, në brigjet e lumit Nil. Ajo ndërtoi një perandori të madhe dhe u njoh si një ndërtuese e spikatur monumentesh, siç dëshmon sot tempulli i saj i mrekullueshëm, Deir el-Bahri. Ai u ngrit në Luginën e Mbretëreshave, në rrëzë të shkëmbinjëve të maleve tebiane, ku fshihet Lugina e Mbretërve. Në ditët e Hatshepsutit, rrobat endeshin me pëlhura liri, ku një inç i tyre kishte 560 fije dhe një fije 356 fibra të imta. Në trupat e gjetur të asaj kohe, kishte mjaft zbukurime floriri nëpër dhembë apo sy të qelqtë artificialë. Ndërsa nga pikëpamja kombëtare ajo sanksionoi një pakt paqeje (i pari që njihet në histori) me kombin e hititëve, me të cilët egjiptianët kishin qenë përherë në luftë.

5 . Zbulimet e dëshmimeve të kombit të hititëve

Deri një shekull më parë, kritikët e Shkrimeve të Shenjta, shpallnin se hititët, të përmendur aq shpesh, në Shkrimet e Shenjta, duhet të jenë “një komb mitologjik”. Asgjë s’ishte zbuluar për ta. Ku jetuan? Ç’lloj jete bënë? Mirëpo në kapërcyell të shekullit XX, zbulohet qyteti i Carchemish-it, e shpejt nisën të zhvarrosen edhe qytetet e tjera hitite, në vende të ndryshme nëpër Turqi. Sot, harta e Turqisë është e pajisur me plot 36 qytete të tillë të moçëm. Tempujt e shenjtorëve, brenda mureve të qyteteve, na paraqesin thesare të tëra me ar, bronz e qeramikë. Katër mijë vjet më parë, hititët ndërtuan dy nivele të një qyteti të nëndheshëm në Kapadoki. Të tjerë nivele u shtuan nga të krishterët, një mijë vjet më parë. Ata gërmuan deri në tetë nivele të tjerë. Sot nuk dyshon askush për ekzistencën e hititëve. Njeriu tashmë mund t’i shohë Shkrimet e Shenjta me më shumë besim se kurrë më parë. Lopata e arkeologëve ka dhënë aq shumë dëshmi, për besueshmërinë e shkrimeve profetike. Në një kohë kur Dan Braun (Brown) me librin “Kodi i Da Vinçit” i vendos në pikëpyetje këto shkrime, edhe pse në fontespicin e librit shkruhet se “... në këtë vepër arti, karakteret, vendet dhe ngjarjet janë ose produkt i imagjinatës së autorit, ose janë përdorur në mënyrë të rreme”. Shumë njerëz mund të jenë nxitur të heqin dorë nga shkrimet, pasi kanë lexuar romanin e Dan Braun. Po ndoshta, ata harrojnë se tekefundit bëhet fjalë vetëm për një prozë letrare. Kjo, pasi faktet e mbështesin vendosmërisht Biblën në mënyra nga më të ndryshmet.

Tutankhameni dhe Moisiu

Midis shumë varreve të mbretërve antikë, në Luginën e Mbretërve, gjendet edhe ai i Tutankhamenit. Howard Carter, ishte duke gërmuar nën varrin e Ramsesit IV, kur zbuloi një rruginë, që ishte e para e 15-të të tjerave. Ai dhe ndihmësit e tij, duke i ndekur

ato, hynë në varrin e Tutankhamenit, djaloshit mbret, i cili vdiq në moshën 18-vjeçare. Lordi Carnarvon, financuesi i ekspeditës, u ftua të mbërrijë në Egjipt për të marrë pjesë në zbulimin e gjithë atyre thesareve të paçmueshëm. Koçi lufte, rruaza, unaza, sarkofagë të praruar, maska vdekjeje prej ari dhe lapis lazuli (lloj guri i çmuar), poçeri alabastre, orendi dhe një fron madhështor, ishin disa nga ato shumë gjëra që qenë vendosur në varrin e Tutankhamenit, i vetmi i këtij lloji i zbuluar me një thesar të këtillë. Shumë nga kjo pasuri sot mund të kundrohet në Muzeun e Kajros, së bashku me shumë përmendore perëndish që qenë varrosur aty.

Shkrimet e Shenjta kujtojnë se Moisiu, profeti i Zotit, braktisi një pasuri të pallogaritshme, kur hoqi dorë nga thesarët e Egjiptit.

Rreth vitit 1450-të p.K., ai udhëhoqi popullin e Zotit, jashtë nga Egjipti, drejt “tokës së premtuar”. Po, përse i përket pasurisë që Moisiu refuzoi, arkeologët kanë tashmë gati dëshmi të konsiderueshme në mbështetje të pohimit të migrimit antik nga Egjipti. Është interesante se si emri Tutankhamenit u harrua, kurse ai i Moisiut u bë i famshëm, edhe pa pasurinë e Egjiptit, që nga koha e Eksodit të Madh.

Qyteti i Petra-s

Një tjetër vend që do të përmendim në këtë përmbledhje është dhe qyteti i Petra-s. Poeti Burgon ka shkruar kështu për këtë vend:

Kundrojeni këtë mrekulli,
Të ruajtur në të lindjes klimë
Një qytet i kuq si trëndafili
Që sa gjysma e jetës e ka moçmësinë!

Petra ishte i humbur, i panjohur për botën perëndimore. 2000 vjet më parë ai gjendej në një rrugë të aq-shumë përdorur nga karvanet

nga Arabia në Siri dhe Liban. Ai shtrihej përballë udhëtarëve të shumë vendeve të Lindjes dhe Mesdheut. Këtu Edomitët, banorët e tij të parë, praktikuan forma antike ritualesh e nderimesh për Zotat. Në vitet e fundit Nabateanët ishin përgjegjës për tempujt, altarët, dhe shtëpitë e gdhendura nga guri ranor i faqeve të shkëmbinjve të ngritura 100 metra mbi rrëzën e luginës. Guri i mrekullueshëm dhe i ngjyrosur ranor vezullonte një bukuri të pashoqe e që ndryshonte nuancat me lindjen dhe perëndimin e diellit. Madje, edhe në pikun e nxehtësisë, ai ka një magji të papërshkruar për çdo turist. Vëreni më poshtë disa parashikime interesante për këtë vend:

1 . Vendi i vetmisë së përjetëshme

Në Shkrimet e Shenjta, banorët e tij njihen si fëmijët e Edomit ose njerëzit e Idumeas. Jeremia 49:17 ka një të parathënë për të, duke parashikuar se ai do të përmbysset: “Edomi do të jetë një çudi; kushdo që do të shkojë aty, do habitet e do fishkëllejë për fatkeqësinë e tij”. Zoti më vonë do t’i rrëfente Ezekielit, se do ekzistonte një vend që do të ishte vendi i vetmisë së përherëshme, pasi njerëzit aty do të zhdukeshin. Shih Ezekieli 35:3-7, kur thotë: “Kështu foli Zoti: Dëgjo o mali Seir, unë jam kundra teje; unë do t’i shtrij duart gjer tek ti, e që të të bëj sa më të shkretë, do t’i rrënojë qytetet e tua, për t’i lënë të vetmuara e në shkatërrim. Atëherë ju do ta kuptoni se unë jam Zoti”.

Ishte mbreti Amaziah, i cili me guxim i udhëhoqi ushtarët e tij në më të pamposhturën kështjellë, duke i shkatërruar të 10000 mijë Edomitët e Malit Seir (Seir është njeri nga malet e Petra-s dhe një vend strehimi i Edomitëve (Kronikave 25:12).

2 . Njerëzit e saj do të shkatërrohen

Me shumë gjasa edomitët u shfarosën dhe vendin e tyre e zunë nebateanët. Edhe egjiptianët kishin interesa të forta në atë vend, por në fund udha e karvanëve u ndryshua e ky vend u bë i shquar, jo vetëm për bukurinë e tij antike dhe joshëse, por edhe për përmbushjen e mrekullueshme të profecive për të.

Libri me një kapitull, i quajtur Obadrah, parathotë gjykimin që do t'i vijë Petra-s. Edhe një herë tjetër, parashikimet u përmbushën në mënyrë të pashoqe, duke i shtuar një tjetër kapitull magjeps analeve të historisë. Vargu i fundit i Obadrah-ut thotë : “Dhe shpëtimtarët do të vijnë në Malin e Zion-it, për të gjykuar Malin e Esaut; e mbretëria do të jetë e Zotit”. Kuptohet që Zoti është përpjekur në shumë mënyra për ta përmbushur profecinë e Shkrimeve të Shenjta.

Guri Moabit, që tani gjendet në Muzeun e Luvrit në Paris, u zbulua më 1868. Ai mbart një histori të rëndësishme të përmendur te 2 Mbretërit 3:24, kur judenjtë arritën të fitojnë kundër mbretit Moabit Mesha dhe djalit të tij që shkoi të luftojë kundër mbretit Jehoshaphat. Ky gur është njëra nga dëshmitë e shumta të përpikmërisë së Shkrimeve të Shenjta. Një tjetër dëshmi interesante u gjet midis viteve 1932 dhe 1938, në Izrael, dhe pati një impakt të jashtëzakonshëm.

Letrat e Lachish-it mbartin informacione mbi ditët e fundit të Judesë, kur mbreti Nebukadnezar i Babilonisë, i mori ata skllëvër në vitin 586 p.K. Kështu, autenticiteti i Shkrimeve të Shenjta u vërtetua sërish nga zbulimet arkeologjike.

Porta e Artë

Ekziston një mur përqark qytetit të vjetër të Jeruzalemit. Për të hyrë në qytet ka një numër portash interesante : Porta Jaffa në murin e perëndimit, porta Dung në murin e Jugut, Porta e Damaskut në murin e veriut dhe porta e Shën Stefanit në murin e lindjes. Ka dhe disa porta të tjera që përdoren si nga rezidentët, ashtu dhe nga turistët. Sidoqoftë, në murin e lindjes ka edhe një portë e cila rri e

mbyllur. Kjo portë u përdor nga Krishti në rrugëtimin e Tij për në Gjethsemani dhe atëherë kur Ai u kthye përsëri në Jeruzalem nga ana e ushtarëve. Ajo njihet si Porta e Artë ose Porta e Lindjes. Edhe atëherë kur muret e Jeruzalemit u rindërtuan nga ana e Sulejmanit të Madhërishëm në shekullin XVI, qindra vjet pas rrënimit të tij nga ana e ushtarëve romakë, për arsye të caktuara ai e rindërtoi portën dhe e mbylli, përpara se ta hapte zyrtarisht. Që nga ajo kohë, kjo portë ka qëndruar e mbyllur.

Por ka mjaft arsye për ne që t'i hedhim një sy një teksti interesant të Ezeieli 44:1-3. “Pastaj ai më solli përsëri te një portë e jashtme e shenjtërores që shihet përkrah lindjes, por që ishte e mbyllur. E Zoti më tha: “Kjo portë do të mbyllet; nuk do të hapet më, dhe asnjëri s’ do të kalojë nëpër të, sepse Zoti, mbreti i Izraelit, hyri prej saj; për këtë arsye ajo do të kyçet. Përsa i përket princit, sepse Ai është Princi, mund të qendrojë e të hajë bukën e vet përpara Zotit; e mund të hyjë nëpërmjet portës, e të dalë në po të njëjtën mënyrë.

Porta gjendet në një pozicion të mirë për hyrje, por ajo ka mbetur e mbyllur. Unë fola me Dr. Steven Thompson, një studiues i aftë i gjuhëve antike, i cili më pohoi se ky tekst flet padyshim për Krishtin. Pas vdekjes së Tij dhe ringjalljes, e më pas shkatërrimit të Jeruzalemit, porta u mbyll e nuk u hap më që atëherë, edhe pse muret e qytetit u rindërtuan. Falënderojmë Zotin për librin e Tij të vërtetë dhe të besueshëm që na jep mundësinë e njohjes të së ardhmes!

2 . Qyteti nën det

Në kërkim të sigurisë

Arkeologët në tokën e Sirisë kanë kryer zbulime të mrekullueshme, që jo vetëm kanë befasuar botën, por që në vitet në

vijim kanë tërhequr në këtë tokë shumë turistë. Në mes të disave prej tyre është qyteti i Palmirës – një qytet romak në verilindje të Sirisë. Ky qytet i rrënuar, por madhështor në mes të shkretëtirës, ka më shumë kolonambajtëse, se sa çdo vend tjetër në botën Romake. Gjithsesi, ai ekzistonte që në kohën e Solomonit, që mbretëronte rreth 800 vjet përpara Krishtit. Emri i tij i dikurshëm ishte Podmor. Megjithatë, një qytetërim akoma dhe më i vjetër, u zbulua nga arkeologët pranë fshatit të Mardikh-ut, në veri të Sirisë. Për shekuj të tërë banorët e Mardikh-ut, i kanë ruajtur shtëpitë dhe dyqanet e tyre të ndërtuara në formën e stilit të jetës së një koshereje. Sot ata janë duke jetuar në banesa më të zbukuruara, falë faktit që fermerët arrijnë të fitojnë shumë më tepër nga prodhimet e tyre të rritura në një tokë pjellore. Në realitet, Siria mund të jetë hambari i bukës për të gjithë Lindjen e Mesme. Shumë nga njerëzit e Mardikh-ut i ndihmuan ekspeditat italiane në punimet e tyre në afërsi të Tel Mardikh-ut.

Tel Mardikh

Në vitin 1976, zbulime të jashtëzakonshme ndodhën më Sirinë e Veriut, në Tel Mardikh, që ndodhet rreth 54 km në jug të Aleppo-s, qytetit të dytë më të madh të Sirisë. Për plot 25 vjet, arkeologët italianë, nën drejtimin e Paolo Matthiae vijuan të gërmonin vendin (Tel), duke arritur në shumë pak rezultate. Ata kishin zbuluar muret që qarkonin qytetin e Eblës, që mbulonin një hapësirë toke prej 56 ha. Aty kishte shumë pak shtëpi dhe një masë të madhe artikujsh qeramikë. Në vitin 1968, një bust i nënshkruar statujë e identifikoi Tel Mardikh-un me Eblan, si qendrën e atëhershme të mbretërisë së Eblës, që dihet të ketë ekzistuar rreth mijëvjeçarit të tretë p.e.s. Duke gërmuar në një seksion të Tel-it, arkeologët u përballën me atë që dukej të ishte si pallati i mbretit. Brenda tij, ata u ndeshën me njërin nga zbulimet më të mëdha të shekullit XX: një dhomë e tërë plot me

20.000 pllaka argjili. Shumica qenë shkruar në gjuhën e vjetër Sumeriane, por shumë të tjera qenë në gjuhën kanaanike, e cila përdorej nga patriarkët, kur ata u vendosën në Palestinë. Kjo gjuhë tani njihet si e hebrejve.

U deshifruan rreth 5000 emra vendesh të Izraelit të tillë, si : Hazor, Joppa, Lachish, Megiddo dhe Salem, një emër i hershëm i Jeruzalemit. U deshifruan gjithashtu edhe emrat e vendeve të Sodomës dhe Gomorrës në Jordani. Doktor Giovanni Pettineto, epigrafi i ekspeditës, raportoi se tekstet përmbanin versionin në gjuhën kanaanike të historisë së krijimit dhe përmbytjes. Edhe një herë historitë e Biblës i kishin dhënë një vrull të jashtëzakonshëm besueshmërisë së tyre nëpërmjet këtyre zbulimeve. Në po të njëjtën kohë, me zbulimet në Tel Mardikh, u zbuluan edhe qytetet e Bab Edh-Dhra dhe Numeira në Jordani, pranë Detit të Vdekur, qytete që shumica besonin të qenë Sodoma dhe Gomorra. Nëpër të gjitha këto gjetje kishte shtresa të trasha hiri, që kishin ardhur si pasojë e përvëlimit të ndërtesave edhe objekteve. Artikujt e qeramikës, nëpër këto shtresa hiri, i datojnë këto qytete në kohën e Abrahamit apo dhe më parë. Ato u lokalizuan në jug-lindje të Detit të Vdekur, e së bashku me to u zbuluan edhe tre qytete të tjerë, që përfshijnë qytetet e përmendura te Zanafilla 10:19 dhe 13:10. Gjithsesi, këto nuk janë qytetet “nën det” të identifikuara në titullin tonë. Duhet të kalojmë kufirin që ndan Sirinë me Libanin, të lëmë poshtë zonat me cedër të Libanit, e të arrijmë së fundi në Jug të tij, për t’i vizituar ato qytete. Po gjersa udhëtojnë për në jug, le të vizitojmë një tjetër qytet të vjetër të këtij vendi të mrekullueshëm.

Biblosi

Dikur në veri të qytetit të bukur të Bejrutit, kryeqytetit të Libanit, gjendet qyteti historik i Biblos-it, 3 mijëvjeçarë më parë. Ky qytet i shquar për nderimet ndaj diellit, ishte i famshëm për tregëti. Një rrëfim i spikatur në antikitet kujton se Hiram, mbreti i Tiros i

ngarkoi cedërit e Libanit nga porti i Biblos, për një tjetër port, afër tij atë të Çezaresë, për ndërtimin e Tempullit të Solomonit dhe pallatit të tij. Mbreti Hiram e donte shumë Davidin, babanë e Solomonit (1 Mbretërit 5:1) dhe për hir të nënës së tij, që ishte një hebreje, ai padyshim që u inkurajua në planet e veta për këto ndërtime. Që nga porti i Çezaresë, cedrat transportoheshin nëpërmjet tokës për në Jeruzalem, për të ndërtuar e zbukuruar pallatet dhe Tempullin e mbretit Solomon.

Emri grek *Biblos* në kohën e Dhjatës së Vjetër, ishte Gebal (Psalmi 83:7). Kur kallamat e papiruseve “u vyshkën” në Egjipt (shiko kapitullin e parë të këtij libri), Egjiptianët u mbështetën në burimet e tyre të letrës në Biblos. Furnizimet e kopjistëve me papiruset që rriteshin përgjatë Nilit, tashmë qenë ndërprerë. (shiko Isaia 19:7). “Papiruset anës lumit dhe në brendësi të tij, e gjithçka që rritet anës lumit, do të thahet, do të zhduket, e s’do të ekzistojë më”). Grekët u furnizuan me papirusë nga Gebali, që ata e quanin Biblos, ndaj dhe librat e bërë prej tyre u quajtën “biblos”, kështu ishte e natyrshme që dhe libri i librave, Shkrimet e Shenjta të quheshin “Biblos-i”, pra Bibla.

Sidoni

Duke udhëtuar në jug të Bejrutit, arrijmë në qytetin e lashtë të Sidonit. Ne po ndjekim të njëjtën rrugë nëpër të cilën Aleksandri i Madh, në shekullin IV p.K. përshkoi me shpurën e tij të besuar. Kur mbërriti në Sidon, ai u tmerrua nga një shenjë e frikshme. Le të kthehemi prapa në histori për të kuptuar arsyen.

Ndërsa Biblosi filloi të zbehej nga roli i “dritares së historisë”, fenikasit u mbështetën gjithnjë e më shumë në portin dhe qytetin bregdetar të Sidonit. Me fushat e tij pjellore aty pranë, natyrshëm dhe ai u shndërrua në nyjen e industrisë dhe të peshkimit. Popullariteti i tij shpejt tërhoqi mizorët dhe imoralët. Profeti Ezekiel pati një vegim që parathoshte fatkeqësinë e sidonianëve. “Kundromë, o Zion, unë

jam kundra teje! Unë do ta mposht lavdinë që të vlon përbrenda. Ata do ta njohin se unë jam Zoti, kur t'u pllakosë ndëshkimin, e kur ta tregojë shenjtësinë time mbi ta. Do t'u dërgojë një fatkeqësi e do të bëjë që rrëke gjaku të rrjedhin nëpër rrugë. Të vrarët do të dergjen kudo me shpatën në dorë drejtuar kah vetes. Atëherë ata do ta kuptojnë se unë jam Zoti” (Ezekieli 28:22, 23).

Ky parashikim ndodhi në ditën e mbërritjes së Aleksandrit të Madh, që përmendëm më sipër. Ndërsa ai po marshonte fitimtar nëpër pjesë të ndryshme të Sirisë dhe Libanit Verior, sidonianët lidhën një pakt vdekjeje në mes tyre, në mënyrë që Aleksandri të mos i zinte dot të gjallë. Kur arriti, ai u tmerrua, kur zbuloi se sidonianët kishin vrarë veten. Burrat kishin vrarë gratë dhe fëmijët e pastaj i ishin kthyer vetes. 36 mijë banorët e Sidonit kishin vdekur. Profecia u përmbush plotësisht. Por, për këtë qytet Zoti kurrë nuk tha se ai s'do të ngrihej a rindërtohej përsëri, siç tha për qytetin simotër të Sidonit.

Ai u rindërtua. Në kohën e kryqëzatave, një kështjellë e bukur u ngrit në mbrojtje të ushtarëve, për të mbetur ende dhe sot në gjendje natyrale. Pazaret në rrugët e Sidonit shpërthejnë nga tregtia. Shumë minare të xhamive spikasin portikët e qiellit.

Tiro

Le të kalojmë tani në jug, në “Qytetin nën det”. Ky ishte porti i madh industrial i Fenikasve, Tiro, ku gëlonte një bazë detare dhe një qendër e rëndësishme tregtare. Siç e kemi përmendur, mbreti i Tiros, Hiram, e ndihmoi Solomonin me materiale për ndërtimin e tempullit të tij.

Kur Aleksandri dhe ushtarët e tij marshuan pas kalimit të Sidonit, ai duhet të jenë drejtuar patjetër në këtë qytet fenikas. Qyteti i vjetër vuante ende rrënimin e lënë nga Nebukadnezari II.

Tiro i vjetër përbëhej nga dy pjesë: një hapësirë e gjerë toke që shërbente si zonë rezidenciale dhe një ishull rreth gjysmë milje larg

nga toka, ku ishte lokalizuar zona industriale dhe anije-ndërtuese. Tregtarët e Tiros qenë përrallisht të pasur dhe këtë e tregonin fasadat e jashtme të ndërtesave që pasqyronin pasurinë që zotëronte ky qytet i Lindjes. Kur arriti Nebukadnezari, njerëzit shpëtuan duke u larguar në ishull, pasi Nebukadnezari nuk kishte anije dhe nuk e harxhonte kohën t'i blinte apo t'i ndërtonte ato. Sidoqoftë, ai e shkatërroi tërësisht hapësirën tokësore të qytetit. Rrënojat e lëna u përdorën nga Aleksandri për të ndërtuar një urë deri tek ishulli, rreth 1 km të gjatë. Në kuptimin figurativ, ai e “shtyu” qytetin e vjetër në detin Mesdhe. Gjithsesi, Aleksandri kishte fuqinë punëtore të ushtarëve, kurse fenikasit varkat e tyre, me të cilat ata arritën të shpëtonin duke u larguar nga deti.

Te Ezekieli 28:12-17, lavdia e Mbretit të Tiros krahasohet me atë të Satanit, “engjëllit të mbuluar” në parajsë përpara rrëzimit të vet. Dekadenca e Tiros u bë shtangëse dhe Zoti e paratha qartësisht fatkeqësinë e zonës tokësore të qytetit. Vëreni se ç’ thotë Ezekieli 26:

Vargu 7: Nebukadnezari, mbreti i Babilonisë do ta shkatërrojë Tiron.

Vargu 9: Ai do të shpjerë drejt saj deshët për rrëzimin e kështjellave.

Vargu 12: Gurët, lëndët e drurit dhe pluhuri do të mbulojnë detin.

Vargu 14: Qyteti do të bëhet i shkretuar, si maja e një shkëmbi.

Vargu 14: Ai do të kthehet në një vend ku do të shpërhapen veç foletë e zogjve.

Vargu 21: Ai nuk ka për t’u themeluar përsëri.

Të gjitha këto profeci të spikatura u përmbushën deri në detajin më të imët! Sot nuk ka asnjë gjurmë të Tiros së vjetër, të shkatërruar së pari nga mbreti Nebukadnezar II i Babilonisë. Qyteti i vjetër u “zhvesh” lakuriq dhe çdo pjesë, sado e vogël e qytetit të shkatërruar, u vendos në det për të ndërtuar urën për në ishull nga ana e Aleksandrit të Madh. Ai e rrënoi Tiron plotësisht, madje edhe ishulli për një kohë mbeti rrënojë. A s’ është e madhërishme të kuptosh se si profecitë e fjalës së Zotit u plotësuan në mënyrë kaq të përpiktë?

Ashtu siç thotë Isaia: “Fjala e Zotit qendron përgjithmonë!” Ç’tabllo tërësisht të ndryshme ne shohim, kur studiojmë së bashku historinë, arkeologjinë dhe Shkrimet e Shenjta.

Edhe një gjë tjetër për fenikasit. Të katër shkrojtësit e Ungjillit, kujtojnë historinë e kryqit të Jezu Krishtit. Kryqi u dizenjua nga fenikasit 700 vjet përpara se Krishti të kryqëzohej në një të tillë. Mënyra e dizenjimit bënte që shkalla e torturimit të qe maksimale për një mundim minimal. Siguronte një vdekje mizore. Fenikasit e dizenjuan atë jo vetëm si një ndëshkim, por që viktimat e tij të paraqiteshin si një sakrificë për perëndinë e diellit, e cila nderohej nga shumica e feve të moçme. Është pikërisht kjo vdekje mizore, ajo që përshkruhet nga secili prej shkruesve të Ungjillit.

Shumë njerëz mund të jenë zhgënjyer me fenë, me kishat dhe me atë që ata e quajnë hipokrizi. Gjithsesi, ekziston një fakt që nuk mund të mohohet: Shkrimet e Shenjta u qëndrojnë të gjitha llojeve të shqyrtimeve nga më të imtësishmet. Kërkojini ato të siguron veten. Mësoni gjithnjë e më shumë duke lexuar këtë libër e do të shijoni zbulime akoma edhe më ngazëllyese, nga bota ku jetojmë e që pohojnë saktësinë e Shkrimeve, forcojnë besimin dhe eksplorojnë dëshirat e Zotit për secilin prej nesh.

3. Astronomia moderne e Bibla - ose gara për yjet

Mrekullitë e qiellit të yjësuar

Njeriu ka qenë gjithmonë kurioz mbi hapësirën, por ka ndodhur vetëm nëpër këto dekadat e fundit, e veçanërisht me mbërritjen e epokës së hapësirës dhe teleskopëve të tillë, si Hubble, që dija jonë mbi qiejt ka arritur të shtrihet përtej besimit. Idetë e njeriut kanë ndryshuar shumë herë përgjatë shekujve, por edhe pse e habitshme, jo çdo ndryshim ka qenë progresiv.

Besimet antike dhe astronomia

Egjiptianët e lashtë besonin se harku i qiejve ishte trupi i perëndeshës së qiejve Nut, e cila mbante trupin duke u mbështetur mbi duar dhe këmbë. Toka ishte trupi i perëndisë së tokës Qed. Lëvizja përqark Diellit shpjegohej thjeshtësisht kështu:

Çdo ditë Nut i jep lindjen diellit, i cili udhëton nëpër trupin e saj, kurse natën ajo u jep lindje yjeve. Perëndia e ajrit, Shu, përshkruhet si ndihmues në mbrojtjen e trupit të Nut. Perëndia Diell, besohej të udhëtonte në një varkë mbi trupin e Nut; edhe planetet gjithashtu udhëtonin nëpër varka, madje përmendet se me raste, Marsi lundronte në kah të kundërt.

Qenë Babilonasit, 1000 km në lindje të Egjiptit ata që hodhën themelet e Astrologjisë. Ata e konsideronin tokën si një disk të sheshtë të rrethuar nga uji. Qiejt kishin formën e kubeve dhe mbaheshin prej maleve. Toka ishte e palëvizshme, ndërsa ishin qiejt ata që rrotulloheshin përreth saj. Perënditë e tyre qenë në luftë me njeri-tjetrin dhe ky pështjellim ndihmoi në lindjen e astrologjisë. Duket ende dhe sot, kur ka aq shumë gjëra të së ardhmes që janë kaq të pasigurta, se njerëzit e konsiderojnë astrologjinë vetëm për ngushëllim.

Priftërinjtë vedikë të Indisë besonin se toka mbështetej në 12-të shtylla masive. Dielli kalonte diku nën tokë gjatë natës duke iu përvjedhur këtyre shtyllave. Kronologjia Hinduiste shkon akoma dhe më tej, duke postuluar se toka qëndronte në shpinë të katër elefantëve, që nga ana e tyre qëndronin në shpinën e një breshke të

stërmadhe, që mbështetej mbi një gjarpër që lundronte në një oqean të pacak.

Grekët qenë të parët që bënë një përparim real kah kuptimit të vërtetë universal. Pitagora, i famshëm në mes të nxënësve të shkollave për teoremën e tij mbi këndet e një trekëndëshi, ishte i pari në fushën e shkencave, që e postuloi tokën si sferike, duke ndërthurur edhe konceptin e “harmonisë së sferave”.

Ptolemeu, në shekullin e 2-të p. K. i kristalizoi pikëpamjet e njerëzve deri në atë kohë, kështu që sistemi i tij ptolemeik mbretëroi suprem në kozmologji për plot 1300 vjet pas vdekjes së tij. Idetë e tij u ndryshuan vetëm më 1543 nga polaku Kopernik. Kontributi që solli për kozmologjinë, së bashku me hulumtimet e mëtejshme të Johann Kepler-it, hodhën themelet e erës moderne të kozmologjisë.

Këndvështrimi Biblik

Është e mrekullueshme se si përmes gjithë këtyre ideve dhe vendimeve që kanë mbizotëruar gjatë këtyre tre mijëvjeçarëve të fundit, Shkrimet e Shenjta kanë qenë supreme. Vëreni këtë varg te Jobi 26:7. “Ai i shpërndau tej e tej qiejt e veriut, nëpër hapësirën e zbrazët; ai e pezull-vendosi tokën mbi asgjënë”. Shkencëtarët dhe astronomët e konsideruan si qesharake këtë ide gjatë shekujve, por është diçka më se e vërtetë se Krijuesi di gjithçka që në fillim, edhe pse mëkatarit njeri i parapëlqejnë idetë legjendare të Atlasit, elefantëve dhe breshkave. Deri 200 vjet më parë, universiteti i famshëm Yale në Shtetet e Bashkuara mësonte se bota ishte e sheshtë. Arsimiti nuk ishte ndikuar ende nga zbulimet e Kopernikut. Besojeni ose jo, por ekziston ende dhe sot një Shoqëri e Botës së Sheshtë, pavarësisht pse kuptohet që ajo ka vetëm 200 anëtarë.

Në mënyrë të habitshme, Shkrimet e Shenjta, flasin për një tokë sferike, ndërkohë që filozofët e shkenctarët besonin vendosmërisht te një tokë e sheshtë, që lundronte ose mbështetej diku. Isaia shkroi, rreth 2500 vite më parë, “për qarkësinë e tokës”. (40:22). Qarkësi në

original do të thotë “sferë” ose “top”. Por shumë filozofë s’e kuptonin këtë shenjë. E vërteta që ata kanë kërkuar gjatë gjithë kohës gjendej tek Shkrimet e Shenjta.

Një heretik francez Zhan Bon St. Andre, u foli kështu fshatarëve të krishterë gjatë Revolucionit Francez: “Ne do t’i shkatërrojmë kishat tuaja, do t’i djegim Biblat dhe do të rrënojmë gjithçka që ju flet për Zotin”. Fshatarët e krishterë iu përgjigjën qetësisht: “Po ti s’ mund të na zhdukësh yjet”. Për atë që yjet mbeten, ata do të na tregojnë qartësisht e do të na sjellin nëpër mend fjalët e Zotit.

Duke lundruar nëpër Mesdheun blu, nën qiellin e yllëzuar, Napoleoni e godiste pareshtur kuvertën, duke dëgjuar me radhë oficerët e tij të pafé t’i argumentonin kundra besimit dhe Zotit. Por duke u kthyer befasisht, ai e ndali këtë kuvendim me këto fjalë domethënëse: “Shumë bukur, zotërinj, por ju lutem më thoni, kush i krijoi vallë, këta yje”?

Yjet nuk mund të numërohen

Yjet janë të panumërueshëm. Jeremia 32:22, “Banorët e qiellit nuk mund të numërohen”. Po të kthehemi pas në Tokën e Abrahamit, nga njeriu mendohej se ekzistonin vetëm mijëra yje. Babai i astronomisë, Hiparku, thoshte se ata ishin 1080, madje edhe Ptolemeu e konsideronte këtë numër të matshëm. Mund t’i jetë dukur e çuditshme Abrahamit të dëgjonte nga ana e Zotit se fëmijët e tij do të “shumëfishoheshin si yjet e qiellit apo si kokrrizat e rrërës së bregdetit”. (Zanafilla 22:17).

Filozofët grekë mendonin se ata ishin më shumë se 1 mijë, ndërkohë që Jeremia, tashmë kishte thënë se yjet nuk mund të numëroheshin. Grekët, më në fund arritën në një numër rreth 5149 yje, por, kur Galilei më 1610 ndërtoi teleskopin e tij, numri i tyre u rrit jashtëzakonisht. Sot ne e dimë se vetëm në Galaktikën tonë ka rreth 100. 000. 000. 000 yje, e se ka të paktën 10. 000. 000. 000 galaksi. A ia vlen të vazhdojmë të numërojmë më tej? Jeremia kishte të drejtë: “Banorët e qiellit nuk mund të numërohen”.

Me kaq shumë miliona yje të panumërueshëm, padyshim që duhet të ekzistojë një rrezik përplasjeje. Megjithatë, një gjë e tillë duket larg të qenit e vërtetë. Edhe astronomët thonë se shanset që yjet të përplasen ndonjëherë janë jashtëzakonisht të pakta. “Një përplasje është po kaq e mundur, sa goditja e një monedhe (centi) me një plumb në një largësi prej një milje, në një mbrëmje të errët, kur drejtimi i lëvizjes së monedhës është i panjohur!

Qiejt nuk mund të maten

Jobi: “S’është vallë Zoti në majë të qiejve? E kundron kah yjeve, se sa lart ata janë”. Jeremia pohon se është e pamundur të maten qiejt (Jobi 22:12; Jeremia 31:37). Sa e vërtetë është një gjë e tillë? Universi, që njohim është i madh e i gjerë përtej kuptimit të përmasave tona, por megjithatë njeriu vijon t’i zhvillojë e t’i përsosë instrumentet e tij, për t’i shtyrë kufijtë e hapësirës, më shumë se sa mund të imagjinohej vetëm pak vite më parë.

Ilustrimi i mëposhtëm na ndihmon t’i kuptojmë më mirë distancat. “Imagjinoni sikur trashësia e një flete letre të përfaqësojë distancën nga toka te dielli (150. 000. 000 km ose 8 minuta-dritë). Atëherë distanca me yllin më të afërt (433 vite dritë) është një stivë letrash 15 metra e lartë. Diametri i galaksisë sonë (100. 000 vite dritë) është 500 km i trashë, kurse skaji i njohur i universit nuk arrihet deri kur pirgu i letrave të arrijë lartësinë 50 milionë km, një e treta e distancës me diellin.

Rend dhe rregull i mrekullueshëm

Rendi dhe rregulli kundrohen kudo nëpër univers. I tërë universi është i ndërtuar në bazë të parimit që, çdo gjë që rrotullohet rreth tjetrës.

1. Elektronet rrotullohen rreth bërthamave të atomeve.
2. Hëna rrotullohet rreth Tokës.
3. Planetet rrotullohen rreth Diellit.
4. Dielli, së bashku me shpurën e vet të planetëve, qarkohet rreth Galaksisë së Udhës së Qumështit.
- 5 . Galaksia e Udhës së Qumështit është një nga ato 17 Galaksi që përfshijnë atë grupim, që rrotullohet rreth një qendre të përbashkët midis Galaksisë sonë dhe Galaksisë së Andromedës.
- 6 . Grupimi ynë i përket një super-grumbulli Galaksish, që e kanë qendrën e tyre në grupimin e Virgjëreshës, rreth 230 milion vite dritë larg. Edhe për këtë ka mjaft dëshmi rrotullimi, në një kohë që rrotullardhje kryhet, ndoshta për 100. 000. 000.000. vjet.
- 7 . Ka dhe mjaft super-grumbuj të tjerë Galaksish brenda Universit, të cilët nga ana e tyre rrotullohen gjithashtu, rreth qendrës së Universit.

Për shekuj të tërë njeriu që i aftë ta maste me përpikmëri kohën duke përdorur yjet.

Zbulesa e disa lavdive të Zotit.

Vërtet që “qiejt shpallin lavdinë e Zotit” (Ps. 19:1). Rendin dhe rregullin e shohim gjithashtu edhe nëpër bukuritë e natyrës kudo nëpër tokë. Në botën e gjallë dhe atë inorganike ka mjaft dëshmi të rendit dhe rregullit që rrëfejnë për dashurinë e Zotit ndaj së bukurës. E gjithë natyra është identifikimi i dashurisë së krijuesit (Kolosianëve 1:16, 17) na tregojnë shumë më tepër mbi krijuesin. Duke folur për Birin e Perëndisë, ato thonë: “Prej Tij u krijuan të gjitha gjërat, që janë në tokë dhe në qiell ... te gjitha gjërat u krijuan prej Tij dhe për Të ... e prej Tij konsistojnë të gjitha gjërat”.

Kërkojeni Zotin në këto ditë të fundit

Ekziston dhe një kohë për të kërkuar Zotin. Amos 5:6-8 thotë: “Kërkojeni Zotin dhe jetoni ... gjurmojeni drejtësinë në tokë (atë që krijoi Orionin dhe Plejadat, që kthen errësirën në dritë dhe dritën në natë, që i tërheq ujrat e deteve dhe i vërshon ato përsëri mbi fytyrën e tokës): Zoti është emri i Tij”.

Vërtet, mesazhi i Zotit për yjet i sjell ndërmend njeriut gatitjen për t’u takuar me Të. Po si mund të gatitemi? Një rrugë është: ta kërkojmë Zotin nëpërmjet astronomisë. Me fjalë të tjera, të kuptojmë se sa të parëndësishëm jemi, kur shohim bukuritë dhe harmoninë e organizimit të sistemit yjor. P.sh. le të sjellim ndërmend Plejadat dhe madhësitë e yjësive së Orionit. Astronomët për vite të tëra i kanë drejtuar teleskopët e vet kah Mjegullnajës së Orionit me gjithë bukurinë e saj. Edhe teleskopi Hubble ka dërguar mjaft foto të mrekullueshme, si dëshmi të kësaj bukurie. Ato mund të shikohen sot në internet. Zoti është kaq shumë i interesuar pas bukurisë dhe rregullit, Ai jo vetëm që e vendosi këtë bukuri në qiell, por krijoi edhe ngjyresat e bukura të vjeshtës, mrekullinë e flokëve të dëborës, në mënyrë që kjo bukuri të shijohet akoma dhe më shumë. Kërkojini Ato përmes fjalës së Tij - Shkrimeve të Shenjta. Ato i sjellin lexuesit kuptim, vitalitet, gëzim dhe shpresë.

Ndërsa njeriu fluturon në hapësirë duke shpikur anije hapësinore, e teleskopë gjithnjë e më të medhenj e të fuqishëm, duke u përpjekur të kuptojë misteret e saj të mëdha, koha për ne po shkon drejt fundit. Gjatë kësaj kohe Bibla na thotë që të përgatitemi të takohemi me Zotin. Jezusi tha: “Në shtëpinë e Zotit tim ka mjaft banesa, nëse s’do të ishte kështu do t’ju thoja: Unë po shkoj të përgatis një vend për ju dhe do të kthehem e do t’ju marr me vete që, aty ku të jem Unë, të jeni edhe ju”. A s’është ky vallë, një premtim i mrekullueshëm? Jezusi shkoi për të ardhur përsëri, për të na marrë me vete. Atëherë do të ndodhë, siç u shkruajt te 1 Korintasve 2:9: “S’e ka parë asnjë sy, s’e ka dëgjuar asnjë vesh, s’e ka përfytyruar asnjë mendje atë çfarë Zoti ka përgatitur për ata që e duan. Prekeni

rastin menjëherë që të siguroheni se nuk ekziston asnjë distancë mes jush dhe shpëtimtarit Tuaj, në mënyrë që në ditën e gjykimit përfundimtar, ju të jeni të aftë të thoni : “Shikojeni, Ai është Zoti ynë, ne e kemi pritur dhe Ai do të na shpëtojë”(Isaia 25:9).

4. Pergamenat misterioze të Detit të Vdekur

Pak km nga vendi ku lumi Jordan degëzohet për kah Detit të Vdekur gjenden rrënojat e Qumran-it. Deri në shkatërrimin e Jeruzalemit në vitin 70 p.e.s., besohet se esenët jetonin këtu në një izolim pothuajse total me pjesën tjetër të tokës. Uji që i mangët, por këta njerëz të mrekullueshëm kishin ndërtuar ujësjellësa të vegjël, për ta mbartur ujin nga burimet në kodrat aty pranë të Judeas. Ata ndërtuan dhe çisterna prej shkëmbinjve për ta ruajtur ujin e çmuar, në mënyrë që për shtëpitë e tyre, ndërtuar mes gurëve, ato të ishin një rezervë e bollshme.

Njeri nga shqetësimet kryesore të esenëve ishte kopjimi i Shkrimeve të Shenjta. Ata kishin edhe një punishte ku kopjoheshin me shumë kujdes e përpikmëri të gjitha shkrimet e patriarkëve dhe profetëve, të njohura për ne si Dhjata e Vjetër, nuk lejohej asnjë gabim në këto dorëshkrime e, nëse ndodhnin me gabime, gabimet nuk fshiheshin ose korrigjoheshin, siç mund të veprohet në ditët e sotme, përkundrazi i gjithë dorëshkrimi shkatërrohej e puna niste nga fillimi. Shumica e pergamenave u shkruan mbi qiellza të buta ose mbi lëkura kafshësh, veçanërisht dhish dhe delesh.

Pak dihej për Qumran-in dhe banorët e tij, deri kur dy beduinë të rinj, duke ndjekur tufat e bagëtive të familjes, u ndeshën në një zonë me një bimësi të rrallë. Aty përbri, lartoheshin faqe të rrëpirta mali, e në majë të tyre, ata vunë re një zgavër të madhe në zemër të shkëmbit. Siç bëjnë zakonisht fëmijët, ata nisën një garë se kush arrinte më parë ta hidhte gurin në zgavër. Njeri nga djemtë e rroku

shënjestrën. Kur guri hyri në atë vrimë, prej andej u dëgjua një zhurmë kërcëllitëse që jehoi kudo nëpër shkëmbinjtë e luginat përreth. Djemtë ia mbathën vrapit duke pyetur se kush e kishte krijuar atë tingull.

Ata vendosët të ngjiteshin nëpër ato maja, duke u futur në njërën nga vrimat që lidhej me tjetrën e që vazhdonte deri në zemër të shkëmbinjve. Teksa ia arritën qëllimit, nisën të kundronin një çift shpellash, fqinje me to, duke gjetur aty vazo qeramike, eshtra, monedha dhe produkte të tjera të bëra nga njerëzit. Disa prej qypave qenë thyer nga gurët që kishin hedhur djemtë, kështu që, tashmë përballë tyre ata panë qypa të thyer që përmbanin dorëshkrime të mbështjella me lëkurë. Shpejt lajmin u treguan edhe baballarëve të tyre, të cilët i morën disa prej këtyre dorëshkrimeve dhe i nxorën në pazarin e Jeruzalemit, duke ia shitur një rabini, si për lëmoshë, me shumë pak dollarë. U kuptua menjëherë se dorëshkrimet qenë të çmuara. Ndaj ato iu shitën një sipërmarrësi në Nju Jork, që kishte lidhje me hebretë. Sot, shumica e këtyre dorëshkrimeve, janë kthyer përsëri në shtetin e ri të Izraelit dhe ruhen në një ndërtesë të posaçme të quajtur “Faltorja e Dorëshkrimeve”, e cila gjendet përgjatë rrugës që të shpie te Knesset, ndërtesa e parlamentit të Izraelit. U ndeshën mjaft vëshirësi që e vonuan përkthimin e këtyre dorëshkrimeve. Edhe pse shumë prej tyre ishin në gjendje të kënaqshme, për moshën 2000 vjeçare, përsëri shfletimi i tyre duhej bërë me shumë kujdes. Solucione të veçanta spërkatëse u përdorën për ta zbutur e bërë elastike lëkurën, kurse për t’i shfletuar e hapur të gjitha dorëshkrimet, u deshën tre vjet. Ndërsa, klima e Detit të Vdekur ndihmoi në ruajtjen e dokumenteve, ato u bënë pothuajse të brishta me kalimin e viteve. Kur dorëshkrimet u botuan, u pa qartësisht se më të famshmet e shkrimeve antike, qenë ato të profetëve Isaia dhe Daniel. Pothuajse 5 vëllime të plota të librit të Isaia gjendeshin mes zbulimeve dhe nëntë libra të Danielit. Kishte mjaft fragmente të librave të tjerë, disa pothuajse të plotë. Jo të gjitha

ishin Shkrime të Shenjta, pasi disa dokumente kishin natyrë legale dhe politike.

Sa të vjetra qenë dorëshkrimet? Lajmi befasues gjendej në faktin se secili prej librave biblikë datonte të paktën 150 vjet përpara Krishtit. Datimi u krye prej njehsorëve Geiger dhe me anë të metodës së datimit me karbon. Këto qenë dorëshkrimet më të vjetra biblike që njiheshin deri atëherë. Kopjet më të vjetra të shkrimeve të Dhjatave të zbuluara para vitit 1947, datojnë pothuajse 1000 vjet më vonë. Për vite kritikët e Shkrimeve të Shenjta patën shpallur se si Danieli, ashtu dhe Isaia ishin shkrime historike, shkrime të bëra pas kohës së Krishtit, dhe jo të shkruara nga profetët me emrat e tyre. Këto pohime ishte e vështirë që të sprovoheshin, pasi ekzistonin shumë pak dorëshkrime më të hershme se viti 900 p.e.s. Një tjetër arsye pse kritikët shpallin një datë të mëvonshme për këta dy libra, ishin parashikimet e tyre të detajuara në lidhje me Mesinë, Jezu Krishtin.

Isaia përshkruan lindjen, aftësitë dhe vdekjen e Krishtit, e për ata që nuk e besonin profecinë, ishte një zgjidhje e lehtë ta klasifikojë librin si një shkrim historik më tepër se sa profetik. Danieli, jo vetëm që profetizon kohën e ardhjes së parë të Krishtit (Danieli 9), por parathotë ngritjen dhe rënien e kombeve të tillë, si: Persia, Greqia dhe Roma, bashkë me mbretëritë që do të ndërtoheshin pas kolapsit të Perandorisë Romake.

Nga viti 1947 kritikët filluan të heshtnin, për shkak të zbulimit të dorëshkrimeve që provuan përfundimisht të qenë shkruar përpara kohës së Krishtit, e në fakt, ashtu siç do ta përmendim më vonë, të paktën 150 vjet përpara ardhjes së parë të Krishtit. Danieli shkroi dhe jetoj rreth 550 vjet përpara Krishtit, kurse Isaia ishte 150 vjet më i hershëm se Danieli. Shkrimet e tyre u transmetuan prej kopjistëve nëpër shekuj dhe zbulimet e fundit qenë ato të kopjuara nga banorët e Qumran-it.

Si mund të krahasohen dorëshkrimet e Detit të Vdekur me Shkrimet tona të Shenjta sot? Përgjigjia është se përtej shqiptimit

të fjalëve dhe ndonjë diferencë në formimin e frazave, këto dorëshkrime të zbuluara janë identike. Po e njëjta gjë provohet nga krahasimi në shumë versione të tilla të vjetra, si: siriane, koptike, armeniane dhe etiopiane, për të përmendur vetëm disa. Ndërsa ato qenë të ndara gjeografikisht, në kultura dhe në vlera të ndryshme hebreje dhe të krishtera, përsëri librat biblikë janë të njëjtë. Duket se kjo mund të ndodhte vetëm nëpërmjet një ndërhyrjeje hyjnore në mbrojtjen dhe udhëheqjen e duarve të masoretëve ose kopjistave.

“Kodi i Da Vinçit” dhe dorëshkrimet e Detit të Vdekur. Pas gjithë asaj mbrojtjeje që iu bë Shkrimeve të Shenjta, Dan Braun në librin “Kodi i Da Vinçit”, kërkon ta mohojë domethënien dhe rëndësinë e tyre kah mos-besimit dhe mbulimit apo harresës. Lexoni se ç’ thotë Braun në gojën e personazhit Teabing:

“Fatmirësisht për historianët ... disa pre Ungjillëve që Konstantini u përpoq t’i shfaroste, arritën të mbijetojnë”.

Pergamenet e Detit të Vdekur u gjetën në vitin ’50-të, të fshehura në një shpellë pranë Qumran-it, në shkretëtirën judeane. E padyshim, edhe pergamenet koptike në vitin 1945, në Nag Hammadi. Në vend që të tregonin historinë e vërtetë të Gral-it të shenjtë, këto dokumente flasin për shërbëtarinë e Krishtit në terma shumë njerëzorë. Sigurisht, që Vatikani, ne vijim të traditës së vet të mosinformimit, u përpoq shumë fort ta ndalonte shpërhapjen e katyre mbishkrimeve. E pse duhet vallë ta bënin një gjë të tillë? Pasažhet e dorëshkrimeve të verbonin nga fabrikimet dhe mospërputhjet historike, duke konfirmuar qartësisht se Bibla moderne u grumbullua dhe u botua nga njerëz që kishin një axhendë politike, për të promovuar hyjninë e njeriut Jezu Krisht dhe përdorimin e ndikimit të Tij në forcimin e bazës së fuqisë së tyre”.
(“Kodi i Da Vinçit”, fq, 317).

Brauni i klasifikon pergamenat e Detit të Vdekur si ungjij: “Këto dokumente flasin për shërbëtarinë e Krishtit në terma shumë njerëzorë”, thotë ai.

Ups - ç' gafë e sikletshme! Pergamenat e Detit të Vdekur, në fakt, janë libra hebraikë. Ju mund të blini një kopje ne dyqan dhe do të kuptoni se këta libra s'kanë përmbajtjen e dorëshkrimeve, por përmbajtja e tyre është përmbledhja e të gjithë librave të Biblës Hebraike (e quajtur Dhiata e Vjetër nga të krishterët), përveç historisë së Esterit, bashkë me komentet rreth këtij libri dhe disa materiale me vlerë që i përkisnin një komuniteti konservativ hebrenjsh që jetonin në shkretëtirë. Braun në gojën e Teabing i quan ato “kujtimi më i hershëm i Krishtit”, në një kohë kur ato janë hebraike dhe para-kristiane, pasi shumica e kopjeve daton 150 vjet përpara Krishtit. Kjo nuk është dyshuar nga asnjë studiues dhe përfshihet në të gjitha enciklopeditë, nëse Dan Brauni do t'i kish bërë mirë kërkimet e tij. Gjithashtu, ato nuk u gjetën në vitet 1950, por në vitin 1947. E gjithë kjo është veçse një copë e vogël dhe e lërosur historie, në krahasim me pohimin se ato ishin “ungjij”. Fakti befasues është se Dan Braun-i nuk i korrigjoi këto gafa në intervistat e mëpasshme (cituar kryesisht nga Dr. Grenville Kent).

Për vite të tëra që, kur u gjetën pergamenet e Detit të Vdekur, zërat e kritikëve heshtën, ndërkohë që në vitin 2003, Dan Braun arriti të hapë edhe një herë temën e besueshmërisë, sigurisë dhe saktësisë së pergameneve të famshme të Detit të Vdekur. Edhe pse vetë Braun-i shkroi në fillimet e librit se libri është thjesht një prozë letrare artistike nga mënyra se si është shkruar dhe paraqitur, ai i jep shkas lexuesit ta harrojë atë çka po lexon dhe ta konsiderojë fantazinë si fakt. Kjo do të thotë se nga një prozë letrare artistike ai kthehet në një të vërtetë për shumicën e lexuesve, për të qenë intelektualisht dhe shpirtërisht shumë e rrezikshme. Le të zbulojmë ndërkaq disa nga të profecitë më marramëndëse të bëra nga Isaia dhe Danieli, që pohojnë sigurinë dhe besueshmërinë e shkrimeve të tyre.

Libri i profetit Isaia shpesh cilësohet si Ungjilli i Pestë, për arësye të profecive të përpikta rreth Mesisë (Krishtit), shërbëtarisë së Tij, vdekjes dhe mesazhit. Këto profeci janë disa nga 300 profecitë që

hasim në Dhiatën së Vjetër të cilat janë përmbushur detajësisht në jetën e Jezus Krishtit. Edhe vetë Jezusi kuptoi që Shkrimet e Shenjta flisnin për Të. “E përmes tyre Ai tha se se “këto janë fjalët që Unë thashë për ju, ndërsa isha mes jush, e se do të përmbushet gjithçka që është shkruar në Ligjin e Moisiut, të Profetëve dhe të Psalmeve, në lidhje me Mua (Luka 24:44). Le t’i përmendim disa nga këto profeci të plotësuara në detaj:

Vendlindja e Krishtit

“Por ti, o Betlem Efratah, megjithëse je i vogël midis mijërave të Judës, nga ti do të dalë për mua Ai që do të jetë sundues në Izrael, origjinat e të cilit janë nga kohërat e lashta, nga ditët e përjetësisë” (Mikea 5:2). Ky parashikim i famshëm është bërë rreth 700 vjet përpara Krishtit. S’bëhet fjalë vetëm për Bethlehemin, që do të thotë një fshat i vogël, por për Bethlehem Efratah. Askush tjetër përveç qytetit të Mbretit David. Aty duhej të lindte Krishti. E megjithatë, duhet të kujtojmë se, në qoftë se Krishti do të kish lindur vetëm pak orë më parë, profecia nuk do të përmbushej saktësisht. Nga të gjitha vendet, Krishti u lind në Palestinë. Nga të gjitha fshatrat e Palestinës, ai u lind në Bethlehem Efratah!

Lindja nga një virgjëreshë

Mateu 1:22-23. “E gjithë kjo ndodhi që të përmbushej fjala e Zotit, e thënë me anë të profetit që thotë: “Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t’i venë emrin Emanuel, që do të thotë: “Zoti me ne”. Isaia ishte profeti që parashikoi lindjen e mrekullueshme (hyjnore) të Krishtit pikërisht nga një virgjëreshë (Isaia 7:14).

Lindja nga fisi i Judës

Zanafilla 49:10: “Skeptri nuk do t’i hiqet Judës, as bastuni i komandimit nga këmbët e tij, deri sa të vijë Shilohu; dhe Atij do t’i binden popujt.”. Juda ishte breznia e mbretërisë dhe fisi udhëheqës i Izraelit. Nga kjo brezni do të vinte edhe Mbreti i Mbretërive. Është vërtet e jashtëzakonshme se si një mijëvjeçar e gjysëm më pas do të lindte Jezusi, jo përtej apo nga ndonjë fis tjetër, por pikërisht nga ai i Judës.

Paraardhësi i tij do të përgatisë rrugën

Isaia 40:3: “Zëri i dikujt që bërtet në shkretëtirë: “Shtroni udhën e Zotit, hapni në shkretëtirë një rrugë për Perëndinë tonë”. Pikërisht në këtë kohë profecia u përmbush te Gjon Pagëzori, i cili predikonte në shkretëtirën e Judesë, duke tërhequr turma ta mëdha njerëzish me mesazhin e vet të pendesës.

Profecitë në lidhje me fushën e shërbëtarisë

Isaia 9:1-2. ; “Por errësira nuk do të zgjasë gjithnjë mbi atë që tani është në ankth. Ashtu si në të kaluarën ai mbuloi me turp vendin e Zebulunit dhe vendin e Neftalit, kështu në të ardhmen do ta mbulojë me lavdi tokën pranë detit, matanë Jordanit, Galilenë e kombeve. Populli që ecte në terr pa një dritë të madhe; mbi ata që banonin në vendin e hijes së vdekjes doli një dritë.”. Çfarë profecie e mrekullueshme! Njerëzit përrreth Galilesë përfituan pjesën më të madhe të shërbëtarisë së Jezus Krishtit. Kur kaloi për pak kohë në Perea dhe Jeruzalem, shërbëtaria e Tij u përmbush në zonat e Zebulunit dhe Naftalit, që kufizojnë detin e Galilesë.

Hyrja triumfuese e Krishtit në Jeruzalem

Zekaria 9:9: “Ngazëllohu me të madhe, o bijë e Sionit, lësho britma gëzimi, o bijë e Jeruzalemit! Ja, Mbreti yt po të vjen; Ai është i drejtë dhe sjell shpëtimin, i përulur dhe i hipur mbi një gomar, mbi një gomar të ri”.

Tek Ungjilli i Mateut, kapitulli 21, tregohet se Krishti i pyeti dishepujt e Tij të shkonin e të merrnin një gomar të ri, që s’e kish kalëruar askush. Ai hipi mbi të, duke shkuar nëpër shtegun nga Bethania për tek Mali i Ullinjve. Ndërsa hyri me të në Jeruzalem, njerëzit e brohorisnin si mbretin e tyre, duke hedhur degë palmash për nder të Tij (shih Mateu 21:1-11).

I tradhtuar nga Juda

Psalmi 41:9 “Madje edhe miku im i ngushtë, tek i cili kisha besim dhe që hante bukën time, ka ngritur kundër meje thembrën e tij”. Mbreti David, nën frymëzim, dhe nga përjetimi personal, portretizon kështu tradhtimin e Krishtit. Ungjijtë thonë se ky mil i ngushtë i Krishtit the ishte Juda (Iskarioti) i cili e shiti dhe e tradhtoi Zotin. Vini re se madje edhe shuma monetare e shitjes profetizohet nga profeti Zekaria në Dhiatën e Vjetër.

Për tridhjetë aspra argjendi

Zekaria 11:12-13: “Unë ju thashë: Në se mendoni se kështu është më mirë, jepmani pagesën, por në se jo, mbajeni! Kështu ata më paguan 30 aspra argjendi”. Juda e shiti Krishtin pikërisht për 30 aspra argjendi dhe, pasi e breu ndërgjegjia, i flaku ato në këmbët e kryepriutit dhe shoqëruesve të tij. Ata s’mund t’i kthenin këto para në thesarin e tempullit, pasi ato ishin çmim gjaku. Për këtë arsye u përdorën më vonë për të blerë një oborr varreze ose një tokë poçerie.

Gjyqi dhe vdekja e Krishtit

Profecia më e madhe, në lidhje me vdekjen e Zotit tonë gjendet te Libri i profetit Isaia, kapitulli 53. I gjithë kapitulli parathotë gjyqin, agoninë dhe vdekjen e Zotit. “ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të...Ai i mbarti të gjitha mëkatet, që iu numëruan në vendin tonë”.

Këto janë disa pasazhe të thjeshta të parashikimeve që zbulojnë natyrën shpenguese dhe shpaguese të vdekjes së Krishtit. Kryqëzimi i Tij ishte një vrasje despotike; pa një gjyq korrekt, qoftë edhe sipas standardeve hebraike, lë më ato romake.

Ajo vdekje në Jeruzalem ishte për ju dhe për mua. S’ kemi pse të frikësohemi për të ardhmen, sepse Krishti vdiq që ne të jetojmë. Ai kreu atë vdekje, që na takonte neve, në mënyrë që ne të jetojmë këtë jetë që është e Tij. Mirëpo, ajo vdekje në Jeruzalem, atë të premtë, të 2000 vjetëve më parë, ishte një zëvendësim i vdekjes, që, na takonte me të drejtë neve. Rruga e shpëtimit nga kjo vdekje e përjetshme është përmes besimit te Jezu Krishti, si Biri i Perëndisë.

Ringjallja

Psalmi 16:10: “sepse Ti nuk do ta lësh shpirtin tim në Sheol dhe nuk do të lejosh që i Shenjti yt të shohë prishjen”. Krishti u ringrit triumfues nga varri, fitimtar mbi vdekjen, pa dyshim ngadhnjyes edhe ndaj mëkatit. Ai u pa nga rreth 500 njerëz njëherësh pas Ringjalljes e në disa raste të tjera në grupe më të vogla. (shih 1 Korintasve 15:4-6).

Ne përmendëm kështu disa nga profecitë e mrekullueshme në lidhje me Krishtin si Shpëtimtar. Ato janë veçse një pjesë nga ajo masë domethënëse prej 300 profecish që mbulojnë ardhjen e parë të Shpëtimtarit tonë.

Miq, po ju vallë ç’do të bëni me Krishtin e këtyre profecive? Është imperative që ta pranoni Atë jo vetëm si Krishtin, por edhe si Shpëtimtarin tuaj personal? Si shpërblim do të merrni prej Tij

përfitimet që Ai dëshiron t'ju japë përmes vdekjes dhe ringjalljes së Tij.

5. Si u shkruajt Bibla

Shkrimtari dhe historiani i madh britanik Sër Uolltër Skot (Sir Walter Scott) ishte në shtratin e vdekjes, kur i kërkoi dhëndërrit të tij t'i lexonte diçka. “Po nga cili libër”? e pyeti djaloshi. “Ka vetëm një libër”, i tha njeriu i madh. Ky libër i vetëm është fokusi i diskutimit tonë në këtë artikull. Bibla është i vetmi libër që lartohet mbi të gjithë të tjerët. Ke shumë pak vende ku ajo nuk është e disponueshme. Është botuar në më shumë gjuhë se çdo libër tjetër në botë.

Shkrimet e Shenjta janë të ndryshme nga librat e tjerë. Këta libra e shkrime përgjithësisht kanë një autor, ose të paktën janë shkruar përgjatë nga breza. Ndërkohë që Bibla u shkruajt nga të paktën 40 njerëz, për një periudhë prej 1500 vjetësh. Ajo jo vetëm që është shkruajtur në shekuj të ndryshëm, po edhe në vende të ndryshme e në tri gjuhë të ndryshme. Këto fakte përbëjnë edhe mrekullinë e Shkrimeve të Shenjta. Megjithë këto diferenca, Bibla përsëri zotëron një unitet në mesazhin dhe frymëzimin e saj, e cila mund të vijë vetëm prej Autorit hyjnor “që foli përmes profetëve”(2 Timoteut 3:16).

Bibla është ruajtur në mënyrë të mrekullueshme përgjatë shekujve. Përveç kohëve të shkatërrimit dhe korrupsionit, ajo mbijetoi për të qenë vërtet “Fjala e Zotit që jeton dhe mbetet përjetë”. Ajo vjen kryesisht nga shkrimtarët hebrenj, por është shumë më superiore se sa shkrimet e tjera, që shkrimtarë të pafrymëzuar kanë arritur të

prodhojnë, duke qenë shumë më lart se shkrimet e kombeve të tjera. Po edhe kështu, është e çuditshme që shumica e hebrenjve duket të jenë në një revoltë të pafundme kundër objektivave të këtyre shkrimeve. Ata parapëlqenin të përhapin stilin dhe mënyrën e jetesës së fqinjëve të tyre paganë, e herë pas here ngjanin të ishin diametralisht kundër frymës së Shkrimeve të tyre të shenjta. Një tjetër fakt i mrekullueshëm, rreth Biblës është se mesazhi i saj iu drejtohet të gjithë njerëzve të çdo kombi e moshe. Aq më tepër që ndikimi i këtyre Shkrimeve, në jetën e njerëzve është ndjerë në mbarë botën. Ky ndikim do të kish qenë akoma edhe më i madh, nëse njerëzit do ta lexonin e do të lejonin që Fryma e Shenjtë të ndryshonte jetët e tyre. Do të siguronin më shumë paqe ndërkohë që një stil i shëndetshëm jetese (i promovuar nga Bibla) do të gëzonte çdo kënd. Të krishterët besojnë dhe e kuptojnë se Shkrimet e Shenjta kanë qenë së pari në mendjen e Zotit në përjetësi, për t'u përcjellë në mendjet e njerëzve përmes profetëve. Zoti nuk i diktoi përpikmërisht (çdo gërmë, pikë e presje) fjalët e këtyre Shkrimeve, me përjashtim të Dhjetë Urdhërimeve (Eksodi 20). Ai vendosi mendimet e Shkrimeve të Shenjta në mendjet e shkrimtarëve, të cilët përcollën mendjen e Perëndisë në gjuhën e tyre. Zoti e mbikqyri shkrimin, kopjimin e pastaj botimin, e ato qenë vërtet Fjalët e Tij për njeriun. Ndërsa përkthimet në gjuhë të tjera janë bërë nga njerëz të gabueshëm, Zoti i ka udhëhequr ata mrekullisht, në mënyrë që ne sot të kemi fjalën e mrekullueshme të Perëndisë: Biblën.

Le të analizojmë disa nga njerëzit që kanë kopjuar Shkrimet e Shenjta. Në kohën e Dhjatës së Vjetër ekzistonin shkruesat ose mazoretët që kishin një respekt të jashtëzakonshëm, për çdo gërmë të kësaj Fjale. Ata e shihnin atë si fjalën e Perëndisë. Njihet se ata i numëronin gërmat, përpara se të nisnin kopjimin, duke e kryer këtë numërim edhe kur ajo përfundonte. Ata e dinin me përpikmëri, se sa fjalë kishte Dhjata e Vjetër. Ata dinin edhe fjalën e mesit të të gjithë librit, apo të një kapitulli të vetëm, bashkë me shumë informacione të tilla. Asnjë fshirje nuk lejohej, nëse zbuloheshin gabime. Shkrimet

shkatërroheshin në çdo rast gabimi dhe fillonin nga fillimi. Kjo solli një shkallë të admirueshme saktësie duke i bërë Shkrimet e Shenjta shumë të vlefshme e sipas të gjitha gjasave, kjo kontribuoi në ruajtjen e rrallë që iu bë përgjatë shekujve.

E njëjta shkallë saktësie u tregua edhe në kohët e Dhiatës së Re. Tekstet e Shenjta u rikopjuan nga transkriptuesit. Ato u kopjuan nëpër manastire, kolegje, pallate, kisha apo dhe në shtëpitë e priftërinjve. Kishte shkruar në gjuhën greke, latine, armeniane, etiopike, sahidike, persiane, sllavonike, koptike, siriane e shumë gjuhë të tjera. Natyrisht ato u kopjuan në një numër të ndryshëm vendesh. Por vetëm në tri shekujt e fundit u bë e mundur të transkriboheshin përkthimet e ndryshme. U bënë të njohura diferencat në shqiptimin e fjalëve dhe në disa fraza, por jo ndryshime në kuptimin thelbësor në kuptimin e çdo vargu. Kjo është vërtet një arritje madhështore, e kujdesur, natyrisht nga lart, nga një mrekulli hyjnore.

Ne do të përmendim vetëm diçka nga historia e konflikteve që kanë përndjekur Shkrimet e Shenjta. Në ditët e Dhiatës së Vjetër, ato u bënë subjekt i robërisë së babilonasve, po njëllor siç mbetën hedhurina që nga kohët e filistinëve dhe seleucidëve. Në epokën e krishterë, përndjekjet e Perandorisë Romake, kundra të krishterëve përgjatë shekujve të parë, herë pas here vunë në dyshim edhe vetë ekzistencën e këtyre Shkrimeve, duke rrezikuar zhdukjen e tyre. Nga shekulli i 7-të deri në shekullin e 9-të, libra të rremë, legjenda e dekriftime u shumëfishuan ngado në kundërshti me kanonet e Shkrimit të Shenjtë.

Pastaj analfabetizmi i shekujve X dhe XI, ku edhe princërit mezi arrinin të lexonin, bëri që ato pothuajse ta humbnin rëndësinë e tyre. Në disa vende evropiane, gjatë shekujve XII dhe XIV, përdorimi i Shkrimeve të Shenjta në citate dënohej me vdekje. Këto janë disa nga faktet e jashtëzakonshme që lidhen me historinë e Fjalës së Perëndisë. Po sipas Profecive së Tij, asgjë nuk do ta tjetërsonte kontekstin e Fjalës së dhënë njëherë e përgjithmonë ndaj profetëve.

Kjo pohohet gjithashtu edhe nga zbulimi i pergamenave të Detit të Vdekur në vitet 1946/47.

Le të trajtojmë disa nga tekstet e Shkrimeve e të shohim se si ato e përshkruajnë paraqitjen dhe ruajtjen e Fjalës së Zotit. Disa ngjarje historike janë ruajtur nëpër libra që të ishin një memorial. Vëreni Eksodin 17:14 ku Moisiut i thuhet të shkruajë për kujtim një libër për mposhtjen e amalekitëve. Më pas Tek Numrat 33:2, Moisiu urdhërohet të hedhë në letër pikat filluese të rrugëtimit të bijëve të Izraelit. Te Jozueu 24:26, udhëheqësi i ri Izraelit, Jozueu, kujton në një libër marrëveshjen që Izraeli bëri me Zotin për t'i qëndruar Atij besnik, për gjithë mëshirën që kish dhuruar për ta. Samueli shtoi një libër në 1 Samuelit 10:25, edhe shumë të tjerë dhanë kontributin e tyre, të tillë si, Jeremia, (Jeremia 36:2) dhe Danieli (Danieli 9:2).

Besohet se ishte shkruesi Ezra ai që i përmblodhi shkrimet e plota të epokës së Dhiatës së Vjetër, dikur pas periudhës së robërisë së hebrenjve në Babiloni. Ju mund të thoni, po si mund të dimë me siguri se 39 librat që përfshijnë sot Dhiatën e Vjetër, janë të njëjtit libra që u përdorën nga hebrenjtë përpara Krishtit? Jezusi vetë tha se “Shkrimet e Shenjta nuk mund të shprishen”. Kur Ai foli me një rëzit përgjatë rrugës për në Emaus pas ringjalljes, Luka tha: “Duke filluar nga Moisiu e të gjithë profetëve të tjerë, Ai u parashtroi në të gjitha Shkrimet e Shenjta gjëra që kishin të bënin me Të”. Këto janë fjalët që iu thashë, kur isha ende mes jush, ashtu siç do të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar në ligjin e Moisiut e të profetëve, dhe në atë të Psalmeve, në lidhje me Mua”.

Ndarja antike e Shkrimeve nga ana e Hebrenjve, ishte si më poshtë:

Ligji

Profetët

Hagjiografia (Psalmet dhe disa libra të tjerë)

Në librin e tij të njohur “Historia e Antikitetit” faqe 216, Jozefusi, i cili jetoi dhe e shkroi historinë e tij rreth 400 vjet pas vdekjes së

Krishtit, thekson këto fjalë : “Ne nuk zotërojmë një masë të panumërt librash që kanë mospërputhje apo kundërshti në mes tyre (siç kanë grekët), por vetëm 22 libra që përmbajnë gjithë historinë e kohëve të shkuara: ata me të dejtë besohen të jenë hyjnorë dhe nga këta 5 i përkasin Moisiut... Profetët, që erdhën pas Moisiut, shkruan atë çfarë u bë në kohën e tyre në 13 libra. Katër librat që mbeten, përmbajnë himne kushtuar Zotit”.

Jozefi, një shkrimtar hebre, i huajtur nga romakët në kohën e rënies së Jeruzalemit në vitet 70, p.K. thotë se janë gjithsej 22 libra. Po si është e mundur që ne kemi 39? Kjo ndodh thjesht pse hebrenjtë i sistemojnë dhe i rendisin në mënyrë të ndryshme këto libra nga versionin anglez. Le të bëjmë një tabelë të vogël.

HEBRENJTË		VERSIONI ANGLEZ
5	LIBRAT E MOZEUT	5
8	PROFETËT	21
9	PSALMET DHE SHKRIMET E TJETRA	13

Le të shpjegojmë, së pari, se ku qëndron diferenca te librat e profetëve. Hebrenjtë klasifikojnë Librat e Jozueut, Gjyqtarëve, Samuelit dhe Mbretërit si 4 profetët e përpamë. Menjëherë mund të vërehet se sot Samueli dhe Mbretërit janë të ndarë në 2 libra secili. Pra, në vend të 4 janë bërë 6 libra.

Përsa i përket profetëve të mëtejshëm, hebrenjtë kishin 4 të tillë, Isaia, Jeremia, Ezekieli dhe 12 profetë më të vegjël që nga Hosea deri te Malaki që klasifikohen si një libër i vetëm. Pra, në vend të katër, ata janë 15 libra. Po t’u shtohen këtyre dhe 6 librat e parë, na del numri 21, pra njësoj me versionin anglez.

Tani le të trajtojmë Psalmet, që hebrenjtë i përmbledhin në 9 libra.

Ezra dhe Nehemia, të përfshirë në këtë listë, përlllogariten si një libër. Kronikat i trajtojnë si një, në një kohë, kur ne kemi 2 libra për secilin. Pjesa tjetër e librave, Psalmet, Fjalët e Urta, Jobi, Kënga e Solomonit,

Ruthi, Vajtimet, Predikuesi, Esteri dhe Danieli, e shpiten totalin në 13 libra.

Nëse do t'i përmbledhim të gjithë librat, atëherë do të marrim në totalin e përgjithshëm plot 39 libra, ashtu siç i njohim sot. Hebrenjtë kishin 22 libra, por ne sot kemi të njëjtët libra të ndarë në 39 të tillë. Ju mund të pyesni edhe pse Danieli është i përfshirë te Psalmet dhe jo te Profetët, pasi ai ishte njëri nga Profetët më të spikatur. Ndoshta arsyeja kryesore ishte se disa nga veprat e tij kishin natyrë historike dhe u konsideruan si të kësaj fushe. Shumë nga librat e Dhjatës së Vjetër, të përmendur këtu, janë cituar në librat e Dhjatës së Re.

Disa mund të pyesin për librat apokrife. Kjo është një seri librash që padyshim, shtrihen gjer në kohën e apostujve, e shumica prej tyre janë shkruar gjatë periudhës, midis dy Dhjatave. Ato nuk referohen kurrë nga Jezusi apo nga apostujt. Ato nuk konsiderohen si shkrime të shenjta, as edhe nga vetë hebrenjtë. Ato nuk u konsideruan të tillë as nga kisha e hershme e krishterë, e kësaj nuk mund të konsiderohen të jenë pjesë e kanonit të Shkrimeve të Shenjta në ditët e sotme. Në çdo rast, shkrimet apokrife nuk citohen brenda tyre si pjesë e Shkrimeve të shenjta, as ne nuk zotërojmë kurrëfarë dëshmie që ato t'i atribuohen veprës së Frymës së Shenjtë. Gjithsesi, pjesa më e madhe e tyre janë histori të detajuara.

Dhjata e Re përmban 433 citime drejtpërdrejt nga Dhjata e Vjetër. 30 nga 39 librat e Dhjatës së vjetër citohen drejtpërdrejt. Edhe numrat e citimeve duken të jenë të përafërta. 144 citime janë nga Pentateuchi (nga greqishtja e vjetër, pesëshja e librave të Moisiut - pra pesë librat e parë të Biblës), 148 nga profetët dhe 141 nga hagiografia. Duhet theksuar se nuk ka pasur asnjë autoritet, të ndonjë koncili kishtar që u ka dhënë autorësinë Shkrimeve të Shenjta. Ato e kanë pasur këtë autoritet që në ditën e parë, kur u shkruan dhe u pranuan si të tilla edhe nga kisha e parë e krishterë. Shkrimet e Shenjta zotërojnë atë autoritet të brendshëm, që “mëson Fryma e Shenjtë” (1 Korintasve 2:13). Askush s' kishte, as ka, autoritetin të heqë apo të shtojë diçka në Shkrimet e Shenjta. (Zbulesa 22: 18,19).

Kësisoj Bibla nuk është një përmbledhje e autorizuar librash, por një përmbledhje librash të autorizuar. Shumë versione dhe përkthime të shkrimeve kanë ardhur deri te ne që nga kohët e hershme. Siç e përmenda që në fillim të këtij pasazhi, uniteti i gjendur në këto versione dhe përkthime është i mrekullueshëm. Pergamenave të Detit të Vdekur i shtuan edhe 1000 vjet dorëshkrimeve më të vjetra që ishin gjetur para vitit 1946. Këto gjetje ndihmuan të pohojnë saktësinë e Fjalës së Shenjtë, duke pohuar gjithashtu se, si Isaia ashtu edhe Danieli, kanë jetuar përpara Krishtit. Deri në kohën e këtyre gjetjeve, shumë kritikë i kane datuar këta dy libra pas kohës së Krishtit, kryesisht se ata përmbanin profeci përreth Tij. Isaia shpesh është referuar si “Ungjilli i Pestë”, por pergamenet e Detit të Vdekur arritën të bindnin shumë dëshmitarë për saktësinë e profecisë së Biblës.

Unë besoj, se ju lexues të dashur, do të jetoni për këtë fjalë, ashtu siç kanë bërë shumë të tjerë përpara jush. Lejojeni dritën dhe të vërtetën e saj t’u zhvellojnë rrugën ku do të shkoni. Që mendja juaj t’i vijë pas, studiojini ato t’ju pasurojnë gjithë jetën e t’iu përgatisin për jetën që do të vijë. Duke studiuar, njihje edhe Autorin e vërtetë, duke e lejuar Atë të bëhet pjesë e jetesës suaj të përditshme dhe Shpëtimtari i jetës suaj.

6 . Misteret e Lindjes pushtojnë Perëndimin

Njerëzimi ka qenë për mijëra vjet në kërkim. Ai kishte frikëra që duhej të fashiteshin, dëshirime për t’u kënaqur dhe një kuriozje për dijen e jetës përtej varrit. Një jetë e paqte e çliruar nga terrori i luftës,

sëmundjes dhe vdekjes, do të kishte qenë iluzore. A ekziston diçka jashtë njeriut që mund të sjellë këtë paqë?

Grupi “Beatles” popullarizoi interesin modern në filozofit e Lindjes. Nga ky interes nisën të vinin guru nga India, bashkë me Meditimin Transhendental. Në po të njëjtën kohë, Hippitë “u rritën si kërpudhërat pas shiut pranveror”. Ata qenë të lodhur nga një jetë pa kuptim. Ata u rebeluan kundra disiplinave të edukimit. Ishte koha për një jetë më të lirë. Po gjithësesi, ata ishin “në kërkim”. Menduan se kishin arritur më në fund te “Utopia” nëpërmjet përdorimit të marihuanës dhe drogërave të tjera më të rënda. Këto i jepnin një kuptim lirisë, paqes dhe zbavitjes si asgjë tjetër më parë. Dukeshin të ndihmonin njerëzit të harronin të keqen e të përjetonin të mirën. Si Eva në kopshtin e Edenit, ata besonin se mund t’i shtrinin dijet dhe njohuritë e tyre. Ata mund t’i shtonin përvojës së tyre “Utopike” edhe marrjen e drogave të paligjshme.

Megjithatë, problemet e njerëzimit ishin shumë më të thella. Ashtu si komunistët që besonin se kishin përgjigjen për nevojat e njeriut dhe kërkimin e tij për diçka më të mirë, po kështu edhe Hippitë nuk e kuptonin gjendjen e vërtetë njerëzore. Njeriu, në mëkat, ka një gjendje të njohur si “shthurja totale”. Kjo do të thotë se tërësia e njeriut është mëkatore. Madje, edhe vetë Hipitë u tronditën, kur e panë Utopinë e tyre të përfundonte në përdhunime, vrasje e sëmundje.

Kishte dhe zëra të tjerë që synonin të sundonin mendimin dhe drejtimin njerëzor. Këta zëra bërtisnin “Zoti vdiq”. A ishte përçarë e shkatërruar vallë, besimi në Zot? Hippitë kishin diçka përbrenda- një uri për diçka- që kapërcente (në mënyrë transcendentale) nivelin e njohjes dhe përvojës njerëzore. Arsyetonin se diçka e tillë nuk mund të gjehej në Perëndim. Ata e eksperimentuan, si Beatles-at, duke udhëtuar drejt Lindjes. Ah, pikërisht, ky kërkim për një jetë më të mirë i drejtoi ata kah Lindjes!

Pothuajse të harruarat “shenja të zodiakut” dalin përsëri në sipërfaqe. Astrologjia, e njohur aq gjatë në Lindje, së bashku me metafizikën e

Lindjes, u bënë përsëri tërheqëse. Të moçmit e Europës dhe lindjes së Mesme kanë ngritur monumente që i drejtoheshin diellit, planetëve dhe yjeve, si mjaft të rëndësishëm për njerëzimin. Monumente megalitikë, si Stonehedge, apo dhe qarkore të tjera gurësh në Angli e të tilla në Francë dhe vende të tjera të Europës, na sjellin nëpër mend se antikët e shihnin diellin si një perëndi të bekimit, e ndonjëherë edhe si perëndi e mallkimit. Dielli dukej i nevojshëm për rritjen e bimëve, por edhe për ngrohtësinë e shëndetin. Ndaj ishte i domosdoshëm që të nderohej, pasi mund të inatosej! Kuptohet kësisoj, se astrologjia (e rastësisht astronomia) ndërthurej me kujdes me fenë.

Le të kthehemi për pak çaste te Beatles-at. Ata u ndërfutën në meditimet e Guru-ve të hinduizmit. Muzika e tyre rok dhe Hinduizmi ngjanin çuditërisht të pajtueshme. Por kishte edhe gjëra të tjera, që binin në kundërshti. Në fenë e Lindjes, dukej të mos kishte kurrëfarë fajësie apo dënim për një gabim të së shkuarës. Në fakt, pati edhe kriminelë që u bënë njerëz të Shenjtë, për të shmangur ligjet e vendeve, ku jetonin Guru-të e Lindjes. Deri në këtë pikë, qenë të gabuara edhe ndjenjat e fajit. Ekzistonin gjithashtu, edhe interesa lakmitare e përfituese. Të ngjashëm me filozofët e priftërinjtë antikë të Babilonisë, Guru-të mësonin rëndësinë e shpëtimit, falë veprave të kryera.

Mirëpo ju s'do të bënit asgjë ose s'do të ishit asgjë, në se do të dëshironit të vepronit kështu. Qenia ka nevojë të ngazëlletet. Në realitet, e gjitha kjo i ngjante një kopje të vërtetë të Humanizmit të shekujve 15-të deri 18-të, por e rikthyer tashmë në një shije tjetër. Kishte dy besime kryesore në Persinë e lashtë, Zoroastrianizmi dhe Mithraizmi. Ndërsa që të dy i drejtonin nderimet e tyre kah fuqive të Zotit Diell, që të dy e shpallnin qenien individuale si të përgjegjshme për vepra të caktuara që mund të sillnin përfitime të veçanta falë zotave të tyre.

Perëndimi kishte popullarizuar urgjencën morale, kur ishte më e rëndësishme që ai të qe i drejtë me Zotin. Faji dhe mëkati nuk mund

të transformoheshin nga veprat e njerëzve me faj. Ishte kjo ndjenjë, ndoshta më shumë se të gjitha të tjerat, ajo që popullarizuan Beatles-at. Muzika e albumeve të tyre ndryshoi gati dramatikisht. Më 1965 Xhorxh Harrison shkoi ne Indi. Studioi muzikë me Ravi Shankar, dhe është më se e qartë, se ai do t'i ketë ngulitur disa nga konceptet fetare hinduiste. Xhorxhi kishte një simbol dielli të pikturuar në çatinë e makinës së vet. Nderimi lindor për diellin, po zvarritej edhe në Perëndim. Akoma dhe më e efektshme në këtë drejtim qe muzika që sollën albumet e Beatles-ave. Me siguri që nuk dëgjoheshin në to rrëketë e muzikës së vjetër 2000 vjeçare të lindjes, por këngë të tilla, si: “Në kërkim të kordës së humbur” dhe “Ne të gjithë jemi në kërkim të dikujt” , e pohojnë gjithë këtë të vërtetë. Kërkimi për siguri, shpresë dhe njohje nuk përfundoi me pushtimin lindor që promovuan Beatles-at.

Gurutë shpjegonin se Meditimi Transhendental (M.T.) lindor është rruga kah sigurisë. Xhon Lenon shpallte se “Ne po shkojmë të përdorim gjithë fuqinë që kemi në shpërhapjen e meditimit”. Njeriu i Shenjtë nga Lindja Maharishi Mahesh Yogi dhe Meditimi Trashendental tashmë u bënë sinonime. Ashtu siç raportonte revista “Time” (13 tetor 1975)...”ndoshta fakti më domethënës mbi marrëzinë e Meditimit Trashendental është se ... ai këshillon një uri “të natyrshme” dhe të vërtetë për “përvojat fetare dhe mistike”. Klubet e M.T. u shpërhapën kudo nëpër botën perëndimore, mandje edhe në rangjet e forcave të armatosura të disa vendeve. Nuk flitet shumë për to sot, edhe pse M.T praktikohet nga një numër i caktuar të devotshmish. Nëpërmjet M.T. një person mund të ndihet i lirë nga faj, nga e keqja e të bëhet më i fortë në vetvete. Yoga, karateja dhe disa forma të tjera ushtrimesh, u bënë një pjesë e jetës së Lindjes që po pushtonte Perëndimin, por pak nga këta pjesëmarrës në Perëndim i kuptonin lidhjet fetare në këto forma ushtrimore.

Maharishi Mahesh Yogi u ndoq shpejt nga disa Guru të tjerë në Lindje, që kishin mësuar rrëmbithi se të qenit një Guru të sillte edhe mjaft përfitime materiale. Pasuria e Guruve u rrit shumë e po kështu

edhe numri i njerëzve që lidheshin me ta. Veçanërisht të rinjtë ishin ata që frekuentonin rangjet e Guruve, në rrugëtimin e tyre në kërkim të lirisë nga faji dhe shpresës se në fund do të arrinin tek utopia “iluzore”. Ky kërkim solli mjaft përshtjellim në botën perëndimore. Shoqëritë e sotme shekullore, duke përfshirë edhe Hippetë, i përkasin kësaj ere të mbizotërimit të një pështjellimi të brendshëm. Shoqëritë shekullore, në përgjithësi, nuk e hedhin poshtë Zotin, por as edhe e pranojnë Atë. Shprehet shpesh idea se ndoshta Zoti nuk ekziston aspak. Gjithsesi, në shumicën e rasteve mundësia lihet e hapur.

Duke folur për ditët e fundit Isaia 2:6, thotë “Ju i keni braktisur njerëzit tuaj, bashkë me shtëpinë e Jakobit. Ato janë dendur plot me supersticione nga Lindja; ata e praktikojnë këtë hyjnizim njëloj si filistinët dhe rrokin duart me paganët”. Ashtu siç paratha Isaia, era moderne njohu futjen e filozofive dhe besimeve të lindjes, duke përfshirë spiritualizmin, astrologjinë, rimishërimin dhe marrjen e drogave të paligjshme.

Interesi për rimishërimin sot është një fenomen real. Disa nga besimet këshillojnë që personat që vuajnë duhet të lejohen të vuajnë, përndryshe atyre do t’u duhet të vuajnë përsëri në jetën tjetër. Mësuesit e Karmas shpjegojnë se ajo çfarë i ndodh sot një personi, është ajo çfarë i ka ndodhur atij në jetën e mëparshme. Ndaj, është e rëndësishme ta ndihmosh vetveten përtej vullnetit të çdokujt tjetër. Njerëzimi s’është në të vërtetë më i rëndësishëm edhe se mizat. Ndaj, ruajini të gjitha qeniet e gjalla, sepse ju ndoshta mund të keqtrajtoni një tjetër qenie njerëzore në atë fazë të ekzistencës së vet. Jeta nuk është kështoj përjashtimisht e rëndësishme. Torturat mund t’i bëjnë një favor të torturuarit. Atij mund t’i shkojë mbarë në jetën tjetër!

Ndoshta këto ide nuk janë zhdukur në mes të fanatikëve vetëfshikullues të Filipinëve. Sa herë që festohen Pashkët në shumë vende të Filipineve e në disa pjesë të Spanjës, ka njerëz që dalin vullnetarë për t’u prerë me xham në kurriz apo me thikë. Pastaj ata e fshikullojnë veten me 9 thupra të lidhura në fund të një filli. Kjo gjë e

mban vazhdimisht gjakun në rrjedhje, ndërsa njerëzit i drejtohen një altari të Shën Mërisë në një vend të hapur ose në kishë. Me të arritur aty, ata shtrihen për tokë që të ndenjurat e tyre të rrihen me një rrip e pastaj plagët të lahen me një solucion kriprash. Disa të tjerë përdorin edhe detin për të larë plagët. Kjo përvojë përsëritet vetëm pas një viti, në kremtimet e tjera. Po pse vallë, e bëjnë një gjë të tillë? Me njerin që fola më tregoi se e bënte këtë gjë prej 32 vjetësh me shpresën se kjo do t'i ndihmonte prindërit e tij të mjekoheshin nga reumatizma. Kurse një djalë tjetër ndjente se Zoti do të kënaqej, nëse ai vepronte kështu. Ky ishte viti i tij i dytë. Ai e dëshironte shpëtimin dhe kjo me doemos që do ta ndihmonte atë, më tha.

Nëse dikush do të donte të trajtonte fenë antike Hittite, Kanaanite, Budizmin modern dhe Hinduizmin, ngjashmëritë e vërejtura do të jenë interesante. Që të përfitojnë shpërblesën e zotave ose Zotit të Qiellit, njerëzit duhet të sillen e të veprojnë në një mënyrë të caktuar, që në fund të fitojnë përjetësinë. Nëse dikush do të ketë një jetë të përjetshme të sukseshme, ai duhet të punojë për këtë gjë në këtë jetë. Le t' hedhim një sy fillimit të atyre çështjeve që trajtuam në fillim të këtij kapitulli. A janë të reja këto ide? Nëse jo, ku e kanë zanafillën?

Në histori dhe në Bibël mbretëritë e vjetra dhe qyteti i Babilonisë dhanë pjesën më të madhe të kontributit. Babilonia ishte pothuajse në kundërshti me Jeruzalemin. Priftërinjtë e Babilonisë vepronin në mënyrë të ndryshme me shërbyesit e Zotit. Diferenca më e rëndësishme dhe më themelore gjendej në fushën e sjelljeve dhe veprave të njeriut.

Në Babiloni, një njeri duhet të bënte veprime të caktuara për t'i bërë të lumtur zotat e tij të shqetësuar. Shpëtimi dhe jeta e pëртејshme i dhuroheshin vetëm atij njeriu, sjellja dhe veprimet e të cilit i kënaqnin zotat. Kurse Jeruzalemi dhe njerëzit e tij besonin në drejtësinë që vjen nga besimi te Zoti dhe jo te veprat njerëzore. Krishtërimi e bëri shumë të qartë një gjë të tillë.

Babilonia sillte Zotin më afër njeriut, në vend që njeriun ta lartësonte te Zoti. Në Babiloni, njeriu shpresonte që një ditë, falë sjelljes dhe

veprimeve të tij të fitonte parajsën. Ai gjendej gjithmonë në kërkim dhe i trysnuar gjatë këtij kërkimi, pasi atij i duhej të mbështetej vetëm në veprat e veta. Ai s'mund ta dinte kurrë nëse kishte bërë mjaftueshëm për të kënaqur Zotin. Po kështu s' mund të dinte, në se të gjitha ato që bënte, qenë të drejta dhe të pranueshme. Ai qëndronte me durim e shpresonte se Zoti ose zotat do ta vërenin këtë gjë.

A mund të themi tani me siguri se po ndjekim rrugën e drejtë ose po lëvizim në drejtimin e duhur, kur ndjekim udhën e Shkrimeve të Shenjta në vend të sistemit të Babilonisë?

Ekziston një diferencë e madhe! Krishtërimi lartoi njeriun te Zoti. Një i krishterë beson se vetëm duke pasur një besim të thjeshtë te Zoti dhe Biri i Tij Jezu Krishti, ai mund të ketë jetë të pëртеjshme. Çdo vepër e mirë që bën, është rezultat i këtij besimi ose shkak i besimit të tij te Krishti. Ky besim gjendet në dashurinë e Zotit, e cila është e pakushtëzuar, e pashtershme dhe e përjetshme. Ajo s' mund të shuhet, sepse vjen nga Zoti. Jeta që i përket Zotit i është dhënë njeriut si dhuratë, në rastin kur ai rrëfëhet dhe i falen mëkatet, falë fuqive të Zotit. Zoti dëshiron të ketë komunikim me njeriun e dëshiron ta ndihmojë atë vazhdimisht në shtegun e vet të jetës. Dashuria gjendet jo vetëm në fillimin e përvojës së krishterë, për në gjithë udhën e kësaj përvoje, kur ajo i drejtohet Krishtit.

Shtrohet shpesh pyetja: “Ç'mund të themi për Epokën e Re?” Ne duket sikur jemi zgjuar një mëngjes dhe dëgjojmë të flitet për Epokën e Re. Që nga ky moment librat, revistat, muzikat dhe sistemet e besimit kanë shumëfishuar shprehjen e një besimi të fortë në Epokën e Re.

Nëpër tregje, janë shitur kristale, pasi njerëzit besonin se ato do të luanin një rol të madh në jetën e tyre dhe në shpëtimin e ardhshëm. Nëpër disa dyqane muzike, 1/3 e prodhimeve muzikore quhen muzikë e Epokës së Re. Ato promovojnë spiritualizmin dhe mishërimin. Bibla nuk e bën një gjë të tillë. Zoti është kundër të

gjitha llojeve të supozuara të komunikimit me të vdekurit. Vëreni një dyshe tekstesh të cituara:

1 Timoti, 4:1; Shpirti qartësisht thotë se në kohët e ardhshme do të ketë njerëz që do ta braktisin shpëtimin dhe do të ndjekin shpirtra mashtrues dhe gjëra të mësuara nga demonët.

Zbulesa 16:14; do ekzistojnë shpirtra demonësh që do të përmbushin shenja të mrekullueshme, e do të shkojnë nëpër mbretërit e të gjithë botës, për t'i mbledhur ata në betejën e Ditës së madhe të Zotit të Madhërishëm

Spiritualizmi dhe demonizmi janë padyshim kundra Krishtit dhe Ungjillit. Ata e vënë theksin te njeriu dhe veprat e tij, duke injoruar veprat e Krishtit për shpëtimin.

Cila është diferenca midis Epokës së Re dhe Krishterimit? Epoka e Re flet për Satanain që punon me Krishtin në një lloj akordi paqeje. Gjarpri është gjithashtu e më shumë pjesë e Zotit dhe Krishtit. Ata janë parë të punojnë së bashku. Mirëpo Zoti nuk mund të punojë me Satanain. Satanai e ndau veten nga Zoti dhe krijimi i planetëve të tij, duke e cakëzuar veten në tokë. Në çdo detaj ai është duke punuar kundra Zotit dhe së vërtetës së Tij. Epoka e Re është shumë më tepër një fe Satanike, që ngre lart qenien dhe promovon Djallin si qenie përkujdesëse dhe të admirueshme.

Apostulli Pal do të thoshte : “Jo unë, por Krishti jeton te unë”. Në këto ditë të fundit është e rëndësishme që njerëzit të ndjekin Krishtin dhe jo besimet satanike të Epokës së Re. Këto janë kohët, kur ne duhet të ndjekim vetën Krishtin e të vërtetën e Tij. Atëherë dhe vetëm atëherë do të vijë fundi i kërimit të paqes dhe qetësisë, në të cilën duhet të jetë angazhuar së fundi shumica e planetit.

Miq! Jezusi kërkon që t'iu japë një mundësi në jetën tuaj. Ai tha: “Unë jam rruga e vërteta dhe jeta”. Po, besojeni Atë. Ai është përgjigjia. Pranojeni Atë, lëreni t' ju pushtojë jetën e t'ju japë sigurinë e jetës së përjetshme dhe paqen, që t'i shijoni menjëherë!

7. Lindja në Bethlehem - vdekja në Jeruzalem

Në kapitullin katër, ne i trajtuam disa nga këto çështje, por le të hedhim një shikim shqyrtues mbi disa nga profecitë më magjepsëse që lidhen me ardhjen e parë të Krishtit. Jo larg nga vendi, ku lumi Jordan derdhet në Detin e Vdekur gjenden rrënojat e Manastirit të Qumramit. Për shumë shekuj kjo zonë nuk vizitohej nga njeri, përveçse ndonjë beduini të përhumbur. Ishin dy të tillë që, duke ndjekur tufat e tyre në vegjetacionin e rrallë të zonës, ranë në gjurmë të “pergamenave të Detit të Vdekur”, siç quhen ata sot.

Një botë e tërë e ngazëlyer në vitin 1947 dhe 1948, priti përkthimin e këtyre dorëshkrimeve antike, që qenë shkruar një shekull ose dy përpara Krishtit. Këto janë sot dorëshkrimet më të vjetra të disa prej Shkrimeve të shenjta. Për shembull, Libri i Isaia, besohet nga shumica, të ishte më tepër historik, se sa profetik. Arsyeja ishte se shumë nga profecitë e tij të detajuara e portretizonin Mesinë në shumë nga aktivitetet e Tij. Kritikët për një shekull apo më shumë u shpejtuan të nxirrnin në pah rolin historik të librit më tepër se sa rolin profetik.

Të krishterët u ngazëllyen të mësonin se midis pergamenave të Detit të Vdekur, ishin zbuluar të gjithë librat e Isaia. Penat dhe zërat e kritikëve u heshtën edhe një herë. Ky libër i mrekullueshëm shpesh është quajtur si Ungjilli i pestë, për parashikimet e përpíkta mbi Mesinë, shërbëstarinë e Tij, vdekjen dhe mesazhin. Parashikimet janë gjithsej 300 nga Dhjata e Vjetër, që janë përmbushur plotësisht me jetën e Krishtit. Jezusi vetë tha se Ligji, Psalmet dhe Profetët flasin për Të. Le të trajtojmë disa nga këto parashikime:

Vendlindja e Krishtit

Micah 5:2: ““Por ti, Bethelëm Ephratah, edhe pse aq i vogël mes fiseve Judah, do të sjellësh prej gjirit tënd, Atë që do të bëhet

sundimtari i Izraelit, rraca e të cilit vjen prej lashtësisë, prej përjetësisë” . Rreth 700 vjet përpara Krishtit është bërë ky parashikim i mrekullueshëm. Sot Bethlehem vizitohet nga qindra mijëra njerëz çdo vit. Ne mund të shohim edhe grupime të tjera fetare si Hinduistët dhe Taoistët të vizitojnë vendin ku nëna e Konstantinit, Helena, ndjeu të qe vendi, ku pat lindur Krishti. Aty pranë ju mund të vizitoni fushat e barinjve, aty ku engjëjt vizituan barinjtë dhe i shpallën lindjen e Krishtit.

Po, ky është Bethlehem Ephrathah, i shpallur nga Micah, 700 vjet përpara kësaj ngjarjeje. Nga 300 parashikimet e ardhjes së parë të Krishtit në Dhjatën e Vjetër, ky është sipas të gjitha gjasave, më i sakti dhe më i qarti i të gjitha parashikimeve. Ne do të trajtojmë edhe shumë parashikime të tjera, që lidhen me Jezusin, por le të vijojmë tani me skenën përmbyllëse të shërbëtarisë së Tij.

Hyrja triumfale e Krishtit në Jeruzalem

Zekaria 9:9: “Gëzohu madhërishëm, o bijë e Zionit! Brit nga gëzimi, bija e Izraelit! Shikoje, mbreti po vjen te ti, i drejtë dhe me shpëtimin mbi krye, i hijshëm dhe i hipur mbi një gomar, mbi një gomaricë”.

Në dramën e Pasionit të Oberammergaut, paraqitja fillon me hyrjen triumfale të Krishtit në Jeruzalem. Termi i saktë “E diela e Palmave”, i përdorur nga një numër i madh besimesh të krishtera, vjen nga përmbyllja e profecisë së Zekarias, bërë 500 vjet përpara se ajo të ndodhte.

Më vonë, përgjatë asaj jave, Krishti provoi agoninë e Gethsemane-it, ku Ai i dhuroi shpirtin e Tij Atit Qiellor. “Në se është e mundur, mësoni këtë kupë të kalojë prej meje”, u lut Ai. Grafiku i ndodhive të Ungjillit portretizon agoninë e shpirtit të Tij, ndërsa mbarte mbi vete mëkatet e botës.

Gjyqi dhe vdekja e Zotit tonë

Ndoshta, profecia më e rëndësishme që lidhet me vdekjen e Zotit tonë, gjendet tek Isaia 53. I tërë kapitulli parathotë gjyqin, agoninë dhe vdekjen e Zotit. Le të vërejmë disa nga këto vargje, që kanë arritur të shtangin, madje edhe disa studiues hebrenjë, duke i bërë ata ta pranojnë Jezusin si Zotin dhe shpëtimtarin tonë.

Vargu 2-6: “

SHTOJI NGA BIBLA

Pastaj le të shikojmë vargun e 8-të dhe të lexojmë:

SHTOJI BGA BIBLA

Ka pak shembujsh parashikimesh që zhvellojnë natyrën e delegimit në emër të të tjerëve, të vdekjes së Krishtit. Kryqëzimi i tij ishte një vrasje despotike; një vdekje pa një gjyq të ndershëm e korrekt, as edhe për standardet hebreje, jo më romake.

Vdekja e Tij në Jeruzalem ishte për ty dhe për mua. Ne s’duhet t’i frikësohemi së ardhmes, sepse Krishti vdiq që ne të jetojmë. Ai vdiq në mënyrën që ne meritojmë, për të jetuar atë jetë që është e Tij. Vdekja e Tij në Jeruzalem, aq shumë shekuj më parë, ishte një vdekje që zuri vendin tuaj, në vdekjen e përjetëshme, që ju të mund të kini jetë të përjetëshme. A s’është kjo vallë, diçka e mrekullueshme?

Ne kaluam vetëm nëpër disa profeci të mrekullueshme në lidhje me Krishtin si Mesia. Le ta përmbyllim këtë kapitull, duke i hedhur një sy

profecisë së “kohës”. Danieli, profeti që jetoi më shumë se 500 vjet, përpara Krishtit, na ka dhënë një zbulesë madhështore të kohës së saktë se kur do të vijë Krishti. Le të vërejmë disa vargje.

Profecia e kohës së Danielit

Daniel 9:24-27 thotë: “

SHTOJI NGA BIBLA

Këto vargje të mrekullueshme lidhen me një periudhë prej 70 javësh. Shumica e studiuesve biblikë e kuptojnë këtë periudhë si 490 ditë ose 490 vite profetike (referojuni Ezekielit 4:5 dhe Numrave 4:34, si një referencë e kryqëzuar e faktit, se një ditë është ekuivalente e një vit)i. Po të shqyrtojmë këtë profeci, ne kuptojmë se një periudhë prej 490 vitesh, u jepet Hebrenjëve për të përfunduar periudhat e mëdha të braktisjes së besimit ose fe-lëshimit, dhe për t’u ripajtuar me Zotin. Hebrenjtë, njerëzit e Zotit, patën 70 javë ose 490 ditë, për ta zhdukur braktisjen e tyre të vazhdueshme. Vetëm atëherë do të vinte Krishti, për t’i dhënë njerëzimit ndëshkimin e merituar. Fillea e kohës së kësaj profecie ishte në ditët e Artaxerxes, kur në përfundim të tri dekreteve, u vendos programi i ndërtimit tërësor të Jeruzalemit dhe tempullit, që ishin shkatërruar nga pushtimet e Nebukadnezarit 150 vjet më parë. Data e kësaj komande të rindërtimit ishte viti 457 p.K. Një datë kjo që u përcaktua përfundimisht nga gjetjet arkeologjike në ishujt Elefantinë, në Egjipt e në burime të tjera.

Shtatë javët e para janë periudha 49 vjeçare që u nevojiti për të mbaruar programin e ndërtimit, duke e sjellë profecinë në vitin 408 p.K. Periudha tjetër prej 62 javësh është periudha prej 434 vitesh që mbaron në vitin 27 p.K. kur u pagëzua Krishti, i mirosur nga Zoti dhe Fryma e Shenjtë e, kur Ai nisi shërbëtarinë e Tij, në moshën 30


vjeçare. Kur te Marku 1: 15, Jezusi tha : “Koha u përmbush”, Ai iu referua padyshim kohës së kësaj profecie.

Java e fundit na sjell në vitin 34 p.K. Kjo periudhë shenjohe nga martiri i parë krishterë Stefani, dhe nga mohimi i Krishtit si Mesia nga Hebrenjtë Sanhedrinë, trupi më i lartë qeverisës i Hebrenjve. Teksti më tej pohon se “në mes të javës ai do të sakrifikohet dhe do të rreshtë blatimet”. Vdekja e Krishtit, tre vjet e gjysëm pas fillimit të shërbëtarisë së Tij, shenjon mesin e javës. Vdekja e Tij i dha fund nevojës së sakrifikimit të kafshëve të tilla, si: qingja, cjepër, deshë të tredhur. Të gjitha këto shenjojnë kohën kur Krishti do të vdiste në Kalvar. Me vdekjen e Tij Velloja e Tempullit që ndante vendin e Shenjtë nga vendi më i Shenjtë, u gris në dysh. Jozefi, një historian hebre thotë se kjo vello ishte tre inç e trashë. Ajo u gris nga fillimi deri në fund. Pothuajse një mrekulli, po të mendohen përmasat dhe trashësia e saj. Dikush mund të mendojë se çdo hebre duhet ta pranojë Krishtin, si rezultat i kësaj profecie. Unë njoh mjaft që kanë bërë kështu. Gjithësesi nuk është e lehtë që një hebre të pranojë faktin se Hebrenjtë tradicionalë duhet ta kenë përçmuar Krishtin.

Në Gjermani ka patur një debat midis të krishterëve dhe Hebrenjëve. Natën e fundit të debatit, të krishterët e përdorën këtë profeci, për të përqaftuar argumentete tyre në lidhje me besueshmërinë e krishterimit. Hebrenjtë heshtën. Pas kësaj, ata nxorrën një dekret, që mund të përmbledhet pak a shumë kështu: “Kalbtë eshtrat dhe kujtimin e Tij ai që do të orvatet të numërojë 70 javë”.

Në se numërojmë këto 70 javë, ne vetëm mund të rrëqethemi, për zbulesën e mrekullueshme të Zotit tonë. Që nga viti 34, p. K. , deri në fund të profecisë, Ungjilli duhet të shkonte te Paganët, ose te të gjithë pjesa tjetër e botës. Miq, çfarë ju mendoni të bëni me Krishtin e kësaj profecie?

E keni provuar Atë dhe e keni shpënë të vërtetën e Tij në pjesën tjetër të botës? Ju mbresë-lëntë Zoti të ndiqni udhëheqjen e kërkesat e Tij.



8. Historia e Hebrenjve dhe pasioni për dramën e Oberammergaut

Frederiku i Madh i Prusisë, i cil vuante nga dyshimi i besimit, sfidoi një predikues të provonte vërtetësinë e Biblës në një fjalë të vetme. Pasi u mendua pak, predikuesi tha: "Hebrenjtë, madhëri, Hebrenjtë." Njëra nga dëshmitë e mëdha të së vërtetës dhe autenticitetit të Shkrimeve të Shenjta është historia e jashtëzakonshme e racës hebreje. Kryeministri i Anglisë, Dizraeli, një hebre, u bë qesharak në Dhomën e Lordëve në rastin, kur u ngrit përballë një kundërshtari duke i thënë : "kur paraardhësit e zotërinjëve të nderuar këtu përreth

qenë njerëz të egër, paraardhësit e mi ndërtonin tempullin e Solomonit”.

Rraca më e vjetër në botë

Sot Hebrenjtë janë rraca më e vjetër në botë. Të gjitha racat e moçme që persekutuan hebrenjtë, u zhdukën. Filistinët, Moabitët, Edomitët, Amoritët, Kaldeanët (Babilonasit) dhe Asirianët e lashtë, pothuajse janë zhdukur në harrim, vetëm grekët dhe Persët miqësorë me ta kanë mbetur. Por shpesh është ngritur e njëjta pyetje : “Prej nga erdhën Hebrenjtë”?

Abrahami njihet si babai i hebrenjve, por edhe i shumë prej Arabëve. Ky patriarch antik u thirr nga Zoti ta lërë Ur-in e Kaldaes-ë, një vend ku po rritej korrupsioni dhe degradimi. Sipas të gjitha gjasave, ai duhet të jetë drejtuar nga Zoti për në tokën e Kanaanëve, ku nipi i tij Jakob dhe 12 bijtë e Jakobit, u bënë pasardhësit e racës së tij burrërore, e po kështu edhe të Jezu Krishtit. Për 2500 vjet fëmijët e Izraelit (Jakobit) qenë skllavër në Egjipt. Gjatë kësaj kohe ata u rritën shumë në numër, dhe Faraoni i fundit “i cili nuk e njhte Jozefin (djali i parë i Jakobit me Rakelën, që u bë kryeministër i Egjiptit), i skllavëroi ata (Eksodi 1:8). Pas shumë vitesh të rëndë e të mjerueshëm nën pushtetin e tiranëve mizorë, Zoti e thirri Moisiun që t’i çlirojë njerëzit e vet nga “kjo tokë e prangave”. Ata u udhëhoqën nga Egjipti përmes një ndërhyrje Hyjnore e në vijim të rrugëtimit të tyre arritën në Malin Sinai; ndodhi aty që atyre iu dhuruan “10 urdhërimet” (e shkruar nga Zoti mbi gur- Eksodi 32:16), së bashku me ligjet e tjera civile, shëndetësore dhe ceremoniale. Këto ishin ligjet e mirqënies së tyre shpirtërore, fizike e mendore, shumë më të përparuara se ato që kishin mësuar në Egjipt.

Për rreth 3500 vjet këto ligje kanë qenë jo vetëm një bekim i madh dhe një ndihmë e posaçme për Hebrenjtë, por edhe për disa rraca të tjara që i respektuan fortësisht dhe i ndoqën pas ato. Përpara se

Moisiu të vdiste, Zoti e zhvelloi të ardhmen e Izraelit, përmes një profecie të paharrueshme që gjendet të Ligji i Përtërirë 28.

Hebrenjtë kanë qenë udhëheqës

Le të njihemi me disa nga pikat më të spikatura të Ligji i Përtërirë 28. Vargu 1 thotë: “Nëse i bindeni me zell zërit të Zotit, për të ndjekur me kujdes 10 Urdhërimet që Unë iu dërgova, atëherë Zoti do t’ju ngrerë lart mbi të gjithë popujt e tokës”: Vargu i 13-të e vazhdon këtë temë me premtimin e të qenit “*koka dhe jo bishti*”. Ç’komb i madh dhe i rëndësishëm do të kishte qenë Izraeli në shekuj, nëse do të kishte vazhduar të ndiqte këshillat e Zotit. Po edhe kështu ata kanë lënë shenjë të tyre në mbarë-vajtjen e botës, në mençuri, dije, shkencë, muzikë dhe arkitekturë, për të përmendur vetëm disa disiplina.

Hebrenjtë kanë qenë udhëheqës. Jozefi u bë kryeministër në Egjipt, ashtu si Danieli në Babiloni dhe Mordekai në Persi. Në Britani, Amerikë, Rusi dhe Francë- për të përmendur vetëm disa kombe- Hebrenjtë kanë mbajtur pozicione të spikatura në qeverisje. Në shkencë e mjekësi, Hebrenjtë u shquan me njerin nga qeniet më të mëdha të njerëzimit, Anjshtajnin, në botën e muzikës Mendelson, Bah, Rubenshtajn e Shubert, janë mjaftë të njohur dhe të lëvduar. Rreth 3 mijë vjet më parë Moisiu paratha se Hebrenjtë do të jenë koka dhe jo bishti. Edhe pse kjo nuk u realizua plotësisht, për shkak të harresës që ata i bënë Zotit, aftësitë e trashëguara u shfaqën në shumë prej tyre. Psh. rreth 30% e fituesve të çmimit Nobel, kanë qenë Hebrenj.

Të japin me qera dhe jo të huazojnë

Në Ligji i Përtërirë 28: 12, Hebrenjëve u thuhet : “Të japim me qera dhe jo të huazojmë”. Për mijëra vjeçarë ata kanë qenë ekspertët financiar të botës. Në mesjetë, kur kisha katolike e dënoi huadhënien, Hebrenjëve iu shtrua rruga drejt kontrollit të “tregut të parasë”. Ata financuan Kristofor Kolombin me ekspeditën e tij, për zbulimin e botëve të reja. Napoloni u financua derisa i hapi luftë Rosisë. Edhe Xhorxh Uashingtoni u ndihmua në SH. B. A. Lufta Ruso-Japoneze, u luftua nga Rusët me paratë e Hebrenjve, por edhe Revolucioni i Tetorit u financua po nga i njëjti burim. Sot, kudo nëpër botë, Hebrenjtë kontrollojnë shumicën e industrisë kinematografike, të veshjeve dhe të ushqimit, dhe një përqindje të konsiderueshme të financës së lartë botërore.

Sidoqoftë, pavarësisht superioritetit të tyre të dukshëm, ata janë parë gjithmonë si “një çudi, një proverb a një legjendë”. Jeremia 24:9 shkoi një hap më tej duke pohuar se “ata do të jenë të përbuzur”. Një masë e madhe armiqësie është ngritur kundra hebrenjve. Ligji i Përtërirë 28 : 49-57, parashikoi fitoren e romakëve kundra tyre. Çdo detaj i kësaj profecie u përmbush plotësisht me shkatërrimin e Jeruzalemit në vitin 70 p.K.

Të shpërhapur nëpër botë

Vëreni pak këto detaje interesante. Vargjet 64-68, zhvillojnë se ata do të bëhen robër dhe do të mbushin tregjet e skllëvërve të kohës. Kjo ndodhi, kur tregjet e skllëvërve të Egjiptit u dyndën prej tyre, ashtu siç kish parashikuar Moisiu në frymëzim e sipër. Vargu 64, pohon se ata “do të shpërhapen midis kombeve”. Ky parashikim u përmbush detajësisht. Shumë pak njerëz janë të shpërhapur nëpër botë si hebrenjtë. Në xhunglat më të thella, në vende të shkreta, si Timbaktu, në mes njerëzve të getove dhe të pasurve të botës, Hebrenjtë janë kudo të pranishëm. Edhe pse shumë janë vrarë përgjatë shekujve, ekzistojnë rreth 30 milionë hebrenj që jetojnë sot praktikisht në të gjitha kombet e botës.

Njerëz të persekutuar

Levitiku 26:33, pohon se ata do të jenë njerëz të persekutuar. Shumë kombe Europiano Perëndimore i kanë persekutuar ata. Madje dhe Anglia i mbajti Hebrenjtë jashtë truallit të saj për 400 vjet. Për shkak të persekutimit Hebrenjtë lëvizën nga kombi në komb. Jo më kot ata quhen “Hebrenjtë shetitës”; një term ky i përdorur te Hosea 9:17.

Njerëz të shqueshëm

Numrat 23:9, spikasin faktin se Hebrenjtë do të “banojnë të veçuar”. Ata do të jenë vërtet të shqueshëm. “Hebrenjtë nuk do të shfarosen kurrë”, siç u orvatën disa kombe ta bëjnë një gjë të tillë.

“Ata nuk do të shfarosen kryekëputësisht” (Levitiku 26 : 44). Hitleri bëri një gabim të madh kur iu ndërsye Hebrenjëve, një gabim që bota nuk e ka harruar kurrë. Paraardhësi i tij, perandori Vilhelm, u miqësua me ta dhe iu dha strehim në Gjermani. Shkrimet e Shenjta thonë se ata nuk do të zhduken kurrë plotësisht.

Në se rraca Hebreje do të kishte pritur Krishtin si Shpëtimtarin dhe Shpëtuesin e vet, sa e ndryshme do të kish shkuar historia. Kur arritën të kishin kontrollin e fuqisë kombëtare, ata menduan se Krishti do të ishte në rrugën e tyre. Kur në të vërtetë, Ai ishte “Rruga”. Pilati nuk mundi të gjejë asnjë gabim tek Ai, ndaj bërtiti: “Shikojeni njeriun” e paskësaj tha: “A mund ta kryqëzoj vallë mbretin tuaj?”. “Ne s’ kemi mbret tjetër, përveç Qezarit(perandorit)!” u përgjigjën ata. Atëherë Pilati lau duart me shpresën se do të çlirohej nga “gjaku i pafajshëm”. “Lëreni gjakun e Tij të pikojë mbi ne dhe fëmijët tanë”- bërtisnin njerëzit. Padyshim që ata vuajtën agoni të tmerrshme për atë që i bënë Mesisë. 39 vjet më vonë, mbreti i tyre romak “i përdhosi, i vrau dhe i skllavëroi”. Në atë kohë romakët e sollën racën hebreje në prag të shfarosjes.

Ne s'duhet ta lëmë Krishtin jashtë jetëve tona. Ai është Shpëtimtari i të gjithë njerëzve. Ai do që ne ta pranojmë e të ecim në jetë sipas planeve të Tij. Po ju çfarë jeni duke bërë me Jezusin, me Krishtin? Le të udhëtojmë për në Bavari e të diskutojmë “Dramën e Pasionit”, luajtur në Oberammergau, e të shohim pse duhet ta pranojmë Krishtin në mendjet tona dhe në jetën tonë të përditshme.

Oberammergau

Disa nga vendet më të bukura të Europës gjenden në Bavari, në jug të Gjermanisë. Në jug-lindje është Austria, e të folezuara mes Alpeve që ndajnë të dy vendet, gjenden pallatet e famshme mbretërore Hohensshvangau dhe Nojshvanshtain. Në më pak se 45 minuta udhëtim me makinë gjendet qyteti i këndshëm i Oberammergau-t, në rrëzë të Alpeve Ammergau. Në çdo kohë të vitit që të vizitohet, qyteti i famshëm është një spektakël. Ndaj çdo ditë të vitit ky vend vërshohet nga mijëra turistë. Që nga viti 1634, një herë çdo 10 vjet, (me ndonjë përjashtim të rrallë), njerëzit e qytetit vënë në skenë “Pasionin e Jezu Krishtit”, një histori që mbulon javën e fundit, përpara kryqëzimit të Krishtit.

Plagët bubonike kishin zaptuar gjithë Europën në vitin 1632. Me shumë gjasa murtaja u shtri edhe në Bavari e në qytetet e saj të bukura. Me mijëra vdiqën nga sëmundja e tmerrshme. Së fundi ajo mbërriti edhe te vetë Oberammergau. Kur dy njerëz vdiqën, njerëzit e fshatit vendosën t'i përgjërroheshin Zotit ta ndalonte murtajën e lutjet e tyre gjetën përgjigje. Për banorët e Oberammergau-t kjo ishte një mrekulli, ndaj ata i premtuan Zotit ta zhvillonin Krishtin sa më shumë që të mundeshin, nëpërmjet skenimit të “Dramës së Pasionit”. Është provuar që kjo u përsërit çdo 10 vjet, përveç kohës së luftrave, që nga koha kur murtaja u ndal. Në vitin 1984, në 350 vjetorin e ndaljes së murtajës, pati një sesion veror shtesë të kësaj drame.

Pranë qendrës së qytetit, u ndërtua një teatër i madh, ku mund të uleshin rreth 4000 njerëz. Po nëse audienca e zakonshme mund të qëndronte e ulur, relativisht rehat, skena u ndërtua në ajër të pastër. Nëse binte shi apo borë, ndërsa drama vazhdon të luhet, aktorët edhe pse mund t'i vuajnë këto pengesa, nuk i ndërpresin kurrë shfaqjet. Ato fillojnë në maj dhe mbarojnë në tetor. Nisin me një muzikë të luajtur nga një orkestër e mrekullueshme, shoqëruar nga një kor elegant; paskësaj, banorët e qytetit aktrojnë javën e fundit të jetës së Krishtit, të njohur si Pasioni i Tij. Nëse dikush hyn e qendron të shikojë dramën, audienca është gjithnjë e përqendruar dhe asgjë nuk pipëtin. Çdo sy e çdo vesh, me vëmendje më të plotë, kërkon të rrokë çdo detaj të skenimit të javës së fundit të jetës së Krishtit në tokë. Në pritje të kësaj dite, aty paraqiten njerëz të shumë besimeve. Sheh myslimanë, hinduistë, budistë e të krishterë të ulur së bashku. Ata vijnë nga shumë pjesë të botës, si përfaqësues të 500 mijë të tjerëve, të cilët përmes pesë muajve të paraqitjes së kësaj drame, paguajnë më shumë se 100 \$ për të përjetuar këtë paraqitje prekëse të klasit botëror.

Çdo skenë madhore e javës së fundit të Krishtit: hyrja triumfale e Krishtit në Jeruzalem, mirosja e këmbëve të Krishtit nga ana e Maries në Bethany; tradhëtimi i Krishtit nga Juda; darka e fundit; lutja e Krishtit në kopshtin e Gethsemane-s; gjyqet përballë Annas-it Kajfas dhe Pilatit; çlirimi i Barabës; kryqëzimi dhe skena e Ringjalljes, janë që të gjitha të portretizuara grafikisht. Drama zgjat rreth 6 orë. Gjithsesi, ajo ndahet në pjesë 3 orëshe, me një 2 orësh ndalesë për të ngrënë drekë. Koha rrjedh shpejt, sepse e portretizuar përballë audiencës, është ngjarja më e madhe e krishtërit, vdekja e Krishtit për mëkatet e botës. “I drejti në vend të padrejtit, për të na sjellë më afër Zotit”. Ashtu siç u shkroi Pali romakëve. “Ndëshkimi i mëkateve është vdekja, por dhurata e Zotit është jeta e përjetëshme te Jezu Krishti, Zoti ynë” (Romakëve 6 : 23). Jezusi lindi prej racës së hebrenjve. Ai ishte Hebreu më i madh që ka jetuar ndonjëherë dhe që bëri të mundur jetën e pëртеjshme për çdo njeri. Ashtu siç

Oberammergau luan qartësisht e portretizon detajësisht Shkrimet e Shenjta, Krishti vdiq dhe u ngrit përsëri. Ringjallja e Tij është prova më e pakundërshtueshme se te Ai do të ringrihen të gjithë. S'ka rëndësi çfarë kredoje, besimi apo feje ke, jeta e Krishtit, vdekja dhe ringjallja e Tij, kanë një ndikim pozitiv tek të gjithë ata që e besojnë. Ja, pse është e rëndësishme të besosh tek Ai, sepse ata që e bëjnë një gjë të tillë do të kenë përfitime të përjetshme. Ashtu siç thonë shkrimet: Ata s'do të shuhen, por do të kenë jetë të përjetshme". (2 Pjetrit 3:19)

9. Rënia e Jeruzalemit dhe e ardhmja e planetit tokë

Në një të përjavshme Britanike të kohëve të fundit, një editorial i titulluar "Këto ditë të fundit", fillon me këto fjalë domethënëse: "Që fundi i botës, siç e njohim ne, mund të ndodhë në çdo kohë, është një fakt i thjeshtë". Tomas E. Murray, njëri nga drejtuesit e Komisionit të Energjisë Atomike, ka cituar : "Me gjithçka dimë do të qe i pakuptueshëm dhe i pashpjegueshëm vullneti i Zotit për ta bërë shekullin XX kohën përmbyllëse të racës njerëzore". Kjo kohë kaloi, por në një intervistë të mëvonshme të rrjetit ABC, në maj të vitit 2006, disa shkencëtarë sugjeruan se kishin ngelur vetëm 25 vjet jetë për planetin tokë. Në 12 janar të 2012-ës shkencëtarët e mbarë botës në mbledhjen e tyre të Nju Yorkut e lëvizën orën me plot 5 minuta. Sa e kthjellët, aq edhe e tmerrshme për shumë njerëz! Jezu Krishti e tha qartë se nuk është gjë e mençur që njeriu ta dijë datën dhe orën e "fundit të kohës". Megjithatë, ai iu paratha dishepujve të vet një profeci të famshme te Mateu 24, e cila zhvillon "kohën e fundit".

Ai ishte në majë të malit të Ullinjve me dishepujt e Tij. Vëmendja e tyre qe përqendruar te qyteti, Jeruzalemi, dhe në veçanti te tempulli mrekullisht vezullues. Aty Jezusi bëri një pohim befasues, kur tha: “S’do të ngelet këtu asnjë gur që s’do të rrëzohet përtokë.” Është e qartë se Jezusi po fliste për fundin e botës me dishepujt e Tij, pasi më vonë ata e pyetën: “Kur do të ndodhin këto gjëra e cilat do të jenë shenjat e ardhjes Tënde dhe fundit të botës?” Vëreni, se si ata duan të dinë se kur do të ndodhë shkatërrimi i tempullit e shenjat që do të paraprijnë ardhjen e Jezusit dhe fundin e botës. Është e qartë se ata besojnë se dy ngjarjet do të ndodhnin njëkohësisht.

Jezusi u shpjegua me tre vargjet e para të Mateut 24, që do të paraqiten në vijim të kapitullit. Parashikimi që bëri Jezusi, në lidhje me shkatërrimin e tempullit, arriti 40 vjet pas vdekjes së Tij. Romakët të udhëhequr nga Titus-i, e pushtuan qytetin pas një lufte shtatë-mujore, dhe në zhvillimet e këtyre betejave humbën jetën nga 600 mijë deri në 1 milionë hebrenj. Tempulli u shkatërrua dhe gurët e tij u grabitën nga ushtarët romakë që kërkonin tek ata arin e përzier me llaç. Menjëherë, pas kësaj, hebrenjtë e mbetur u shitën në tregun e skllëvërve të Egjiptit. Ky shkatërrim u pasua nga shkatërrimi i Herodianit, një vullkan në formën e Tel-it, jo larg nga Bethlehemi. Ushtritë marshuan më tej drejt Makersit dhe Masadas.

Masada ishte një sfidë tërësisht e ndryshme. Ajo njihej si vend i fshehjes së familjeve të Herodit, kështu që, kur ushtritë romakë arritën në rrëzë të këtij mali majë-sheshtë, aty gjendeshin rreth 1000 njerëz të strehuar nëpër vende te sigurt. Në çdo anë kishte shkëmbinj që ngjanin më shumë se sa një rrezik për ta. Gjithsesi, Titusi ishte i vendosur që të shkatërronte çdo vend ku gjendeshin Hebrenjtë. Ndërsa rrëmonin shkëmbinjtë, gurët dhe pluhurin, ata mbroheshin nga shigjetat që u vinin nga larg, nëpërmjet disa mburojave të lëvizshme

Një ose dy ditë përpara se të shpinin aty deshët e tyre sulmues ushtarët kundruan një re të zezë dhe të stërmadhe tymi që ngrihej lart nga maja e kolonisë së hebrenjëve. Ata po digjin vendstrehimet,

ushqimet dhe orenditë e tyre, për të kryer një vetëvrasje në masë. Vetëm 6 njerëz u gjendën të gjallë, kur ushtria kaloi përmes atyre mureve ca ditë më vonë. Romakët kishin fituar. Do të ndodhte vetëm në vitin 1948 në luftën kundra arabëve, që hebrenjtë do të arrinin më në fund ta ngrinin flamurin e tyre në majë të Masadas. Jeruzalemi që shkatërruar, tempulli u rrënuar dhe çdo fshat apo fortesë hebreje kishte mbetur gërmadhë. Roma kishte fituar, ashtu siç kishte parathënë Moisiu dhe Jezusi (Ligji i Përtërirë 28 dhe Mateu 24).

Pjesa e dytë e pyetjes që dishepujt i bënë Jezusit, në Malin e Ullinjve, kishte të bënte me ardhjen e tij dhe fundin e botes. Le të shohim disa ngjarje që do të shërbejnë, si shenja të kthimit të Tij, të shpejtë. Varg. 6:7: “E do të dëgjosh të flitet për luftra dhe plane luftrash: por mos u shqetëso, se më pas të gjitha këto do të kalojnë, ngaqë fundi ende s’ka mbërritur. Se kombe do të ngrihen kundra kombeve të tjerë, ashtu si dhe mbretëri kundra mbretërive të tjera: do të ketë zi buke, tërmete dhe epidemi vdekjeprurëse në vende të ndryshme të botës”. Këto ngjarje të së ardhmes do të jenë shenjat që do të zhvillojnë që ardhja e Atij e dytë në këtë tokë është shumë pranë.

Luftra dhe plane luftrash

Kombet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin se në çdo periudhë të caktuar nëpër botë, ndodhin më shumë se 50 luftra. Shekulli i shkuar pa të vriteshin më shumë njerëz se në çdo kohë tjetër në historinë e tokës. Kjo s’ ndodhi vetëm në dy luftrat botërore, por edhe më pas në vende të tilla, si: Vietnami, Kamboxhia, Somalia, Iraku, Afganistani dhe Uganda, luftrat vazhduan me një numër të madh viktimash.

Le të shohim pikat e mëtejshme të kësaj profecie të jashtëzakonshme. “E do të ketë edhe zi buke”. Bota sot duhet të ketë arritur në një pikë të “mos-kthimit” prapa. Sipas specialistëve,

agronomëve dhe statisticienëve që e kanë studiuar me kujdes çështjen, bota nuk arrin dot të ushqejë sot çdo burrë, grua apo fëmijë të saj. Shkalla e njerëzve që vdesin nga uria rritet çdo ditë. Qindra-mijëra të tjerë vuajnë nga kequshqimi. Le të përmendim edhe situatën e refugjatëve, në shumë vende, duke përmendur këtu Darfurin dhe Somalinë, miliona njerëz kërcënohen nga kequshqimi, uria dhe sëmundjet. Kjo zonë është shembulli i milionave të tjerë, që vuajnë në pjesët e tjera të planetit.

“Do të ketë edhe epidemi vdekjeprurëse”. Në vitet e fundit, studimi i ekologjisë ka nxjerrë në dritë disa fakte alarmante. Qeveritë, këshillat dhe universitetet, po punojnë e trajnojnë ekologjistë, për t’i ndihmuar të reduktojnë problemet e ndotjes që janë rritur me të shpejtë këto kohët e fundit. Zgjerimi i dijes njerëzore e ka shpënë njerëzimin në një luftë të minutës së fundit për shpëtimin e nipërve të tij. Dr. Lee Dubridge, një këshilltar i Shtëpisë së Bardhë në SH.B.A. thotë: “Është gjithë planeti ynë ai që është në rrezik shkatërrimi.”


Pastaj le të mendojmë për epideminë e HIV AIDS, që sjell miliona të vdekur në vit, veçanërisht në Afrikë. Duket, gjithsesi se shumica e vendeve janë të shqetësuara nga kjo sëmundje, madje disa prej tyre, nga propocioni i tmerrshëm në lidhje me popullsinë e tyre.

“Do të ketë tërmete”: shkatërrime nëpër qytete të mëdha dhe fshatra të vegjël, mund të priten pothuajse çdo javë në pjesë të caktuara të tokës. Ato po rriten, në vend që të zvogëlohen. Në kohët e fundit ne sapo u njohëm me shkatërrimet masive të disa tsunameve. Me qindra-mijëra vdiqën apo u bënë kufoma nëpër Oqeanin Indian më 2004-ën. Një tjetër tsunam në Japoni më 2011-ën shkaktoi me mijëra të vdekur dhe miliona dollarë dëme. Autoritetet kanë dhënë statistikat e mëposhtme në lidhje me tërmetet e manjitudës më të madhe se 6.99 të shkallës Rihter çdo 38 vjet që nga viti 1863.

Tërmete (Manjituda > 6:99)

1863. deri 1900 = 38 vjet, 12 tërmete
1901 deri 1938 = 38 vjet, 53 tërmete
1939 deri 1976 = 38 vjet, 71 tërmete
1977 deri 2014 = 38 vjet, 164 tërmete
(deri në 2011) u parashikuan 190 tërmete.

Vëreni edhe grafikun e mëposhtëm i cili flet vetë. Tërmete kanë filluar të bëhen më të shpeshtë vitet e fundit.



“Dhënie dhe marrje në martesë”. Kjo është një referencë e shthurjes së kushtizimeve morale gjatë këtyre kohëve të fundit. Divorcet dhe problemet sociale, të lidhura me një moral të shthurur jete, të shoqëruara këto edhe më probleme emocionale, janë njëra nga tragjeditë e epokës moderne. Ne dëgjojmë sot aq shumë për pornografinë, së bashku me abuzimet seksuale të fëmijët. Padyshim, që Sodoma dhe Gomora s’do mund të kishin qenë më keq!
Përdorimi i drogave të palejuara dhe i drogave të forta, si heroinë e kokainë, së bashku me alkolin, duhanin dhe marihuanën, e bëjnë të zymtë tablonë, që duket e ngjashme me atë të ditëve të Noes, siç lexojmë te Mateu 24:37-39.

Mund t'u shtojmë këtyre obsesionin mbarë-botëror të kumarit dhe partnerin e trishtë të korrupsionit. që lëndon praktikisht çdo komb. Jezusi tha se kur të shihen të gjitha këto gjëra, ato mund të shërbejnë si një sinjal i kohës së fundit. Çdo shenjë e ka rritur intensitetin e vet të spikatur në këto kohët e fundit e ne mund të pohojmë me siguri se bota me të shpejtë po shkon drejt fundit të kohës, ashtu siç thuhet nga shkencëtarët.

Ungjilli për botën

Sidoqoftë, shenja e fundit reale do të jetë në një fushë krejtësisht tjetër. “Ky Ungjill i mbretërisë do të predikohet në të gjithë botën, i dëshmuar në të gjitha kombet; vetëm pastaj do të vijë fundi”. Kjo do të jetë një shenjë reale, jo politike ose fizike, por shpirtërore. Ungjilli, lajmet e mira të saj që ndodhi përgjatë Kalvarit, duhet të shpërndahen në të gjithë botën e të dëshmohen në të gjitha kombet. Jezusi zuri vendin e njeriut në vdekje, sepse shpërbleta e mëkateve është vdekja”. (Romakëve 6: 23). Çdo njeri është mëkatar. Ai ka lindur me një prirje të brendshme për mëkatin. Ishte Jezusi që mbarti mbi vete dënimin e vdekjes. Ai dha jetën e vet që ne të mund të jetojmë përgjithmonë. Ky është lajmi i mirë. Ungjilli është lajmi i mirë i kësaj dhurate madhështore. Ky lajm do të shkojë te çdo komb e njerëzit do të jenë dëshmitarë të saj. Ai do të shihet në jetët dhe fjalët e atyre që pranojnë jetën e Krishtit. Sot televizionet, satelitët dhe faqet e uebit e kanë bërë këtë gjë më të mundur se kurrë ndonjëherë. Miliona njerëz në shumë vende janë të aftë të shohin televizione kristiane nëpërmjet satelitëve.

Sidoqoftë, edhe një tjetër fakt shpirtëror u përmend prej Krishtit. Ai zhvelloi se do të kishte kundërshti ndaj Ungjillit të vërtetë, nëpërmjet përdorjes së një Ungjilli të rremë. “Kur ju të shihni atëherë kudo trishtinë e izolimit dhe të vetmisë, të treguar nga profeti Daniel, strehohuni në vendin e Shenjtë”. (vargu 15)

I vetmi profet ose libër që Jezusi thotë se duhet të lexohet e të kuptohet, është libri i Danielit. Ky libër shqyrton me saktësi veprën që do të bëjë Jezuesi në oborrin qiellor pas kryqëzimit dhe ngritjes në Qiell. Në fakt, shumë pasazhe të Dhjatës së Vjetër tregojnë për këtë shërbestari të Jezusit, jo vetëm të asaj që ai përmbushi në kryq, por edhe shërbesat që Ai kreu më vonë në qiell për gjithë njerëzimin. Kafshët e flijuara të Dhjatës së Vjetër fokusojnë secila sakrificën në kryq të Shpëtimtarit. Edhe shërbimet e Shenjtërores i drejtohen veprës së Krishtit dhe shërbesës së Tij priftërore në qiell. “Për gjithçka folëm, ky është përfundimi: ne kemi tani një prift kaq të lartë që është vendosur në krahun e djathtë të fronit të Madhërisë në Qiell; një të dërguar të Perëndisë, për Shenjtëroren dhe për faltoren (tempullin) e vërtetë, që përzgjedhi Zoti dhe jo njeriu”. (Hebrenjtë: 8:2).

Është vepra e Krishtit në Shenjtërore ajo që duhet të ndiqet, ashtu siç tregoi profeti Daniel. Jezusi tha që të lexohet dhe kuptohet mirë ky pasazh. (Fjalët “Shenjtërorja e kokë-përmbysur ose e dëshpëruar” të Danielit dhe “Neveria e vetmisë” e Krishtit, janë të ngjashme). Jeruzalemi do të shkatërrohet, ashtu siç përmendëm, por vepra e Krishtit për shpëtimin e njeriut do të ndërhyhet nga krye-mashtruesi: Satanai.

Shenjtërorja u flet njerëzve për veprën e Krishtit. Ajo tregon aspektet më të imta të shpëtimit në detaje grafike, në mënyrë që ato të mund të kuptohen nga njerëzit, përpara kryqit. Shenjtëroria tregon të vërtetën e Ungjillit. Ajo rrëfen se njeriu nuk mund ta fitojë vetë shpëtimin e tij. Ai duhet të mbështetet plotësisht te Krishti për dhuratën e shpëtimit, pasi ajo nuk mund të fitohet. Pushtetet dhe institucionet mund të rrisin kurajën e njerëzimit për t’u përpjekur dhe për të punuar për shpëtimin e vet. Ka shumë dëshmi të kësaj, në të gjithë botën e sotme, madje edhe midis disa besimeve të krishtera. Por njeriu thjesht nuk mund ta fitojë shpëtimin; kjo është e pamundur!

Krishti parashikoi që në vitet pas kohës së Tij, atë bëheshin aq shumë përpjekje për ta shkatëruar veprën e Tij, ashtu siç i shkatërruan

edhe vetë tempullin, në kuptimin fizik. Pali e tha shumë qartë se ne kemi “një ndërmjetës midis Zotit dhe njeriut, njeriun Jezu Krisht”. Këto dhe çështje të tjera u errësuan me shtrirjen e kishës kudo nëpër botë. Çështja e së vërtetës u kompromentua me kalimin e viteve dhe besimet e botës pagane hynë në kishën e krishterë. Një çështje e tillë ishte ajo e ndërmjetësimit të Krishtit. Njeriu u bë ndërmjetës dhe zuri vendin e Krishtit, pikërisht ashtu siç njeriu zuri vendin e njerëzve përpara zotave në tempullin e Dianës në Efes.

Akti final i Krishtit

Ne kemi përfshirë në këtë përmbledhje një numër të parathënash shumë interesante që Jezusi u bëri dishepujve të Tij rreth 2000 vjet më parë. Parashikimi i fundit i bërë nga Mateu 24, lidhet me Ungjillin që do të shpërhapet në çdo komb, racë, gjuhë dhe njeri.

E vërteta mbi Jezusin gjendet sot pothuajse në çdo komb. Nëpërmjet medias elektronike kombet e mëdhenj sot po hapen gjerësisht kah mesazhit të Ungjillit. Kombe si India, Kina, Japonia, Rusia, Amerika e Jugut dhe Afrika, po e shohin dhe po e dëgjojnë gjithnjë e më shumë Ungjillin, ndaj duhet të jemi shumë mirënjohës që në këto ditët e fundit të historisë, po bëhemi dëshmitarë të përparimit të tij. Ne duhet të jemi mirënjohës që u udhëhoqëm nga Jezusi. Duhet të jemi mirënjohës që Ai do të vijë përsëri që të na mbartë në lavdi. Duhet të jemi mirënjohës që kemi mundësinë të njohim Atë “që do të thotë të njohësh jetën e përjetëshme”, (1 Gjonit 5:11-13). Me rënien e Masada-s, ngjau pothuajse e pamundura. Fundi i tokës ishte më se i sigurtë.

Miq, kundroni kah Zotit për Hirësinë e Tij shpëtimtare dhe pranoni dhuratën e jetës së përjetëshme që Ai po iu ofron. Kundroni kah Tij dhe për përgjegjshmëritë personale në marrjen e kësaj dhurate. Pastaj gjeni vendin tuaj ndanë Tij dhe zhvilloni maturinë e krishterë, në përputhje me qëllimet që Ai ka për ju. Fundi do të vijë shpejt, e duhet të ketë lajme ngazëllyese për ata që njohin këtë ngjarje të madhe.

10 . Pse ra komunizmi?

Toka e Irakut dhe Profeti Daniel

Nën mbretërimin e Sadam Huseinit, Iraku ishte një vend i njohur i Lindjes së Mesme, i vizituar nga shumë njerëz të biznesit, nga grupe dhe individë. Shumica prej tyre vizitonin qendrën e vetme arkeologjike të vendit, pranë qytetit Mosul-Ninevean antike; Babiloninë, në jug të Bagdatit dhe qytetin Ur të Kaldeasve, që shtrihet akoma dhe më në jug, pothuajse në Basra. Ndërsa këto janë qendrat kryesore, ekzistojnë edhe disa qendra të tjera më të vogla, të tilla, si Ctesiphon, Hatia, Khorsabad dhe Burs Nimrud.

Disa vite më parë revista “Time” nxori portretin e Sadam Huseinit në kopertinë, ndërsa. në artikullin përkatës shkruhesh se ëndrra e tij ishte të bëhej Nebukadnezari III. Ne do ta rrëfejme më poshtë historinë e Nebukadnezarit II. Sadami ndërtoi disa pallate luksoze përreth vetes, me një lloj mbrojtjeje e sigurie që u përkiste vetëm mbretërve.

Arkeologët kanë arritur të gërmojnë mjaft “Tel-“e, mes pluhurit dhe rrënojave ku gjendeshin bazat e qyteteve dhe qytetërimeve të disa mijëra viteve më parë. Nga këto qytetërime të varrosura, këta kërkues të zellshëm kanë zbuluar gurë, pergamene, artikuj qeramike, orendi e mbishkrime. Këto nga ana e tyre janë kthyer në një thesar të mrekullueshëm faktesh që pohojnë besimin dhe u rijapin shpresë miliona njerëzve të trishtuar e të mëdyshuar. Le të shqyrtojmë pak

qytetin Ur të Kaldeasve në jug të Irakut, tre apo katër orë rrugë nga Basra.

Ur i Kaldeasve

Për vite të tëra shumë njerëz qenë të bindur se Abrahami ishte një figurë legjendare e Shkrimeve të Shenjta. Ai ishte djali i Terah-ut që jetonte në qytetin Ur të Chaldees-ve. Po ku është vallë ky qytet? Sër Leonard Woolley beson, ta ketë zbuluar këtë qytet 240 km në jug-lindje të qytetit të vjetër të Babilonisë. Gjiri Persik ishte shumë më pranë Ur-it në kohën e Abrahamit, por ardhja konstante e baltës dhe e llumit në vite, bëri që ai të zhdukej nga ajo sipërfaqe për më në jug. Woolley u mrekullua me gjetjet e zbuluara përgjatë gërmimeve të periudhës 1922-1934. Ai zbuloi një qytet me një sistem të plotë të shkarkimit të ujrave të zeza (të tillë që mjaft qytete të kohës së sotme do të qenë të lumtura ta kishin), me gjykata, shkolla e shtëpi të sofistikuara. Shumica e këtyre zbulimeve mund të gjenden në Muzeun Britanik, në Londër dhe në Muzeun Arkeologjik të Bagdatit, Irak.

Ka dyshime që, pas grabitjes që ndodhi në suksesin e koalicionit të ushtrive perëndimore në Bagdat, këto objekte të jene zhvendosur nga Muzeu i këtij qyteti.

Disa të tjerë dyshojnë, në se zbulimet e Sër Leonard Woolley mbi qytetin e Ur-it janë autentike dhe ai është Ur-i zanafillor. Arkeologu i njohur W.F. Albright e pohoi zbulimin, por disa nga tekstet e Ebla-s e përmendin Ur-in më afër Haran-it në pjesën veri-lindore të Mesopotamisë. Ata flasin për qytetin Ur, në territorin e Haran-it, gjë që është më afër Turqisë. Mund të përmendim edhe një tjetër qytet që nuk është gjetur, gjë që ngjall diskutime, se sa larg shtrihej në atë kohë territori i Haran-it.

Gjetjet e Sir Woolley-it mbi Ur-in, duken të autentifikohen nga zbulimi i emrit të Abrahamit në njerën nga shtëpitë e tij. Ai gjendej në mbishkrimin e një tulle të baltosur, që pohonte se aty ekzistonte

një njeri me emrin Abraham e që merrej me blerjen e bagëtive. Të paktën emri i njihej dhe i përdorej në Ur, në jug të Irakut. Edhe në një numër varresh mbretërore përfshihen mes zbulimeve, e në njerin prej tyre, Mbretëresha Al Shubaid dhe familja e saj duket të jenë varrosur së bashku. Ndoshta nuk ishte një ide e mirë të ishe pjestar i familjes mbretërore të atyre kohërave.

Ninevea

Mosuli modern gjendet përgjatë lumit Tigër, në krahësim me Ninevean e vjetër. Ky qytet antik u ndërtua aty ku profeti Jona mbërriti më në fund e nisi të predikojë. Është, gjithashtu një qytet, që një numër profetësh të Dhjatës së Vjetër e parashikojnë të rrënohet. Në zenitin e vet, Ninevea ishte një qytet “tejmasësisht i madh”. Ai u themelua nga Nimrodi, siç përmendet te Zanafilla 10:11 dhe Patroni mbrojtës i Zotave të Nineveas ishte Ishtari. Shumë mbretër Asirë ndërtuan këtu pallatet e tyre dhe i pari prej tyre ishte Shalmaneser I që mbretëroi në vitet 1274- 1244 p.K. Në atë kohë qyteti Calah dhe Ashur qenë shumë më të rëndësishëm se sa Ninevea, që nisi të spikaste në kohën e mbretërve Asirë të përmendur në Shkrimet e Shenjta. Sennasherib, djali i tij Esarhaddon dhe Ashurbanipal ishin disa nga mbretërit udhëheqës të kësaj ere. Ky i fundit është i njohur për bibliotekën e tij të stërmadhe me pllaka shkrimesh kuneiforme.

Erdhi një kohë që Medet nisën të grabisnin qytetin. Profecitë e Nahum 2&3 dhe Sofonia 2:13-15 në lidhje me perëndimin e qyteteve të mëdhenj nisën të përmbusheshin. Shikoni se ç’shkruhet në tekstin e mëposhtëm: “Ai nisi të shtrijë dorën e tij kundra veriut, shkatërroi Asirinë dhe e ktheu Ninevean në një rrënojë, po aq të thatë sa shkretëtira. Vetëm tufat e bagëtive do të gjendeshin në mes të tij. Ky është qyteti i gjithë festimeve që banonte i sigurtë e i thoshte zemrës së vet : “Jam vetëm unë e s’ka asnjë tjetër përveç meje”. Po sa i pikëlluar dhe i shkretë ai u bë, një vend veç për bisha. Ç’dokush që do të kalojë ndanë tij do të fishkëllejë e do të tundë grushtin”!

Është e jashtëzakonshme të shohësh se me ç'përpikmëri është përmbushur ky parashtrim. Qyteti i stërmadh i Nineveas tashmë jeton fundin e tij.

Çdo herë që e kemi vizituar atë, fëmijët kundrojnë shpesh përtej grigjave të bagëtive të prindërve, se mos gjejnë diçka nga ato pallate e ndërtesa qeveritare që mbushnin Ninevean. Ato pallate luksoze të mbretërve të Asirisë nuk janë më, kështu që dhe njëherë tjetër profetët e Shkrimeve të Shenjta janë më se të shfajësuar.

Babilonia

Nebukadnezari II ishte përgjegjshës për sulmet e para të furishme kundra Asirianëve dhe kryeqytetit të tyre Ninevea. Ai ndërtoi qytetin e Babilonit në shekullin e gjashtë p. K. Në këtë kohë, Hebrejtë ishin robër të Babilonëve. Njeri nga këta robër, Danieli, u bë kryeministri i Babilonisë, duke qenë njëherësh edhe profeti i Zotit. Në librin Biblik që mbart emrin e tij, ekziston një profeci e jashtëzakonshme, që ka qenë një sfidë për të gjithë sundimtarët e botës dhe një ngushëllim i përgjithmontë për të krishterët. Ky parashikim i përgjigjet aftësisht çështjes së sundimit të botës nga Rusia, Amerika, Islami apo çdo lloj fuqie tjetër botërore që mund të lindë.

Përpara se Babilonisë t'i vinte fundi, ajo ishte një perandori botërore dhe mbreti i saj Nebukadnezari një ditë pati një ëndërr të jashtëzakonshme të dhuruar nga Zoti. Si shumë nga ëndërrimtarët, ai nuk e kujtoi dot atë pas zgjimit. I mbetur i frymëzuar nga rëndësia e saj, i thirri të gjithë astrologët dhe njerëzit e mençur, që t'i rindërtonin ëndrrën dhe interpretimin e saj. Këta njerëz s' kishin patur kurrë më parë një sfidë të tillë, pasi në rastet e mëparëshme mbreti iu kishte treguar ëndrrën dhe iu kishte kërkuar vetëm interpretimin e saj. Por kjo ëndërr qe ndryshe. Ishte imperative që mbreti ta rindërtonte atë, ta interpretonte dhe të kuptonte se për çfarë bëhej fjalë. Ata astrologët antikë nuk mundën ta zgjidhnin dilemën e mbretit, asht siç nuk mund të zgjidhin dot problemet e

sotme. Në pallat mbrëriti Danieli, një rob hebre, që tashmë ishte i spikatur në oborrin e mbretit. Ai kërkoi kohë dhe e siguroi mbretin për një zgjidhje të gatshme të problemit.

Në një seksion lutjesh së bashku me shoqëruesit e vet, Danieli parashtrroi ëndrrën dhe interpretimin e saj nga Zoti. Gjithësesi, kur mbreti u interesua për të, Danieli u tregua shumë i kujdesshëm që t'ia jepte meritat vetë Zotit. Mbreti mësoi kështu se Zoti i Qiejve është i aftë të zgjidhë të gjitha gjërat e ndërlikuara. Vëreni se ç' thotë Danieli 2:28: “Se është Zoti në Qiell Ai që i zhvillon misteret. Ai i tregoi mbretit Nebukadnezar se çfarë do të ndodhë në ditët që do të vijnë...”. Kjo ëndërr nevojitet të shtrihet drejt e në ditët e sotme, duke na dhënë një arsyetim të mjaftueshëm për shqetësimet tona. Vëreni, gjithashtu, se përsëkrimi i Danielit për ëndrrën, u njoh nga mbreti, pikërisht si ëndrra e tij origjinale. Ja se ç' thotë Danieli 2: 31-35: “Kundrojeni, o mbret, se aty para jush ngrihet një statujë aq e gjerë, aq e stërmadhe - një statujë aq ngazëllyese dhe e mrekullueshme në dukje. Koka e statujës është bërë prej ari të pastër, krahët dhe kraharoni prej argjendi, barku dhe kofshët prej bronxi, këmbët prej hekuri dhe shputat gjysëm hekur e gjysëm argjil i pjekur. Po ndërsa po e kundron, ti do të shohësh një shkëmb që do të shkëputet, por jo prej duarve njerëzore. Ai do ta godasë statujën në këmbët prej bronxi dhe argjili dhe do t'i copëtojë ato. Pastaj do të nisë të thërrmohet hekuri, argjili, argjendi dhe ari duke u bërë në mijëra copa.

Era pas kësaj do fryjë duke i shpënë ato tej e duke mos lënë asnjë gjurmë. Veçse shkëmbi që goditi statujën, do të bëhet një mal i stërmadh që do të mbushë gjithë tokën”.

Po ç'lidhje ka vallë e gjitha kjo me Rusinë, Islamin ose qëllimet e çdo kombi tjetër për sundimin e botës? Mendojeni pak këtë histori të mrekullueshme të parathënë kaq qartësisht. Ndërsa Danieli filloi të interpretonte ëndrrën, ai i tha mbretit: “Ju jeni koka e tij prej ari”. Po, vërtet, Babilonia ishte një perandori dhe mbretëri e madhe dhe mund të përfaqësohej mjaft mirë prej kokës së artë. Po ky nuk është fundi,

sepse “ pas teje do të lindë një tjetër mbretëri më inferiore”. Sipas vegimit, koka e artë do të vijohet nga krahët dhe gjoksi i argjendtë, një metal më inferior (më pak i çmuar) se ari”. Po njëllon, në historinë e kombeve, ishin Medët dhe Persianët ata që ndoqën perandorinë e fuqishme Babilonase, si fuqi dominuese botërore. Shikoni Daniel 2:39: “ Pas jush do të ngrihet një tjetër perandori, më inferiore se e juaja. Pas kësaj, një mbretëri e tretë, prej bronxi, do të qeverisë gjithë tokën. Perandoria e tretë, pas Babilonisë, ishte Greqia që u përfaqësua nga kofshët dhe një bark prej tunxhi. Danieli 8:20-21, i përmend me emrat aktualë sekuencën e mesme të këtyre mbretërive. Medet dhe Persët u ndoqën nga Grekët. Vijoi një mbretëri e katërt botërore e përfaqësuar nga këmbët e hekurit, që ndoqi Greqinë. Kjo perandori e re ishte Roma.

Gjendet te shputat e imazhit të ëndrrës ajo qeverisje e kohëve të fundit, e përfaqësuar nga shumë mbretëri që do të sundojnë botën. Shputat kanë një përzierje hekuri dhe argjili. Danieli 2:41 thotë: “Ashtu siç ju do të shihni se shputat dhe gishtat janë pjesërisht prej argjile të pjekur dhe pjesërisht hekur, po kështu do të ekzistojë një mbretëri e ndarë, që do të ketë një pjesë të fuqisë së hekurit brenda vetes, edhe pse ju do ta shihni hekurin të përzierë me argjilën. Vargu 43 shpjegon : “Ashtu siç ju patë hekurin të përzierë me argjilën e pjekur, po kështu edhe njerëzit do të jenë një përzierje e s’do të mbeten të bashkuar, sa më shumë hekuri do të përzieret me argjilën. S’do të ekzistojë më kurrë një perandori e tillë botërore, si Roma, Greqia, Persia dhe Babilonia. Mbretëritë e përfaqësuar nga këmbët prej hekuri dhe argjili, do të mbeten të ndara e s’do të bashkohen kurrë në një komb të vetëm.

Fjala i “përzierë” apo i “gërshetuar” do të thotë se qeverisësit do të bashkëpunojnë. Nëse do t’i hidhnim një sy skenës së sotme Europiane, ndërveprimi i pushteteve ka arritur t’i bëjë bashkë të gjitha shtëpitë mbretërore në Europë. Ekziston një lidhje e fortë gjaku mes gjithë mbretërive, por jo një unitet domethënës. “Ato s’kanë për të mbetur më të bashkuara me njëra-tjetrën”. Që kur u

shkatërrua mbretëria e madhe pagane e Romës, në asnjë epokë bota s'ka qenë e bashkuar nën një komb të vetëm. S'do të jenë të tilla as Rusia, as Kina e as një komb tjetër.

Vitet që kanë kaluar, kanë pohuar të vërtetën e këtij parashikimi. Historia ka treguar se qeverisësit e shumë kombeve i janë orvatur qeverisjes së botës. Karlomanji ishte një i tillë ; Udhëheqësi i monogolëve, Xhengis Khan në shekullin e 13-të, ishte një tjetër. Në kohët më të vonshme Napoleon Bonaparti, Kaizeri Vilhelm (perandori) dhe Hitleri, u përpoqën që ta sundonin botën. Çdo herë që ata u munduan ta pushtonin botën dhe ta qeverisnin atë, Zoti ka ndërhyrë dhe i ka mbyllur shtigjet e tyre kah sundimit të botës. A s' mund ta kuptoni vallë, pse nuk ka asnjë komb në historitë e mëvonta, që të jetë i aftë të qeverisë botën? Edhe planet e qëllimet e Ruisë komuniste duhet t'i nënshtroheshin përpikmërisë së këtij parashikimi të madh. Ky është shkaku pse kombet e së tashmes e gjithashtu të së ardhmes nuk do të jenë të zotë të qeverisin botën?

Çfarë do të ndodhë në të ardhmen?

Danieli në 2:44, thotë: “Në ditët e këtyre mbretërve, Zoti i qiejve do të ndërtojë një mbretëri që nuk ka për t'u shkatërruar kurrë; e kjo mbretëri nuk do t'u lihet njerëzve të tjerë. Ajo do të ndahet në copa e do t'i shprishë të gjitha këto mbretëri, për të jetuar përgjithmonë” Kështu do të jetë! Shpejt Krishti do të ndërtojë një mbretëri të pashkatërrueshme, kaq të ndryshme nga mbretëria tokësore. Kjo mbretëri do të jetë një mbretëri e vërtetë ku dashuria, paqja dhe lumturia do të mbretërojë në të gjitha kohët. Ajo përfaqësohet, në ëndërr, “prej shkëmbit të copëtuar pa duar”. S'ka rëndësi se cili është besimi ose feja juaj, ju duhet t'i përujeni shpalljeve të kësaj profecie. Historia, pothuajse e 2000 vjetëve më parë ka provuar pa grimë hije dyshimi se kjo profeci, që nga koha e Babilonisë është e vërtetë. Kombet kanë rënë, dhe madje janë zhdukur, por Krishti ende jeton. Një ditë qeverisja e Tij do të pushtojë gjithë tokën tonë, ashtu siç ka

bërë me pjesën tjetër të universit, që tashmë është nën sundimin e Tij.

Por ka dhe diçka tjetër. Përpara se të ndodhë kjo, Ai kërkon të hyjë në jetën tonë. Ashtu siç foli edhe ai vetë: Kushdo që do të përplasët me këtë shkëmb (Zotin) do të thyhet; por mbi këdo që do të bjerë, ai do ta grijë e do ta bëjë pluhur (Mateu 21: 44). Miq, pse nuk e vendosni veten fortësisht në anën e Krishtit, të bini te Ai, e në fund të fitoni gëzimin e të jetuarit e mbretërimit bashkë me Të?

11 . Zanafilla e së keqes

Është shtruar shpesh pyetja: “Po pse vallë, duhet të vdiste Jezusi?” Pse vallë, Zoti e lejoi mëkatin në vend të parë? Në një univers të përsosur, si ndodhi që pati zanafillë mëkati apo e keqja? Pse njerëzit e pafajshëm duhet të vuajnë? Këto janë disa nga pyetjet më të vështira për t’u përgjigjur. Po ne do të përpiqemi!

Shumë vite më parë bota pësoi një tjetër tronditje me lajmen e vrasjes së Robert Kenedi-t. Një djalë i ri, i lindur në një fshat jashtë Jeruzalemit, ishte ai që e kreu vrasjen, i vetëm. Prindërit e djalit ishin prindër të mrekullueshëm që s’ kishin bërë kurrë keq. Kur lindi Sirhan Sirhani, e gjithë familja u ngazëllye. Ai ishte një djalë i dashur, i lindur nga prindër të mirë. Vite më vonë u bë një kriminel, nisur nga vendimet që mori, duke u shkaktuar një zemërthyerje prindërve të vet paqedashës. Ata ishin tmerrësisht të shqetësuar për aktin e të birit të tyre e të ligështuar për zonjën Kenedi dhe familjen e saj. Arsyeja pse vendosi të bëhej një kriminel janë të shumëfishta, por zgjedhja që veç e tij.

Lejomëni të ndaj me ju një citim të mrekullueshëm nga libri im i preferuar: “Zoti është dashuri. Natyra e Tij, ligji i Tij, është dashuri, kështu ka qenë gjithmonë; E kështu do të jetë... çdo manifestim i fuqive krijuese, është një shprehje e dashurisë së pafundme... Ligji i dashurisë, si themeli i qeverisjes së Zotit, po njëlloj si dhe lumturia e te gjitha qenieve inteligjente, varen nga pajtueshmëria e tyre e përkryer me parimet e mëdha të drejtësisë. Zoti dëshiron nga të gjitha krijesat shërbesën e dashurisë, shërbesë që shpërthen nga vlerësimi i karakterit të Tij. Ai s’provon kënaqësi nëpërmjet bindjes me forcë; ndaj të gjithëve Ai dhuroi lirinë e vullnetit, që ata t’ia kthejnë në një shërbesë vullnetare. Për aq gjatë, sa të gjitha qeniet do të njohin besnikërinë e dashurisë, do të ekzistojë një harmoni e përkryer në tërë universin e Zotit”. (Patriarkët dhe Profetët ; E. G. White, faqe 33-34).

Në fjalitë e mësipërme ne kemi një tabllë të përpiktë të një hapësire të mirë-krijuar, të një universi të tërë të dashurisë dhe pages. Po si ndodhi kjo përmbysje?

Zoti krijoi shumë krijesa dhe midis tyre qenë edhe urdhrat e ndryshëm të Engjëjve të përmendur te Shkrimet e Shenjta. Më i larti i të gjithëve njihet si Luçiferi ose “djali i Agimit”. Një portretizim të tij e shoh si karakterin e gjendur pas veprimeve të Mbretit të Tires. Vëreni disa citimet e përmendura te Ezekieli 28:12-17: Ja, se ç’i tha Zoti sovran: “Ju ishit modeli i përsosmërisë, plot mençuri dhe bukuri. Ju ishin në Eden, në kopshtin e Zotit. Çdo gur i çmuar ishte për t’ju stolitur... ato u përgatitën në ditën që u krijuat dhe ju. Ju u paraqitët si një engjëll mbrojtës, për këtë ju urdhërova. Ju ishit në Malin e Shenjtë të Zotit; shëtisnit mes gurëve krenarë. Ishit i pafajshëm në veprime që nga dita kur të krijova, deri kur të molepsi ligësia. Zemra t’u krenua për shkak të bukurisë, ndaj e shprishea mençurinë, për shkak të shkëlqimit. Ndaj, të flaka në tokë dhe të bëra spektakël përpara mbretërve”.

Ashtu si të gjitha krijesat e Zotit, Luçiferi kishte liri zgjedhjeje. Ndërsa Zoti vazhdonte punën e Tij të krijimit, e veçanërisht të

krijimit të tokës, Luçiferi u nxit nga dëshira e vetëngazëllimit. Isaia 14-13: “Ju i thatë zemrës: unë do ngjitem në qiell; e do ta ngre fronin tim lart, mbi yjet e Zotit; e kështu i fronësuar do të qendrojë në Malin e Kuvendit në pikën më të lartë të Malit të Shenjtë”. Nguliteni këtë gjë në mendje, edhe i lavdishmi Luçifer është krijuar nga Zoti. Ai tash po lakmon haraçin e vetë krijuesit. Ai kishte pozicionin më të lartë në morinë e qenieve të krijuara, por kërkoi më shumë.

Isaia 14:14 vazhdon : “Unë do të ngjitem edhe mbi majat e reve; unë do ta bëj veten më të lartin e të gjithëve”. Imagjinoni një qenie të krijuar nga Zoti, të flasë në këtë mënyrë! Zoti i nderuar, i vendosur mbi Luçiferin, nuk është plotësisht i vlerësuar për këtë dhuratë të veçantë që i ka bërë atij. Ai nis ta konsiderojë veten si qendra e Universit e të bëhet ziliqar për krijuesin e vet. Pakënaqësia e Luçiferit u nda me të pangjashmit e vet e nisi të rritej. Ndërsa Zoti e trajtonte zilinë e Luçiferit korrektësisht, duke i lejuar çdo mundësi për t’u përmirësuar, kjo pakënaqësi u shndërrua në rebelim, që në fund nuk mund të frenohej në Qiell. Duke lejuar rebelimin e hapur, Zoti zgjodhi të tregojë natyrën e qëllimeve të Luçiferit. Kjo nuk u bë menjëherë. Zoti e caktoi Luçiferin në një planet të ri, në tokë. Pasi kaluan disa mijëra vjeçarë, mbretëria e gabimit dhe e së keqes u shfaq fitimtare, për t’i treguar gjithë universit se dashuria e Zotit është rruga më e mirë. E kundërta e dashurisë është urrejtja.

Në kohët e sotme ne kemi mësuar shumë në lidhje me veprimet e terroristëve. Aktivitetet e tyre janë të holla, të pabesa e të frikshme. Veprimet e tyre të këqija janë vetë-shkatërrimi dhe rrënimi. E gjithë kjo filloi me rebelimin e hapur në qiell. Luçiferi dhe kolegët e tij ishin të paaftë të qendronin, kështu që u vendosën në tokë. Edhe këtu atij iu dhanë shumë mundësi të tregojë qëllimet dhe ambiciet e tij. Fatëkeqesisht, e kundërta e dashurisë është urrejtja dhe ajo u shfaq në tokë në shumë mënyra.

Jezusi tha: “ Unë e pashë Satanain të bjerë si rrufe prej qiejve”. (Luka, 10:18). Një tjetër tekst që përshkruan dëbimin e Luçiferit nga Qielli, gjendet te Zbulesa 12:9: “Dragoi i madh u vërvit poshtë, ishte ai

gjarpër antik që u quajt Djall apo Satana, që arriti të shpjerë në rrugë të shtrembër gjithë botën. Ai u dëbua në tokë, e bashkë me të edhe engjëjt e tij”. Në tokë iu la kohë për t’u menduar dhe penduar. Por krenaria egoiste nuk e la kurrë të pendohet. Qëllimi i vetëm kishte qenë dëmtimi i krijimit dhe shpërhapja e qëllimeve dhe veprimeve të tyre egoiste. Kur Zoti krijoi njeriun, Ai e bëri atë të drejtë. Ai ishte i përsosur dhe pasqyronte imazhin e Zotit e veçanërisht karakterin e Tij. Ashtu siç Luçiferi dhe shpura e tij engjëllore kishin vullnet të lirë, po kështu kishte edhe njeriu. Ai mund t’i shihte veprat e krijuesit mirëbërës, mund të përjetonte dashurinë e Tij e t’i përgjigjej me këngë lëvdimi dhe mirënjohjeje. Edhe Luçiferi ishte lejuar të provonte besnikërinë e njeriut dhe dashurinë për Zotin.

Fatëkeqësisht, njeriu kapitulloi para tundimeve të holla të Satanait, kur ai u afroji njerëzve dijen e epërme. Njeriu ndoqi fjalët e tij bindëse dhe mëkatore, e për këtë arsye u nda nga Zoti. Luçiferi e kishte fituar betejën. Por ai nuk kishte dhe nuk mundej ta shterte dashurinë e Zotit. “Barra e mëkatit është vdekja, por dhurata e Zotit është jeta e përjetëshme, përmes Jezu Krishtit, Zotit Tonë. (Romakëve; 6:3). Edhe Luçiferi e përfitoi këtë dhuratë në fillim, por zgjodhi rrugën e tij dhe planin e vet. Ndërsa njeriu iu dorëzua këtij tundimi, ai e kuptoi marrëzinë e bërë dhe pranoi dhuratën e Zotit. Edhe unë besoj se ne jemi të aftë ta kuptojmë njeriun zanafillor që nuk ka vullnet të shprishë këshillat e Zotit në mënyrë zhurmë-madhe, sepse ai e pranoi me të shpejtë rrugën e Zotit përtej gjendjes së tij të papëlqyer. Ndërsa vdekja ishte rezultat i mëkatimit, Jezusi krijoi një rrugë shpëtimi. Po, kështu është, edhe tundimet e holla të Satanait u bënë të mundura nga hirësia e Zotit dhe dashuria e Tij e pakushtëzuar.

Ashtu si Adami dhe Eva e pranuan planin e shpëtimit nga mëkati, po kështu edhe pasardhësit e tyre kanë sot po të njëjtat zgjidhjeje. Besojini këtë: liria e zgjedhjes është e juaja. Një mori e madhe njerëzish e kanë pranuar vizionin e madhërishtëm të përjetësisë me Krishtin, por për fat të keq ka edhe shumë të tjerë që s’e kanë bërë një gjë të tillë. Rezultati përfundimtar do të jetë subjekti i një kapitulli

tjetër. Koha, që Zoti lejoi për mëkatit, të shpalosë të korrat e tij shpejt do të mbarojë, kur Zoti ka për të ndërtuar Mbretërinë e vet.

Tani le të analizojmë veprën e Zotit për shpëtimin dhe se si Ai lejoi mallkimin e mëkatit. Satanai e fajësoi Zotin si një diktator dhe shkatërrues të atyre që nuk i pranojnë kërkesat e Tij. Nëse Zoti do ta kishte dëbuar Satanain që kur ai nisi rebelimin, tërësia e krijimit të Tij do t'i kishte shërbyer atij prej frikës. Dashuria nuk do të kishte qenë në majë të mendjes së çdo krijese, frika do të kishte zenë vendin e saj. Nëse Zoti do të kishte shkatërruar Luçiferin, akuzat që ai kish hedhur ndaj Tij, do të ishin pranuar si të vërteta, mëkati do të ishte i panjohur, dhe qeniet e krijuara s'do të kishin mundësi të shikonin se gjer ku do të arrinin përmasat e tij. Përmes parashikueshmërisë së vet, Zoti i dinte rezultatet, por Universi duhet të qe dëshmitari i të dyjave: dashurisë së Zotit dhe rebelimit të Satanait. Udhë e dashurisë dhe udhë e së keqes duheshin të shfaqeshin tërësisht, në mënyrë që mëkati të mos nginte më krye përsëri. Zoti me mençurinë e Tij e lejoi natyrën e vërtetë të mëkatit të zhvellohej plotësisht. Zoti është dashuri, e fortë dhe jo e dobët, dhe në një kohë të volitshme në të ardhmen, Ai do të bëjë një hap përpara, do të ndalë të keqen përgjithmonë e do të sjellë drejtësinë e përjetëshme.

Tash ne jemi në pozicionin e shtrimit të pyetjes, në se akuzat e Satanait për diktaturën dhe padrejtësinë e Zotit janë korrekte? Mbretëria e Satanait i ka shpënë njerëzit kah dëshpërimi, mashtrim, krimet, vrasjes, vuajtjes, të gjitha llojeve të sëmundjeve, luftave dhe vdekjeve. Ai u bë “princi” i kësaj bote. Ashtu siç tha Pali, njeriu u bë “një spektakël për botën, për engjëjt dhe vetë njerëzit”. (Korint. 4:9). Ndërkohë që kur njerëzit i përgjigjen dashurisë së Zotit, ata bëhen spektakël për Universin, duke provuar njëkohësisht se Satanai është zhytur në gabim.

Njerëzit janë të lirë të pranojnë dashurinë e Zotit dhe planin e Tij për shpëtim ose të përdorin vullnetin e tyre të lirë e ta refuzojnë atë. Mbretëria e Zotit nuk është krijuar nga forca dhe shtypja, ajo është krijuar nga dashuria.

Kjo vërtetohet aftësisht përmes vdekjes së Jezu Krishtit. Zoti dha Birin e Tij të vetëm, në mënyrë që ne të kishim jetën që ishte e Tij. “Drama e Pasionit” e Oberammergau-t e ilustron shumë mirë atë çka bëri Krishti për të përfunduar e keqja, bashkë me planin e Tij, për të hyrë në një mbretërim të harmonisë dhe gëzimit të përjetshëm. Është vërtet e çmuar pranimi i vizionit të Kalvarit dhe ndjekja e shtegut të së vërtetës së Jezu Krishtit, në mënyrë që ne të kemi një pjesë të përjetësisë me Të. Mos e lini jetën tuaj të rrjedhë pa e përdorur vullnetin tuaj të lirë të pranojë vizionin e Zotit për shpëtimin. Është më e lehtë se sa e besojnë shumica.

12 . Pse ka kaq shumë vuajtje dhe dhimbje?

Tregojnë për historinë e një princi persian i cili ishte duke u përgatitur për ardhjen në fron. I ndërgjegjshëm për nevojën e tij për më shumë dije, ai mblodhi njerëzit e tij të mençur dhe i urdhëroi t’i përgatisnin një histori të njerëzimit. 20 vjet më vonë studiuesit i sollën 6000 libra. Shumë i zënë me punët e shtetit, për të shpenzuar kohën me kaq shumë libra, mbreti iu tha që t’i botonin librat e t’i përmbledhnin në një libër të vetëm.

Kaluan edhe 20 vite të tjera dhe studiuesit iu paraqitën mbretit me librin e vetëm që ai kërkoi. Mbreti ishte duke vdekur dhe nuk qe i aftë të lexonte librin. Nga shtrati i tij ai kundroi kah njerëzve të mençur e u bërtiti : “Atëherë unë do të vdes pa e njohur historinë e njerëzimit”. “Zotëri!- ia ktheu njeri nga grupi,- unë do t’ua përmbledh veprat në pak fjalë : “ Njerëzit lindin, vuajnë dhe vdesin”.

Ka pak gjëra për të cilat ne mund të jemi absolutisht të sigurtë në këtë botë; por për një gjë mund të jemi të sigurtë, se do të vuajmë. E po kështu do të jetë e vërtetë se disa do të vuajnë më shumë se të tjerët. Kjo vuajtje i përfshin të gjithë. Të rinj apo të vjetër, të pasur

apo të varfër, të edukuar apo analfabetë, çdokush ndonjëherë duhet të vuajë.

Po përse vallë kaq shumë vuajtje?

Le të mendojmë një djalë të ri me një trup të fortë e të shëndetshëm. Muskujt i ka të fryrë dhe fytyra e tij është e patrembur. I gjithë trupi duhet të fërgëllojë nga një jetë vibruese dhe dallgëzuese. Por kujdes! Është natë dhe rrugët janë të rrëshqitëshme nga shiu. Makina e tij është plot me shokë, të cilët qeshin, të shkujdesur. Kthesa është më e fortë, se sa e mendonte ai, shpejtësia është më e madhe se sa duhet dhe shtylla më afër, se sa ai e priste. Atëherë një goditje, shoqëruar me britma, ngashërime dhe ofshaje; një vajzë vdiq, një tjetër dergjet për vdekje. Ndërsa i riu ka një kafkë të thyer dhe një legen të shembur. Që nga ajo natë, për gjithë pjesën tjetër të jetës, ai do të ketë dhembje fizike, por një dhimbje akoma dhe më të madhe të ngulitur në kujtesë.

Është një vajzë e re. Ajo është e bukur, magjepse, e hijshme. Por kujdes! Ajo vëren një gungë të fortë në gji dhe bërtet: “Nuk mund të ndodhë kështu! Thjesht, nuk mund të ndodhë! Jo mua! Unë kam qenë gjithmonë e shëndetshme”. Por gunga qendron dhe rritet. Frika dhe mosbesimi nuk e tresin atë. Duhet shtrimi në spital dhe operimi. Ajo përsëri qesh. Ata duan ta operojnë përpara se gjithçka të bëhet serioze.

Veçse më pas ajo fillon të qajë : “Oh, jo! Të lutem Zot, mos ma bëj përsëri këtë gjë!” Mirëpo tumori malinj i është përhapur shumë shpejt e shumë thellë. Dhimbje, dhimbje të forta, nisin ta lëndojnë përbrenda gjithë trupin e saj. Ajo lutet, luten edhe miqtë e saj. Por kjo gjë e keqe, e uryer, e grryen dhe e përpin fort. Sytë blu ia humbasin shkëlqimin, kurse mollëzat e venisin rrezatimin e tyre. Nis të rrudhet edhe trupi i gjallë e vibrues. Në fund, ajo fillon të shohë vdekjen si qetësimin e saj të ëmbël.

Çfarë duhet të bëjë një njeri, kur jeta e gropos? Si mund ta vazhdojë jetën një njeri, kur bota që ai njeh, duket të jetë kolapsuar? Kur dhimbjet digjen si zjarr në gjak e çdo qelizë e trurit duket sikur dëshiron të ulërasësh : “S’mundem të vazhdoj dot!”

Kah kujt kthehet njeriu të kërkojë ndihmë, kur të gjithë ndihmesat njerëzore duken të pafuqishme?

Ku gjenden përgjigjet?

Ka shumë libra që orvaten t’i përgjigjen çështjes së vuajtjes njerëzore. Janë shkruar libra nga psikologë, filozofë e predikues. Por e vërteta është që asnjë përgjigje e volitshme nuk gjendet në këta libra që të shpjegojë vuajtjet, që ne të gjithë provojmë herë pas here. Gjithsesi, ndërsa krishterimi mund të mos jetë i aftë të zhdukë vuajtjen, ai ka arritur të sigurojë një rrugë të zhvillimit të burimeve dhe rezervave të tij të brendshme, për të qenë i aftë të jetojë me to e t’i kapërcejë shqetësimet.

Pse njerëzit vuajnë në këtë botë e ku vendoset Zoti në këtë tabllë? Ka mjaft arsye që mund të afrohen si përgjigje në këtë çështje komplekse.

Ndonjëherë vuajtja mund të vijë për fajin tonë. Zoti na ka krijuar si veprues të lirë e moralë. Ne s’ jemi robotë. Përderisa kemi fuqinë e zgjedhjes, është e mundur që të ndërmarrim veprime të gabuara. Zoti ka vënë në veprim edhe ligjet e natyrës, që mund të jenë një bekim, në se u bindemi ose një shkatërrim, në se abuzojmë me to. Ka dhe ligje të shëndetit, të cilat në se nuk përmbushen, mund të na shkaktojnë dhimbje. Ne duhet të pranojmë rezultatet e vendimeve tona, e të përfitojmë nga gabimet. Duket sikur Zoti ka zgjedhur t’i lejojë këto ligje të vijnë, duke ndërhyrë rrallë.

Herë të tjera vuajtja vjen kur ne bëhemi viktima të të tjerëve, ndërsa ata kacavirren dhe lluksohen për pushtet. Ka gjithashtu, edhe

diktatorë e tiranë që duken të begatohen. Edhe kësaj here duket se Zoti ndërhyr shumë rrallë.

Herë të tjera vuajtja vjen prej natyrës, kur ka tërmete, epidemi, tufane, përmytje dhe thatësira. Po le t'i kthehemi Biblës në kërkim të përgjigjeve tona.

Mateu 5:43-45 thotë: “ Ju keni dëgjuar se ç’ju është thënë. Duhet t’i doni fqinjët dhe t’i urreni armiqtë. Por unë po ju them, Duajini armiqtë, bekojini ata që ju mallkojnë, bëjini mirë atyre që ju urrejnë dhe lutuni për ata që , pavarësisht kësaj, ju përdorin dhe persekutojnë, në mënyrë që të bëheni bijtë e Atit tuaj në qiell; sepse Ai e bëri diellin e Tij të ngrihet mbi të mirën dhe të keqen; dhe lëshoi shiun mbi të drejtët dhe të padrejtët”. Vëreni se si të dyja palët ndikohen nga shiu dhe dielli!

Luka 11:11-13 thotë: “Në se një fëmijë kërkon bukë, prej secilit prej baballarëve në mes jush, jo do t’i jepni atij një gur? Ose, në se ju kërkon një peshk, ju do t’i jepni një gjarpër në vend të peshkut? Ose, nëse ju kërkon një vezë, do t’i afronit një akrep? Në se edhe ju, që mund të jeni edhe të këqinj, e dini si t’u jepni fëmijëve tuaj dhuratat të mira, si mundet akoma dhe më shumë, Ati juaj Hyjnor, të mos ua japë Shpirtin e Shenjtë atyre që kërkojnë për Të!” Do të vërejmë më poshtë se ruhen bekime për të gjithë ata që e vendosin besimin e tyre te Zoti.

Shumë njerëz ndjejnë se Zoti i ka harruar e kjo duhet t’u sjellë më shumë dhembje se sa vuajtjet fizike të mishit dhe kockave. Por vëreni se sa larg shkoi Zoti për ne: (Filipianëve 2:5-8)

“Le të jetë te ju edhe ajo mendje që ishte te Jezu Krishti, i cili, duke qenë në formën e Zotit, nuk e konsideronte robëri të qenit i barabartë me Zotin, por e shndërroi veten në njeri pa kurrëfarë fame, duke marrë formën e një shërbyesi, e duke ardhur me njëllorshmërinë e njeriut. I gjetur në dukje si një njeri, Ai e përuli veten dhe u bind deri në pikën e vdekjes, madje të vdekjes në kryq;

Po, Bibla aktualisht na mëson se Zoti erdhi në botë të vuajë e të vdesë për njerëzimin.

Vëreni edhe dy vargje të tjerë mbi këtë subjekt të Hebrenjve, 2:14-15: “Po ashtu siç ngjajnë fëmijët me mish e me gjak, edhe Ai vetë u nda me të tjerët në po të njëjtën mënyrë, që nëpërmjet vdekjes të mund të shkatërronte atë që kishte fuqinë e vdekjes, d.m.th. djallin, e të çlironte ata që nëpërmjet frikës së vdekjes ishin përgjatë gjithë jetës së tyre subjekt i skllavërimit”. Në të vërtetë Zoti dëshiroi të vdiste, që ne të mund të jetojmë. Ky është një vendim i mrekullueshëm, s’ besoni vallë kështu?

Shumica e atyre që kanë lexuar Biblën, mund të pohojnë se ideja më ngazëllyese që po vjen prej saj, në lidhje me Zotin, nuk është mençuria ose fuqia e Tij e pafundme; por dashamirësia e Tij e pafundme. Ata theksojnë faktin se përpara përmbytjes, Zoti ishte i pikëlluar që kishte krijuar qeniet njerëzore, kur pa dobësinë e tyre. Ata kujtojnë se, kur Izraelitët ishin në Egjipt, si skllavër të shtypur, Zoti kishte thënë: “Unë e kam parë mizerjen e popullit tim në Egjipt. Unë e kam dëgjuar britmën e tyre ... e jam i interesuar për vuajtjen e tyre ... (Eksodi 3:7).

Mateu 6:25-34 na sugjeron se Zoti është i interesuar për të gjitha dhimbjet që vuajnë njerëzit nga uria e shkaqe të tjera. Te 2 Korint. 11:22-29 thuhet se “edhe pse Pali vuajti, Ai e dinte se Zoti po përkujdesej për të. Kjo i dha Atij qëndrimin për të vazhduar. Kështu do të ndodhë edhe për shumë, ata që do ta shohin e kuptojnë se Zoti do t’u japë fuqi, që t’ia dalin mbanë në të gjitha provat dhe telashet”. Një numër i madh burrash dhe grash kanë gjetur lehtësim dhe fuqi nga leximi i Romakëve, 8:28-39 ku thuhet: “Ne e dimë se të gjitha gjërat veprojnë së bashku, për të mirën e atyre që e duan Zotin dhe të atyre që thirren të veprojnë në përputhje me qëllimet e Tij. Për ta Ai e paratha, e gjithashtu u destinua të qe në përputhje me imazhin e Birit të Tij, në mënyrë që të ishte i linduri i parë mes shumë vëllezërve të tjerë”.

Kushdo që e ka lexuar këtë pasazh ka vërejtur se, jo të gjitha gjërat që ndodhin te ne janë të gjitha të mira, por që Zoti ende vepron në jetët tona. Ai ende i kontrollon ato. Ai kërkon të na bëjë si Jezusi në karakter. Nga ana tjetër, njerëzit ndiejnë lehtësim e fashitje duke lexuar vargjet 16-17, ku pohohet se , nëse i ndajmë vuajtjet e Jezusit, ne do të ndajmë gjithashtu edhe lavdinë e Tij.

Pse u ndodhin gjëra të këqija njerëzve të mirë?

“Unë e urrej Zotin! E urrej Atë!” Atmosfera ishte e tendosur, e gruaja e ve fliste me shumë pasion. Vizitori i saj ishte i nervozuar e ndikuar nga shpërthimi i beftë, ndaj e pyeti: “Po, përse vallë, e urren Zotin?” Kur isha shtatzënë , - u përgjigj ajo rrufeshëm,- unë lutesha pa pushim për jetën e fëmijës tim, po kështu edhe kur ai lindi. Më pas, im vëlla u përfshi në një aksident rrugor, ku qeshë dëshmimtare edhe unë. Ai u zu në kurth në një makinë në flakë dhe vdiq duke u përpjekur të më hapte derën e pasme, që unë të shpëtoja. Zoti nuk i dëgjoi britmat tona. Ndaj unë e urrej Atë!”

Një gjysh i trishtë dhe i turbulluar shkroi këto rreshta: “Gruaja ime dhe unë kishim një vajzë dhe dy mbesa të vogla që ne i adhurim. Që të trija u vranë në shpërthimin e një tornadoje. Vajza jonë ishte vetëm 21 vjeçe, ishte e bukur dhe e shëndetshme, dëshironte aq shumë nga kjo jetë. Ishte një nënë shumë e mirë për fëmijët e saj dhe i donte ata vërtet shumë. I varrosëm bashkë në të njëjtin varr. Ishte diçka që s’ mund ta harrojë kurrë. Një makth i vërtetë. Përpiqesha të jetoja si një i krishterë. Dhe, që nga ajo ditë lutesha vazhdimisht që Zoti të na tregonte arsyen e të na jepte përgjigje. A mendoni vallë, se Zoti ka një arsye dhe një qëllim për një gjë të tillë?

Ky gjysh po përpiqet të qendrojë fort në besimin e tij, në Zot, pavarësisht kësaj tragjedie. Po jo të gjithë sillen kështu, p.sh. një njeri i hidhëruar pyet: “Pse ekzistojnë vallë, dy klasa njerëzish në tokë, disa të cilëve u është dhënë çdo aftësi e mundësi që në lindje, për të fituar çdo gjë që duan në tokë, e disa të tjerë që lindin mendërisht të

vonuar dhe fizikisht të deformuar, sa të mos kenë asgjë normale? Mos vallë Zoti mendon se këta të pafat nuk duhet të dëshirojnë asgjë nga kjo jetë? Në se dikush pagan, pse jo të gjithë?

Ne s' kemi jetuar kaq gjatë në këtë tokë, përpara se të kuptojmë se këtu ka diçka tmerrësisht të gabuar. Ekziston një masë e stërmadhe vuajtjesh kudo përreth nesh. Jo të gjithë vuajnë njësoj, por shumica e vuajtjeve ngjan të jetë e padrejtë. Nuk është pa arsye fakti që këngët më popullore janë ato të trishtat. Ka mjaft filozofi të ndryshme me njëra-tjetrën, që përpiqen ta trajtojnë çështjen e vuajtjes, po ky nuk është padyshim një problem për atesitët. Pse vallë ata duhet të presin diçka krejt të ndryshme? Nëse nuk ekziston Zoti, pse çdokush duhet të ankohet? Kujt i ankohen vallë njerëzit? Çdo gjë është ashtu siç e kanë determinuar ligjet e natyrës. Problemi ekziston vetëm për besimtarët e Zotit të Biblës. Shumë kanë thënë se problemi i së keqes dhe vuajtjes janë “thembra e Akilit të krishterimit”. Kjo shndërrohet në një problem, kur ju kuptoni atë çka Zoti i Biblës shpall për vetveten. Vëreni pasazhin e mëposhtëm.

“Zoti u shfaq përpara nesh në të shkuarën, duke thënë : “Unë ju desha me një dashuri të pashtershme; Unë ju krijova me dashuri- me ëmbëlsi (Jeremia 31:3). Kujtojeni gjithmonë gjërat e mëparëshme, ato të shumë kohëve më parë; Unë jam Zoti e nuk ka asnjë tjetër si unë; Unë jam Zot e nuk ngjaj me askënd; Unë e njoh fundin prej fillimit, e di që prej kohëve antike se çdo të ndodhë. Unë them se qëllimi im do të rrojë përgjithmonë”. (Isaia 5:9-10).

Duke njohur ato çka Zoti i Biblës shpalli për vetveten, pse mund të mendoni se vuajtja në këtë botë mund të konsistojë një problem për pranimin e besimit të krishterë?

Shumë njerëz pyesin : Është vallë, Zoti që tund tokën dhe krijon tërmetet? A mos vallë luan Zoti me valët e baticave? A mos po përgatit një kometë të na fshijë nga kjo tokë? Si përshtatet vallë, Zoti me këtë botë që bëri për ne? A mos varet Ai shumë afër nesh, sa për të na rrokur, dhe me një të lëvizur të krahut, shkakton një vdekje tragjike apo një vërshim përmbytës? Apo mos i heshtur Ai rri si

spektator, ulur në një karrige lëvizëse, duke lejuar botën të shprishet përgjatë luftrave, dhunës e tragjedi? A është vallë Ai përgjegjës për vdekjen tragjike të princeshës Diana?

Bibla ia jep fajësimet për të gjitha vuajtjet një personi të vetëm.

“Ji vigjilent dhe i vetë-kontrolluar. Armiku yt Djalli kuturis përqark si një luan bulëritës në kërkim të një preje për ta përpirë”. (1 Pjetrit 5:8). Po nga ku vallë, erdhi kjo qenie? “Ai u përgjigj : “Unë e pashë Satanain të bjerë si rrufe nga Qielli (Luka 10:18)

Ne mund të ravijëzojmë historinë e kësaj qenie, në se do të lexonim Biblën në pasazhet e mëposhtëme. Lexoni Isaian 14:12-14 dhe Ezekielin 28: 13-17. Këto pasazhe na tregojnë se pat ekzistuar një kohë, kur një krijesë e mrekullueshme, pranë fronit të Zotit, shkoi në rrugë të gabuar dhe u rebelua ndaj Zotit. Mos vallë, si rezultat i këtij rebelimi kundra Zotit, ndodhi një luftë në qiell që shkaktoi probleme për ardhjen në tokë? Vëreni se ç’ ndodhi? Zbulesa 12:7-9 thotë: “E lufta shpërtheu në Qiell: Mikaeli dhe engjëjt e tij luftuan me Dragoi; luftoi edhe Dragoi me engjëjt e tij, por Satanai s’ia doli dot, nuk mbeti më vend në Qiell për të. Kështu dragoi i madh u dëbua, u dëbua ai gjarpër i moçëm i quajtur Djall dhe Satana, që mashtroi gjithë botën; Ai u dëbua në tokë, e bashkë me të u dëbuan edhe engjëjt e tij”. Atëherë, vëreni edhe vargun 12. “Ndaj gëzohuni, o Qiej, dhe ju që do të banoni në ta! Dhimbje paçi ju banorët e tokës dhe të detit! Se Djalli ka ardhur poshtë me ju, me ngut të madh, se ai e di që ka veç pak kohë”. Bibla na jep kështu fajtorin për problemet e tmerrshme të dhimbjes e vuajtjes.

Ju mund të pyesni : “Pse vallë, zoti s’i fshin nga ekzistenca atë dhe engjëjt e tij? Pse vallë, Ai e lejoi këtë të keqe të zbrësë në tokën tonë? Kjo nuk është një pyetje e lehtë për t’iu përgjigjur. Krishterët besojnë se Zoti, në se do e kish bërë këtë gjë, do të krijonte probleme të tjera. Engjëjt e tjerë që do t’i kishin qëndruar Zotit besnikë në Qiell, do fillonin të mëdysheshin. Asnjëri prej tyre nuk kishte përjetuar një rebelim kundra Zotit ose kish qenë dëshmimtar i pasojave të tij. Mund të kishte ndodhur që ata të prireshin t’i

shërbenin Zotit nga frika dhe jo nga dashuria. Zoti i Biblës e zhvellon veten si Zoti i dashurisë, që dëshiron që të gjitha krijesat e Tij t'ia shpërblejnë me dashuri. Ai dëshiron t'u japë atyre vullnetin e lirë ta bëjnë një gjë të tillë, ose vullnetin e lirë ta hedhin Atë poshtë. Dashuria e vërtetë nuk mund të tryshohet. Dashuria e vërtetë mundet të ekzistojë në një atmosferë lirie.

Romakëve 3:4 dhe Zbulesa 15:3-4, duket të nënkuptojmë se Zoti gjendet diku për të gjykuar. Në fund të kohës ekziston një skenë, kur ata që janë në Qiell i luten Zotit, për shkak se tashmë ata mund të shohin se Ai kish qenë i drejtë dhe i ndershëm në gjithçka që kish bërë me ta.

Ndërkohë që ne jetojmë në një botë, ku gjithçka duket e përmbysur. Shumë nga gjërat që ndodhin nuk kanë kuptim. Ndoshta ka rregulla që duheshin zbatuar në këtë konflikt, për të cilat ne nuk kemi dijeni. Në Bibël është shkruar një libër i tërë për të hedhur dritë mbi to. Është libri i Jobit. Ironikisht të krishterët vuajtës fitojnë lehtësim me leximin e këtij libri. Kapitulli i parë flet për historinë e një njeriu të mirë që besonte në Zot, por bota e tij u rrënua e tëra dhe ai filloi të vuante pamasësisht.

Kapitulli i dytë tregon se nuk ishte Zoti që ia kishte shkaktuar këto probleme, po se Ai kishte lejuar Satanain ta bënte këtë. Miqtë e Jobit i rrinin pranë duke i dhënë ngushëllim e simpati. Ata uleshin në shtëpinë e tij për shumë ditë pa thënë asgjë. Kjo ishte gjëja më e mirë që mund të kishin bërë, pasi kur hapën gojën, për të shpjeguar vuajtjet e Jobit, ata veç i dhanë atij këshillat e gabuara. Ajo çka duhej t'i thoshin ishte kjo: "Job, Zoti po përpiqet të të thotë diçka. Ti ke vuajtur pamasësisht, e duhet të ketë një arsye. Arsyeja e vetme logjike është se ju duhet ta keni zemëruar Zotin nëpërmjet mëkatimit. Ndaj, rrëfeji mëkatet e Zoti do të ta lehtësojë mizerien". Jobit iu dha edhe një mundësi tjetër nga gruaja, e cila i sugjeroi: "Të mallkonte Zotin e te vdiste".

Gjithsesi, Jobi nuk mund të pranonte çfarë i thanë. Ai s' mund të mendonte se ç' kish bërë për të merituar çfarë i ndodhi më pas. Në

mes të mizeries së vet ai dëshironte të gjente Zotin dhe të fliste me Të. Në fund Zoti u shfaq dhe skena që ndërtuar e tillë, që Ai të shpjegonte gjithçka kish ndodhur. Por, çuditërisht Zoti nuk dha asnjë shpjegim. Në vend të kësaj Ai renditi të gjitha krijimet e mëdha të natyrës dhe pyeti, nëse Jobi mund t'i shpjegonte. Por Jobi nuk mundej; Zoti atëherë tha se Ai nuk mund ta kuptonte atë ç' kish bërë; ai vetëm duhet të besonte. Jobi mësoi se Zoti përkujdesej për të dhe se Ai qeveriste botën. Kjo mjaftonte. Në fund Jobit iu rikthyen të gjitha gjërat. Ai mori shumë më tepër nga ç' kish pasur. Sidoqoftë, përpara se kjo të ndodhte, atij i duhej të jetonte me besim e jo me intuitë. Atij iu tha të besonte Zotin, edhe kur gjërat nuk kishin kuptim.

Kjo është ajo çka Bibla thotë në lidhje me këtë temë. Ajo nuk i jep të gjitha përgjigjet; por në këtë mënyrë ajo i jep shpresë dhe i zbut dhembjet. Ne dëftuam një arsye të përgjithshme, pse Zoti zgjodhi të lejojë vuajtjen dhe vdekjen të mbretërojnë për një kohë në këtë botë. Po përse bota duhet ta lerë mënjane një njeri? S' mund ta themi e as ta hamendësojmë përse. Zoti, një ditë, do të qartësojë gjithçka. Ndërkaq, le ta besojmë Atë. Le të ushtrojmë besimin e thjeshtë që kanë fëmijët, kur besojnë në prindërit e tyre.

Zoti nuk është dikush jashtë Universit, moskokëçarës për shqetësimet tona. Ai ka hyrë në botën tonë dhe ka vuajtur bashkë me ne. A s' është kjo gjë një ngushëllim i madh?

13 . Kisha e mrekullueshme kelte e Britanisë

Krishtërimi primitiv në Britani njihet më mirë përmes keltishtes, një gjuhë indo-europiane e një grupi emigrantësh që u shpërhap kudo,

nëpër Europë dhe në Britani, prej punëtorëve të minierave së kripës pranë Halstadt, Austri. Këta emigrantë u vendosën në Kornuoll, në jug-perëndim të Uellsit, në Skoci dhe Irlandë. Aspekte të rëndësishme të jetës së keltëve zhvellojnë se ata qenë të parët në Britani që përqafuan krishtërimin dhe, se ata ishin të vullnetshëm në ndjekjen e besimit dhe praktikës së të krishterëve primitivë të Dhjatës së Re, të cilët njihen vërtet si njerëzit themelues të kishës së krishterë. Në se nuk dihet saktësisht viti se kur mbërriti për herë të parë krishterimi në Britani, pohohet se besimet dhe praktikat origjinale u ruajtën që më parë dhe pas misionit italian të Agustinit në vitin 597 p.K.

Ndërsa disa legjenda pohojnë se dhe Jezusi vetë shkoi në Britani, me shumë gjasa është korrekte të thuhet se disa nga ndjekësit e Jezusit rrugëtuan deri në Britani, pasi u dëbuan nga Palestina, në kohën e shkatërrimit të Jeruzalemit në vitin 70 p.K, ose më vonë prej kanosjeve të hebrenjve. Me pushtimin e Britanisë nga Romakët shumë europianë dhe të krishterë të Lindjes sollën sektin e tyre të veçantë të krishterimit në Britani. Cilado qoftë koha e themelimit të kishës në Britani është mëse e qartë se ajo arriti të nxjerrë disa udhëheqës të shkëlqyer të tillë si, Patriku i Irlandes, Kolumba, i cili forcoi lidhjen besimit kishtar në Skoci, Davidi i Uellsit dhe Aidan-i i Anglisë-për të përmendur vetëm disa prej tyre.

Shumica e informacionit që njihet mbi kishën kelte në Irlandë, fillon me epokën e Patrikut. Ky udhëheqës i hershëm lindi në Kirkpatrik, Skoci, në vitin 389 dhe, pasi kaloi disa vite si skllav në Irlandë, dhe pastaj si mërgimtar në kontinent, u kthye përsëri në Irlandë. Aty ai plotësoi si shërbëstar nevojat shpirtërore të njerëzve, në mënyra nga më të paharrueshmet. Ka disa dëshmi, por jo të identifikuara ose tërësisht të dokumentuara, se Patriku u kthye edhe një herë, për një kohë të shkurtër në Skoci. Sidoqoftë, Kolumba shkoi në Skoci, pasi shërbeu për pak kohë si prift në Irlandë, ku ai themeloi një numër manastiresh dhe kishash. Ai themeloi edhe vend-qëndrimin e Iona-s, i cili që atëherë u shndërrua në vendin më të shenjtëruar në gjithë

truallin skocez. Gjatë shekujve VII-XI, 48 mbretër skocezë u dogjën në Iona. Disa nga gurët e varreve të tyre mund të shihen ende dhe sot. Një “Iona” e dytë u ndërtua nga Aidon në “Ishullin e Shenjtë të Lindisfarne-it”. Ky “ishull” në veri të Anglisë, u bë një bazë e mrekullueshme për propagandimin e Ungjillit në Angli dhe në pjesët e kontinentit.

Le t’ i hedhim një sy disa prej besimeve kryesore të krishterëve keltë që u bënë promotorët e këtij besimi kudo nëpër Ishullin Britanik.

Shkrimet e Shenjta

Si Dhjatae Vjetër ashtu dhe ajo e Re, siç i njohim ne sot, u pranuan si Shkrime Hyjnore për t’u lexuar dhe për t’u predikuar. Ata nuk shfaqën kureshtje të njihnin shkrimet Apokrife, të cilat u përfshinë më vonë në Shkrimet e Shenjta të besimit të Romakëve katolikë. Theksi u vu në autoritetin Biblik e kjo i udhëhoqi ata në zbatimet praktike të ligjeve të mëdha të jetës që parashtrohen në Shkrimet e Shenjta.

Një udhëheqës i hershëm i kishës kelte, Kassian, i inkurajoi njerëzit t’i linin mënjëanë të gjitha librat e tjerë, madje edhe komentaret, për të qenë të devotshëm vetëm në leximin e Shkrimeve të Shenjta. Në një rast, kujtohet se dy njerëz, Germanusi dhe një Abbat, me emrin Nestorus, po flisnin së bashku. Germanusi pyeste se cila ishte rruga më e mirë për të hequr nga mendja nocionet e autorëve paganë. Nestorusi u përgjigj : “Lexoji Shkrimet e Shenjta me të njëjtin zell që i ke lexuar këta libra e mendimet e tua do të kthjellohen”. Ç’ shembull i mirë në ditët e sotme për inkurajimin e leximit të Shkrimeve.

Irlanda shpejt u bë një qendër për studimin më të thellë të këtyre shkrimeve. Kujtohet se Finnian themeloi një shkollë në Clonard (tani Clonmacnoise) e cila gjatë një periudhe të caktuar tërhoqi rreth 3000 studentë nga i gjithë kontinenti, po ashtu si dhe nga Anglia. Ata vinin

parësisht për të studiuar Shkrimet e Shenjta. Një poet i shekullit 17-të, B. Moronus e portretizon aq bukur këtë prirje:

Nxitojnë tash Shambrët nga i rrëmbyeshmi Rin;
I lënë djerrë tash Bohemianët toka e tyre të ftohta veriore;
Avernja dhe Hollanda bashkë, i bashkohen baticës,
Tej nga shkëmbinjtë e brymtë të Gjenevës ata gëlojnë;
E paktë është rinia helvete e Ronës dhe Saonës,
Po ishulli i perëndimit tash është shtëpia e tyre.
Nga aq shumë vende, nëpër aq shumë rrugë të ndryshme,
Rivalë në zellin e devotshmërisë, ata kërkojnë
Të mblidhen në vendin e famshëm të Lismorit!

Tërheqja ndaj Shkrimeve ishte e konsiderueshme. Kjo ishte e njëjta platformë mbi të cilën qenë mbështetur Pali dhe të gjithë dishepujt. (II Timoti 3:16, 17, “Të gjitha shkrimet u shkruajtën nga frymëzimi i Zotit, e kjo është me mjaft përfitim për doktrinën, për provimin, për korrigjimin e për predikimin në drejtësi, në mënyrë që njeriu i Zotit të jetë i plotësuar e tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë”).

Shpëtimi

Kjo doktrinë qendrore e besimit të krishterë, u mësua me shumë pasion. Ajo u parashtrua si doktrina e drejtësisë vetëm përmes besimit të Krishtit dhe jo te ose përmes veprave njerëzore. Mëkatarët nuk mund të kërkojnë mirësi tjetër, përveç mirësisë së Krishtit. Veprat e mira nuk janë një portëkalimi në qiell, por ato kryhen nga njerëzit, sepse ata e duan Krishtin që tha: “Nëse në don mua, atëherë zbatojini urdhërimet e mia”.

10 Urdhërimet e Zotit

Shumica e kishave të atëhershme kelte, përfshinte një recitim të urdhërimeve në shërbesat e veta. Patriku kishte besim të thellë te 10 urdhërimet e besonte se përmes hirësisë së Krishtit, është e mundur që njerëzit t'i zbatojnë të gjitha ligjet e Zotit. Si Patriku, ashtu edhe Kolumba, përdornin në mënyrë të veçantë pesë librat e parë të shkrimeve si bazë për shumicën e predikimeve të tyre.

Sabati i ditës së shtatë

Në fe dhe praktikë keltët ishin besimtarë të 10 urdhërimeve. Për shembull, Sabati i ditës së shtatë të urdhërimeve, zbatohej në Irlandë, Angli, Skoci, po ashtu si dhe në Uells. Një letër e Colambanus pohon: “Ne jemi të shtërnguar të punojme gjashtë ditë, por të shtatën e cila është Sabat, ne shkëputemi nga çdo punë tjetër. Edhe prej vetë numrit gjashtë nënkuptohet përmbushja e punës sonë, përderisa gjashtë ishin ditët, kur Zoti bëri tokën dhe Qiellin. Ndaj ne në Sabat jemi të ndaluar të bëjmë ndonjë tjetër lloj pune, përndryshe kjo është mëkat”. Konteksti prej nga është shkëputur ky pasazh zhvillon se shkrimtari besonte se Sabati ishte e shtuna.

Më vonë, vijuan ndikimet Romake në ruajtjen e së shtunës, por kjo është diçka tjetër. Kjo përmendet gjithashtu edhe nga Dan Braun në veprën e tij letrare “Kodi i Da Vinçit”.

Në Skoci, deri në shekullin 13-të, një numër i madh keltësh e konsideronin Sabatin nga perëndimi e së premtes deri në perëndimin e së shtunës. Kujtohet dhe Davidi i Uellsit që pohonte se “mbajtja e Sabatit, sipas tij, bëhej nga perëndimi i një dite në perëndimin tjetër”. Ai e fillonte përkushtimin e “Sabatit” të tij në perëndimin e ditës së premte. Kjo ishte “mbrëmja e Sabatit”. Miurchu kujton se: “Patriku dhe Viktriciui takoheshin çdo ditë të shtatë të javës për lutje dhe bashkë-kuvendime shpirtërore”. Kjo thuhet edhe te Shkrimet, ndaj ne duhet të presim që njerëzit që e duan Biblën, ta gëzojnë atë duke mbajtur Sabatin.

Le të shqyrtojmë shumicën e arsyeve pse Sabati kremtohej nga keltët dhe pse më vonë ai u gjend në një pozicion çnderimi nga pjesa tjetër e Britanisë, kur ata u bënë të krishterë.

1. Kisha e hershme e krishterë tërhoqi vëmendjen e shumë hebrenjve që nisën të konvertohen. Në këtë mënyrë kisha më e hershme u bë pjesa e komuniteti hebre. Këta hebregj nuk e mbanin Sabatin sepse ishin hebregj, por në nder të krijuesit dhe në bindje të urdhërimit të katërt.

2 . Gnosticizmi dhe Mithraizmi ngjallën shpejt tensione në mendimin e krishterë. Shumica e Gnostikëve “kremtonin të dielën e çdo jave, jo si pasojë e Ringjalljes së Krishtit, se kështu do të kishin qenë të papajtueshëm me Docetizmin e tyre, por si një ditë që i shugurohej diellit, që ishte në fakt Krishti i Tyre”. (A.Neandar, Historia e përgjithshme e kishës dhe fesë kristiane II”, fq. 194).

G. L. Laing “Të mbijetuarit e besimit Romak”, fq. 148, vazhdon të pohojë po njësoj: mbajtja jonë e së Dielës si dita e Zotit, është e prejardhur nga Mithraizmi. Argumenti që përdoret ngandonjë herë kundra këtij pohimi , d.m.th. se e diela u zgjodh sepse në këtë ditë ndodhi Ringjallja, nuk është mirëpeshuar. Shumë historianë mbështesin pikëpamjen se në Perandorinë Romake, ku nuk ekzistonte anti-semitizmi, të krishterët vijuan të ruanin mbajtjen e Sabatit të ditës së shtatë”.

3 . Keltët nuk u përballën me anti-semitizmin në Britani, sepse ata gjendeshin në periferi të Perandorisë Romake. Për disa shekuj, më pak kundërshti, ata mbetën Sabat-mbajtës. Kjo traditë në Skoci që më e fortë se në Irlandë. Veçanërisht në lëvizjet misionare, që shpërhapeshin prej ishullit Iona-s, po njëlloj si dhe nga Ishulli i Shenjtë i Lindisfarne-it, që gjendej në jug të kufirit skocez.

Nuk ka ndonjë dokument në lidhje me faktin që Patriku të ketë thënë diçka rreth takimeve të së Dielës ose nderimeve të kësaj dite. Gjithsesi, shekuj pas vdekjes së tij, rrëfenjat popullore u bënë të përhershme rreth së Dielës së Patrikut, kur ai kryente aktivitete, në

vend që të inkurajonte Irlandezët të mbanin të Dielën si Sabat. Po në të gjitha këto, gjenden referime për domethënien e veçantë që Patriku i bashkëngjiste Sabatit. “Një Himn për lavdinë e Shën Patrikut” një Engjëll i flet Patrikut kështu: “Ju do të nxirreni nga dhembjet (e Ferrit) shtatë herë, çdo të enjte dhe 12 herë çdo të shtunë”

Davidi i Uellsit ishte një tjetër udhëheqës kelt. Prej tij kujtohet ky pasazh: “Që nga mbrëmja e Sabatit gjer kur drita të ndriçojë në orën e saj të parë, pas lindjes së ditës së Sabatit, ata e punë-zënë vetveten me kundrime, lutje e gjuhë-ujë, përveç një ore të shërbimit të mëngjesit të Sabatit”. “Mbrëmja e Sabatit ishte në perëndimin e së premtes. Sabati mbahej si një ditë e bekimit në Uells, njëlloj si në Irlandë dhe në tokat e tjera kelte.

Gjurmë të mbajtjes së Sabatit në ishujt Faroe (pranë Norvegjisë) dhe Islandës janë gjetur në bazë të studimeve të O. A. Anderson në veprën e vet: “Monumenta Historica Norvegia”, fq. 39. Në këtë libër ai diskuton faktin se banorët e hershëm të këtyre trojeve iu bashkangjitën Judaizmit. Kjo është një referencë e qartë e mbajtjes nga ana e tyre e Sabatit. Në fakt, njihet se misionarët keltë u shpërngulën prej Iona-s në ishujt Hebrides dhe që prej Lindisfarne-it, jo vetëm në kontinentin European, por edhe në klimat e ashpra të Islandës dhe ishujve Faroe.

Shekujt e fundit të Sabat-mbajtjes

Është krejt e mundur që kujtimi i Davidit të Uellsit dhe tradita e tij e Sabat-mbajtjes të lidhet me një interes të ngushtë të studimit të Biblës, por përsëri shumica e Uellsianëve shfaqen si Sabat-mbajtës në shekullin e 17-të dhe të 18-të (Shiko Bryan W. Ball “Njeriu i ditës së shtatë”, fq. 223-224). Kemi një rritje domethënëse të ruajtjes së traditës së Sabatit në shumë pjesë të Britanisë gjatë kësaj periudhe të historisë.

Është interesante të përmendet se më shumë se një shekull më parë Finlanda kishte një lidhje me mbretin Gustavus Vasa të Suedisë, i cili qeveriste Finlandën. Ai u dërgoi një epistull finlandezëve, duke u diktuar ndalimin e mbajtjes së Sabatit, në mënyrë që në vend të tij të përdornin energjitë në nderimet e së dielës. Ishte pasuesi i vet Mbreti Gustav Adolfi II (1594- 1632), i cili shpalli dënimin me vdekje të Sabat-mbajtësve. Gjithsesi, Norlin në veprën e tij “Sevenska Kyrkans Historia” pohon se disa persona “më mirë japin jetën, se sa t’i ndryshojnë opinionet e tyre”. Është e qartë që edhe pse Shkrimet e Shenjta lexoheshin asokohe me mjaft interes, përsëri shumë njerëz e kuptonin “Sabatin e Zotit” më tepër si një ditë që u përforcua nën ndikimin e Konstantinit dhe të perandorive të mëvonëshme të Romës.

Sot ne kemi sfidën e ruajtjes së Sabatit, ashtu si Zoti e mendonte, pavarësisht materializmit dhe shekullarizimit. Bota jonë bashkëkohore është e joshur nga një ditë që sjell pushim nga trysnitë e jetës dhe që ajo të jetë një ditë gëzimi dhe paqeje. Kjo mund të jetë sfida më e madhe për Sabat-mbajtësit modernë: të propagandojnë përsëri ditën që Zoti i dha njeriut për ta bekuar atë në një mënyrë që të mos ketë ditë tjetër të bekuar! Në se Zoti e shenjtëroi, pusho, shplodhu dhe bekoje atë ditë, se ajo mund të ketë domethënie për çdo kohë dhe veçanërisht për kohën e sotme. Le të përmendim edhe dy besime të tjera që iu bashkangjitën keltëve në ishujt britanikë.

Pagëzimi

Pagëzimi (baptizmi) ndodh përmes kredhjes në ujë, dhe fjalori e shpjegon atë si një përmbushje simbolike të vdekjes së Krishtit, varrimit dhe Ringjalljes. “Kur ne kalojmë te Pagëzimi, ngjet ngjashmëria e varrosjes së Tij dhe vdekjes për ne”. (Ky është një komentari i Romakëve 6:1-6). Patriku thotë se përpara pagëzimit, një

njeri duhet të predikohet, një mësim ky që duhet të vazhdojë edhe pas pagëzimit (Mateu 29:19, 20). Po, edhe një herë tjetër, çdokush mund të jetë një dëshnimtar i zoti i pajtueshmërisë së fortë të mësimëve të keltëve me ato Biblike origjinale.

Në kundërshtim të fortë me ta ishte Agustini, i cili e udhëhoqi shpurën e vet italiane nga Italia në Britani. Edhe ai e predikonte pagëzimin, por kishte diferencë me metodën e përdorur nga keltët.

Në vitin 601 p. K. me kërkesën e tij, mbreti i Kentit, udhëhoqi 10 000 njerëz kah deti dhe i pagëzoi ata me tehun e shpatës. Kështu që, nuk duhet të habitemi, pse ka kaq shumë paganizëm të ndërhyrë në kishën e krishterë. Njerëzit e pranuan krishterimin nën presion më tepër se sa përmes konvertimit.

Ardhja e dytë

Patriku tha: “Ne presim për ardhjen e Tij të dytë, si të një gjykatësi të të gjallëve dhe të vdekurve”. Ngjarja finale e ditëve të fundit të tokës besohet të jetë Ardhja e dytë e Krishtit. Lutësit e tij të zjarrtë, përgjithësisht e parashikojnë si të shpejtë mbërritjen e shpëtimtarit, që ata e prisnin të vinte me lavdi, për t’i mbartur mbi vete njerëzit e Tij.

Historia mbresëlënëse e keltëve na ndihmon të kuptojmë se sa larg kemi shkuar në shtrembërimin e mësimëve zanafillore të krishtera. Besimi dhe praktika e tyre ishin Shkrimet e Shenjta, që mbështeten deri më sot nga shumë të krishterë anëmbanë globit. Zoti dëshiron dhe i inkurajon njerëzit të jetojnë sipas fjalës së Tij.

14 . Pushimi që i nevojitet botës

Shkrimet e Shenjta u zhvellojnë të gjithëve një pushim të vërtetë. Jezusi vetë e kuptoi se njerëzve u nevojitet pushimi. Shikoni Mateun 11:29: “Ejani tek unë të gjithë ju që jeni rënduar keqazi, e unë do t’ju jap shpłodhje shpitrave tuaj”. Në këtë pasazh është pikërisht kjo shpłodhje e pushim, për të cilën ne duam të ndajmë bashkë disa vëzhgime. Shpesh i dëgjojmë njerëzit të thonë: “Jam i lodhur, doja vetëm të kisha sa më shumë pushim”. Ndoshta kushdo ndihet shpesh kështu. Libri i hebrenjve në disa vargje flet për këtë nevojë. Shiko Hebrenjve 4:1-11, ku në fund sugjerohet se “ne punojmë për të hyrë në pushimin e Tij”

Kur zgjedhim të hyjmë ne pushimin e Tij, shfaqet përgjithësisht një ndryshim i vërtetë në stilin e jetës. Shumica prej nesh kanë nevojë për atë ndryshim, që vjen gjithmonë për të mirë. Kur shumë njerëz hyjnë në pushimin e Tij, ata mësojnë “të flenë” më mirë. Shumë prej njerëzve mbartin mbi vete pesha të rënda shpirtërore, nëse ia lënë ato Krishtit, është e jashtëzakonshme diferenca në gjumin e tyre. Ata gjithashtu kanë më shumë kohë për gjumë, nga atë kohë që shpenzonin më parë për të ndezur qiri pas qiriri gjithë natën. Edhe zakonet “e të ngrënit” shpesh kanë nevojë për ndryshim dhe ardhja e pushimit të Jezusit, sjell me vete një dëshirë për ushqime më të mira e më të shëndetshme, që të kontribuojnë sa më fort në shëndetin e mirë të sa më shumë njerëzve. Shto këtu ushtrimet fizike dhe ajrin e freskët, që shumë njerëz e kanë humbur, për t’u ndeshur kështu menjëherë me disa nga përgjegjësitë e krishtera. Frymëmarrja e thellë dhe ushtrimet e vazhdueshme e gatisin trupin të jetë në formë, në mënyrë që ne ta vlerësojmë krijuesin sa më mirë.

Vlerësimi është një tjetër temë e shkrimeve, që shumë njerëz e kanë harruar, si një pjesë të stilit të tyre të jetës. Vlerësimi ndaj krijuesit të Universit sjell shumë bekime dhe fryte gëzimi në jetën e një personi. Njeri prej këtyre bekimeve është përkujdesja ndaj të tjerëve. Ashtu siç tha Jezuesi: “Është më bekuese të japësh, se sa të marrësh”. Kjo përkujdesje mund të jetë në kohë, në të mira apo në fonde. Unë besoj se ju po filloni të kuptoni se “hyrja në pushimin e Jezusit po përfshin tërë jetën tonë dhe ky është shkaku, pse na ndryshon stili i jetës. Për mijëravjeçarë, Satanai është orvatur të sjellë kundërshti ndaj “pushimit” që njerëzit mund të kenë te Krishti. Ai na siguron se jeta shndërrohet në një barrë, në një tollovi të pareshtur aktiviteteve që nuk të shpien askund. Kjo ndodhi në kohën e Mbretit Ahab, kur ai u martua me Jezebelin, një profeteshë që vlerësonte Baal-in. Baalbek, në Liban, ishte një komunitet tipik diell-nderues me tempujt e vet, sallat e banketeve dhe oborret për përgatitjen e priftërinjëve. Përgjatë historisë njerëzit i drejtoheshin diellit për vlerësim dhe adhurim. Tek e fundit ai u falte dritë, shpresë e ngrohtësi. Mbreti Ahab dhe Jezebeli u ngërthyen në një botë materialiste, mes priftërinje që nderonin diellin dhe që e udhëhiqnin Izraelin larg Zotit. Ata nuk e konsideronin pushimin e Zotit, ndaj u mënjanuan nga nderimi i Zotit në ditën e Tij të Shenjtë.

Është interesante se si Libri i Shenjtë i Muslimanëve, Kurani, është i bazuar te Shkrimet e Shenjta. Gjashtë herë ai tërheq vëmendjen në vlerësimin e sabbatit, por muslimanët e mbajnë të Premten, si ditë të Shenjtë. Kjo është dita e tyre tradicionale e nderimit. “Rrëfimet e moçme të vendosjes së pushimit javor të muslimanëve, tregojnë vetëm një lidhje midis saj dhe feve të mëparshme: mësimet e dhëna nga Muhameti, ndaj përfaqësuesve të vetë në Medina, për mbajtjen e shërbimit publik, në ditën, kur Hebrenjtë sollën të parathënat e tyre për Sabatin”. (Kashani, Bada’i al-sana’i; Kajro 1327/8, I, 268).

Gjithsesi, të krishterët që vlerësojnë ditën e parë të javës, e kanë marrë këtë traditë nga Paganët. Ky pohim që Dan Brauni bën në veprën e vet letrare “Kodi i Da Vinçit”, mund të jetë njeri nga

pohimet më të vërtetë të librit. Vëreni këtë pasazh: “Originalisht” tha Langdoni, të krishterët nderonin Sabatin Hebre të së Shtunës, por Konstantini e zhvendosi atë që të përkonte me ditën e nderimit pagan të diellit... Ndaj, ende dhe sot , shumë kisha i mirëpresin shërbimet në mëngjesin e së dielës, pa më të voglën ide se ato janë vijim i traditës së tributit pagan të nderimit javor të Zotit diell.

Sabati te Krijimi

Le të kthehemi te Krijimi dhe të trajtojmë pushimin që Zoti i dha njerëzimit që në fillimet e Tij. Te Zanafilla 1:31 : “Zoti pa çdo gjë që kish bërë dhe iu duk vërtet e mirë. Kështu mbrëmja dhe agimi ishin në ditën e tyre të gjashtë”. Atëherë Zoti e bekoj ditën e shtatë dhe e Shenjtëroi, sepse në të Ai pushoi nga gjithë puna që kish bërë e kish krijuar”.

Zoti e dinte se njeriu kishte nevojë për kohë, hapësirë dhe vlerësim për shplodhjen, për veten dhe familjen. Njeriu do të ndeshej me nevojat e tij fizike, mendore, sociale dhe shpirtërore, duke mbajtur Sabatin.

Përgjatë gjithë Shkrimeve të Shenjta, Zoti ilustron se Ai na do. Për këtë gjë Ai na ka dhënë një emblema të dashurisë së Tij, që të na e sjellë atë nëpër mend e të na tërheqë gjithmonë në përqafimin e Tij të madh të dashurisë. Në fakt, Zoti këtë emblema e quajti Shenja e Tij. Vëreni Ezekielin 20:20 : “Shenjtërojeni Sabatet e mia; e ato do të jenë një shenjë midis Meje dhe jush, që njerëzit të dinë se unë jam Zoti i tyre”. Ky nuk është teksti i vetëm që flet për këtë shenjë të Zotit tonë. Në shumë pasazhe të Shkrimeve, Zoti zhvillon domethënien dhe rëndësinë e Sabatit të Tij. Zoti mori një ditë të zakonshme 24 orë të gjatë dhe e shndërroi në Sabat. Po shumë njerëz thonë se një ditë është po kaq e mirë, sa një ditë tjetër dhe se çdo ditë është një Sabat ose mund të përdoret si Sabat.

Adami dhe pasardhësit e tij e mbajnë Sabatin

Zanafilla 4:3: “E në rrjedhën e kohës, ndodhi që Kaini i mbledhi të gjitha frutet e tokës, për t’ia afruar Zotit”. Caqet e pasazhit të cituar, pohojnë se te Hebrenjtë kjo nënkuptonte “në fund të ditëve”. Studiuesit Hebrenjë janë unanimitë në faktin se kjo nënkupton fundin e javës ose Sabatin. Ç’bënin Kaini dhe Abeli në fund të javës ose në Sabat? Ata bënin fljime dhe nderonin.

Bijtë e Izraelit

Mijëra vjet pas krijimit, bijtë e Izraelit e shkuan kohën e tyre në Egjipt, në periudhën e fatkeqësive. Ata gjendeshin aty edhe atëherë kur doli një faraon që nuk i njihte zakonet e tyre zanafillore, ose të madhin Jozef, që i udhëhequr nga Zoti shpëtoi si Egjiptianët ashtu dhe Izraelin. Ata qenë bërë skllavër, kur Zoti thirri Moisiun, që t’i shpinte jashtë Egjiptit, në atë që quhet Eksodi apo Mërgimi i madh. Duke e harruar Zotin dhe mënyrat e tij, bijtë e Izraelit u drejtuan kah malit Sinai. Ndodhi aty që Zoti u dha Ligjet e Tij morale, ceremoniale, ligjore dhe shëndetësore.

Dhjetë urdhërimet Zoti i foli me gojën e Tij e pastaj i shkroi me gishtat e vet nëpër pllakë. Në zemër të ligjit ishte pushimi që Zoti e dha së pari te Krijimi e tashmë në shkretëtirën e Sinait, si një kujtesë të qartë të nevojave të tyre. Vëreni Eksodin 20:8-11: “Kujtojeni ditën e Sabatit, për ta mbajtur atë të Shenjtë. Për gjashtë ditë ju do të punoni dhe do të kryeni gjithçka, por dita e shtatë është e Zotit tonë. Në të ju s’keni për të punuar. Sepse për gjashtë ditë Zoti krijoi qiejt, tokën dhe detin, gjithçka që gjendet brenda tyre, për të pushuar në ditën e shtatë. Për këtë arsye Zoti e bekoj ditën e Sabatit dhe e shenjtëroi atë”. Kjo ishte një kujtesë e qartë e krijimit të botës dhe nevojave të njeriut. Shumë herë profetët i kujtonin Izraelit Sabatin. Pasi shpëtuan nga skllavëria babilonase, rabinët vendosën shumë

shtërngesa rreth Sabatit dhe mënyrës së mbajtjes së tij, që ai të mos jetë aspak një barrë. Do të ishte e pafat nga ana e tyre, që këtë ditë të mrekullueshme ta kthenin në një ditë të bezdisshme. Kur erdhi Jezusi, Ai u përpoq që t'i korrigjonte të gjitha këto shtërngesa të sajuara nga njeriu. Disa njerëz, i interpretonin korrigjimet e Tij, sikur të qenë madhështore në papajtueshmërinë e tyre me Sabatin. Natyrisht që s' kish qenë kurrë kështu.

Koha e Krishtit

Kur Jezusi erdhi në tokë, Ai e rivendosi Sabatin në mënyrën se si duhet të mbahet në të vërtetë (Marku 2:27, 28). “E Ai u tha atyre: “Sabati është bërë për njeriun dhe jo njeriu për Sabatin. Prandaj, Biri i Zotit, është gjithashtu edhe Zoti i Sabatit”. Jezusi është zoti i Sabatit, ç’bekim për gjithë njerëzimin! Është gjithashtu zakoni i Tij festimi në Sabat së bashku me njerëzit. Luka 4:16 thotë: “Kështu Ai erdhi në Nazaret, kur tashmë ish pranuar. E ashtu siç e kishte zakon, shkoi në sinagogë ditën e Sabatit e qëndroi aty për të lexuar”. Kur parashikoi rënien e Jeruzalemit, Jezusi u bëri një kërkesë atyre që e ndiqnin : “Lutun, që rrugëtimi juaj të mos jetë në dimër ose në ditën e Sabatit”. (24:20). Kur ushtritë e Vespasianit rrethuan qytetin e Jeruzalemit në vitin 66 p.K. pa pritur ata u larguan dhe shkuan kah bregdetit në Caesarea. Ishte koha, kur të krishterët po luteshin dhe arratiseshin për të shpëtuar jetën në Pella, në brigjet e Jordanit. Rrugëtimi i tyre u krye në vjeshtë dhe në ditën e mërkurë. Në se nuk do të arratiseshin në këtë kohë, do ta kishin të pamundur ta bënë një gjë të tillë, pasi një errësirë e thellë i bllokoi të gjitha lëvizjet, brenda dhe jashtë qytetit. Kur Jezusi vdiq në kryq, Ai pushoi në varr ditën e Sabatit. “Ajo ditë ishte dita e përgatitjes; e ndoqën pas dhe gratë që kishin ardhur me të nga Galilea; ishin ato që i ruajtën varrin dhe kundruan se si ishte shtrirë trupi i Tij. Pas kësaj, ato u kthyen për të përgatitur vajrat aromues dhe erëzat. Veçse pushuan ditën e Sabatit, ashtu siç e kërkonte urdhërimi (Luka 23:54-24:1). Vëreni se si

dishepujt e mbanin Sabatin, ashtu siç e kishin mësuar nga Mjeshtri i Tyre. Luka shkroi shumë vite pas kryqëzimit, për t'u kujtuar lexuesve se Sabat-mbajtja duhej të bëhej në përputhje me urdhrat e dhëna në malin e Sinait. Nuk është rregjistruar asnjë ndryshim dite që prej asaj kohe.

Koha e apostujve

Të krishterët e hershëm e mbanin Sabatin, ashtu siç thuhej në një numër vargjesh të Dhjatës së re Re shkruar nga Luka dhe Pali. “Që prej aty (Neapolis) gjerë në Filippi, që është qyteti i fundit i asaj pjese të Maqedonisë, shtrihej një koloni. Qëndruam aty për ca ditë. Në ditën e Sabatit shkuam jashtë qytetit, në anën tjetër të lumit, ku lutja ishte bërë e zakonshme. U ulëm edhe folëm edhe me disa gra që takuam aty (Veprat 16:12, 13). Ashtu siç Shpëtimtari ishte falur në Sinagogë në ditën e Sabatit, kështu bënë edhe dishepujt. (Veprat 13:14). “Po kur u larguam nga Parga për të shkuar në Antioch të Pisidia-s, shkuan në Sinagogë, në ditën e Sabatit dhe qëndruan aty”. Ç’ shembull për të gjithë ne në ditën e sotme!

Shumë vite më vonë, kur Gjoni shkroi librin e Zbulesës, ai gjendej në mërgim, në ishullin e vetmuar të Patmos-it. Ai shkroi: “Unë, Gjoni, isha në ishullin që quhej Patmos për fjalën e Zotit dhe për dëshirën e Jezu Krishtit. Unë isha në shpirtin e Ditës së Zotit e dëgjova para meje një zë të lartë, si një trumpetë”. (Zbulesa 1:9,10). Sabati ishte Dita e Zotit, ashtu siç lexohet në Shkrimet e Shenjta: “Jezusi ishte Zoti i Sabatit”.

Ditët e fundit

Thellë në histori, që prej kohës së apostujve, ekzistonin mjaft grupe Sabat-mbajtës. Shumë prej tyre persekutoheshin. Keltët në Skoci, shumë nga Vaudois (Vaduat-ë), në Italinë e Veriut; Etiopianët gjer në shekullin e 16-të, janë shembuj të gjithë atyre që e vazhduan

praktikën e Sabat-mbajtjes. Vëreni se ç’thotë Zbulesa 24:12: “Këtu gjenden ata që mbajnë urdhërimet e Zotit”. Ky është një referim i njerëzve të Zotit në ditët e fundit. Ashtu siç ishte në Izraelin e kohëve të vjetra, po kështu edhe sot, Sabati është një shenjë midis Zotit dhe njerëzve të Tij. Midis shumë gjerave të tjera, Zoti u kërkon njerëzve të vet t’i kthehen mbajtjes së Sabatit, sepse kur Ai të mbrrijë, njerëzit do t’i mbajnë të gjitha urdhërimet e Tij. Profeti Isaia, ashtu siç ai shkruan në fund të veprës së vet, u thekson lexuesve krijimin e Ri që Zoti do të sjellë me vete: “Se qiejt e rinj dhe toka e re, që unë do të krijoj, do të shtrihen përpara meje, - tha Zoti,- e do të ndodhe që nga një hënë e re në një tjetër dhe nga një Sabat në tjetrin, të gjitha krijesat e brishta do të vlerësohen përpara meje”. (Isaia, 66: 22,23). Ç’pushim i mrekullueshëm do të jetë atëherë, kur të gjithë anëtarët e familjes së Zotit përgjatë gjithë shekujve do të shihen ta vlerësojnë Atë së bashku.

Sabati është gjithashtu një shenjë domethënëse e Shpëtimtarit tonë. Madje dhe Izraeli, duke dalë nga Egjipti, ku ata kishin qenë skllavër, e zbuloi shpëtimin e Zotit. Ai ua kujtoi këtë gjë te Ligji i Përtërirë 5:15, kur tha: “Mos e harro që ti ishe një skllav në tokën e Egjiptit, e Zoti ynë të nxori jashtë prej andej, me dorën e Tij të fuqishme dhe me krahun e Tij të shtrirë; Prandaj Zoti ynë urdhëron mbajtjen e ditës së Sabatit”. Ka shumë vargje të tjera që tregojnë shpëtimin e mrekullueshëm të Zotit, që me marrjen e kësaj dhurate, kemi përgjegjësinë ta ndjekim Atë nga pas. Ashtu siç tha Jezusi: “Nëse më doni mua, zbatoni urdhërimet e Mia” (Gjoni 14:15). Fakti i mrekullueshëm është se Ai na mundësoi t’i mbajmë ato sikur Ai të qe me ne përgjatë gjithë rrugës, duke na udhëhequr, në se do zgjedhim ta lejojmë një gjë të tillë. Ai dëshiron që ne të hyjmë në pushimin e Tij. Në çdo aspekt të jetës sonë, në mënyrë që të jemi të bekuar, të pasuruar dhe të fuqizuar në rrugëtimin tonë jetësor. Ç’shembull Ai qe në tokë e ç’gëzim i madh të hysh në pushimin e Tij. Pse të mos e përpiqemi vallë për këtë pushim?

15. Beteja e madhe për të vërtetën

Zoti i paratha ndryshimet që do të ndodhin në mes njerëzve. Ai e paratha korrupsionin dhe perversitetin e madh të së vërtetës, teksa njerëzit do t'i ndërtonin besimet e praktikat e tyre bazuar mbi zakonet dhe traditat, më tepër se mbi Fjalën e Zotit. Ai e zhvelloi këtë të ardhme nëpërmjet profetëve e shërbëtorëve të Tij. Jezusi i këshilloi dishepujt të shkonin e të studionin profetin Daniel. Le ta bëjmë këtë gjë së bashku, për të analizuar profecitë mbresëlënëse që gjenden në kapitullin e shtatë.

Profecitë shpesh e fshehin të vërtetën nga armiqtë e Zotit, por e zhvellojnë atë për njerëzit e Tij. Ashtu siç ka thënë edhe Danieli 1:

“Asnjë nga antagonistët e Zotit nuk do ta kuptojë, por njerëzit e mençur po” (Daniel 12:10).

Danieli 7:23 :Vëreni këtu tre gjëra kryesore. Era, deti dhe katër bishat. Era përfaqëson sflitjen dhe përmallimin (Jeremia 49:36-37). Deti- deti i madh - kuptohet të jetë Mesdheu. Detet dhe ujërat përfaqësojnë njerëzit dhe kombet përrreth sferës së këtij deti. Vëreni zbulesën 17:15 : “ ...Ujërat që ju shihni, janë njerëzit, turmat, kombet dhe gjuhët”. Danieli 7:17 thotë : “Ato bisha të mëdha që janë katër, janë katër mbretërit që do të ngrihen prej tokës”. Ju mund t’i shihni nga këto tekste se profecia shpjegon vetveten.

Mbretëria Luan - Danieli 7:4. Ishte Babilonia e para mbretëri e kohëve të Danielit. Ashtu si te Danieli 2, ku koka e imazhit përfaqëson mbretërinë e Babilonisë, edhe në këtë kapitull, bisha e parë e përfaqëson zotësisht të njëjtën mbretëri. Luani ishte një simbol dekorativ i parapëlqyer i artit Babilonas, e ndërthurej shpesh me shqiponjën, mbretin e shpendëve. Luani përfaqësonte fuqinë dhe krahët e tij shpejtësinë. Këto ishi ilustrime shumë të përshtatshme për pushtimet brilante të Nebukadnezarit. Krahët, gjithsesi, ishin të palosura, pasi përfaqësonin Babiloninë pas vdekjes së Nebukadnezarit. Pastaj profecia zhvillon një tjetër mbretëri.

Mbretëria Ari - Daniel 7:5. Ky ari mizor përfaqëson më së miri mbretëritë e kombinuara të Medëve dhe Persëve, që pushtuan Azinë e Vogël (Turqinë) në betejë me Lidianët, Egjiptianët dhe Babilonasit. Ariu kishte tre peshq në gojën e vet, që përfaqësojnë pikërisht këto tri pushtete të mëdha. Bibla thotë se ai arriti të gëlltisë shumë mish. Kjo mbretëri mbulonte një hapësirë prej 3300 miljesh nga Lindja në Perëndim dhe 1500 të tjera nga Veriu në Jug.

Bisha Leopard - Danieli 7:6. Ashtu si bronxi vijoi argjendin, në imazhin e Danielit 2, po kështu edhe ariu ndiqet nga leopardi, pra Persët ndiqen nga Grekët. Kjo kafshë e çuditshme me katër kokë

dhe katër krahë përfaqëson fushatat e mëdha të Aleksandërit e atyre që e ndoqën atë. Ai me shpejtësi arriti të pushtojë botën, me falangat e tij të mrekullueshme ushtarake, që arritën të marshonin deri në Succur të Indisë. Mirëpo, pas vdekjes së tij të parakohshme, në vitin 323 p.K. gjeneralët e tij luftuan për dy dekada ta mbanin perandorinë të bashkuar, por ajo u nda në 4 zona në betejën e Ipsusit më 301. p.K.

E tmerrshmja bishë e katërt - Daniel 7:78. Çdo nxënës shkolle e di se mbretëria e mëpastajme, që erdhi të shndërrohej në një perandori botërore dhe që qeverisi me një fuqi të stërmadhe ishte ajo Romake. Legjionet e famshme të ushtarëve romakë marshonin kudo nëpër botë. Por gjëja më e çuditshme mbi bishën e kësaj mbretërie janë dhjetë brirët që shfaqen në kokën e saj. Përveç këtyre brirëve shfaqet edhe një tjetër bri i vogël, që palos apo kaplon tre nga brirët e parë. Danieli thotë se dhjetë brirët janë dhjetë mbretëritë që do të dalin pas shkatërrimit të perandorisë Romake, kurse ai bri i vogël do të jetë një tjetër fuqi që do të ngrihet në mes të atyre të dhjetave. Perandoria Romake kishte dy periudha të mëdha, së pari periudhën pagane dhe më pas periudhën papnore. Briri i vogël përfaqëson fuqinë papnore. A mund të provohet kjo gjë? Le të shqyrtojmë disa pika që spikasin në këtë kapitull dhe që do të na ndihmojnë të kuptojmë se fuqia e këtij briri të vogël është Papati, i cili aktualisht përfaqëson gjithçka që ndodh në tokë dhe që ka lidhje karakteri me Zotin.

1 . Ishte një fuqi Europiane. U ngrit në mes dhjetë mbretërive të Europës.

2 . Ishte një bri i vogël.

3 . U ngrit pasi u stabilizuan 10 mbretëritë. Kjo u bë fakt në vitin 476, p.e.s. kur Herulët, Ostrogotët dhe Vandalët, bashkë me ushtritë e tyre, u mundën. Që nga viti 538 p.e.s. Roma Papnore u bë pushtuese.

4 . Do të jetë e ndryshme. Papati ishte një fuqi fetaro-politike.

5 . Do të ndryshojë kohët dhe ligjet.

6 . Do të flasë fjalë të mëdha kundra Zotit të lartë.

- 7 . Do të përdorë titullin e Krishtit.
- 8 . Do të ketë sytë e një njeriu.
- 9 . Do të mbretërojë për 1260 vjet – për një kohë, dy kohë dhe një gjysëm kohe.
- 10 . Do të shndërrohet në një fuqi persekutuese.

Pikat e mësipërme zhvellojnë qartësisht një fuqi fetare që, aktualisht në fakt do të ndjekë prirjet e veta, e ndërsa do të besojë veten se është Zoti, do të dalë nga harmonia me Të. Kjo ishte e natyrshme, pasi historia i zhvelloi njerëzimit të qenit vazhdimisht i interesuar për ndërtimin e egos së tij.

Pas përmbytjes njeriu ndërtoi kullën e Babelit. Ai bëri diçka më tepër për veten e vet, se sa për të jetuar në harmoni me Zotin. Ai mendoi se mund ta shpëtonte veten, po përkundrazi kjo gjë i solli fatkeqësi të vazhdueshme kundra vetes. Ai ndërtoi një kullë kundra përmbytjes së ardhme, në vend që të besonte në Zot.

Shohim të përsëritet edhe një herë tragjedia e Malit Sinai. Zoti e zhvelloi planin e shpëtimit në shenjtërore: iu dha njerëzve 10 Urdhërimet dhe Ligjin, po përsëri ata vepruan sipas vetëdijes së tyre. Ata shkonin dhe nderonin idhuj të tjerë duke i venë në vend të Zotit. Pas zbulimit të dashurisë së Zotit të Krishti, arriti fuqia e ditës së pesëdhjetë. Mirëpo më pas dekadencia nisi ta zvarriste kishën përsëri. Pali tha se Misteri i Ligësisë është në veprim. Ai është i kundërti i Misterit të Mirësisë së zhvilluar të Jezu Krishti.

Papati, sipas kësaj profecie, do të qe një sistem që do të përfaqësonte qëllimet dhe idealët e njeriut, më tepër se sa të vërtetën e plotë të Zotit. Sistemi do të ishte mbarëbotëror. Ai do t'u shpallet njerëzve si e vërtetë, e përsëri nuk do të jetë tërësisht e vërteta, pasi në disa aspekte do të jetë e kundërta e së vërtetës.

Le të vërejmë tash disa pika që do të na qartësojnë subjektin tonë:

- 1 . Ishte një fuqi Europiane. Ajo u ngrit nga mbetjet e fuqisë pagane romake prej dhjetë mbretërive kryesore që lindën në Europë.

2 . Ishte një bri i vogël; ose një mbretëri e vogël; territori i saj ka një sipërfaqe prej 108 ha.

3 . Kjo mbretëri u ngrit, pasi qenë ndërtuar edhe 10 mbretëri të tjera. Për t'u kthyer në mbretëri, iu ndesh të shkatërrojë ndikimin e perandorive Ariane të Ostrogotëve, Vandalëve dhe Herulëve. “Tri dhëmbë u shkulën nga briri i vogël” (Daniel 7:8). Kështu, ishin këto 3 mbretëri që i hapën udhë fuqisë Papnore.

4 . Ishte një mbretëri e ndryshme. 10 kombet e tjera kishin qenë fuqi politike, por siç thotë Giboni: “Bisha e mori filozofinë pagane dhe e bëri atë mburojë të besimit kundra të pafeve”. Papati u bë një fuqi politiko-fetare. Feja u përzie me politikën. Ndodhi një pleksje e krishterimit dhe paganizmin dhe një mori praktikash nisën të vërshojnë nëpër kisha, që nuk gjendeshin aspak te Shkrimet e Shenjta.

5 . Do të mendojë të ndryshojë kohët dhe ligjin e Zotit. Smith dhe Goodspeed e përkthejnë kështu këtë varg: “Ajo e ngriti fuqinë mbi stinët e Shenjta dhe mbi ligjin e Zotit”.

Ndryshime të mëdha iu bënë ditëve të shenjta, kur Papati arriti të ngrihej tërësisht si fuqi më vete.

Ndryshimi i parë domethënës dhe real erdhi në ndryshimin e 10 Urdhërimeve. I dyti u hoq dhe i dhjeti u nda në të nëntin dhe të dhjetin. Urdhërimi i dytë kishte të bënte me vlerësimin e imazhit. Ai u hoq, kurse i dhjeti, që lidhej me lakminë, u nda. Tashmë kishte dy urdhërime që lidheshin me lakminë. Ndryshimi i dytë i madh në ligj, ishte ndryshimi i Sabatit, nga dita e shtunë në ditën e dielë. Konstantin ndërftoi ligjin e këtij ndryshimi.

6 . Ajo do të drejtohet me fjalë të mëdha kundra më të lartit (Danieli, 7:25). Çdokush mund të habitet se si kisha e krishterë mundi ta përmbushë këtë predikim. Por le të vërejmë një nga shumë pohimet e këtij lloji. Njëri i takon Papa Leonit XIII në “Letrat enciklike” : “Ne mbajmë mbi tokë vendin e Zotit të madhërishëm”. Tiara (kurora) e Papëve ishte përgjithësisht një kurorë trefishe, që aktualisht do të thotë :”Mbreti i Qiellit, i Tokës dhe i Rajoneve më të Ulta”.

Te Mateu 23:9, Jezusi thotë: “Mos quani askënd atin tuaj”, duke iu adresuar Zotit si Ati i Shenjtë. Bibla katolike dhe protestante janë pothuajse të njëjtat. Që të dyja ato pohojnë fortësisht se në mënyrë shpirtërore, asnjë njeri nuk mund të quhet “At”.

7 . Do të përdorë titullin e Krishtit. Në 2 Selanikasve 2:3,4 Pali tha se misteri i ligësisë do t’i kundërvihet Zotit e madje do të ulet në vendin e Zotit. Vetë Papatë përdori tituj të tillë si “Vikari i Krishtit” dhe duke përdorur rrëfimin, që është një privilegj vetëm i Krishtit, pushtoi kështu vendin e Krishtit.

8 . “Do të ketë sytë e njeriut”: Kjo është një referencë për largpamësinë e mprehtë të kësaj fuqie dhe qasjen e saj ndaj përfitimeve dhe biznesit.

9 . Do të mbretërojë për “një kohë, e dy kohë dhe një gjysëm kohe”.

Një kohë është një vit i kohës së Biblës	= 360 ditë
--	------------

Dy kohë janë dy vjet	= 720 ditë
----------------------	------------

Një gjysëm kohe	= 180 ditë
-----------------	------------

= 1260 ditë

Një ditë në profeci është një vit, sipas kalendarit Antik Hebre që ka 360 ditë në vit. Viti, siç ne e njohim sot, ka disa ditë më shumë për ta sjellë atë në barazi me kohën e rrotullimit të sistemit diellor. Mbretëria e Papatit filloi si një fuqi Politiko-Fetare në kohën e dekretit të Justinianit në vitin 538 dhe përfundoi kur Berthier zuri rob Papën më 1798.

Në vitin 1844 mori udhë gjykimi kundra Bririt të vogël dhe atyre që do të jenë të të njëjtit mendim me të. Por, ai do të jetë në favor të “të Shenjtëve të Zotit” (shiko Danieli 7:27).

10 . Do të jetë një fuqi persekutuese. “Ajo do të veshë petkun e Shenjtëve të Zotit të Lartë. Zaletti, historiani dhe racionalisti romak, ka thënë për Papatin: “Kisha e Romës çoi në vdekje më shumë njerëz se çdo institucion tjetër”.

Kur një njeri apo fuqi përpiqet të bëjë punët e veta, ajo fillon ta vendosë veten në një pozicion superioriteti. Me autoritetin e saj ajo fillon t'i shtypë ata që i kundërshtojnë autoritetin. Të ashtuquajturit “heretikë” u masakruan me qindra e mijëra. Shumë nga persekutorët ndjenin se po zbatonin vullnetin e Zotit, duke hequr qafe kundërshtarët. Kudo, nëpër Europë dhe veçanërisht në Italinë e Veriut, në Spanjë dhe Francën e Jugut njerëzit vuajtën për besimin e tyre.

Danieli 7 tregon dy mistere të mëdha:

1 . Misteri i Ligësisë, kur njeriu mëkatar merr mbi vete të drejtat hyjnore (vargu 25).

2 . Misteri i Mirësisë, kur Zoti i Shenjtë u përul dhe mori mbi vete pafuqitë njerëzore.

Në misterin e parë, njeriu është më i interesuar për vlerat materiale, se sa për Mbretërinë përfundimtare që Krishti do t'ua japë të gjithëve që i binden Atij. Sot, botës i nevojitet i gjithë Ungjilli i Krishtit në plotësinë e së vërtetës. Drita e Zotit do të ndrijë gjithmonë dhe ne kemi nevojë ta ndjekim atë, në mënyrë që të ngazëllemi me Krishtin në mbretërinë e Tij.

16. Në gjyqin e Martin Luterit

Mesjeta njihet për vitet e saj të pasigurisë dhe analfabetizmit. Bota e krishterë ishte në kërkim të parreshtur për të vërtetën që rrallë kuptohej, e padyshim nuk mësohej. Tradita kishte mbuluar shumë nga ato perla të çmuara të ardhura nga fjala e Zotit. Ishin kohë kur njeriu ngrihej dhe dëshmonte me kurajë dritën e Fjalës së Zotit. Gjithsesi, e gjitha kjo ngjallte zemërimin e kishës tradicionale dhe sundimtare. Uajklifi i Anglisë, Ylli i Mëngjesit i Reformës, siç quhet, ishte njeri nga këta njerëz. Edhe pse ai vdiq në mënyrë natyrale, trupi iu përdhos prej varrit. “Mëkati” i tij në sytë e kishës tradicionale, ishte

përkthimi i Fjalës së Shenjtë në gjuhën lokale angleze. Ndodhte shpesh që përpjekjet e “reformuesve” copëtoheshin përpara se të kishin mundësinë të ndikonin tek sa më shumë njerëz.

Jan Huss

Jan Hus kishte lindur më 1369 në Bohemi, por shumë pranë kufirit bavarian, në Gjermani. Deri në ditët e tij të fundit të vdekjes në Zvicër, ai jetoi e dha mësim në Bohemi. U bë një pasues i zjarrtë i Uajklifit të Anglisë. Ky studiues i Oksfordit i parapriu Huss-it, vetëm për pak vjet, duke lindur rreth viteve 1300 dhe duke vdekur më 1384, në moshën 84 vjeçare. Uajklifi përktheu për herë të parë Shkrimet e Shenjta nga latinishtja në gjuhën e tij amtare angleze. Por kjo s’u shkonte shumë për shtat shijeve të atyre kohërave të vështira. Uajklifi inkurajoi shumë reforma. Ai u përpoq të ndreqë shumë nga gjërat që udhëheqësit e kishës i bënë në mënyrë të papajtueshme me normat. P.sh, dy papë që mbretëronin njëherësh. Studentët Bohemianë i sollën veprat e Uajklifit në Universitetin e Pragës, ku Jan Huss-i i mori, i studioi dhe vendosi se ato ishin e vërteta për ditët e tij. Edhe pse u ndalua të predikojë, Bohemianët e donin dhe vazhdonin të refuzonin çdo dënim që vinte nga Roma ose nga ndonjë vend tjetër. Jan Huss-i filloi të ndërtojë skenën për reformën që do të vinte. Kjo ndodhi në mënyrën më të fortë të mundshme që mund të mendohej, kur ai u vra. Iu dha një leje kalimi për në Kostancë, Zvicër, ku duhej të shpjegonte besimin e tij, por s’iu lejua kurrë një seancë dëgjimi, pasi u godit nga prelatët e sundimtarët. U dogj në turrën e druve në Kostancë, më 1415. Fakti që leja e tij e kalimit u shkel nuk u harrua deri një shekull më vonë, kur edhe Luterit iu dha një “leje-kalimi” për t’u paraqitur në Vorms.

Savonarola

Shumë më të afërta me kohët e Luterit, qenë ato të Savonarolas, një mjek nga Firencia në Itali. Ai jetoi 46 vjet përpara se të vendosej në turrën e druve dhe të digjej.

Savonarola dashurohej nga njerëzit për predikimin e tij, inkurajimin dhe reformat. Ai predikonte shpesh në katedralen e Shën Lorencos, në qendër të Firences. Kjo katedrale e bukur vizitohej nga mijëra florentinas, që ishin në kërkim të së vërtetës së Ungjillit. Në ato kohë, botimi ishte bërë popullor dhe kopjet e Fjalës së Shenjtë qenë të disponueshme dhe të lexueshme kudo në kontinent. Firencia ishte qendra e Rilindjes dhe bashkë me të erdhi edhe dëshira për më shumë dije të Fjalës së Zotit. Mediçët ishin sundimtarët e korruptuar të Firences dhe në mbështetje të tyre ishin Papët Borxhia në Vatikan. Në pjesën më vitale të jetës së Savonarolës, Aleksandri ishte njëri nga Papët Borxhia. Savonarola foli jo vetëm kundra veprimeve të Vatikanit nën pushtetin e Aleksandrit, por edhe në mënyrë të veçantë kundra Mediçëve që qeverisnin Firencën. Me mijëra njerëz u tërhoqën nga thjeshtësia e mësimëve të Savonarolës. Ai njihet si pararendës i reformës në Itali dhe së bashku me Huss-in, vendoset strategjikisht në monumentin për nder të Reformës në Vorms. Figura qendrore e monumentit është Martin Luteri. Savonarola vdiq më 1498 në Firenze, kur Luteri po shndërrohej në një studiues i njohur dhe teolog në Gjermani.

Martin Luteri

Lindja e Luterit më 1493 u kremtua shumë në botë, me rastin e 500 vjetorit të saj, në vitin 1993. Studiues nga shumë vende të botës paraqitën leksione dhe seminarë për këtë personalitet të jashtëzakonshëm të Reformës.

Martin Luteri lindi në qytetin e Eislebenit, por shpejt pas lindjes familja e tij u transferua në Mansfeld, ku babai i tij u bë një udhëheqës shoqëror. Të ardhurat e tij të respektueshme erdhën si pasojë e vjeljes së interesave të komunitetit. Ndodhi në këtë qytet, ku

Martini shkoi në një shkollë “latine”, në moshën 5-7 vjeçare. Pas këtyre viteve hyrëse shkollimi, ai shkoi për një vit në Magdenburg, ku studioi nën udhëheqjen e “Brethrenëve të Dritës së përbashkët”. Këta murgjër e kishin nisur udhëtimin e tyre në Hollandë, rreth një shekulli më parë. Programi i tyre edukues ishte i një standardi shumë të lartë dhe shumë shpirtëror. Edhe pse ende i ri, Luteri u ndikua shumë nga mësimet e këtij vendi. Në periudhën 1499-1501 edukimi i Luterit vazhdoi në Eisenach, ku atij i la shumë mbresë Jan Brauni, një prift françeskan. Ishte nën ndikimin e Braunit, që Luteri vendosi të mos vazhdonte për drejtësi, por të përfshihej te urdhrat fetarë.

Pas kësaj, ai ndoqi universitetin e njohur të Erfurtit. Në atë kohë me 100 manastiret, kishat e katedralet e veta, atij i ishte ngjitur nofka “Roma e vogël”. Universiteti që themeluar më 1392-in dhe radhitej i dyti për nga prestigji, pas atij të Këlnit për nga mënyra e përparuar e edukimit.

Luteri hyri në shkollën e Ligjit me dëshirën e të atit. Gjithësesi, më 1505, ndërsa po mbërrinte në Erfurt, më 2 korrik, u godit nga një vetëtimë. I frikësuar filloi të bërtiste : “E dashur Shën Mëri, të lutem, më shpëto e unë do të bëhem murg”. Duke qënë njeri i fjalës, ai hyri në manastirin e Augustinianëve heremitë më 17 korrik. Ju s’ mund ta imagjinoni se sa i ligështuar ishte i jati i tij nga ky veprim!

Ai u shugurua prift në pranverën e vitit 1507. Pas kësaj u zhvendos për në Wittenberg për të ndjekur studimet teologjike. Në 1509, ai u kualifikua të japë mësim në teologji sistematike. Në 1509-1511, ai u bë pedagog në universitetin e Erfurtit, e ndodhi pikërisht gjatë kësaj kohe që udhëtoi për në Romë. Disa gjera e shqetësuan pa masë në qytetin e famshëm duke i lënë mbresë për gjatë gjithë kohës së shërbëtarisë së tij. Pas kthimit nga Roma, ai u dërgua në Wittenberg, ku mori doktoraturën më 1512-ën.

Në Wittenberg, njeriu me ndikim Johann Staupitz ishte udhëheqësi i urdhrit Augustinian, që ekzistonte kudo nëpër tokat gjermane. Staupitzi e njohu Luterin me disa parashtrime të Bernar Klervosë. Në njerin nga predikimet e tij Luterin e tërhoqi në mënyrë të veçantë

pohimi : “Njeriu, pa meritë, është i justifikuar përmes besimit”. Ky pohim dhe “Zbulimi i kullës”, (i ndodhur diku mes viteve 1512-1514) në lidhje me drejtësinë e Zotit, shkaktuan një ndikim të thellë në mendjen dhe në të ardhmen e tij.

Vëreni përshkallëshmërinë e kuptimit të tij Biblik të paraqitur përmes leksioneve. Studimet e para qenë mbi librin e Zanafillës, në 1512-1513, pastaj mbi Psalmet, në 1513-1515, e në fund Letrat ndaj Romakëve, 1515-1516, dhe Galateasve, 1516-1517. Me këto leksione, udhëtimi i tij shpirtëror dhe reformues u zhvillua në sfondin teologjik dhe Biblik. Ndodhi në këtë kohë të veçantë, që ai përjetoi një ndjenjë të fortë dashurie për drejtësinë e Zotit, në një kohë, kur Roma shpesh përfshihej ta shiste faljen me para, ose duke theksuar rëndësinë e veprave të mira që duhet të kryente njeriu. Në Vatikan po ndërtohej Shën Pjetri dhe faljet ishin baza që ndihmonin në financimin e këtij projekti fortësisht të kushtueshëm. Ndaj, ishte e natyrshme, që kjo lloj faljeje të pritej me një kritikë të rreptë nga ana e Luterit. Nocioni i tij baritor e udhëhoqi të përfshihej mprehtësisht në krizën që shkaktoi shitja e faljeve. I spikatur në promovimin dhe shitjen e faljeve në tokat gjermane ishte një tjetër personalitet i njohur me emrin Tetzel. Me inkurajimin e Luterit, Princi i Saksonisë nuk e lejoi vazhdimin e shitjes në tokat e tij. Ky vendim i detyroi disa bashkëqytetarë të Luterit të udhëtonin deri në kufi për t’i blerë ato. Përgjigjia e Luterit u dha me një mori predikimesh dhe artikujsh.

Ndoshta më shumë se çdo gjë tjetër, këto falje e detyruan që “95 Tezat” e tij mbi faljen të vendoseshin në derën e kështjellës së Wittenbergut më 31 tetor 1517. Vazhduan për tre vjet debatet midis priftërinjëve, Papës dhe Luterit. Më në fund u vendos që të mbahej një kuvend, ku të gjykoreshin Luteri dhe doktrina e tij. Më 17-18 prill të vitit 1521, Luteri u shfaq para asamblesë perandorake të Vormsit. Atij i ishte dhënë një leje kalimi për vajtje-ardhje në gjyq, por gjithësesi dihej se ishin vënë njerëz për ta vrarë në atë vend. Mbahej mend se ç’ kishte ndodhur me lejen e kalimit të dhënë ndaj Jan

Huss-it një shekull më parë. Fakti i shkeljes së saj i kish zemëruar njerëzit.

Këto plane për vrasjen e Luterit, u shkatërruan që në fillim, kur ai u morr dhe u vendos diku larg, në kështjellën e Wartburgut më 4 maj, ndërsa po udhëtonte për t'u kthyer në Wittenberg. Nga kështjella ai mund të kundronte pejsazhin e tij të dashur Eisenachut. Ndërsa e ligështonte fakti që nuk mund të gjendej dot në Wittenberg, ai e përdori këtë kohë për t'i dhënë penelatat e fundit përkthimit të Dhjatës së Re në gjuhën gjermane. Për herë të parë populli gjerman mund të lexonte, të paktën një pjesë të shkrimeve në gjuhën e vet amtare. Ky përkthim i Shkrimeve të Shenjta u botua në mars 1522.

Më 1525 ai martohet me Katerina fon Bora, e cila në fakt ishte një ish murgeshë, mjaft e mbresëlënur nga mësimet e Luterit. Që nga ajo kohë, ajo i kishte shkëputur lidhjet me urdhrat e kishës së saj, për të ndjekur vetëm mësimet e Shkrimeve të Shenjta. Luteri dhe Katerina patën 6 fëmijë, dy nga të cilët vdiqën para kohe. E para ishte Elizabeta e cila vdiq, kur ishte 8 muajshe. E dyta ishte Magdalena, e cila vdiq në moshën 13 vjeçare gjatë një sëmundjeje në verë.

Më 1525 ai u nda nga Erazmi që kish shkruar “Skllavëria e vullnetit”. Martini shkroi veprën e vet me titull “Mbi lirinë e vullnetit”. Këto dy doktrina të kundërta vijuan edhe në kishat e reformuara kalviniste dhe në kishat Luterane. Kjo doktrinë është njera nga faktorët ndarës, sipas argumentimeve të shumicës, i protestantizmit të sotëm.

Që nga viti 1534, Luteri botoi versionin e parë të Biblës së plotë në gjuhën gjermane. Më 1543 ai shkroi mbi Hebrenjtë, e cila në fakt është njera nga pikat e trishta të shërbëtarisë së Luterit. Ai mori një pozicion të fortë politik dhe fetar kundra Hebrenjve. Shumë hebrenj erdhën në atë kohë në tokat gjermane, pas dëbimit nga Spanja. Më 1546, Luteri vdiq në mënyrë natyrale në Eiselben, më 18 shkurt 1546. U varros në katedralen e Wittenbergut më 22 shkurt.

Rivendosja e Shfajësimit prej besimit

E vërteta e "shfajësimit prej besimit", humbi përgjatë shekujve duke bërë që mbizotëruese të qe drejtësia përmes veprave. Kur njerëzit nuk kishin mundësi të lexonin Fjalën e Zotit, ishte e pashmangshme që ata të kuptonin se ç' duhet të bënin për të fashitur Zotin dhe për të fituar shpëtimin e Tij. E tërë ideja fillonte me Kainin, djalin e Adamit, i cili mendonte se mund të anashkalonte planet e Zotit, në lidhje me problemin e mëkatit. Priftërinjtë e ndërfitën këtë sistem në kohën e tyre, të frymëzuar nga Nimrodi, për të cilin Bibla thotë, se ishte "një gjahtar i fuqishëm në luftën kundër Zotit". Plan i Zotit për shpëtimin u zëvendësua nga plani i njeriut, veprat e njeriut, filozofitë e njeriut. Shumë vite pas Nimrodit, filozofët grekë inkurajuan ide të ngjashme.

Ishte Krishti ai që rivendosi Shfajësimin si planin qiellor, prej të cilit njeriu duhej të shpëtohej. Njeriu nuk mund të shpëtohej prej veprave të veta. Ai është i shpëtuar prej dashurisë dhe hirësisë së Zotit. Shpëtimi nuk mund të fitohet, sepse është një dhuratë. Veprat kanë vendin e tyre për të zhvilluar mirënjohjen e njeriut për Zotin dhe për dhuratën e Tij të pashoqe të Jezu Krishtit në vdekjen e tij të tmerrshme në emër të mëkateve tona.

Këto të vërteta e humbën fuqinë e tyre përgjatë Mesjetës. Disa autorë të katolicizmit shkruan në lidhje me besimin e dhënë njëherësh ndaj shenjtëve. Gjithsesi ata qenë të paktë atëherë, kur shkrimet nuk qenë të disponueshme, për t'u kthyer në udhëheqje.

Martin Luteri i studioi këto shkrime. Ai i përktheu ato në gjermanisht, duke u bërë kaq familjar, sa dhe të debatonte për to. Njëri nga debatet më të paharruara ishte ai me Dr. Eck. Martini bazohej te shkrimet dhe vetëm te shkrimet. Dr. Eck i tha : "Në se është kështu, dhe nuk i shkoni përshtat traditës, atëherë pse nuk e mbani Sabatin e Shkrimeve të Shenjta"? Që nga ajo ditë, Melanktoni, këshilltari më i ngushtë i Luterit, por edhe një studiues përkrah të tij, e mbajti Sabatin rregullisht. Justifikimi prej besimit, ishte çështja e

atyre ditëve dhe mbajtja e Sabatit duhet të ishte fruti i “të qenurit i justifikuar. Ai nuk është një mjet i shpëtimit, por një rezultat i tij.

Martini u mor gjatë me çështjen e madhe të shpëtimit.

Edhe ne duhet të vazhdojmë në besimin e tij, duke njohur se pa justifikim, nuk mund të kemi jetë të përjetëshme. E vërteta e shkrimeve është individuale për ne dhe si e tillë, edhe sot në vitet 2000, ne mund ta njohim gëzimin e shpëtimit dhe paqes te Jezu Krishti, përmes pranimit të gjithçkaje që na ka dhënë Shpëtimtari ynë.

17 . A mund të falet një vrasës?

Unë po udhëtoja për në Filipine, kur lexova një artikull në një gazetë të Manila-s rreth një djali të ri, një vrasësi, të cilit sapo i ishte anuluar dënimi me vdekje. Artikulli thoshte se kjo ishte hera e parë që ndodhte një gjë e tillë në Filipine. M'u kujtua ky artikull pak ditë më vonë, kur u takova me këtë djalë. Ai kishte vrarë nënën dhe motrën. Shumica e Filipinasve mbajnë thika me vete, e për fat të keq shumica kanë karakter të keq. Ky djalë i ri nuk bënte përjashtim. Në inat e sipër ai kishte vrarë nënën dhe motrën e tij. Për këtë ishte dënuar nga gjykata me vdekje.

Në Filipine, dënimi me vdekje mund të zgjasë deri në 4 vjet për t'u ekzekutuar. Për gjatë kësaj kohe pritjeje, djali i ri mori pjesë në një takimin tonë Ungjillor për të burgosurit. Dëgjoi muzikë e këngë, dhe u kuriozua të mësonte më shumë rreth programit që ne po ndiqnim në burg. Ai erdhi në javët e ardhshme e vazhdoi të merrte pjesë çdo herë në këto takime, deri sa më në fund u konvertua dhe u bë një i krishterë i vërtetë. Qëndrimi i tij rebel që ishte aq i dukshëm më parë, në çdo ditë të burgut, ndryshoi plotësisht. Ai u bë i dobishëm për kujdestarët, e ndryshimi ishte kaq i dallueshëm sa duke u konsultuar me Adventistët që e kishin ndihmuar të gjente besimin e tij të ri, ata arritën të siguronin një përfaqësim te Presidenti i Filipineve, Zoti Markos. Më në fund, dënimi i tij me vdekje u anulua. Sa i lumtur ish ai dhe ç'ndryshime të mrekullueshme kish bërë konvertimi në jetën e tij. Unë e takova këtë të djalë të ri në burg e munda të shoh se ç'ndryshim të mrekullueshëm ai kish arritur të përjetonte, qoftë edhe në një qeli burgu. Unë e dija se Zoti e kish falur këtë njeri; kjo ishte kaq e qartë. Edhe pse s'do ta harronte kurrë atë akt të tmerrshëm, gjersa të rronte në tokë, ai ishte falur nga Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti. Faji i këtij djali të ri që vendosur mbi Krishtin në kryq. Se vërtet, edhe një vrasës mund të falet. (Shih Romakëve 5:8).

Në dallim me të, dy djem të rinj në Viktoria, Australi, qëndronin pa iu dridhur qerpiku, kur juria iu dha verdiktin e fajësisë për një vrasje. Këta dy të rinj kishin qenë në një ekspeditë gjuetie në një pyll. Kishin mbetur pa ushqime, kur po kalonin përgjatë një ferme të izoluar. Këtu ata menduan t'i mbushin rezervat e tyre. Por kjo gjë doli të qe e komplikuar. Një fermer i ri po riparonte makinën pranë shtëpisë. Ata iu afruan nga pas dhe e goditën prapa kokës, për t'i marrë gjithçka që kishte, për t'i ngrënë. Duke përmbledhur rastin, Zoti Justice Scholl tha : “Ishte një rast jashtëzakonisht tragjik ku humbi një jetë shumë e çmueshme e një djali të ri. Por është gjithashtu një shembull i asaj që mund të ndodhë, kur ekziston një edukim tërësisht shekullor dhe një mungesë morali në trajnimin e rinisë”.

Dhjetë Urdhërimet kanë qenë gjithmonë një standard hyjnor për sjelljen njerëzore. Ato janë guidat morale të njerëzimit, se si duhet udhëhequr jeta e si njerëzimi mund t'i tregojë gjithë dashurinë e tij Zotit dhe njerëzve. Mirëpo ka një problem. Disa pjesë të Ligjit hyjnor, nuk janë të përshtatëshme për jetën e njerëzve modernë, madje edhe të shumë njerëzve të kishës. Për t'i anashkaluar këto rregulla apo detyrime, u zhvillua prirja për ta harruar tërë ligjin.

Lermëni ta qartësoj pak më shumë. Janë bërë mjaft sugjerime në lidhje me çështjen se Ligji është shfuqizuar, është zëvendësuar ose ndryshuar në një lloj mënyre. Tekstet e Shkrimeve të Shenjta që pohojnë se njeriu “jeton nën hirësinë e Zotit dhe jo të ligjit”. (Galateasve; 2:16, Romakëve; 3: 28 etj), janë marrë jashtë prej kontekstit të tyre, me përpjekjen për të provuar se standardi hyjnor i Zotit për sjelljen është shfuqizuar. Veçse, unë po ju pyes : a mund t'i thoni një njeriu se Ligji Hyjnor është shfuqizuar dhe pastaj të habiteni, kur ai i thyen ato ligje?

A mund ta vini në dyshim autoritetin e Zotit e pastaj të prisni prej të barabartëve tuaj ta respektojnë atë? Le të kujtojmë se ç' thonë Shkrimet:

Te Mateu 19:16,19 Shpëtimtari vendosi përballë një sundimtari të pasur të ri, faktet e Dhjetë urdhërimeve. “Përpara dikujt, eja e thuaji, o Mësuesi i Mirë, ç' gjëra të mira duhet të bëjë për të pasur një jetë të përjetëshme? Kurse Zoti iu përgjigj: “Pse më quan i mirë? Askush s' është i mirë, përveç Njerit që është Zoti; po në se do që të hysh në jetën e përjetëshme, zbato Dhjetë Urdhërimet”! Atëherë u shtrua pyetja: “Cilat urdhërimet?” E Jezusi nisi t'u referohej urdhërimeve : “Mos vrit!”, “Mos kryej tradhti bashkëshortore!”, “Mos vidh!”, “Mos jep dëshmi të rreme!” Ai e plotësoi historinë duke thënë: “Nderojë nënën dhe babanë tënd!” dhe “duaji fqinjët si veten!” A s' mund ta kuptoni atëherë Jezusin, se pse ai që ishte i pari që iu dha njerëzve Ligjin Hyjnor, e nderon atë kaq shumë?

Njeriu i mençur, mbreti Solomon, në këshillën e tij për kishën, te Eklez. 12:13,14 e përmbloodhi atë në këtë mënyrë :”Le të dëgjojmë

përfundimin e gjithë çështjes. Ki frikë nga Zoti dhe zbatoji urdhërimet e tij, kjo është gjithçka që i takon njeriut. Se Zoti do të vendosë në gjykim çdo vepër, qoftë edhe gjënë më sekrete, qoftë e mirë apo e keqe. Këto urdhërime janë standardi udhëheqës i gjykimit të Zotit.

Jezusi tha: “Në se më doni mua, zbatojini urdhërimet e mia.” Ndërkohë, ja si shkroi dishepulli i tij Gjoni në një letër: “Tashmë ne e kuptuam se e njohim atë, nëse i zbatojmë urdhërimet e Tij. Ai që thotë se e njeh Zotin dhe nuk i zbaton urdhërimet e Tij, është një gënjeshtar dhe e vërteta nuk gjendet në të. Vetëm ai që e zbaton Fjalën e Zotit, dashuria e Tij do të jetë vërtetësisht e përsosur për të. Falë kësaj gjëje ne kuptojmë se jemi në të” 1 Gjoni: 2:3-5.

Pali shkroi për ligjin e Zotit si “të Shenjtë, të mirë e të drejtë”, (Romakëve 7:12). Le të kujtojmë se mëkati është shkelja e Ligjit (1 Gjoni; 3:4). Shumë njerëz, duke përfshirë dhe disa njerëz të rinj, mendojnë se do të ishte mrekullueshme të mos kishte asnjë ligj. Të kesh liri pa ligje, ky lloj mendimi dhe jetese sjellë kaos.

Ne e kemi parë këtë në “Pranverën Arabe”. Mosekzistenca totale e ligjeve solli kaos! Liria dhe e drejta mund të ekzistojë vetëm kur njeriu i përshtatet Ligjit Hyjnor, sepse ky Ligj sjell liri dhe i bën njerëzit më të lirë. Ligjet e Tokës janë bazuar te Dhjetë Urdhërimet. A mund të imagjinojmë një botë pa ligje? Bota do të qe në një kaos të plotë. Imagjinojmë aksidentet prej trafikut në rrugë, në se nuk do të kishte ligje. Aksidentet janë të shumta edhe me këto ligje që kemi! Imagjinojmë kaosin e mëtejshëm, sikur njerëzit të vidhnin çdo gjë që ti mendon se të përket ty! Por, padyshim, Jeremia kishte të drejtë, kur shkroi për ligjin e Zotit si “Ligjin e Lirisë” (Jeremia 2:8-12).

Ekziston edhe një tjetër aspekt, i Ligjit të Zotit që njerëzit shpesh e nënvlerësojnë. Bazat e Ligjit Hyjnor është dashuria. Dashuri ndaj Zotit dhe njeriut. Katër urdhërimet e para lidhen me faktin se si ne e duam Zotin, kurse gjashtë të fundit lidhen me atë, se si ne duhet t'i duam njerëzit. Jezusi e dashuroi njerëzimin aq shumë, sa Ai vdiq në kryq për të sjellë shpëtimin e njerëzve që e kanë thyer e që do ta

thyejnë Ligjin e Tij. Nëse ligji do të zhdukej, atëherë edhe kryqi do të qe një farsë; në kryq krishti vdiq për njerëzit që i thyejnë Ligjet. Përmes vdekjes Ai u ofroi njerëzve Hirësinë e Tij.

Ligj-thyesit që mbeten të pafolur, përfundojnë në vdekje. Nga njëra anë Hirësia e Zotit, u jep jetë të gjithë atyre që e pranojnë atë. Një vrasës mund ta marrë këtë Hirësi të mrekullueshme po njëlloj, si çdo njeri që ka kryer lloje të tjera mëkatesh. Urdhërimet janë gjithashtu një zbulesë e karakterit të Zotit. Dashuria e Tij manifestohet më vonë, kur Ai na ndihmon dhe mundëson që ne të zbatojmë ligjin e vet. Ai s’e dha kurrë ligjin në mënyrë arbitrare, duke pritur që njeriu ta zbatojë atë pa kurrëfarë ndihme. Ai na premton ndihmë që t’i zbatojmë këto ligje, madje edhe kur dhjetë urdhërimet iu dhanë së pari izraelitëve në Malin Sinai, premtimet e Tij ishin për ndihmë ndaj tyre.

Katër urdhërimet e para të 10 urdhërimeve, u dëftojnë njerëzve, se si ata duhet ta duajnë Zotin. Urdhërimi i parë tregon se Zoti duhet të nderohet drejtpërdrejt, kurse i treti na drejton kah mirënjohjes që i duhet dhënë Zotit. Urdhërimi i katërt i fokuson njeriut një kohë speciale nderimi.

Gjashtë urdhërimet e fundit lidhen me marrëdhëniet e njeriut me njeriun.

Çdo aspekt i jetës është i përfshirë në këto marrëdhënie. Le t’i kundrojmë shkurtimisht, se për çfarë flet realisht Zoti në këto “Dhjetë Fjalë”, për t’i përballur ndershmërisht me përgjegjshmëritë tona.

1 . Ju s’duhet të kini tjetër Zot përpara Meje”.

Racat pagane kishin zota prej druri dhe gruri; ndërkohë që racat e Perëndimit kishin zotat e kënaqësisë, modës, parave, muzikës, sporteve e gjërave të tilla. A mund të kënaqet zemra njerëzore me zota të tillë? Gjithnjë e më shumë po shihet se gjëra të tilla nuk kënaqin, por shpesh përfundojnë në dhembje dhe vdekje.

“Asnjë njeri nuk mund t’u shërbejë dy zotave”. Kur është Zoti i pari, gjërat e tjera ndjekin rendin e tyre të prioriteteve.

2 . “Ju s’duhet të kini më statuja zotash”.

Ky urdhërim lidhet me rrugën më të drejtë të sjelljes e nderimit. Format e rreme të nderimit nuk falen. Satanai do të donte që njerëzit të nderonin të gjitha llojet e idhujve, në mënyrë që Zoti të mos nderohej në mënyrë të drejtpërdrejtë. Është e mundur që format dhe imazhet ta degradojnë konceptin tonë mbi Zotin. Nëse Ai është në zemrat tona, nuk ka nevojë ta shohim Atë në çfarëdo lloj forme tjetër përpara syve tanë, ashtu siç ne e nderojmë.

3 . “Ju duhet të nderoni emrin e Zotit”.

Përdorimi i emrit të Tij lehtësisht ose me mospërfillje, përdorimi profan, përбетimi dhe blasfemia zhvellojnë një mungesë respekti. Këto gjëra nuk duhet të gjenden në jetën dhe ligjeratën e një të krishteri.

Sa herë ne i shkelim herë pas here ligjet edhe pa e kuptuar!

4 . “Kujtohuni të mbani të Shenjtë Ditën e Sabatit”.

Koha e nderimit është një pjesë e Ligjit të Zotit. Për zhvillimin e karakterit të njeriut, nevojitet koha e tij me Zotin. Zoti premton përmes Shkrimeve të Shenjta, një bekim për të gjithë ata që ruajnë Sabatin. Sabati është gjithashtu një kohë e veçantë për kremtimin e ribërjes sonë.

5 . “Ndero prindërit”.

Ky është urdhërimi i parë që lidhet me dashurinë tonë dhe lidhjen me njeriun. Zoti i vendos prindërit si detyrimin tonë të parë në tokë. Të krishterët e vërtetë e fillojnë me shtëpinë, për këtë arsye ne i nderojmë prindërit tanë të Zoti.

6 . “Mos vrit”.

Krishti zhvillon se edhe urrejtja është një formë vrasjeje. Ne shpesh e shohim se si ajo të shpie në vrasje dhe vdekje.

7 . “Mos shkel kurorën”.

Shoqëria e ka paraqitur keq dashurinë. Kurorë-shkelja është një mëkat i zakonshëm sot, aq sa popullarizohet nëpër gazeta, tv, dhe forma të tjera të medias. Gjithsesi, ashtu si të gjitha shkeljet e urdhërimeve, nëse njeriu pendohet dhe e rrëfen mëkatin, Zoti i fal.

8 . “Mos vidh!”

Edhe pesha e masa janë gjithashtu pjesë e këtij urdhërimi. Njerëzit shpesh i harrojnë detyrat ndaj Zotit, duke e hyjnuar, madje me kohë e para.

9 . “Dëshmi e rremë”.

“Shkelja e betimit, gënjimi, përgojimi dhe skandali, përfshihen të gjitha në këtë urdhërim. Është e rëndësishme të siguroheni për burimin e informacionit, përndryshe ne mund të fajësohemi për përgojim”.

10 . “Lakmia”:

Zoti do që ne të jemi të kënaqur me atë që kemi. Nëse ne kemi një nevojë për të rritur kapitalin ose investimin tonë, kjo duhet të arrihet me mjetet dhe punën e pandërprerë, nëpërmjet përdorimit të talenteve dhe fuqive tona.

Kur njeriu fajësohet për thyerjen e këtyre urdhërimeve, Zoti i siguron kaluarin dhe hirësinë e Tij fitimtare. Të gjitha këto janë për ata që pendohen dhe i rrëfejnë mëkatet e tyre. Këtu gjendet fuqia për të gjithë ne të ndalojmë mëkatimin e të duam atë që na ngre mbi ligësinë e botës sonë. Te kaluari ne gjejmë shpëtimtarin tonë. Ai është rruga e vërtetë dhe jeta. Le ta ndjekim rrugën e Tij dhe të bëhemi një pjesë e mbretërisë së Tij, kur Ai të kthehet herën e dytë pa mëkate dhe për shpëtimin tonë.

18 . Ritet misterioze të shkretëtirës Arabike- Shenjtërorja

Mali Sinai, Abu Simbel dhe njollat e gjakut në shkretëtirën Arabike

Mali Sinai është i spikatur në Shkrimet e Shenjta për disa arsye:

- 1 . Kur Izraelitët, të udhëhequr nga Moisiu, u arratisën nga Egjipti, në atë që tash njihet si Eksodi, ata u mësuan pikërisht në këtë vend mbi marrëdhëniet me Zotin
- 2 . Dhjetë Urdhërimet e dhëna u shkruajtën nga Zoti prej këtij Mali
- 3 . Ligjet e ceremonive, shëndetit dhe marrëdhënieve civile iu dhanë Moisiut nga Zoti e pastaj edhe njerëzve, po në këtë vend.
- 4 . Aty Izraelitët mësuan rreth Hirësisë e gjykimit të Zotit.
- 5 . Një faltore e mbartëshme u ndërtua këtu, përmes së cilës Izraeli mësoi më me përpikmëri rreth mbërritjes së Mesisë dhe shpëtimtarit.

Abu Simbel

Rreth 150 vjet pas Eksodit, Ramsesi II ndërtoi Tempullin e vet në bregun perëndimor të Nilit, pranë kufijve të Egjiptit dhe Sudanit.

Shumë rrallë qenë ndërtuar tempuj në bregun perëndimor të Nilit. Karnak, Luksor dhe Amarna, për të përmendur tre nga më të famshmit, u ndërtuan në bregun lindor të Nilit. Kur prifti shërbente në këta tempuj, ai gjendej përballë lindjes së diellit. I kundërt është rasti i tempullit që Ramsesi II ndërtoi në Abu Simbel. Ndryshe nga tempujt e tjerë egjiptianë, ai kishte dy dhoma, një dhomë më të madhe përmes së cilës prifti mund të hynte në një dhomë më të vogël. Pse ky ndryshim?

Ramsesi II, padyshim që provoi mbresëlënie nga ajo s'ka ndodhi përgjatë Eksodit e veçanërisht në vendosjen e një vendi nderimi për Zotin e Izraelitëve. Skllëvërit vetëm sa u larguan nga Egjipti, ashtu siç desh fuqia e Zotit të tyre. Ata kishin ndërtuar vend-nderime që shikonin kah perëndimit. Shenjtërorja ose faltorja e tyre kishte dy dhoma, një më e madhe dhe një më e vogël, ku rrinte Zoti i Tyre. Tashmë ata qenë bërë një komb për t'u konsideruar, e kjo ishte arsyeja pse ai ndërtoi një tempull të ngjashëm në Abu Simbel. Më shumë se sa tremijëvjeçarë më vonë, kur u ndërtua diga Aswan 2, e vetmja mënyrë për të shpëtuar tempujt e Abu Simbelit prej liqenit të ri e më të madh të shaktuar nga diga e re, ishte ngritja e tyre mbi nivelin e ujërave. Sot vizitorët nuk arrijnë ta kuptojnë se dy tempujt e

ndërtuar për Ramesin II dhe gruan e tij Nefetari janë ngritur rreth 100 metra, vetëm për të mos u arritur nga vërshimi i ujërave të liqenit Nasser. Këta tempuj u zhvendosën me ndihmën e UNESCO-s. Sharra shumë të imta u përdorën për të prerë gurin ranor nëpër blloqe të mëdhenj, të cilat, më pas u ngritën lart në pozicionin përkatës. Trarë të mëdhenj të çeliktë u përdorën të mbështesnin blloqet nga zhvendosja. Sot çeliku është i mbuluar me gurë dhe rërë, prapa tempujve. Puna është kryer me shumë përpikmëri, saqë, kur rrezet e diellit, ndriçojnë vendin më të Shenjtë të tempullit dy herë në vit, një gjë e tillë vijon të ndodhë edhe në pozicionin e ri të tempullit. Tempujt egjiptianë bënë shumë pak për zhvillimin dhe rritjen shpirtërore të njerëzve, por ishte ndryshe për Izraelin dhe shenjtëroren e tyre.

Shkrimet e Shenjta e tregojnë qartësisht se gjaku përfaqëson jetën dhe vdekjen. Krishti vdiq që ne të mund të jetojmë. Por jeta jonë e re është e mundur vetëm përmes vdekjes së Tij. Te Gjoni 8:16, Jezusi tha: “Abrahami u ngazëllye të shihte dritën time. E kur e pa, u kënaq”. Nëpërmjet besimit Abrahami mundi të shihte agimin përgjatë gjithë viteve të jetës gjer në mbërritjen e Shpëtimtarit tonë. Ai e pa atë akoma dhe më qartë, kur qingji zuri vendin e Isakut në Malin Moriah. Abrahami po bëhej gati të therte Isakun, por Zoti e mbajti dorën e tij. S’ka dyshim se ai ishte i lumtur të shihte pas kësaj, falë besimit në ditën e Shpëtimtarit që të mos sakrifikohej në qingja e këto lloj provash që përjetoj Isaku, të mos ndodhnin më. Përse vallë, duhet të sakrifikojmë qingja? Janë të gjitha këto flijime e ceremoni vërtet të nevojshme? Le të shkojmë në Malin Sinai për përgjigjen!

Shenjtërorja

Përpara kryqëzimit të Krishtit, kalvari konturizohej në atë që njihet shpesh si “lloje dhe hije”. Zoti e përdori këtë metodë që njerëzit të mund të dinin sa më shumë gjëra rreth Tij. Vëreni tekstin 1 Pjetër,

2:9 : “Por ju jeni një brezni e zgjedhur, një priftari mbretërore, një komb i shenjtë, një rracë me njerëz të veçantë; e ju duhet të më tregoni të gjitha lavdet e Atij që ju thirri e ju nxori prej errësirës në dritën e vet madhështore.” Ajo është e vërteta. Zoti donte që njerëzit e Tij të dilnin në dritë. Një shembull shumë i mirë për këtë është rasti kur Ai i thirri njerëzit e vet jashtë prej Egjiptit në Eksod. Zoti donte të qenë bashkë, sepse ata ishin thesari i Tij i veçantë. Ai i kërkoi Moisiut: “Ndërto një Shenjtërore që Unë të banoj në mes tyre.”. (Eksodi 25:8). Në rajonin shkretinor të Sinait, njerëzit shijuan për pak praninë e Zotit, teksa Ai banoi midis tyre me mesazhin e Tij të shpëtimit.

Shumë vite më vonë, mbreti David do të thoshte : “Udha jote, o Zot, është te Shenjësia”. Po cila udhë vallë, gjendet te Shenjësia? Udhë e Shpëtimit. Njeriu u rrëzua mizorisht në mëkat, po përsëri Zoti gjeti një rrugë shpëtimi për të. Ai premtoi që Jezusi do të vdiste dhe do të bëhej zëvendësuesi i njeriut të vdekur. Kur Davidi tha se udha e Zotit gjendet te Shenjësia, ai kuptoi atë që po bënte Zoti për të siguruar një shpëtim nga pasojat e mëkatit.

Përgjatë Eksodit, në Malin Sinai, Zoti i mësoi njerëzit e Izraelit të ndërtonin një Shenjtërore ku Ai të zhvillonte veten dhe përkujdesjen e Tij për ta. Shumë vite më vonë kur njerëzit e Tij u kthyen nga Babilonia, ku kishin qenë skllavër, Ai u tha që ta rindërtonin Shenjtëroren. Po si ishte kjo Shenjtërore? Vëreni se si përshkruhet ajo te Hebrenjtë 9:2-5: “Dhe një faltore u përgatit: pjesa e parë, në të cilin që vend-qëndrimi i llampës, tryeza dhe dëftonjësja e bukës, që quhej shenjtërore. E prapa vellos së dytë, pjesa e faltores, që quhej vendi më i Shenjtë; aty gjendej Temjanica e praruar dhe arka e Besëlidhjes e lyer nga të gjitha anët me ar, në të cilën gjendej vazoja e praruar që përmbante manna-n, shkopi i Aronit që mugëlloi dhe tryeza e besëlidhësve, përmbi të cilët rrinin engjëjt e lavdisë që hijezonin nga sipër vendin e së Mëshirshmes. Për këto gjera ne nuk mund të flasim tani me detaje. Kur shenjtërorja u ndërtua, ajo ishte e mbartshme. Ajo u zëvendësua, kur Solomoni ndërtoi tempullin e tij e

kur ndryshime të tjera u bënë shekujve të mëvonshëm në kohën e rindërtimit nga Zerrubabeli dhe Herodi.

Kur njerëzit shkojnë përmes portës lindore, shpina e tyre i drejtohet diellit, derisa arrijnë në një oborr me përmasa 25m x 52m. Në këtë oborr ishte një altar ku bëhej djegia e dhurimeve. Ky altar dhe veçanërisht shërbimi i tij përfaqësonin Kalvarin. Midis altarit dhe hapësirës së derës për te Shenjtërorja, gjendej një legen ku prifti lante duart dhe këmbët” (Eksodi 30: 17-20). Ndërsa Zoti tregojë i veçantë për pastërtinë, ai interesohej shumë më tepër në pastrimin e zemrave dhe jetëve të atyre që i shërbenin dhe vlerësonin Atë! Pjesa e parë e Shenjtërores, i quajtur Vendi i Shenjtë përmbante tri pjesë kryesore orendish. Në të majtë ishte një shandan me 7 qirimbajtës. Ai ndriçon gjithë vendin e Shenjtë dhe përfaqëson Jezun Krishtin, dritën e botës. Vaji përfaqëson dritën e Ungjillit të bërë të gjallë në zemrat e njerëzve përmes Shpirtit të Shenjtë. Pjesa e dytë ishte një tryezë e praruar dhe e bukur që përmbante që përmbante 12 copë bukëmbajtësesh. Jezusi ishte buka e Jetës (Gjoni 6:48). Përpara perdes së madhe ose vellos, që ndan Vendin e Shenjtë nga Vendi më i Shenjtë, gjendet Altari i Temjanit. Aty temjani digjet vazhdimisht dhe përfaqëson disponueshmërinë e Zotit për gjatë gjithë kohës për të dëgjuar lutjet e fëmijëve të Tij.

Vetëm Prifti i Madh, mund të kalojë përtej vellos një herë në vit dhe kjo quhet Dita e Mundimeve të Jezusit. Në Vendin më të Shenjtë, e vetmja orendi ishte Arka e besëlidhjes. Në qendër të arkës ishte vendi i mëshirimit (që përfaqëson praninë e Zotit), i cili hijezohej nga sipër nga dy engjëj, nën të cilët qenë vendosur drejtpërdrejtë 10 urdhërimet.

Falja e Zotit e zhvilluar te Shenjtërorja

Si sillen “njerëzit e veçante” të Zotit në shërbimet e tyre? Le të marrim një shembull nga Levitikui 5:17-16: “Në se një person

mëkaton, e kryen njëërën nga ato gjëra që ndalohen nga Urdhërimet e Zotit, edhe pa e ditur, ai është fajtor e do të mbartë ligësinë e tij. E duhet t'i sjellë priftit një dash pa cen nga tufa, sipas vlerësimit të tij, si një blatim mëkati. Kështu prifti do të bëjë shlyerjen e fajit për të, për shkak të padijes ku ai endej, për ta falur pas kësaj. Ndërsa njeriu i sjell blatimet e tij Zotit, ai i njeh kushtet e kalvarit. Ashtu siç thotë te Hebrenjve 9:22: “Pa derdhje gjaku, nuk ka falje”. Ashtu si çdo njeri përgatit dhuratën e tij për mëkatin dhe e vret atë, po ashtu ai shpreson te kryqi, kur shpëtimtari të vdesë, për t'i dhënë tij falje një herë e përgjithmonë. Akti i sjelljes dhe afrimit të dhuratave zhvillon besimin e plotë në faljen nga Krishti. Ashtu siç tha Gjon Pagëzori, kur Jezusi erdhi për t'u kunguar; “Qingji i Zotit, i cili mbarti mbi vete mëkatet e botës”. E kjo, sepse shpërblemi i mëkatit është vdekja, ndërsa dhurata e Zotit është jeta e përjetshme përmes Jezu Krishtit, Zotit tonë” (Romakëve 6: 23).

E përditshmja

Në kalendarin Hebre afrohen dy nga sakrificat më të rëndësishme. Njera është e vazhdueshme ose e përditëshme (Eksodi 29:38-42). Çdo mbrëmje dhe mëngjes kjo sakrificë afrohet si një mbulesë e parathënë, deri kur mëkatarët të bëjnë rrëfimet ose të sjellin dhurimet e tyre. Psh. një person mund të zgjohet në mes të natës e të kujtojë mëkatet e veta ose ndoshta, mund të jetë shumë larg Shenjëtore. Ky njeri mbulohet nga sakrifikimi i “përditshëm”, derisa ai të sjellë blatimin e tij. “Sakrifikimi i përditshëm” përfaqëson sakrifikimin e Krishtit, që u mundësua për të gjithë ata që i rrëfejnë mëkatet. Kur u bë rrëfimi në Sinai, çdo person ishte i lirë nga dënimi i Ligjit. Ky sistem i paraqitur ndaj Adamit dhe i qartësuar ndaj Izraelit, ishte Ungjilli në hije. Ata që kundrojnë Shënjtëroren, e shohin këtë sistem si “Rrugën e tyre të Shpëtimit”.

Ne jemi të mbuluar në po të njëjtën mënyrë prej Kalvarit. Sakrifikimi i Tij në Kalvar do të thotë që ne zotërojmë ndërhyrjen e

vazhdueshme të Krishtit; ne kemi një kujtesë të vazhdueshme të veprës së Tij mbrojtëse, faljen e Tij të vazhdueshme dhe shpëtimin e vazhdueshëm. Leksioni i madh për ne prej Shenjtërores, është fakti se edhe pse e meritojmë vdekjen, Zoti ka siguruar për ne një rrugë shpëtimi përmes faljes dhe rrëfimit!

Dita e mundimeve të Krishtit

Shërbimi i dytë më i rëndësishëm i Shenjtërores, është ai i Ditës së Mundimeve të Krishtit (Levitiku 23:27-29). “Dhe dita e dhjetë e muajit të shtatë, duhet të jetë Dita e Mundimeve të Krishtit. Aj do të jetë një shërbesë e Shenjtë për ju; do të dhimbeni në shpirt e do t’i ofroni Zotit një dhuratë prej zjarri. Nuk do të punoni atë ditë, sepse ajo është Dita e Mundimeve të Krishtit, që Krishti të falet për ju përpara Zotit tonë. Se çdo njeri që bën ndonjë punë në këto ditë, unë do ta shkatërroj në mes të njerëzve të vet”. Për Izraelin kjo ishte Dita më solemne e vitit. Por edhe në bazë të vargjeve të tjera, ajo është një ditë gjykimi. Të gjithë ata që nuk e kanë faljen e mëkateve, do të dëbohen nga grupi. Do të bëhen flijim edhe në këtë ditë të rëndësishme gjykimi. Gjykimi i Zotit bazohet në Ligjin e Tij. Mëshirimi shtrihet deri te mëkatari përmes sakrifikimit të Krishtit .

2 Korintasve 5:10: “Gjithçka do të shfaqet përpara fronit gjykues të Zotit”. Plani i Zotit nuk është të dënojë botën, pasi Ai dërgoi edhe Birin e Tij të vetëm, që bota të shpëtonte. Por ata që mohuan Birin, duhet të marrin gjykimin e Zotit e të ndahen për jetë nga Ai. E vetmja rrugë e të qenit i gatshëm për gjykimin është pranimi i Krishtit dhe ecja me Të. (Gjoni, 5:18-29). Është falë sakrificës së Jezu Krishtit dhe pranimit të Tij nga ana jonë, që ne mund të jetojmë apo të vdesim. Zoti do që ne të jetojmë.

Koha e gjykimit

Zbulesa 14:6,7: “Ora e gjykimit të Tij do të vijë”. Po kur vallë, është kjo kohë? Shkrimet e Shenjta thonë : “Ai ka caktuar një ditë në të cilën do të gjykojë botën”. Po, kur është kjo ditë? Danieli jep jo vetëm një përshkrim të ditës së gjykimit, por edhe të vetë gjykimit. Shiko Daniel 7:9, 10, 22, 25, 26. Atëherë le të kujtohet gjykimi i Zotit! Librat janë hapur. Ekziston gjykimi edhe mbi fuqinë e Bririt të Vogël. Po pse, vallë, te fuqia e Bririt të Vogël? Sepse kjo fuqi ndërhyr në “sakrifikimin e përditshëm”. Është njëherësh një fuqi blasfemuese dhe persekutuese. Mbretërimi i saj shtrihet gjer në kohën e fundit kur do të jepet gjykimi, e kur më në fund sundimi dhe pushteti i Bririt të vogël do të humbasë.

Njerëzit pyesin : “Pse vallë, kjo fuqi që e zonja të persekutojë? Pse ekziston gjithë ky mëkat? Edhe Davidi e bëri këtë pyetje, pa mundur ta kuptojë, pse ligësia përparonte dhe duhej t’i shpëtonte gjykimit. Por, kur qendroi te Shenjëtorja, atëherë kuptoi fundin e tyre (Psalmi 73:11,17). E njëjta përgjigje jepet te Danieli 9:13, 14. “Po sa zgjat” kjo çështje? Sa gjatë ky Bri i Vogël, do të përdhosë sakrificën e përditëshme? “Deri në 2300 ditë”. Atëherë do të vijë koha e fundit, koha e gjykimit, koha e vendosjes për çdo njeri, duke përfshirë ty dhe mua.

Kjo është një çështje tjetër, por, kur mbaron vallë, profecia e këtyre 2300 ditëve? Ajo filloi në vitin 497 p.K. dhe duke shtuar 2300 ditët apo vitet (siç llogariten në profecinë e Biblës), do arrijmë në vitin 1844 p. K. Mirë, pra, atëherë, ç’ ka ngjarë më 1844? Dita e madhe e gjykimit fillon , kur të gjithë ata që kundërshtojnë Zotin, si psh. fuqia e Bririt të Vogël, do të fillojnë të gjykohen. Është fillimi i gjykimit të paraardhjes, kur Krishti i zhvillon gjithë Universitetin ata që do të shpëtohen nga Falja e Tij. S’do të fshihet asgjë nga gjykimi i madh i Zotit. Kur të ndesheni me gjykimin hyjnor, nuk do të ketë person të dënuar padrejtësisht ose të shpëtuar padrejtësisht.

Miq! Kur Krishti të shfaqet herën e dytë, do të vendoset gjykimi për të gjithë ata që kanë jetuar. Tani është dita e përgatitjes së gjykimit

tuaj. Askush prej nesh nuk mund të përballet me heqjen e shpëtimit. Sot është thelbësore të jetosh me Krishtin e fronësuar në zemrat tona. Sot ne jetojmë në kohën e gjykimit. Pse të mos e filloni edhe ju përgatitjen për të qenë me Krishtin, kur Ai të vijë, duke e besuar Atë si Shpëtimtarin personal dhe duke lejuar që Ai t'ju kontrollojë jetën tuaj të përditëshme? Atëherë gjykimi do të jetë në favorin tuaj. Se Ai është Rruga e Vërteta dhe Jeta. Zoti ju bekoftë që ia përkushtoni jetën Atij!

19 . Sekreti i një shtëpie të lumtur.

Përparimi ngazëlluese të teknologjisë kanë nanuritur miliona njerëz në një ndjenjë të gënjeshtërt sigurie. Paraja, koha për të shkuar bashkë me ta, dhe shkenca do të çlirojnë tërësisht botën prej andrallave të saj. Nëse njerëzve iu thyhet zemra, atëherë gjëja më e mirë është t'i falin zemrën dikujt tjetër. Nëse ndodh një krizë ushqimesh, atëherë si fermë do të shërbejnë detet. Në këto ditë të bollëkut pritet nga shumë njerëz që të shihet diku me besim në të ardhmen.”

Arsyet për rënien e Romës

Në shekullin e 2-të Romakët spikateshin nga ai shpirti i “të mos pasurit kurrë mjaftueshëm”, e falë tij kombi shkoi në shkatërrim. Pesë arsye janë dhënë për rënien e Romës nga historianët më të njohur të periudhës Romake.

1. Shkatërrimi i familjes me rritjen e shpejtë të divorceve.
2. Shpenzimet ekstravagante dhe rritja spiralore e taksave.
3. Brutalizimi i sporteve dhe një marrëzi e theksuar për kënaqësinë.

4. Harxhimet i të ardhurave në fushën e mbrojtjes, për shkak të kalbëzimit të shoqërisë.

5 . Shkatërrimi i fesë me një mori formash e ngatërresash.

Mund të heqim një vijë paralele edhe me gjendjen e sotme. Këto pesë arsye të rënies së Romës, ekzistojnë të gjitha edhe sot. Joseph M. Kennick, presidenti i shkuar i Konferencës Kombëtare të Autoriteteve Juvenile në Shtetet e Bashkuara, duke komentuar shoqërinë e sotme të sëmurë shkroi : “Diku përgjatë rrugës, si prindër dhe si komb, ne gabuam me breznitë e populluara fortësisht nga një rini pa ligje, rebele, kanosëse, e cila nuk kishte respekt për ne ose për veten. Po ku gabuam? Gabuam në shumë mënyra në tolerimin e disiplinës, në llastimin e fëmijëve tanë, pasi duke ua hequr barrën nga shpatullat e tyre, ata duhet të udhëhiqen drejt.” Shpërbërja e strukturave sociale nuk ndodhi brenda një nate. Ajo erdhi përmes një përkeqësimi shkallësor, që nisi të gërryejë gjithë kombin. Kjo gjë ndodhi në Romë e po ndodh edhe sot.

Zoti nuk u gjet i papërgatitur. Tek 2 Timoteut 3:1-5, thuhet : “Ju duhet të përballeni me faktin se epoka finale e kësaj bote do të jetë një epokë shqetësimesh.”

Njeriu s’do të dashurojë asgjë tjetër përveç parave dhe vetvetes; ai do të jetë arrogant, mburravec dhe abuzues; s’do të dijë të ketë respekt për prindërit, asnjë mirënjohje, asnjë mëshirë, asnjë dashuri natyrore; ai s’do të dijë të jetë i pafashitur në urrejtjen e vet, shpifarak, mizor dhe gjak-nxehtë, i huaj ndaj të gjithë zotëve, tradhtar, aventurier, i fryrë veç nga rëndësia e vetvetes. Ai do të jetë një njeri që do të vendosë kënaqësinë në vend të Zotit, njeri që do të ruajë, veç formën e jashtme të besimit, por që do të ndjejë një mohim të vazhdueshëm te realitetit të tij”. Kjo profeci është një komentari i njëmendtë i asaj çfarë ne shohim sot çdo ditë.

Dashuri dhe disiplinë

Një proverb i vjetër Hebre thotë: “Jeruzalemi u shkatërrua, sepse Izraeli dështoi t’i edukoj fëmijët e vet”. Dashuria dhe disiplina duhet të shkojnë dorë për dorë në edukimin e familjes në këtë kohë, ashtu si dhe në kohën e shkuar. Qëndrueshmëria në trajnimin e fëmijëve është e një rëndësie madhore. Dashuria i jep fëmijës një ndjenjë vlere, kurse disiplina një ndjenjë sigurie. Këto dy fakte mungojnë, ndoshta në shumicën e shtëpive.

Së bashku me dashurinë dhe disiplinën, fëmijët duhet të mësojnë edhe vlerat morale. Është e lehtë të fajësosh një brez të ri për sëmundje morale. Sidoqoftë, të rinjtë nuk janë ata që i bëjnë filmat ose shkruajnë skenarët e emisioneve televizive. Ata nuk botojnë libra dhe komedi, dhe nuk janë përgjegjës për mëkatën e pornografisë.

Për shumë dekada, interpretuesit e Shkrimeve të Shenjta me rrjedhime e tyre të gabuara i nënvlerësuan themelet e shoqërisë. Ligjmbajtja është një antidot i natyrshëm për ligjthyerjen. Por pjesë të caktuara të Ligjit Hyjnor nuk janë të përshtatëshme për shoqërinë moderne dhe duke u përpjekur t’i tejkalojë këto detyrime, njeriu e nënvlerësoi autoritetin e Ligjit Hyjnor të Zotit. Janë bërë sugjerime edhe në lidhje me faktin se “Ligji është shfuqizuar ose është ndryshuar apo zëvendësuar dhe mos-zbatuar”. A mund t’i thoni vallë njerëzve se Ligji është shfuqizuar e pastaj të habiteni që ai është thyer. A mund t’i thoni vallë të rinjve se nuk i përgjigjen Ligjit Hyjnor dhe pastaj t’i fajësoni ata, kur thyjnë ligjin civil?

Plani i Zotit

Krishti tha: “Nëse më doni mua, atëherë ju do t’i bindeni asaj çka Unë do t’ju urdhëroj” (1. Gjonit 5:3). Kjo është dashuria për Zotin: t’i bindesh urdhrave të tij; se urdhërimet nuk janë aspak një barrë (1

Gjonit 2:4). Njeriu, i cili thotë: “Unë e njo atë, por nuk bëj atë që Ai urdhëron është një gënjeshtar, dhe e vërteta nuk është me të. Urdhërimet e Zotit janë standardet e së drejtës dhe së gabuarës, e për më tepër edhe standardet në bazë të të cilave Ai e gjykon njeriun në gjyqin e madh përfundimtar. Dhjetë urdhërimet janë ligji i madh moral. Krishti erdhi dhe vdiq, sepse njeriu ishte i pabindur dhe i theu standardet. Krishti nga ana tjetër provoi edhe se si duheshin të ruheshin standardet.

Ky “Ligj Moral” është i bazuar te dashuria. Kështu thuhet te Eksodi 20:17. Urdhërimi i parë zhvillon se si duhet të aduam epërsisht Zotin. Ligji i dytë tregon se si mund ta duam Atë drejtpërdrejt dhe shpirtërisht pa asnjë kushtëzim. Pastaj urdhërimi i tretë zhvillon se kjo dashuri është mirënjohëse. Kjo dashuri shprehet më mirë rregullisht dhe veçanërisht në ditën e shtatë të javës. Kështu katër urdhërimet e para zhvellojnë rrugën se si duhet ta duam Zotin. Por, ne kemi gjithashtu një detyrë morale për njerëzit tanë dhe kjo zhvillohet në gjashtë urdhërimet e fundit.

I pari, në ligjin moral, që ka të bëjë me ne, gjendet te detyra jonë ndaj prindërve, të cilët duhet të nderohen dhe gëzohen. Urdhëri i gjashtë ka të bëjë me atë se si njeriu duhet të respektojë jetën që i ka dhuruar Zotin. Ai nuk duhet të vritet.

Shtëpia dhe familja jonë të ruajtura dhe të mbrojtura në urdhërimin e shtatë, të cilat thonë se njeriu nuk duhet të kryejë kurorë-shkelje. Nderi dhe reputacioni i njeriut konsiderohen në urdhërimin e tetë, ndërkohë që në të nëntin ruhet dhe mbrohet pronësia e tij. Urdhërimi i dhjetë mbulon të drejtat e njeriut. Këto norma bazë dhe ligjet morale mbulojnë çdo aspekt të mundësive të njeriut për Zotin dhe komunitetin e tij. Janë pikërisht këto parime themelore që njeriu ka përçmuar dhe harruar. Njeriu ka nevojë ta shikojë përsëri të vërtetën e këtyre urdhërimeve. Ai duhet ta zbatojë çdo ditë këtë ligj të madh të dashurisë në jetën e tij.

Si arrihet lumturia

Ja, cili është sekreti i lumturisë. Ky sekret mund të zbatohet në jetë, sepse ai është themeli i dashurisë. Pol Getty ka thënë: “Unë do t’i kisha flakur të gjitha milionat e mia, vetëm për një martesë të suksesshme”. Te Zanafilla 2:18 Zoti tha : “S’është mirë për njeriun të rrijë vetëm; unë do të krijoj diçka ndihmuese për të”. Prapa të gjithë njerëzve të mëdhenj, gjendet një grua e mirë. Gruaja e Adamit u krijua nga një brinjë e marrë prej tij, pranë zemrës. Eva duhej të ishte shoqja e zemrës së Adamit. Shtëpia e parë u ngrit mbi dashurinë. Zanafilla 2:24, zhvillon se njeriu duhet ta lërë nënën dhe babanë e tij në martesë dhe të ndërtojë shtëpinë e vet të re. Shumë martesa përfundojnë, sepse çiftet nuk arrijnë të ndërtojnë vetëm dhe vetëm martesën. Bota duhet të ndërtohej nga Edenë të vegjël, ku të mbretëronte paqja dhe hareja, ku njeriu të shumëfishohej dhe ripopullonte tokën. Zoti iu gëzoftë në shtëpitë tuaja dhe paçi aty pagën e Tij, dashurinë dhe bekimin ngazëllyes.

Gruaja duhet t’i nënshtrohet udhëheqjes së burrit, në po të njëjtën mënyrë, se si ju i nënshtroheni Zotit”. (Efesianëve 5:22, Keneth Taylor). Zoti kërkon që t’i nënshtrohemi Atij, sepse ne e duam Atë. Por kjo marrëdhënie dashurore nuk na bën të humbasim aspak individualitetin tonë. Ka mjaft drejtime për këtë zhvillim. Zoti e nderon marrëdhënien tonë në Të, e pikërisht në këtë kuptim gratë duhet t’u nënshtrohen burrave të tyre. “E ju burra tregoni ndaj grave tuaja po atë lloj dashurie që tregoi Krishti për Kishën, kur vdiq për të”. (Efesianëve 5:5, Keneth Taylor në “Bibla e gjallë”). Nuk ekziston asnjë nuancë egoizmi që kjo dashuri të jetë vetë-flijuese. Dashuria është gjëja më e ëmbël dhe më e shenjtë, dhe më e bukur që Zoti i ka dhuruar njerëzimit. Por ajo është zhvlerësuar dhe abuzuar. Bashkëjetesa e shenjtë është transformuar në një bashkë-vdekje jo të shenjtë, duke bërë që divorci të marrë përpjestime shumë të mëdha. Nëpër shtëpitë e tyre shumë të rinj nuk komunikojnë me prindërit. Kjo ndodh shpesh, sepse vetë prindërit gjejnë vështirësi të komunikojnë me njeri-tjetrin. Periudha e hershme e mirësjelljes, me njerëz të këndshëm, miqësorë e që komunikojnë lirshëm, është

shndërruar në një epokë të heshtjes. Për pasojë, shkatërrimi i martesave na sjell ndër mend atë që Zoti tha te Mateu 24:37,38 “Jepni dhe merrni në martesë”. Martesa është formësuar të mbrojë shtëpitë e fëmijët, e kjo kontratë nuk mund të thyhet pa vuajtje. Zoti lejoi divorcin vetëm në rastet e kurorë-shkeljes, Mateu I 9:9, Mateu 5 : 31, 32, dhe Marku 10 :2-12.

Kurorëshkelësit nuk do ta trashëgojnë mbretërinë e Zotit, po të mos i rrëfejnë mëkatet e tyre dhe të fitojnë mëshirën falëse të Zotit, (Galateasve, 6 :19-20). Një njeri mund ta fitojë faljen, sepse dhe vetë Krishti tha: “As unë s’kam për t’ju dënuar, nëse ju shkoni e nuk mëkatoni më” (Gjoni 8:3-11). Mos-lumturia martesore mund të besohet duke i hequr rrugës shkaqet e saj. 2 Korintasve 6:14 na sugjeron që ne të mos martohemi me jobesimtarë. Kur dy njerëz janë të lidhur së bashku te Zoti, mundësitë për një martesë të lumtur janë shumë më të mëdha, se sa në rastin kur kësaj martese nuk i jepet asnjë shans i këtillë.

Fjalët e Urta 21:19 zhvellojnë të vërtetën e faktit që “dikush duhet ta njohë mirë personin me të cilin duhet të lidhet në martesë. Më mirë të jetojmë në shkretëtirë se sa me një grua gërnjare”, ka thënë Solomoni. Deut 24:5 na paralajmëron kundra martesave të luftës. 1, 5:6, thotë: “Burrat duhet të sigurojnë të ardhura për shtëpinë”. Në fund, Efesianëve 4:26 thotë: “Mos lini që zemërimi juaj të zgjasë deri në perëndimin e diellit”. Pa dyshim që mençuria e Zotit është e rëndësishme në marrëdhëniet martesore.

Shtëpi të lumtura thjesht nuk gjenden. Duhet kohë që të krijohet një shtëpi e lumtur. “Familja që lutet së bashku, qëndron së bashku”. Nëse njerëzit do të zbatonin vetëm këshillën e Shkrimeve të Shenjta për t’u lutur, atëherë lumturia do të mbushë shtëpitë. Lutja kapërcen aq shumë pengesa. Dashuria e vërtetë është sekreti i një dashurie të lumtur. Dashuria për Zotin dhe njeriun është parim i madh, i rëndësishëm për çdo shtëpi. Zoti e bekoftë shtëpinë tuaj që të jetë shtëpia më e lumtur që ekziston sot në tokë.

20 . Njeriu do ta lërë këtë botë i gjallë

Jezusi tha: “Mos e lini zemrën të shqetësohet; besoni në Zot, besoni dhe te unë. Në shtëpinë e Atit tim ka shumë dhoma. Po të mos ishte kështu do t’ua kisha thënë. Unë po shkoj të përgatis një vend për ju, e nëse shkoj të përgatis një vend për ju, do të kthehem përsëri t’ju marrë: se aty ku do të jem unë, do të jeni dhe ju”. (Gjoni 14:1-5)

Ka njerëz që tashmë kanë shkuar në parajsë. Shumë kohë më parë pat qenë Enoh-u (Zanafilla 5:24), e pastaj Moisiu (Mateu, 17:3, Juda 9), e pastaj Elija (Dy mbretërit 2:11). E padyshim Jezu Krishti i cili u ngjiti nga kjo botë për t’u kthyer te Ati. Këta persona qenë paralajmëruesit e të gjithë asaj morie njerëzish që do të bashkohen me ta, kur Jezusi do të vijë për herë të dytë.

Kur Krishti të kthehet, do të ketë vetëm dy grupe njerëzish- të drejtët dhe të liqtë - të shpëtuarit dhe të humburit. Në secili prej këtyre grupeve do të jenë dy klasa njerëzish- të gjallët dhe të vdekurit. Ata formojnë kategoritë e mëposhtme:

1 – Të vdekurit e drejtë

2 – Të gjallët e drejtë.

3 – Të vdekurit e liq

4 – Të gjallët e liq

Ne do të diskutojmë së pari grupin e të drejtëve. Kur Jezusi të vijë përsëri, do të ketë disa që jetojnë e i shërbejnë Atij. Por shumica e stërmadhe që ka qenë e drejtë për gjatë gjithë kohërave, përveç breznisë së fundit që është gjallë, do të jetë nëpër varre, për të pritur thirrjen e Tij: “Se vetë Zoti do të zbresë nga Qielli me një britëm, me një zë arkangjeli dhe me trumpetën e Zotit; e Krishti i vdekur do të ngrihet i pari” (Selanikasve 4:16).

Vdekja nuk mund të mbretërojë në praninë e Zotit të jetës. Kur ai të ecë mes njerëzve, djali i vejushës dhe vajza e Jairus-it do të rringjallen që të dy. Llazari u kyç në varr për ditë të tëra. Megjithatë, Jezusi e flaku tutje gurin dhe e thirri Llazarin të vinte përsëri në jetë. Jezusi tha: “Unë jam ringjallja dhe jeta: ai që beson te Unë, edhe pse mund të jetë i vdekur, përsëri do të jetojë; E po njëjloj, ai që do të jetojë e do të besojë te mua, nuk do të vdesë kurrë. S’e besoni këtë?” (Gjoni 11:25, 26).

Pali tregoi pikërisht të njëjtën të vërtetë. Pasi pohoi se me ardhjen e dytë të Jezu Krishtit, “Krishti i vdekur do të ngjallet së pari”, ai tha. “Ne që jemi gjallë e kemi mbetur në Tokë, do të kapemi së bashku me ta në re, për të takuar Zotin në ajër: kështu do të jemi përgjithmonë me Zotin”. (1 Selanikasve, 4:16, 17). Në këtë kohë i vdekuri i drejtë do të çohet në jetë e së bashku me ata që janë gjallë e që i shërbejnë Jezusit, do të ngjiten nga ky Planet i zymtë për të takuar Mjeshttrin e tyre në ajër. Ata do të shkojnë të jenë “me Zotin”. Te Zbulesa 20:4 treguam se si “ata jetuan dhe mbretëruan me Krishtin për njëmijë vjet”. Shprehje të tilla “me Krishtin” dhe “me Zotin”, na tregojë edhe se kur Jezusi do të vijë të marrë njerëzit e Tij. Në premtimin për t’u kthyer, që ne tashmë e kemi lexuar prej Gjoni 14:1.3, Jezusi tha se: “Ai do të vinte, për t’i shpënë ata në dhomat që kishte përgatitur në shtëpinë e Atit. Ai planifikoi që “aty ku që Ai të qenë dhe ata”. Ne e dimë se Jezusi është në shtëpinë e Atit e në këtë vend qiellor, njerëzit e Tij do të shkojnë shumë shpejt, pas kthimit të Tij në tokë. Gjoni në librin e Zbulesës tha se njerëzit do të jetojnë dhe mbretërojnë aty me Krishtin për njëmijë vjet. Kjo periudhë kohe njihet ndryshe edhe si mijëvjeçari i Biblës.

Çfarë do të ndodhë me të papërgatiturit?

Tani le të vijmë te grupi i njerëzve që njihen si të liqtë. Për fat të keq, jo të gjithë iu përgjigjën dashurisë së Krishtit. Si rrjedhim, po njëjloj, jo të gjithë ata që jetuan e vdiqën në shekujt e shkuar ndoqën fjalën e

Zotit dhe u përgatitën për mbretërinë e Tij. Një shqyrtim tërësor i Shkrimeve të Shenjta, nuk zbulon asnjë premtim mbi faktin se do të shpëtohet çdokush. Zoti planifikoi shpëtimin e të gjithëve, po jo të gjithë e pranuan këtë plan. Çdo të ndodhë atëherë me të pashpëtuarit, kur të kthehet Jezusi? Po me ju që rrini të shqetësuar mes nesh, ç'do të ndodhë, kur Zoti Jezus të zhvillohet prej Qiellit me të gjithë Engjëjt e vet madhështorë. Po kur me një zjarr flakërues do të merret me ata që nuk e njohin Zotin e nuk i binden Ungjillit të Zotit tonë Jezu Krisht? Kush do të dënohet me shkatërrimin e përjetshëm prej pranisë së Zotit dhe prej lavdisë dhe fuqisë së Tij? Po kur Ai të vijë e të nderohet nga të shenjtët e Tij e të admirohet nga të gjithë ata që e besojnë atë ditë”. (2 Selanikas. 1:7-10).

Kapitulli 2: 8 thotë se të liqtë do të shkatërrohen me shkëlqimin e ardhjes së Tij. Toka nuk do të shpëtohet e tëra. Ka një tjetër ndeshje në kundërshtinë e madhe midis së mirës dhe së keqes, të cilën ne duhet ta marrim në konsideratë. Le të kujtojmë Zbulesën 20:1-3: “Dhe unë pashë një tjetër Engjëll të bjerë prej qiellit, duke pasur në zotërim çelësin e një humnere të pacak dhe një zinxhir të madh në dorë. Ai mban të lidhur dragoin, atë gjarpër të moçëm që është Djalli e Satanai, për t’i vënë fre për njëmijë vjet, për ta flakur në humnerën e pacak, për ta kyçur e për ta vulosur, që ai të mos i mashtrojë më kombet deri sa të mbushen 1000 vjet; vetëm pas kësaj kohe ai do të mund të çlirohet veç për pak”. Ky është një vizion simbolik. Humnera e pacak nuk është një vrimë në tokë, pa ndonjë fund. Nuk është as ndonjë shpellë e nëndheshme, ose një hapësirë e hapur diku gjetkë në Univers. Kyçja e dragoit në humnerë ishte thjesht një mënyrë simbolike për të treguar se aktivitetet e Satanait do t’u vihet barrierë.

Vargu 5; ngjarjet e mëdha që do të ndodhin me ardhjen e Jezu Krishtit e që shënjojnë fillimin e mijëra viteve të Zbulesës 20.

1 . Ardhja e Jezusit.

2 . Të vdekurit e drejtë do të ngrihen.

3 . Të jetuarit e drejtë së bashku me të drejtët e ringjallur shkojnë në shtëpi bashkë me Krishtin.

4 . Toka do të shkretohet dhe ç'popullohet.

5 . Satanai dhe engjëjt e tij do të burgosen në botën e shkretuar; aty aktiviteti i tyre do të shkatërrohet.

Nuk ka asnjë shans të dytë shpëtimi përgjatë 1000 viteve. Studimi ynë zhvillon gjërësisht faktin se idea e njerëzve që kanë një mundësi të dytë përgjatë mijëvjeçarit për të gjetur Krishtin dhe shpëtimin, nuk ka kurrëfarë baze në fjalën e Zotit. Zoti ka dhënë me mijëra mundësi në rrjedhën e kohës, por përpara se Jezusi të mbërrijë për herë të dytë, do të vazhdojë dekreti i mëposhtëm : “Ai që është i pa drejtë, mësoni të mbetet i pa drejtë; dhe ai që është i pasur, mësoni të mbetet i pasur. Ai që është i drejtë, mësoni të jetë i drejtë; e kush është i shenjtë, mësoni të mbetet i shenjtë”. (Zbulesa 22: 11)

Nën dritën e së vërtetës, ka shumë që besojnë fortësisht, se një erë e begatisë, zhvillimit, paqes dhe mundësisë do të mbizotërojë në tokë, gjatë periudhës njëmijë vjeçare, e se miliona do të përgatiten, gjatë kësaj ere për përjetësinë. Nuk ka asnjë bazë për këtë besim në Shkrimet e Shenjta.

Si do të mbyllet periudha njëmijëvjeçare?

Le të shohim shkurtimisht kalendarin e ngjarjeve që qarkojnë fundin e periudhës njëmijë vjeçare, ashtu siç tregohet te Zbulesa, kapitulli XX. Ne mund të kalonim shumë kohë mbi këto ngjarje, pasi ato kanë një domethënie shumë largpamëse, por lipset që tq ndalemi domosdoshmërisht shumë shkurt.

Jezusi tha se të gjithë njerëzit do të jetojnë përsëri. Por ata do të vijnë nëpërmjet varrit nëpërmjet dy ringjalljeve të ndryshme. Gjoni 5:28-29 thotë : “Mos u habitni nga kjo gjë, se do të vijë një kohë, kur të gjithë ata që janë në varret e tyre, do të dëgjojnë zërin e Tij; Këta që kanë

bërë të mira, do të jetojnë, kurse ata që kanë bërë të këqija do të ndëshkohen”.Të gjithë do të ngrihen nga varri, por jo të gjithë do të ringjallen në jetë. Ringjallja e jetës është Ringjallja e parë e do të ndodhë kur të vijë Jezusi.

Po kur do të ndodhë ringjallja e mallkimit ose gjykimit? “Po një pjesë e të vdekurve nuk do të jetojnë përsëri kur të përfundojë periudha njëmijë vjeçare”. (Zbulesa 20:5). Ringjallja e parë është për ata që e kanë pranuar Krishtin dhe i janë përgjigjur dashurisë së Tij. Ringjallja e dytë mund të jetë vetëm për të pashenjtët. Teksti ynë e dëfton qartë se ekzistojnë njëmijë vjet midis këtyre dy ringjalljeve. Kur legjionet e te humburve do të ngrihen e do të dalin prej varreve, në fund të mijëvjeçarit, ngjarja tjetër do të ndodhë në mënyrë automatike: “ kur të kenë mbaruar njëmijë vitet, Satanai do të çlirohet nga burgu e do të shkojë të mashtrojë kombet, që gjenden në katër zonat e tokës, Gog dhe Magog (vetëm këta do të jenë miqtë e ringjalljes së të liqve) për t’i mbledhur së bashku në betejë; numri i tyre do të jetë sa rëra e detit”. (Zbulesa 20:7,8). Gjoni thotë se do të organizohen e udhëhiqen nga vetë Satanai në betejë, në betejën e Gogëve dhe Magogëve. Kjo do të jetë beteja finale dhe më shkatërrimtare e tokës. Po kundra kujt ata luftojnë? Cili është objekti i sulmit?

“E ata do të përshkojnë gjithë tokën, e do të qarkojnë Fushën e të Shenjtëve dhe qytetin e përzgjedhur”. (Zbulesa: 20:9). Fusha e të Shenjtëve sot gjendet në tokë. Por ne e kemi zbuluar më parë se të Shenjtët “do të jetojnë e mbretërojnë” me Krishtin përgjatë periudhës njëmijëvjeçare. Ky varg flet për qytetin e përgjakur, Jeruzalemin e Ri, dhe për Shenjtët e Zotit që janë në tokë. E shihni, pra, miq! Është e pamundur , qoftë edhe për një profet, që t’i përshkruajë, në të njëjtën kohë, të gjitha veprimet. Ngjarjet ndodhin njëherësh dhe shpejtësisht në fund të periudhës së mijëvjeçarit. Por Gjoni na e jep edhe shpjegimin e kësaj situate : “Dhe unë, Gjoni, e pashë qytetin e Shenjtë, Jeruzalemin e Ri, të vijë prej Qiellit nga Zoti,

të përgatitur si një nuse e stolisur për dhëndërrin e saj”. (Zbulesa 21:2)

Zoti paskësaj do të mbarojë punë me mëkatin dhe me të gjitha problemet e fatkeqësitë e tokës. E do të ketë paqe e qetësi, dashuri dhe hare përgjithmonë. Ç’ perspektivë e mrekullueshme!

21 . Muzeu i Ateizmit dhe katër kuajt e Zbulesës

Katër kuajt e Zbulesës

Në Muzeun e Historisë së Fesë dhe Ateizmit në Shën Petërsburg, Rusi, qytetarëve rusë u tregoheshin piktura dhe vegla torture, vdekjeje dhe mostolerance. Për vite të tëra, ky dhe institucione të ngjashme me të, kudo në vend, qenë ndërtuar me idenë e poshtërimit veçanërisht të krishterimit, dhe lartësimit të filozofisë dhe praktikave të komunizmit.

Që kur ra komunizmi, këto vende u shkatërruan ose u minimizuan. Ndërsa është e vërtetë se shumë nga karikaturat dhe veprat e artit që shfaqeshin aty qene dinjeshuar pikërisht për këtë qëllim, po kaq e vërtetë është se shumë nga objektete instrumentet e torturave dhe pikturat e shumta vinin nga kohët e persekutimit dhe inkuizicionit. Fatkeqësisht, në emër të krishterimit, persekutimi kundra kundërshtarëve të kishës dhe të ashtuquajturve heretikë, ka ndodhur në të gjithë Europën dhe në pjesët e saj të botës.

Ideja konvergjuese kundra të krishterëve, në pjesën më të madhe të objekteve të shfaqura në Shën Petërsburg është e mëposhtmjia : “Në se të krishterët kanë arritur të përdorin këto instrumente torture, dhe kanë masakruar miliona njerëz të pafajshëm, atëherë si është e mundur që ky besim të jetë i vërtetë? Krishtërimi duhet të shmanget me çdo kusht dhe duhet zëvendësuar me mësimet e kulluara të komunizmit.

Si mund të përfilllet krishterimi me të tillë barrë? Zoti nuk është kapur kurrë në befasi, e shumë kohë më parë se kjo t'i ndodhte krishtërimin, Ai e zhvelloi rrugën që do të ndiqte kisha e krishterë dhe me ç' dhunë do të ndesheshin njerëzit. Zoti e njihte natyrën e mëkatit; Ai e njihte nevojën e njeriut për të kundërshtuar fuqinë e Satanait; Ai e dinte se njeriu pa dashuri do të bëhej jo tolerant.

Në librin e Zbulesës, në kapitullin 4-ërt dhe 5-të, apostulli Gjon dëshmon për gjyqin më të madh që mund të ndodhë ndonjëherë, për rastin kur të gjithë gratë dhe burrat do të vihen përballë gjykimit hyjnor e do të gjykohen në bazë të dashurisë dhe mençurisë së Zotit. Ky gjyq hyjnor përmendet qindra herë në Shkrimet e Shenjta dhe akoma me më shumë qartësi në dy librat e mëdhenj profetikë të Danielit dhe Zbulesës. “Gjykimi u vendos dhe librat u hapën”. U hap dhe një tjetër libër, që është libri i jetës, e të vdekurit u gjykuan prej atyre gjërave që ishin shkruar në këto libra, në përputhje me veprat e tyre.”

Në këtë skenë të tmerrshme gjykimi, Gjoni pa një libër të vulosur me shtatë vula që askush s'mund ta hapte, përveç Jezu Krishtit, Qingjit të Zotit. Në kapitullin 5:9,10 Gjoni dha një përshkrim madhështor të Shpëtimtarit : “Ti je i vlerhtë ta marrësh librin e t'a heqësh vulën, sepse t'i u kryqëzove për të na falur neve te Zoti, veç prej gjakut tënd, jo prej ndonjë fisi, gjuhe, populli apo kombi; e për të na bërë të gjithëve mbretër e priftërinj të Zotit tonë; ndaj ne do të mbretërojmë në tokë”. Ç' dhuratë madhështore na u dha te Jezu Krishti! Atëherë Gjoni e mbyll kapitullin me fjalët e përdorura nga Handel te “Messia”: “I vlerhtë është Qingji që u kryqëzua për të fituar pushtet, pasuri, forcë, mençuri, nder, bekim dhe lavdi”.

Le ta zemë edhe në vendin tonë, përbri profetit mahnitës Gjon dhe le të shohim se si i shpalosi Qingji i Zotit pergamenet që s' mund t'i hapte askush tjetër. Kjo është përgjigjia e madhe e Zotit ndaj akuzave të komunizmit.

Kali i bardhë, Zbulesa 6:2

Me çvulosjen e vulës së parë, shfaqet një pikturë e bukur e një “kali të bardhë”; kush qendron mbi të ka një hark, atij i është dhënë edhe një kurorë”; me to ai “do të shkojë të pushtojë e të pushtohet”. Kjo vulë e parë, si dhe ato vijueset, janë periudha të historisë së kishës. E duke qenë vula e parë, është mëse e qartë se bëhet fjalë për periudhën e parë të kishës. Viktorinus, në shekullin e tretë para Krishtit, në një komentari mbi këto vargje tha ; “Për këtë arsye kali i bardhë është fjala e predikimit, që Fryma e Shenjë dërgoi në tokë”. Gibon-i në “Historinë e Perëndimit dhe rënies së Perandorisë Romake”, ka thënë: “Përparimi i Krishtërit nuk u cakëzua me Perandorinë Romake. Feja e re, brenda një shekulli, pas vdekjes së Autorit të tij Hyjnor, kishte arritur tashmë të vizitonte çdo pjesë të globit”. Apostulli Pal tha: “Falënderoj Zotin që besimi juaj u ligjërua kudo në mbarë botën”. Në shekullin e parë krishtërimi u shpërhap me shpejtësi nën bekimin e Zotit dhe fuqinë e Shpirtit të Shenjtë. Kjo shtrirje brilante u besua të shpinte mezashin e Krishtit në Kinë, Indi e mandej gjer në ishujt e Japonisë, në Lindje dhe përtej ishujve Britanikë në Perëndim. Ashtu siç tha Gjoni, kisha e Krishtit shkoi “të pushtojë e të pushtohet”.

Kali i kuq, Zbulesa 6:4

Njerëzit shpesh pyesin nëse kali i kuq është komunizmi. Ne mund të përgjigjemi qartësisht jo. Kuajt dhe karakteristikat e tyre lidhen me kishën e Zotit. Dallimi midis dy kuajve të përmendur në përshkrimin e Gjoni, është domethënës. E kuqja është ngjyra e mëkatit dhe e zhbërjes. Këto faje u shfaqën në kishë midis shekujve dy dhe katër, për të mbetur edhe për shumë shekuj. Ambicia botërore, konkurrenca dhe kontradiktat shpërthyen ngado dhe felëshimi ishte rezultati i pashmangshëm. Kisha e filloi udhën e vet me zell dhe

frymëzim, por shkallë-shkallë, korrupsioni dhe xhelozia i zunë vendin së vërtetës.

Kali i zi, Zbulesa 6:5, 6

Korrupsioni që filloi në kishë përgjatë shekullit të dytë e të tretë, pas Krishtit, vazhdoi edhe dy shekuj të tjerë. Kjo periudhë solli gjithashtu në një unifikim të forcave politike me forcat e kishës, për të bërë që kisha të vihej nën kontrollin e shtetit. Ashtu siç ka theksuar një shkrimtar : “Kisha jo vetëm e pushtoi Romën, por edhe Roma e pushtoi kishën”. Pa fuqinë e Shpirtit të Shenjtë për të pushtuar kishën, gjera të tilla materiale si pompoziteti dhe madhështia, u bënë prioritete, ndërsa supersticionet pagane u bënë një pjesë e besimit. Elementët supersticiozë ndërfitën relike nëpër kisha e ndërtesat u mbështetën financiarisht nëpërmjet blerjes së faljes. Këto gjëra s’kanë qenë kurrë pjesë e së vërtetës së Shkrimeve të Shenjta, kështu që themelet e fe-lëshimit u hodhën mbi baza të sigurt. Fe-lëshimi u bë gjithnjë e më fortë me ndihmën e paganëve diell-nderues në pozicionet shtetërore, për të vijuar kështu në një kompromis me të krishterët fe-lëshues.

Ashtu siç e pa Gjoni: “një masë gruri u shit për dy grosh”, çka nënkupton një zi të vërtetë; po njëllon edhe kisha kaloi përmes një periudhe të tmerrshme shpirtërore. Sipas fjalëve të Gibbon-it, “Paganizmi u zhduk, për t’u shfaqur veç në kishë”. Zoti e portretizoi këtë skenë përpara se ajo të ndodhte. Ai pa njerëz që ktheheshin kundër dashurisë dhe Hirësisë së Tij. Le t’i kujtojmë vetes se këto gabime i takojnë historisë së kishës, jo të krishtërit.

Kali i zbehtë, Zbulesa, 6:8

“E unë pashë e kundrova një kalë çehre-zbehtë: emri i atij që i rrinte hipur ishte Vdekje, e veç Hadi e ndiqte pas. Fuqi iu dha atij në të katër anët e tokës, për të vranë me shpatë, me uri, me vdekje, e me bishat e botës”. Dukej sikur Krishti nuk do të depërtonte dot errësirën që mbizotëronte. Miliona u vranë për fjalën Zotit. Për 1200 vjet vazhdoi persekutimi, aq sa një historian e përshkroi këtë periudhë duke thënë: “Më shumë njerëz vdiqën nga mungesa e tolerancës së Romës, se sa nga çdo shkak tjetër”. Persekutimi i çdo lloji u përdor kundra kishës së Zotit. Njerëzit që nuk bënë kompromis me të vërtetën dhe që guxonin të kundërshtonin sistemin kishtar, u persekutuan dhe u vranë. Fatkeqësisht, kjo ndodhi në emër të krishtërimit. Shkak mund të qe pikërisht sistemi kishtar, por jo krishtërimi. Rusët i përdorën këto ngjarje të rënda, si një argument shumë të fortë kundra Zotit dhe të vërtetës së Tij, ashtu siç tregohet nëpër disa muzeume. Emri i Krishtit nuk u glorifikua kurrë gjatë fanatizmit dhe mos-tolerancës së epokës së errët të Mesjetës. Fatmirësisht, Zoti zhvelloi se një ndryshim i madh do të vijë e ajo do të ndodhë në Epokën e vulës së pestë.

Vula e pestë, Zbulesa 6:9,11

Nuk mund të gjendet tabllo më e volitshme për kohën e Reformës, se sa këto vargje. Në errësirën e njerëzve, përgjatë Mesjetës, nisi të ndriçojë dora e Zotit. Një etje për dije dhe edukim i solli njerëzit kah Shkrimeve të Shenjta dhe tashmë ata qenë të përgatitur për të mbajtur qëndrim ndaj “Biblës dhe vetëm ndaj Biblës”. Ndërsa Shkrimet studioheshin dhe lartësoheshin, ndërsa mësimet e tyre pranoheshin e praktikoheshin, njerëzit nisën të përballeshin me të vërtetat e mëdha që trashëgonte Fjala e Shenjtë. Njera nga të vërtetat më të paharrueshme, pothuajse e lënë në braktisje gjatë Mesjetës, ishte ajo e “drejtësisë, falë besimit”. Të krishterët rizbuluan sërisht se nuk mund të fitonin shpëtimin e tyre, përveçse si një dhuratë të Zotit. Dhimbja, shërbesa kishtarë, djegia e qirinjve në shenjë nderimi,

lutjet për të vdekurit, etj, nuk mund të sjellin kurrë shpëtimin. Besimi në atë çka përmbushi Jezusi në kryq, ishte e vetmja mënyrë shpëtimi. Më tej, drejtësia e Krishtit ishte e vetmja drejtësi që mund të kënaqë ligjin e Zotit. Reforma solli një vale shprese dhe sigurie tek të gjithë ata që pranonin Biblën dhe vetëm Biblën. Reformatorët e predikonin qartësisht këtë gjë. Duke komentuar pasazhin: “Unë po shoh nën altar, shpirtrat e atyre që u vranë për Fjalën e Zotit dhe për dëshminë që i bënë asaj”, Albert Barnes, komentatori Presbiteran shkruan :”Ne s’ mund të supozojmë se kjo ka ndodhur vërtet kështu dhe se Gjoni ka parë aktualisht shpirtrat e martirëve nën altarë, pasi e gjithë kjo paraqitje është simbolike. Kjo është një paraqitje e njerëzve që i britnin Zotit për drejtësi dhe triumfin e së vërtetës. Drejtësi për gjithë gjakun e derdhur dhe një kuptim i qartë i karakterit të Zotit dhe së vërtetës së Tij.

Poeti i verbër Xhon Milton e shprehu tërbimin e botës kundra krimeve të kryera kundër njerëzve të Zotit, veçanërisht atyre veprimeve dhe krimeve kundra Waldensesëve të Italisë së Veriut, duke shkruar këtë sonet:

“Shpagoji, o Zot shpirtrat e tu të masakruar,
eshtrat e të cilave u shpërndanë maleve të ftohtë alpinë ;
që së vërtetës së moçme s’i humbën një grimë,
edhe kur idhuj e gurë etërit tanë qenë duke nderuar,
Mos i harro, kujtoji në librin tënd çdo ofshim...!

Vula e gjashtë, Zbulesa 6:12-17

Zoti tani përdor mrekullitë natyrore në zgjimin e botës për fillimin e “kohës së fundit” dhe për ndalimin e ditëve të fundit të historisë së tokës. Fatkeqësi të tilla si tërmeti i Lisbonës, më 1 nëntor 1755; Dita e Zezë, më 19 maj 1780 dhe yjet e rrëzuar më 13 nëntor 1833, u zhvelluan njerëzve fuqinë e krijuesit. Këto ngjarje u parathanë rreth 2000 vjet përpara se të ndodhnin. Ato kanë qartësisht një prelud për

fenomene akoma dhe më tragjike natyrore që do të mbrrijnë në ditët e zemërimit përfundimtar të Zotit dhe kthimit të Krishtit. Ato janë një përgjigje e fuqishme ndaj propagandës anti-kristiane ruse.

Ndërsa ngjarjet e ditëve të fundit do të afrohen, bashkë me ardhjen e Krishtit, kur njerëzit e të gjithë klasave do të bëjnë të gjejnë male e shkëmbinj për të fshehur kokën nga fytyra e Krishtit që patën mohuar e përqeshur, atëherë pyetja që shtrohet do të jetë :”Po kush do të jetë i aftë të qëndrojë?”

Vula e shtatë, Zbulesa 7-8:1

Përgjigja është dhënë në pasazhin që shpjegon se do të jetë një shumësi e madhe, që nuk do të ketë njeri që ta numërojë, e që së bashku me 144. 000 do të qëndrojnë përpara fronit të Zotit. Po, do të jetë një turmë e madhe. Të gjithë e kanë pranuar Jezu Krishtin si shpëtimtarin e tyre personal dhe janë të aftë të qëndrojnë; ata janë gati për Krishtin, sepse ata e kanë pranuar drejtësinë e Tij si veshjen e tyre në vend të të qëndruarit vetëm. Në kapitullin 8:1 gjendet një pikturë e ardhjes së Krishtit, me të gjithë shpurën e Qiellit që e shoqëron, ndërsa Ai shpall dhëndërrin, e bërë tashmë gati: kishën e Zotit. Çfarëdo lloj sfide njeriu mund të bëjë kundra Zotit, ai përsëri duhet t’i përgjigjet sfidës së Zotit për njeriun : “Kush do të jetë i aftë të qëndrojë, kur të vijë Krishti? Miq, nuk ka kurrëfarë arsye që ju ta humbisni mundësinë të jeni në shoqërinë e lavdisë së Zotit! Në se ju e keni pranuar Atë si Zotin dhe shpëtimtarin e jetës suaj atëherë, pse nuk i sfidoni të tjerët të ndjekin vendimin tuaj. Në se jeni të vonuar, kjo mund të jetë mundësia juaj e fundit.

22 . Si ta shtyni funeralin tuaj!

Njerëzit e fisit Hunza kanë jetuar në malet e Himalajas për qindra vjet e sot janë të gjallë, të fortë e të shëndetshëm. Shumë Hunzakë jetojnë për më tepër se 100 vjeç e njohin pak sëmundje. Një tjetër grup njerëzish që jetojnë një jetë të gjatë e të shëndetshme, janë ata që jetojnë në Gjeorgji, dikur nën kontrollin e pushtetit të sovjetëve. Po pse vallë këto dy rraca kanë kaq jetëgjatësi? Ata jetojnë mes një ajri të pastër e uji të kulluar. Kryejnë plot veprimtari lëvizëse, ndërsa punojnë kopshtet e tyre; ata bëjnë gjumë të rregullt; kanë një jetë të parrëmujshme dhe dieta e tyre është e thjeshtë. Hanë shumë pak mish, pasi i ruajnë tufat e veta për ndonjë rast të veçantë, duke u ushqyer më shumë me drithëra, arra, perime dhe fruta të stinës. Tokat e tyre janë të bekuara me një bollëk kajsish të cilat i hanë si fruta, por edhe i thajnë për dimër, në mënyrë që t'u hanë edhe bërthamat. (Jo të gjitha llojet e kajsive prodhojnë bërthama që mund të hahen).

Në vitin 2008, Revista Kombëtare e Gjeografisë pati një artikull mbi jetëgjatësinë, duke krahasuar njerëzit e Okinavës, Sardenjës dhe Adventistët Kalifornianë të Ditës së Shtatë. Këta njerëz jetojnë më shumë se 100 vjet dhe kanë një cilësi jete deri në vdekje. Shëndeti është shumë i rëndësishëm, e ndoshta ne mund të mësojmë diçka nga këto pesë grupe njerëzish, që mund të quhen të bekuar në gjithë ambientin tonë.

Është interesante fakti se Jezusi harxhoi më shumë kohë në shërimin, se sa në predikimin e njerëzve. Gjoni në letrën e tretë shkroi: “Për të gjithë ju, o të dashur, unë lutem që të begatoheni e të jetoni plot shëndet”. (3 Gjoni2). Mendja, trupi dhe natyra shpirtërore janë të ndërlidhura e të ndërrvarura.

Faktorët parësor në shëndetin njerëzor janë spikatur në kapitujt hyrës të Shkrimeve. Ju do të vëreni duke lexuar ato, se temat më të mëdha janë:

Zoti, qielli e toka, shpirti.

Fjala e Zotit.

Drita.
Ajri.
Uji.
Vegjetacioni.
Ngrohtësia e diellit.
Kafshët.
Njeriu, martesë.
Bindja ndaj kërkesave hyjnore.
Punimi i tokës dhe
Pushimi i Sabatit.
Le të bëjmë ca komente për disa prej tyre.

Ajri

Zanafilla 1:6 “Le të bëhet firmanenti”

Ajri në kopështin e Edenit ishte i pandotur dhe kaq i ndryshëm, nga ai ku jetojnë sot shumica e njerëzve. Me zhvillimin urban ndotja u rrit në përmasa të panjohura më parë. Ndaj s’duhet të habiteni se në shumë qytete, policia, fëmijët e shkollave në fushat e lojrave dhe shumë të tjerë përdorin maska për të mbrojtur trupin nga ndotja. Njëra nga mrekullitë e tokës sonë është se si arrin ajri të jetë vazhdimisht i pastruar. Zoti e ka rregulluar këtë gjë nëpërmjet planktoneve të oqeanëve e përmes një morie bimësh të tjera. Ndaj, në çdo mundësi që na jepet ne duhet ta thithim thellë ajrin në mushkëritë tona, pasi truri ynë është aq i varur e ka aq shumë nevojë për ajër të freskët.

Në Londrën e vitit 1952, ajri ishte i rënduar nga smogu, si pasojë e tymrave të mëdha që vinin nga oxhaqet e qymyrgurit. Shumë prej njerëzve vdiqën dhe kjo i detyroi organet përkatëse ta pastronin qytetin. Sot ju mund të udhëtoni kudo nëpër qytet e mund të shihni se shumë nga oxhaqet e shtëpive nuk përdoren më. Kjo e ka ulur në

mënyrë të konsiderueshme smogun dhe ka shpëtuar mijëra jetë njerëzish. Emfizema është njera nga problemet e mushkërive të shkaktuara nga ndotja duke përfshirë edhe pirjen e duhanit, e ne shumicën e rasteve ka për shkak mungesën e furnizimit të mushkrive me ajër të pastër.

Dy ndotësit më të mëdhenj me të cilët bota po sfidohet ende, janë monoksidi i karbonit që vjen prej motorëve të makinave, mauneve, barkave, aeroplanëve e tymit të duhanit. 50 vite më parë, rreth 20 mijë njerëz vdiqën në Shtetet e Bashkuara nga duhani dhe helmimi prej tij. Sot tabela të mëdha elektronike u tregojnë njerëzve se 400 000 vetë vdesin çdo vit nga duhani. Fatmirësisht, në Australi qeveria, shteti dhe federalët janë pozicionuar me një qëndrim të fortë dhe duhani është bërë shumë më pak i rëndësishëm e rrjedhimisht pagesat mjekësore janë paksuar, përderisa shumë njerëz arritën ta lënë duhanin e shumë të tjerë as e kanë nisur atë. Ashtu siç thonë doktorët, ajri që ne thithim është më i rëndësishëm edhe se ushqimi që hamë. Mbajini shtëpitë, lagjet ku jetoni, të ventiluara mirë. Kështu, nëse jetoni në qytet, shkoni në fshat, sa herë që të mundeni, duke shmangur tymin dhe duke ndihmuar autoritetet shëndetësore në parandalimin e rreziqeve që lindin nga duhan-pirja.

Ushqimi i mirë

Gjeneza 1:29: “E zoti tha: Shikoni, unë ju dhashë çdo bimë që jep farë e që mund të gjendet në çdo cep të truallit të tokës e çdo pemë frutat e të cilave hapin farë: me to ju mund të ushqeheni”.

Eksodi 23:25 : “Kështu, ju do t’i shërbeni Zotit tonë, e Ai do t’ ju bekojë bukën dhe ujin. E unë do të largoj çdo sëmundje në mes jush”.

Shumë njerëz, kur blejnë një markë të re makine i hedhin një sy të hollësishëm udhëzimeve. Çfarë lloj vaji duhet përdorur, çfarë lloj nafte dhe me sa shumë presion duhet të fryhen gomat?

Zoti ka dhënë gjithashtu edhe një manual veprimi për të gjithë njerëzit: Shkrimet e Shenjta. Nëse injorojmë këto shkrime mund të vuajmë e të kanosemi nga sëmundjet për shkak të padijes sonë.

Efesianëve 4:21-23: “Nëse vërtet e keni dëgjuar Atë, dhe jeni mësuar prej Tij se e vërteta gjendet te Jezusi, atëherë lëroni mënjane sjelljet e mëparëshme, lëroni atë njeri të vjetër që u rrit i korruptuar në përputhje me normat e epshit mashtronjës, por që tani ka rilindur në hpiritin e mendjes suaj”. Ç’ këshillë kumbues! Lëroni mënjane mënyrën e shkuar të të jetuarit dhe nisni një të re! Dija e Krishtit do të sjellë në jetët tona frytet e Shpirtit të Shenjtë. Galateasve 5:22-23: “Mirëpo, fruti i shpirtit është dashuria, gëzimi, paqja, mirësia, hijeshia, besnikëria, mirësjellja dhe vetëkontrolli. Kundra tij s’ekziton asnjë ligj”. Tani le të marrim në konsideratë disa këshilla nga Shkrimet që lidhen me trupin dhe shëndetin tonë.

Çfarë fusim në buzë mund të jetë shkaku kryesor i jetës dhe vdekjes. Ashtu siç përmendëm në fillim të këtij kapitulli, dieta origjinale që duhet t’i jepet njeriut, ka provuar të jetë më e mira modeluar sipas stilit të ushqimit të njerëzve të Hunzës, Gjeorgjisë, Okinavas, Sardenjës dhe Adventistëve të ditës së shtatë të Kalifornisë. Frutat, drithërat, arrat dhe perimet janë të përmendura edhe te Zanafilla 1:29. Ato ofrojnë përbërësit e mjaftueshëm të ushqimit dhe shmangin sëmundjet e kafshëve dhe hormonet që janë aq të përdorshme në ditët tona. Nuk njohim ndonjë sëmundje të bimëve që të ketë ndikuar aq shumë mbi njerëzimin, në një kohë që kemi një numër të madh dëshmish të sëmundjes së lopës së çmendur dhe të gripit të shpendëve; 40 milionë vdiqën vetëm më 1918-ën e mjaft prej tyre vetëm në Spanjë. Këtyre sëmundjeve ne mund t’i shtojmë helmimin nga mercuri (zhiva) dhe ndotësve të tjerë të lumenjve, që kanë ngordhur e infektuar aq shumë peshq.

Psalmi 84:11: “Se Zoti është diell dhe mburojë. Zoti do t’ju japë hirësi dhe lavdi. Se asnjë gjë të mirë s’i ka hequr Ai atyre njerëzve që ecin ndershmërisht”.

Çfarë i ndalohet një të krishteri?

Ligji i Përtërirë 14 : 6, 7 : “Ju mund të hani çdo kafshë me thundra të ndara, d.m.th. që i kanë thundrat të çara në dy pjesë, e që e përtypin ushqimin. Megjithatë, prej atyre kafshëve që e përtypin ushqimin ose kanë thundrat e ndara, ju nuk duhet të hani kafshë të tilla si devetë dhe lepujt; sepse pavarësisht se e bluajnë ushqimin, ato nuk i kanë thundrat e ndara, ndaj janë të papastëra për ju”. Kësisoj, specifikimi Biblik është se ushqimi i kafshëve duhet të ketë thundra të ndara dhe të përtypë ushqimin. Gjedhët, delet, dreri dhe cjepët janë disa nga kafshët që i përshtaten këtij specifikimi. Derri, lepujt, devetë dhe brejtësit jo.

Peshqit dhe krijesat e ujit duhet të kenë fletë dhe luspa.

Vargu 9: “Këto ju duhet të hani mes gjithë atyre që gjenden në ujë: Ju duhet të hani gjithçka që ka fletë e luspa. Peshkaqenët, fokat, balenat e peshqit me guaskë nuk i përshtaten këtij specifikimi, ndërkohë që një numër i madh peshqish, si merluci, trofta, sardelet po.

Zanafilla 9:4: “Veçse ju s’duhet të hani mish të gjallë, d.m.th. me gjak”. Gjaku nuk është i shëndetshëm, sepse ai është plot papastërti, helme e toksina. Hebrenjtë dhe Islamikët janë shumë specifike në ngrënien e mishit të vrarë në mënyrë të posaçme dhe që referohet si ushqim Kosher dhe Hallall. Është gjithashtu interesant të vërehet se disa nga njerëzit më të mëdhenj të historisë i janë referuar ngrënies së ushqimeve prej mishi. Vëreni disa prej tyre:

Shakespeare “Unë jam i dashuruar pas mishit, sa që ngadonjëherë mendoj se është kjo ajo gjë që më bën t’i bluj mendimet kaq të topitur.” (Falstaff).

Uesley: “Falë Zotit, që kur lashë ngrënien e mishit të kafshëve, u thashë lamtumirë të gjitha sëmundjeve që kish trashëguar mishi im”.

Çarls Darvin : “Punëtorët më të jashtëzakonshëm që unë kam parë ndonjëherë, kanë qenë punëtorët e minierave të Kilit. Ata jetonin përjashtimisht vetëm me ushqime vegjetale”.

Disa njerëz mund të thonë se shumë nga pasazhet e Shkrimit të Shenjtë që i referohen mishit të papastër, zogjve dhe peshqve qenë hebreje dhe ato përfunduan me vdekjen e Krishtit në kryq. Mirëpo vdekja e Tij nuk ka asnjë ndikim në shfuqizimin e ligjeve të shëndetit të shkruara nga Moisiu. Edhe në kohën e Noes e të përmbytjes së madhe, në arkë shkuan kafshët e pastra dhe të papastra. 7 çifte kafshësh të pastra dhe dy të papastra. Të parat qenë për ushqim dhe flijime. Vëreni pak

1. Ka shumë pak vegjetacion në dietën normale të njeriut pas përmbytjes.
2. Jeta e njeriut u shkurtua. Ajo u zvogëlua në mënyrë të menjëhershme, pas përmbytjes, falë mëshirës së Zotit. Mos kjo ndodhi për shkak të ngrënies së mishit nga ana e tij? Janë të shumtë ata që e besojnë këtë gjë!
- 3 . Vetëm mishi i pastër ishte i lejuar për ushqim, shumë më përpara ekzistencës së racës Hebreje.

A duhet të pijë alkool një i krishterë?

1 Korintasve 10:31 : “Ndaj, nëse hani apo pini, apo bëni diçka tjetër, bëjini lavdi Zotit”. Ngrënia dhe pirja janë të rëndësishme për Zotin, sepse ato janë çështje domethënëse për stilin tuaj të jetesës. Bibla është e qartë që vera e fermentuar nuk duhet të pihet. Edhe vetë mbreti Solomon, i cili shquhej për mjaft vese, i paralajmëroi njerëzit kundra saj.

“Vera është një shpotitës, pija e fortë një shamatare, e çdo e shkuar në rrugë të shtrembër prej tyre, nuk është e mençur” (Fjalët e Urta 20:1).

“Mos e shihni verën, kur ajo është e kuqe. Kur shkëlqen në gotë, kur rrokulliset ëmbëlsisht në të. Në fund ajo kafshon si gjarpër e të përpëlit si një nepërkë. Gjëra të çuditshme do të shohin sytë e tu, e zemra juaj do të pëshpërisë gjëra perverse. Po, ti do të ndihesh si dikush që shkrihet në mes të detit, ose si dikush që rri në majë të një direku duke thënë; “Ata më goditën, por nuk më lënduan; Ata më shtypën, por unë s’i ndjeva. Kur do të zgjohem, që të mund të kërkoj një gotë tjetër? (Fjalët e Urta , 23: 31-35).

Këshilla të mençura për të gjithë, në këto ditë, kur kaq shumë vdekje shkaktohen nga alkoli. Edhe pse abuzimi i fëmijëve, prindërve dhe grave janë shumë të shpeshta për t’iu atribuuar vetëm verës.

Ka shtatë arsye të forta biblike për të mos pirë duhan:

- 1 . “Ai përmban helme vdekje prurëse. Ligji i Përtërirë 29.17-19. “Ai është një bar vdekjeplotë”.
- 2 . Nikotina i skllavëroi Romakët, 6:16.
- 3 . Duhani dëmton dhe sfilat trupin. 1 Korinthsave, 3:16-17.
- 4 . Duhani shpërdoron para.Isaia 55:2, 1 Korinthsave 4:2.
- 5 . Ne duhet të abstenojmë nga epshi i mishit. 1 Pjetri, 2:11.
6. Mos i prekni gjerat e papastra - ky është një zakon i pashëndetshëm. 2 Korinthsave, 6:17.
7. Ai shkurton jetën. Eksodi 20:13. “Ju s’duhet të vdisni”.

Disa rregulla të thjeshta dhe të përgjithshme mbi shëndetin

- 1 . Hajeni ushqimin në intervale të rregullta. Predikuesit. 10:17
- 2 . Mos u mbingarkoni në ushqim - Fjalët e Urta 23: 2 - Madje edhe Krishti paralajmëroi kundër ngopjes. Luka 21:34.

- 3 . Mos strehoni inatin dhe zilinë - Fjalët e Urta 14:30 - “Zilia sjell kalbëzimin e kockave”.
 - 4 . Mbani një qëndrim të lumtur e të gëzueshëm. Fjalët e Urta 17:22. “Një zemër e hareshme bën mirë njëlloj si një ilaç”.
 - 5 . Kini besim të plotë te Zoti. Fjalët e Urta 19:23. “Frika e Zotit priret kah jeta”.
 - 6 . Barazpeshojini ushtrimet me pushimin dhe gjumin. Eksodi 20:9-10. Vetëm 6 ditë do punoni, por e shtata është Sabati i Zotit tonë.
 - 7 . Mbajini trupat të pastër e të shëndetshëm.
 - 8 . Jini të duruar në të gjitha gjërat. 1 Korintasve 9:25. (Në se hani mish, jini të sigurtë se ai “ është mish i pastër” dhe i vrarë në mënyrë të rregullt).
 - 9 . Shmangiuni stimuluesve të dëmshëm të tillë si kafja dhe çaji.
 10. Bëjeni vaftin një kohë të lumtur. Predikuesit 3:13. “Gëzojeni shpërblimin e punës suaj”.
- Shëndeti është njera nga fushat ku ne shpesh korrim atë ç’ka mbjellim (Galatasve 6:7).
- Me Zotin të gjitha gjërat janë të mundshme (Marku 10:27). Ashtu siç përmendëm edhe më parë “Qofshi të shëndetshëm ndërsa begatoheni në shpirt” (3 Gjonit 2).

23. Njeriu i lindur katër herë

Një grup botanistësh kishin gjithë ditën që po kërkonin një lule të rrallë. Por më në fund britma e shumëpritur erdhi, “ja, ku është”. E përkundur në tokën e butë, në një buzë të ngushtë, poshtë një shkëmbi të mprehtë, gjendej lulja e çmuar. Ishte më se e dukshme, por e vështirë për t’u kapur. Një djalë i vogël po qëndronte ulur duke kundruar njerëzit, teksa diskutonin njëri pas tjetrit planet e

mundshme se si mund ta arrinin atë bimë. Më në fund, dikush pa nga ai djalë dhe tha: “Vogëlush, nëse të lidhim pas belit me litar dhe të ulim poshtë deri tek bima, do ta marrësh atë për ne”? “Veç një moment”,- tha djali i vogël dhe u zhduk në pyllin aty pranë. “Zotëri”! - tha ai. “ Ky është im atë! Tani ju mund të më ulni poshtë gjer te lulja, se unë s’ kam frikë, në se dora e tij është te litari”.

Siguria ishte ajo çka kërkonte parësisht djali i vogël. Sot në botë ne njohim: “sigurinë sociale”, “sigurinë financiare” dhe nevojat e saj, “sigurinë në punë”, dhe ndoshta më të kërkuarën e gjithçkaje, “sigurinë në dashuri”. Por unë mund t’ju propozoj sigurinë më të madhe që njeriu ka pasur ndonjëherë, e që gjendet tek siguria e vërtetë e të qenit te Krishti: a të qenit i krishterë i lindur përsëri. Nga kjo nuk nënkuptohet fakti i lidhjes me kishën, e cila në vetvete është pjesë e të qenit i krishterë. Por të qenit i krishterë në thellësitë e një qenie, është e rëndësishme për atë lloj sigurie që bota sot po kërkon e gjurmon me ngulm.

Problemet që shumë njerëz përballin, vijnë si pasojë e faktit se njeriu ka harruar nevojën për të zhvilluar 4 disiplinat që ai të bëhet një pasues i vërtetë i Krishtit. Këto katër fusha janë fizike, mendore, sociale dhe shpirtërore. 3 të parat përgjithësisht ngjallin mjaft vëmendje, kurse e katërta mendohet shumë rrallë. 3 fushat e para fizike, mendore dhe sociale mbulohen përgjithsisht nga lindja. Një person normal është një qenie fizike, mendore dhe sociale. Po ka disa probleme të lindura me këtë lindje. Davidi, këngëtari i ëmbël i Izraelit tha: “Shikoni, unë iu solla me ligësi në këtë jetë dhe nëna ime më ngjizi në mëkat (Psalmi 51:5)”. Këtu gjendet problemi, ne të gjithë jemi të lindur në mëkat dhe fatkeqësisht nuk mund të bëjmë asgjë për të. Adami mëkatoi dhe i trashëgoi botës prirjen e natyrshme ndaj së keqes. Ashtu siç shkroi Jeremia në kapitullin (7:19): “Zemra është gënjeshtare për të gjitha gjërat dhe dëshpërimisht e ligë: kush mund ta njohë atë? Pali e përmbloodhi këtë problem në këto fjalë: “Se unë e di që brenda meje (d.m.th. në mishin tim) nuk banojnë gjëra të mira;

e se vullneti është i pranishëm tek unë; po rrugën se si mund ta dëftoj atë që është e mirë s'po e gjej dot" (Romakët 7:19).

Lindja e parë na ka dhënë vërtetësisht jetë, por kjo jetë është një jetë mëkatore. "Të gjithë njerëzit kanë mëkatuar dhe kjo i ka larguar nga lavdia e Zotit". Të gjithë njerëzit vazhdojnë të mëkatojnë dhe janë të pandihmueshëm në këtë gjendje, deri sa të ndodhë diçka tjetër. Në këtë gjendje natyrale njeriu mbështetet tek karakteristikat fizike, mendore dhe sociale për t'i zgjidhur këto probleme. Edhe vetë Karl Marksi ra në këtë gabim. Idealet e tij janë të mëdha dhe në teori duken të jenë përgjigje për sëmundjet njerëzore. Gjithsesi, ai dhe të tjerët nuk morën parasysh një gjë, natyrën mëkatore të njeriut.

Zoti nuk e zgjidh situatën ashtu siç e zgjidh njeriu. Zoti e pa njeriun si "të sjellë në jetë me ligësi dhe me një zemër që është dëshpërimisht e ligë". Ai, kështu dëshiron të sjellë një ndryshim te njeriu. Zoti morri një grusht rërë dhe e vendosi atë në zemër te tokës. Nxehësia nga poshtë dhe trysnia nga sipër e shndërruan rërën në një opal (gur i çmuar). Zoti e morri argjilën dhe me të njëjtën lloj nxehësie dhe trysnie prodhoi një ametist. Duke marrë karbonin ai prodhoi po në të njëjtën mënyrë diamantin.

Zoti morri një jetë, që me vullnetin e këtij njeriu dhe me dashurinë e Tij, e bëri të krishterë. Kjo është Lindja e Re.

Te Gjoni 3:5, Jezusi i tha Nikodemit se kush ishte sundimtari i Hebrenjve, një mësues dhe një anëtar i Sanhedrin-it (trupi më i lartë qeverisës i Hebrenjve): "Në mënyrën më absurde, unë e po ju them se deri kur dikush lind nga uji dhe Shpirti, ai s'mund të hyjë në mbretërinë e Zotit". Kjo është arsyeja pse njeriu ka gabuar. Ai nuk e konsideroi pafuqinë e pandihmueshmërimin e tij. Është lindja e re e kryer nga Fryma e Zotit ajo që i solli njeriut ekuilibrin e jetës dhe pastaj të jetës së përtejme. Lindja e kryer nga Fryma eshenjtë e lejon njeriun të bëhet biri i Zotit. E sado shumë që ta marrin këtë Shpirt, Ai do t'ua japë të gjithëve të drejtën e të bërit bir i Zotit" (Gjoni 1:12). Ky është bonusi i madh i të qenit i lindur prej Shpirtit të Zotit.

Solomoni e njihje këtë gjë, kur shkroi: “Njiheni atë në të gjitha mënyrat dhe Ai do t’ua udhëheqë rrugët”.

Njeriu e njeh Zotin falë pendesës së mëkateve të tij dhe rrëfimit të tyre te Zoti. Ai u bë i thjeshtë dhe tërësisht i ndryshëm përmes fuqisë së vullnetit të Shpirtit të Zotit. Të jesh i lindur prej Shpirtit të Shenjtë është lindje e dytë. Njeriu nuk mund ta ndryshojë veten, po është Shpirti ai që sjell ndryshime.

Lindja e tretë, nga të katë lindjet, përmendet tek Gjoni 3:5: “Përveçse një njeriu të lindur prej ujit, ky është pagëzimi dhe simboli i jashtëm i ndryshimit që Fryma e Zotit i ka sjellë njeriut. Krishti ishte shembulli ynë dhe Ai u pagëzua. Pjetri e tha qartësisht këtë gjë te “Dita e pesëdhjetë”: “Pendohuni dhe pagëzohuni secili prej jush në emër të Jezus Krishtit”. Pali e zhvelloi kështu konvertimin e Tij, “ u ngrit, u pagëzua dhe lau të gjitha mëkatet tuaja, duke thirrur emrin e Zotit”. Ky ishte zëri i Zotit që i fliste Atij. Fryma e Zotit na bind e paskësaj ne pagëzohemi si një shprehje publike e besimit që kemi në udhëheqjen e Krishtit ndaj jetëve tona. Jezusi tha: “Ai që beson dhe është i pagëzuar do të shpëtohet” .Përsëri kjo përvojë do të na udhëheqë në sigurinë e njohjes dhe ndjekjes së faktit, se ne kemi përmbushur vullnetin e Krishtit.

Le të vërejmë disa fakte të rëndësishme rreth pagëzimit.

Urdhërimi i pagëzimit është një nga shtyllat themelore të krishterimit, në të cilën Krishti nënshkroi emrin e Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Te Mateu 28:19-20, Krishti i urdhëron dishepujt “të shkonin e t’i mësonin të gjitha kombet, t’i pagëzonin ata në emër të Atit , Birit dhe Shpirtit të Shenjtë, e t’i dëftonin se si të kujdeseshin për gjithçka që Ai i kishte urdhëruar”. Gjendet në këtë varg një urdhër i qartë i dhënë nga Krishti, që njerëzit duhen të mësohen e pastaj të pagëzohen e të vazhdojnë të mësohen. Marku 16:16 thotë: “Ai që beson dhe është i pagëzuar, do të shpëtohet”. Po, përpara se një person të pagëzohet, duhet të besojë në Krisht. Krishti dëftoi rëndësinë e kësaj përvoje, duke u pagëzuar vetë prej Gjoni, si një shembull për të gjithë ata që duan ta ndjekin (Mateu 3:15). Ai u

pagëzua për të përmbushur gjithçka që “është e drejtë”. Pagëzimi, kështu, përfshihet tek drejtësia ose tek veprimet e drejta.

Fjala pagëzim (baptim) vjen nga baptizo=vaftizo=kridhem. Ajo përdoret 60 herë në Dhjatën e Re, si pagëzim nëpërmjet kredhjes (Mateu 3:16; Marku, 1:10; Luka, 3:21, Gjoni, 1:31-34).

Pagëzimi i Jezusit përmendet në të katër Ungjiljet. Baptizo vjen nga fjala bapto, vafto, çka do të thotë; “të zhytesh në ose nën” (Gjoni 13:26; Zbulesa 19:13). Këto dy tekste japin shembuj se si bapto përdoret për zhytjen.

Pagëzimi i Gjoni, fillon jetën e re të personit të konvertuar, duke i siguruar të pagëzuarit, faljen dhe pastrimin prej mëkateve.

Pse u pagëzua Jezusi?

Mateu 3:14 -15 thotë: “Unë kam nevojë të pagëzohem nga Ju e Ju po vinitëk në?”, - i tha Gjoni Jezusit. “Lejojeni, të jetë kështu, se kjo është e volitshme në përmbushjen e gjithë drejtësisë”. Atëherë “ai e lejoi Atë”. Jezusi u pagëzua për të kryer veprimin e drejtë.

Pagëzimi foshnjor

Rasti i parë i pagëzimit foshnjor, kujtohet të jetë në vitin 379 p.K. kur Perandori Valens mësoi se i biri i Galetes ishte në pragun e vdekjes. Babai u betua se i biri nuk do ta humbiste Qiellin për shkak të mospagëzimit, kështu që ai shtërngoi pa dëshirën e vet një peshkop për administrimin e kësaj të drejte. Pas këtij rasti kanë ndodhur edhe raste të tjera të veçuara. Bibla tregon te Luka 2:22-24, se fëmijët mund t’i përkushtohen Zotit. Shumica e Kishave praktikojnë vetëm pagëzimin e madhorëve. Edhe kisha Adventiste ndjek këtë praktikë, sepse kjo është një praktikë e Biblës.

Në zbatim shpirtëror të bërë nga Pali, figura e përdorur nga apostulli bëhet e qartë vetëm nëse kuptohet si pagëzim nëpërmjet kredhjes. Në diskutimin e rëndësisë së pagëzimit Pali vëren se:

- 1 . Ashtu siç Krishti vdiq për mëkatin, po ashtu duhet të vdesë për mëkatin i krishteri.
- 2 . Derisa, Krishti vdiq dhe u varros, kështu dhe i krishteri është simbolikisht i “varrosur” me Të në varrin ujqor të pagëzimit.
- 3 Ashtu siç Krishti u ngrit prej varrit, kështu dhe i krishteri do të ngrihet në rinisjen e jetës, shpirtërisht (Romakëve, 6:3-5; Kol. 2:12).

Natyrisht që figura e varrimit dhe e ringjalljes është e pakuptimtë, nëse nuk nënkupton kredhjen totale. Është e vlefshme të thuhet se prania e pagëzimoreve në kishat antike tregon se prej shekujsh kisha e krishterë ka praktikuar pagëzimin nëpërmjet kredhjes. Disa mendojnë se është i nevojshëm vetëm pagëzimi i Shpirtit; Gjithësesi, Gjoni: 3:3 zhvillon se shpirti vjen në pagëzim. Pagëzimi prej ujit dhe Shpirtit janë thelbësore.

Pagëzimi është gjithashtu një memorial i varrosjes dhe i ringjalljes së Krishtit. Disa thonë se e Diela është një memorial i ringjalljes. Por ajo është memoriali i Zotit, jo një ditë, por një përvojë. Galateasve 2:20, thotë: “Të kryqëzohemi me Të”, Romakët 6:4: “Të varrosemi me Të” dhe Kol. 2:12: “Të ringjallemi me Të”. Sa e rëndësishme është për një besimtar të vërtetë të jetë i pagëzuar.

Sepse, në se jemi të pagëzuar, ne bëhemi anëtarë të kishës së Zotit. Kjo është vërtet një gjë e çmuar për të gjithë. 1 Korinthsve 12: -13-27, thotë “Pagëzohuni në një trup”. Trupi është kisha dhe në sajë të pagëzimit në përmbushim urdhërimit të madh të Zotit : ruajtjen e kishës.

Njeriu i lindur katër herë është një i krishterë. Herën e parë ai lindi prej nënës së vet. Lindja e dytë është prej Shpirtit të Shenjtë që udhëheq jetën e tij të përditshme, duke e udhëhequr gjithashtu atë person në ujërat e pagëzimit për lindjen e tij të tretë. Lindja e katërt

është përshkruar mrekullisht nga Pjetri: “I lindur përsëri, jo prej farës së korruptuar, por i pakorruptueshëm përmes fjalës së Zotit që rron e jeton për jetë, sepse mishi është si bari, kurse lavdia e njeriut si lulet në bar. Bari vyshket dhe lulet kalben, vetëm fjala e Zotit qëndron përjetë. Kjo është fjala që prej Ungjillit predikohet për ju” (1 Pjetri 1:23-25). Lindja e katërt është ajo që vjen si pasojë e studimit të Shkrimeve të Shenjta.

Ndërsa ne i studiojmë ato, Fryma e Shenjë i sjell lindjen jetëve tona në çdo fushë, ku nevojitet vëmendja. Nëse i bindemi udhëheqjes së Zotit, ashtu siç tregohet në Fjalën e Tij, atëherë ne kemi ndjekur pas të Vërtetën e Zotit. Jezusi tha se ne u pastruam përmes fjalëve që Ai tha. Davidi te Psalmet thotë: “Fjala e Shenjtë është llamba e këmbëve të mia dhe drita e udhës sime” (Psalmi 119.105). Fjala e Zotit na jep sigurinë e vërtetë, sepse në të gjendet dija e udhës së Zotit. Nëse është e vërteta e Zotit ajo që udhëheq kah jetës së përjetëshme, një i krishterë duhet të përpiqet ta studiojë Fjalën e Zotit sa më shumë që të jetë e mundur, në mënyrë që ai të mund ta njohë vullnetin e Zotit për jetën e tij. Një i krishterë lindet katër herë, i lindur nga nëna, Fryma e Shenjtë, uji dhe Fjala e Zotit.

Miq, pse s’e ndiqni vallë fjalën e Zotit dhe të rilindni përsëri?

24 . Pse kaq shumë besime - Zbulesa 12

Gruaja, hëna dhe përbindëshi

(Përgjigja, pse ka kaq shumë besime në botë?)

Studimi ynë në këtë kapitull merret me librin e Zbulesës. Ndërsa studioja këtë libër më pëlqente të shihja, se si ai arrinte të ngrihej në lartësinë e emrit të Tij: Zbulesa e Jezu Krishtit. Bukuria e Krishtit dhe hijeshitë, fuqia dhe pushteti i Tij, janë zhvelluar përgjatë gjithë librit. Në këtë kapitull të parë ne shohim Krishtin në Shenjtërore, shiko

vargun 13:22. Përgjatë gjithë librit, Ai shihet duke punuar për Kishën e Tij. Shumë pjesë të Zbulesës zhvellojnë sulmet e bëra ndaj Kishës nga të tjerët, por çuditërisht mjaftueshëm edhe nga vetë brenda saj. Zbulesa përfundon me një pikturë grafike të ardhjes së Tij të dytë dhe restaurimin në tokë të bukurisë dhe shenjtërisë Edenike.

Vëmendja jonë është te Zbulesa 12, e cila lidhet me sulmin mbi kishën e Zotit, nga jashtë dhe brenda saj. Sot ne kemi një numër të jashtëzakonshëm kultesh e sektesh, ku secili shpall të jetë kisha e vërtetë e Zotit. Përmes gjithë morisë së madhe të kishave, Krishti kishte një Kishë të vërtetë. Ndaj, besimi i Krishtit, arriti të qendrojë e të vijojë përgjatë epokave.

Juda 3:4 “... është e nevojshme të shkruaj për ju, e t’ ju dëftojë se seriozisht po përballeni me besimin që njëherë e një kohë iu shpërnda shenjtëve, sepse ka njerëz që zvarriten në papërgjegjshmëri, nga ata që ishin më parë të prirur kah këtij urdhërimi, njerëz pa besim, që e kanë shndërruar hirësinë e Zotit në fëlliqësi epsharake për të mohuar kështu vetëm Zotin tonë e Jezu Krishtin”. Sfida e kishës sot, ashtu si gjithmonë, është të përballët për besimin e kohërave të moçme, të dhënë ndaj ndjekësve të Zotit. Kisha sot nuk ka detyrim tjetër, përveçse të jetojë me mësimet zanafillore të shpëtimtarit tonë. Zbulesa e zhvillon skenën e besimit bashkëkohor, si një Babiloni, ose si një gjendje pështjellore. Krishti jo vetëm që përmend sistemin e Babilonisë dhe na paralajmëron kundra tij, por ravijëzon se si kjo do të ndikonte edhe vetë historinë e njerëzve të Tij. Zbulesa 12 mbulon historinë e kishës së krishterë, që prej ditëve të Ardhjes së parë të Krishtit, deri në Ardhjen e Tij të dytë. Le ta shenjojmë këtë udhëtim nisur nga kjo përmbledhje.

Zbulesa 12:1: “E u shfaq një mrekulli në Qiell; një grua e veshur me diell, me hënën nën këmbë, dhe mbi krye një kurorë prej 12 yjesh”. Natyrshëm, që këtu kemi hyrë në fushën e gjuhës figurative të simboleve. Pse Zoti vallë, e përdor këtë lloj gjuhe? Në epokën e Gjonit, kushtet ishin shumë të vështira për kishën e Zotit. Shumica e historianëve besojnë se Roma pagane ishte ndershmërisht tolerante

kundrejt kishës së krishtere, edhe pse me mijëra njerëz u vranë për besimin tyre. Nëse Roma Pagane do të kishte ditur që të krishterët zotëronin një libër, që portretizonte qartësisht shembjen e mbretërisë së saj të stërmadhe, padyshim që do të kishte bërë të pamundurën që ata të mbijetonin. Shembja e Romës pagane, prandaj zhvellohet në gjuhë simbolike. Në mençurinë e Tij, Zoti ka vendosur një çelës në derën e profecisë, në mënyrë që ai i cili e zgjedh, të mund ta studiojë dhe kuptojë.

Një fuqi fetare portretizohet si e ardhur prej Romës Pagane e cila gjithashtu do ta persekutojë kishën e vërtetë. Edhe kjo vishet me gjuhë figurative. Kisha përfaqësohet si një grua e veshur me të bardha. Bishat në profeci përfaqësojnë mbretëritë, deti përfaqëson popujt, dhe gruaja përfaqëson kishën. Ja, kjo është Gruaja, kisha e vërtetë e Zotit. Komentatorët e shkrimeve pajtohen me këtë. Dr. Albert Barnes, Presbiteran, thotë: “gruaja, përtej të gjitha çështjeve, përfaqëson kishën”. Sipas Biblës katolike (Douay), “gruaja është kisha e Zotit”. Vëreni Zbulesën 12:1: “Gruaja, kisha, është veshur me dliresinë e diellit”. Shkrimet e Shenjta e përshkruajnë gjithashtu kishën, me po të njëjtën gjuhë simbolike ose metaforike. Jeremia 6:2 thotë: “Unë e kam ngjasuar bijën e Zionit (kishën) me një grua të hijshme e delikate”. Shiko 2 Korintasve, 11:2: “Kisha si një virgjëreshë e përkorë”. Një grua e dliresë në profeci simbolizon kishën e vërtetë, ndërsa gruaja e rrëzuar (shiko zbulesën 17) përfaqëson kishën e rrëzuar.

Kisha e Zbulesës 12 mbulon një periudhë që prej periudhës përpara Krishtit dhe gjithë periudhën e kishës së krishterë. Zbulesa 12:2-5, zhvillon dy gjëra, duke pritur lindjen e fëmijës Jezu Krisht: kishën dhe një përbindësh, një monstër. I lindur prej kishës ishte Mesia, i cili më vonë “do të kthehej te Zoti e në fronin e Tij” (Zbulesa, 12:5). Mostra ose fuqia e dragoit, që gjithashtu po priste për Mesinë e kishës, ishte Satanai. Ashtu si Zoti punon me njerëzit për të përmbushur qëllimet e Tij të mëdha, ashtu dhe Djalli punon me njerëzit të kryejë skenarët e tij të këqij. Ai punon përmes Herodit, në

nënshkrimin e dekretit të vrasjes së të gjithë fëmijëve meshkuj. Vetë Djalli paskësaj, u përpoq ta tundonte Zotin që të binte në mëkat. Ai punoi përmes Hebrenjëve për ta vrarë Atë. Por Krishti ngriti një fitore mbi djallin dhe vdekjen. Satanai nuk mund ta përballonte dot Krishtin, kështu që ai sulmoi kishën e Tij nga jashtë.

Zbulesa 12:13 : “Kur Dragoi pa të qe dëbuar në tokë, ai persekutoi gruan që solli fëmijën e njeriun. Pas kryqit të kalvarit, ai e “dinte se ditët e tij qenë të numëruara”. Edhe pse të pakonvertuar, Hebrenjtë e persekutuan Biblën e hershme të krishterë. Me paganët e Romës që persekutuan trupën entuziaste të besimtarëve të Krishtit dhe me Hebrenjtë që persekutuan edhe kishën gjithashtu, çdokush mund të mendojë se kisha do të dorëzohej ose të shfarosej.


Por përkundrazi, kisha militante u rrit në një shkallë të pakrahasueshme. Sa më shumë gjak derdhej, aq më shumë njerëzit i pranonin mësimet e krishtera dhe rriteshin duke ecur me kishën e vërtetë. Njerëzit luftonin seriozisht për besimin dhe në 100 vitet e kishës, Ungjilli dhe e vërteta, u predikuan me një fuqi të pashoqe. Shumë të konvertuar iu shtuan kishës nën këtë persekutim të tmerrshëm, sa që Satanait iu desh të ndryshojë taktikë. Në vend të aq shumë të vrarëve dhe masakrave jashtë kishës, ai filloi ta korruptojë, dobësojë dhe ndajë kishën nga përbrenda. Punoi me një plan të hollë e tinzar.

Pali tha se “misteri i ligësisë” ishte duke punuar në tokën e tij. Braktisja e besimit në të vërtetën e Zotit, e filluar si paganizëm, nisi ta nxjerrë kokën e saj të pështirë brenda kishës së krishterë. Me zellin dhe entuziazmin e të krishterëve, kisha u bë popullore midis miliona njerëzve. Konstantini i madh sipas të gjitha gjasave, u konvertua, e kjo e fuqizoi krishtërimin. Ky popullaritet i madh nuk ndodhi brenda një nate, por përgjatë shekujve, përzjerja me shumë “gjysëm të lindur” të krishterë, brenda kishës bëri që braktisja e besimit të rritej. Konstantini iu afroi të gjithë atyre që pranuan krishtërimin monedha floriri dhe të paktën një zinxhir stolisës. Ai u ofroi qyteteve dhe qytezave kisha të reja duke u siguruar mundësinë e njerëzve të këtyre

qyteteve të bëhen të krishterë. Me këtë lloj rrushfeti, me miliona njerëz u bënë të krishterë së jashtmi, edhe pse zemrat e tyre nuk e njihnin Zotin. Këto masa milionëshe sollën në kishë disa nga ato gjëra që dashuronin te paganizmi, si: qirinjtë, lutjet për të vdekurit, ndërveprimi me shenjtët, reliket, temjanin, purgatorin, etj. Po ndërsa ky kompromis me besimin vazhdonte, vazhdonte gjithashtu edhe besimi i plote i burrave e grave që “nuk donin që jetët e tyre të vazhdonin deri në vdekje” (vargu 11). Ata e kapërcyen këtë korrupsion “falë” gjakut të Qingjit dhe falë fjalës së dëshmisë së tyre”.

Në vitin 538 pas K., Perandori Justinian qarkshkroi në kryet e kishës titullin, “Kreu i të gjitha kishave-ndreqësja e Heretikëve”. Çdo jokonformist shikohej si një heretik; Në se ata nuk e shisnin lëshimin e besimit, ata përfundonin nëpër rrota torturash e thonjëshkulëse.. Kujtohet se vetëm në vitin 538, pas K. vdiqën rreth 1 milionë vetë.

Forma e përpunuar e nderimit të diellit, Mithraizmi u bë mjaft tërheqës kudo nëpër Perandorinë Romake. Por në periudhën e nderimit të krishterimit, ai u përbuz në mënyrë të tillë, sa që edhe vetë dita e nderimit të Zotit që ishte institucionalizuar për të gjithë njerëzit u ndryshua. Në këto kushte të braktisjes së besimit dhe të realitetit të aq shumë njerëzve të vrarë, arriti koha që njerëzit, të cilët donin ta ruanin të vërtetën, të mërgonin. Vargu 6: “E gruaja u arratis në shkretëtirë, ku kishte një vend të përgatitur nga Zoti, ku ata mund të ushqeheshin për njëmijë e dyqind e tre ditë”. Vargu 14 na jep një përshkrim të ngjashëm. Kisha e Zotit do të shkojë të fshihet për 1260 ditë profetike ose 1260 vjet. Ezekiel 4:6 thotë “Një ditë në profeci është një vit. Nga viti 538 deri në vitin 1798, pra, për një periudhë prej 1260 vjet, kisha e vërtetë e Zotit u fsheh në shkretëtirë. Po çfarë ndodhi në vitin 538 që ajo quhet si pikënisje?



- 1 . Nisi një erë e re e kishës dhe e qeverisjes së shteteve.
- 2 .U lëshua një dekret për të gjithë të krishterët për t'u lidhur me kishën e shtetit të ri ose përndryshe të gjitha pronat dhe pasuritë do t'u konfiskoheshin.
- 3 . Të gjitha format e nderimit, të ndryshme nga ato që parashkruhen nga Papati, u ndaluan.
- 4 . Kisha e vërtetë u parashkrua që prej vitit 538 pas K.

Kisha u arratis në shkretëtirë. Një rrjedhë e tërë sekuestrimesh vijoi pareshtur mbi të gjithë ata që nuk i përgjigjeshin dekretit të Papatit. “Por toka e ndihmoi gruan, ajo hapi zemrën dhe e thau përmytjen që dragoi lëshoi me gojën e tij”. Ne theksuam në vargun 6 se “një vend u përgatit për kishën e Zotit”. Njerëzit u arratisën në zonat e pabanuara të Jugut të Francës dhe Veriut të Italisë ose në zemër të Turqisë. Kujtohet se miliona njerëz u arratisën realisht në këto vende, ku Zoti u kishte përgatitur një vend për kishën e Tij të vërtetë. Këto

zona të mëdha malore kishin shumë shpella që u gjetën lehtësisht të gatshme nga të arratisurit e kishës, por që ishte e vështirë të gjendeshin nga pushtuesit. Poezia që unë gjeta në Muzeun e Tore Peliçes në Veri të Italisë, ishte një homazh vërtet i mrekullueshëm i mbrojtjes së Zotit për Kishën e Tij.

“Për fuqinë e kodrinave ne të bekojmë,
O Zot, o Zot, o Ati ynë.
Ti i ke bërë të fuqishëm fëmijët e tu,
Prej prekjës së lëndinave malore.
Ti i ngule harqet mërgimtare,
Aty ku s’kishin shkelur kurrë këmbët e plaçkitësve.
Se për fuqinë e kodrinave ne të bekojmë,
O Zot, o Zot, o Ati ynë!

Përtej persekutimeve, një numër njerëzish u bënë të famshëm për besnikërinë e tyre ndaj së vërtetës. Kështu qenë Albigenezët, në jug të Francës, të cilët u persekutuan dhe në fund u shuan të gjithë, përveçse një grupi njerëzish që qenë të aftë të kalononin Alpet, për në Luginën e Piemontes, për t’u bashkuar me Valdenesët ose Vuduatë. Qenë Palicianët e të tjerë që bashkuan forcat në zonën perëndimore të Turqisë në Luginat Goreme. Ata u shpërngulën prej zonave bregdetare dhe vazhduan ta jetonin besimin nëpër male e nëpër luginat shpellë-gëluese. Ata vazhduan, siç bënë edhe shumë të tjerë, ta ndiqnin Fjalën e Zotit dhe ta ruanin Sabatin e krishterë. Padyshim që ata “kërkuan besimin e shpërndarë që prej shenjtëve”. Në Bohemi, Moravianët u bënë një kullë fuqie për grupet e tjerë, duke u simpatizuar edhe nga Valdenesët. Jan Miltic, në shekullin XIV, la detyrën e tij të priftit në universitetin e Pragës dhe vdiq në Avinjon më 1374, kur shkoi për një bashkëkuvendim papnor. Është në të njëjtën kohë historike me Moravianët, Lollardët në Angli ndoqën pozicionin e Uajklifit dhe më pas e identifikuan veten me Reformuesit. Përgjatë jugut të Francës, gjatë këtyre viteve, një tjetër

popull zhvilloi një ndjenjë të fortë besnikërie ndaj Zotit dhe Fjalës së Tij, duke u ndjekur dhe persekutuar për këtë gjë. Këta qenë Huzhenotët. Kisha e vërtetë do të mbetet në shkretëtirë për 1260 vjet. Ai ish persekutuar për kaq mijë vjet, e tani kishte ardhur koha që të ndihej fillimi i Reformës. Martin Luteri (duke marrë mbështetjen e disa princërve të Gjermanisë) nisi të predikonte fjalën e Zotit. Reforma u pranua nga shumica e gjermanëve. Kisha e Anglisë me Kranmerët dhe Latimerët e vet vazhdoi ta përparonte të vërtetën. Po përsëri ekzistonin ideale pagane, të cilat kishin qëndruar nëpër kisha, e që shpërthyen fort gjatë Reformës.

Zoti po i udhëhiqte çështjet e kishës së Tij në një mënyrë të paharrueshme. Pas 1260 vitesh në shkretëtirë, kishës së vërtetë i duhej të dilte në dritën e ditës. Presbiteranët i shtuan akoma dhe më shumë dritë, ashtu siç bënë Metodistët dhe Baptistët. Pak nga pak e vërteta nisi të përparojë. Mirëpo ishte fatkeqe se shumë kisha ndërtuan një besim përqark dritës së tyre të përparuar. Në çdo rast, ishte përparimi ai që kërkohet. Sa herë që Zoti ngrinte një Kishë të re, ajo vetë ndërtonte rreth dritës së saj një hendek, në mënyrë që zhvillimet pozitive të qenë gati të pamundura. Shumë kisha të reja lindën kështu. Jashtë prej këtyre kishave pati edhe degëzime dytësore, ku njerëz me ide të ndryshme nisën të promovojnë pikën e tyre të vështirimit e të fitojnë ndjekës pas vetes. Shumë nga këto kisha vijuan në një aktivitet të fortë misionar, që Zoti e bekoj fortësisht. Njerëzit e Zotit tanimë nuk qenë cakëzuar vetëm në një kishë. Në fakt Zoti tha në ditët e Tij të fundit: “Nxirrini jashtë prej saj (Babilonisë) njerëzit e mi”. Edhe në Babiloni Ai kishte njerëzit e vet. Por në fund i thirri ata të iknin. Përpara vitit 1798, njerëzit jetonin nën dritën e së vërtetës që ata kishin marrë. Shumë e hidhnin poshtë përparimin, i cili jo vetëm e zhvendosi progresin e së vërtetës, por shkakton edhe lindjen e besimeve të reja.


Në vitin 1799, një numër ngjarjesh shenjuan fundin e 1260 viteve.

1 . Kisha dhe shteti u ndanë në Itali.

2. Gjenerali i Napoleonit Berthier, e shfronësoi Papën dhe shfuqizoi qeverinë e tij.
- 3 . Të gjithë italianëve iu dha liria fetare.
- 4 . Në Itali u ndërtua një formë republikane qeverisjeje.

Pas këtyre ngjarjeve kisha mund të dilte nga shkretëtira. Në këtë kohë njerëzit e gjithë botës filluan të bashkoheshin në një lëvizjeje mbarëbotërore, që të përgatisnin ardhjen e Krishtit.

Zbulesa: 12:17: “Dhe dragoi u zemërua me gruan, e shkoi të bëjë luftë me mbeturinat e farës së saj që ruanin urdhërimet e Zotit dhe qenë dëshmitarë të Jezu Krishtit”. Jashtë prej shkretëtirës duhet të dilte një kishë e pajisur me të tilla karakteristika. Në se kisha së cilës ju i përkisni, nuk ka dëshminë e Jezusit (shpirtin e profecisë të Zbulesa 19:10), ose nuk i ruan Urdhërimet e Zotit (deri në fund), atëherë mendo dhe lutu me kujdes se ku po të udhëheq Zoti. Ai do që ti të jetosh e të lartësohesh te e vërteta që ai dhaër ju, e shembulli yt, padyshim që do të jetë një bekim për të tjerët.



25 . Përrreth botës në 60 minuta - Zbulesa 14

Zbulesa14:14-16: “Unë po shikoja e përpara meje u duk një re e bardhë, dhe ulur mbi re ishte dikush i ngjashëm me Birin e njeriut”, me një kurorë të praruar mbi krye dhe një drapër në dorë. Atëherë një tjetër Engjëll doli nga tempulli, duke i bërtitur me zë të lartë atij që ishte ulur mbi re : “Merre draprin dhe korr, se koha e korrjes ka ardhur, se të korrat e tokës janë pjekur”. Kështu, ai që ish duke qëndruar mbi re e vringëlliu draprin mbi tokë, dhe toka u korr.”

E gjitha kjo shoqërohet me një pikturë të bukur grafike të korries përfundimtare të tokës. Kjo profeci është ardhja e dyte e lavdishme e Zotit tonë e paraprirë nga Mesazhi i Tre Engjëjve, që i trumbetojnë tokës mesazhin përfundimtar të Zotit. Këta Engjëj përfaqësojnë qartësisht lëvizjen e Zotit për shpalljen finale të Ungjillit dhe të vërtetat e tij përkatëse. Në çdo epokë të mbizotëruar nga fatkeqësitë dhe krizat shpirtërore, Zoti i ka dërguar mesazhe paralajmëruese banorëve të tokës. Vëreni disa prej tyre:

Noe Zoti ia zhvilloi të vërtetën e Tij profeti patriarku. E duke bërë kështu Ai anashkaloi udhëheqësit fetarë të kohës. Arka e shpëtoi Noe-n dhe familjen e tij, zogjtë dhe kafshët që ai ruajti, por gjithçka tjetër u zhduk. Mesazhi i Zotit u solli shpëtim atyre që e pranuan ate, por fatkeqësi të tmerrshme atyre që e mohuan.

Elia Ky profet ishte një predikues i fortë, i cili u thirr të shërbejë kur shumica e Izraelitëve i ishte kthyer nderimit të Baal-it. Çështja mund të shtrohet kështu : “A mundet një njeri i vetëm të zotërojë të vërtetën dhe të gjithë mbretërit dhe mbretëreshat, bashkë me gjithë udhëheqësit fetarë të gabojnë”? Zoti i qiejve i kërkoi njeriut ta nderojë Atë në të vërtetën dhe Shpirtin e Tij të shenjtë.

Gjon Pagëzori Gjoni u thirr të përgatiste udhën e Zotit: “U dëgjua zëri i dikujt që bërtiste në shkretëtirë : “Përgatisni udhën e Zotit”! Kisha ekzistuese e kohës nuk u përdor për një gjë të tillë. Zoti i anashkaloi Farizejtë, Seducejtë dhe Essenënët; vetëm Gjoni ishte lajmëtari i rëndësishëm i baticave të mbara.

Kështu, në fund të kohës, Zoti zhvillon një lëvizje mbarëbotërore, që Ai mund të ngrihet e të shpallë Ungjillin në një mënyrë të qartë, Biblike, për të zhvilluar gjithashtu ardhjen e dytë të Zotit tonë, si një fakt të sigurt. Ungjilli do të shkojë në të gjithë botën e pastaj do të mbërrijë fundi. (Mateu 24:14).

Mesazhi i parë i Engjëllit.”E unë pashë një tjetër Engjëll të fluturojë në mes të qiellit, me Ungjillin e përjetshëm që duhej të predikohet te të gjithë ata që banojnë në tokë, tek çdo komb, fis e gjuhë: E të thotë me një zë të lartë : “Frikësojuni Zotit dhe jepini Atij lavdi, se ora e gjykimit të Tij po vjen, ndaj nderojeni Atë që bëri Qiellin dhe tokën, detin dhe rrjedhat e ujrave”! (Zbulesa, 14:6-7).

Përpara fundit do të ketë një Zgjim të madh. I përjetshmi Ungjill i hirësisë shpëtuese të Zotit do të përhapet në të gjithë botën. Ai do të shpallë gjithashtu se po mbërrin ora e gjykimit të Tij. Ky gjykim është i përshtatshëm për të gjykuar fuqinë e bririt të vogël të Danielit 7 dhe për t’i zhvëlluar universitet shenjtët e vërtetë të Zotit. Ky mesazh është një zhvëllim rrëqethës i karakterit të Zotit, ashtu siç Ai është zbuluar te Jezu Krishti. Mesazhi u bën thirrje njerëzve për të nderuar Krijuesin. Në një kohë, kur bota është duke dëgjuar zërin e evolucionistëve, njerëzit e Zotit janë duke shpallur fuqinë e Krijuesit. Krijuesi është gjithashtu një kujtues i Sabatit të Zotit, të caktuar si një memorial për fuqinë krijuese të Zotit.

Mesazhi i dytë i Engjëllit

“E pastaj doli një tjetër Engjëll- që thoshte- Babilonia ra, ra ai qytet i madh, sepse ai i bëri të gjitha kombet të pinin verën e zemërimit të mbrujtur prej saj”.

Babilonia është religjioni i kompromisit. Ajo është në fakt ungjilli i rrejtshëm. Ekziston këtu një tjetër thirrje për t’i qëndruar tundimit, për t’u prirur kah një besimi të lehtë dhe të dobët. Zoti i mësoi njerëzit e Tij kah një pastërtie të përjetëshme te Jezu Krishti. Ai i mësoi njerëzit e Tij të mbanin urdhërimet. Nga ana tjetër Babilonia i mësoi njerëzit ta pranonin Krishtin e të mos kishin asnjë lidhje me urdhërimet. Ky qëndrim iu përgjigjej premtimeve të Zotit, por i përdorte ato siç bëri Satanai me Evën, për të shfajësuar mëkatën.

Modernizimi i mëson njerëzit që të bëjnë më të mirën e mundshme, sepse Jezusi do t’i kapërcejë mëkatet dhe ligësitë. Por Zoti dëshironte që njerëzit të ecnin për të pushtuar dhe për t’u pushtuar. Babilonia

paraqiste ekstreme. Ajo e zhvellone Zotin si një Zot të mëshirës ose si një Zot të zemërimit, ose ndoshta në anën tjetër si një zot i urrejtjes, ose i një sentimentit i cili i kapërcen me ngrohtësi e dhembshuri mëkatet e njerëzve.

Babilonia rrallë jepte një imazh të ekuilibruar të gjithë karakterit të Zotit. Ky mesazh i dytë është një pjesë e të parit, por paralajmëron fortësisht që kisha e Zotit është ndarë në përgjithësi nga standardet e mëdha të së vërtetës.

Mesazhi i tretë i Engjëllit

“E një Engjëll i tretë i ndoqi ata duke thënë : “Në se ndokush nderon bishën dhe imazhin e saj, dhe merr shenjën e saj në ballë, ose në dorën e saj, ai do të pijë edhe verën e zemërimit të Zotit, e cila do të kullojë me gjithë fuqinë e vet në kupën e përbuzjes së Tij. Ai do të torturohet në zjarr e squfur në praninë e Engjëjve të Shenjtë dhe në praninë e Qingjit; Dhe tymi i sflitjes së tyre do të ngjitet për jetë, pa u rreshtur asnjë ditë e natë, që të nderojë Biblën dhe imazhin e saj e të marr shenjën e emrit të tij (Vargu 9:11)

Theksi i këtij mesazhi vihet mbi një provë dhe një vendim. Do të ketë dy grupe në fundin e botës. Njerëzit e Zotit që i mbajnë urdhërimet e Zotit e që kanë besimin e Jezusit, vargu 12 dhe grupi i dytë i përmendur në vargjet 9-11. Ata që janë njerëzit e Zotit dallohen nga bindja, durimi, besimi dhe karakteri i Jezusit. Ata që marrin shenjën janë nderonjës të pakujdesshëm, që zgjedhin rrugën e lehtë, përkulen në bindjen e praktikave dhe ideve të stisura nga njeriu. Dy zgjidhje janë: 1. Dorëzim ndaj Krishtit ose 2. Dorëzim ndaj Satanait dhe traditave të njerzëve.

Sipas meje, e vetmja lëvizje sot, që është duke përmbushur specifikimet e Mesazheve të Tre Engjëjve, është lëvizja e Adventistëve të Ditës së Shtatë. Ndërsa Adventistët kuptuan dhe mësojnë qartësisht se Zoti ka shumë njerëz nëpër shumë besime, duket haptazi se vetëm një lëvizje është duke jetuar sot me mësimet specifike të Biblës mbi Zbulesën 14. Zoti është duke e bekuar këtë

besim në një mënyrë krejt të vërtetë. Adventistët e Ditës së Shtatë ndjekin mësimet e Jezusit në një mënyrë praktike dhe përpiqen të ndjekin metodat e Tij të mëdha të mësimi. Ata ndjekin mësimet e Tij Shpirtërore qartazi e haptazi e besojnë se ka disa rrugë të afrimit të njerëzve me Ungjillin. Ato përmbledhen sot në një numër kategorish :

- Shëndeti dhe shërbimi përmes spitaleve dhe klinikave.
- Mediat botuese dhe elektronike.
- Edukimi : shkollat, kolegjet dhe universitetet
- Programet humanitare dhe të zhvillimit përmes ADRA-s dhe njerëzve të kishave lokale.
- Qendrat dhe fermat e ushqimit të shëndetshëm.
- Kishat dhe grupet shtëpijakë.
- Satelitët dhe televizionet.
- Radiot mbarëbotërore.
- Evangjelizmi publik.

Shëndeti dhe shërimi janë një metodë e rëndësishme e paqëtimit të të krishterëve me dashurinë ndaj të tjerëve. Për këtë arsye Adventistët fokusohen në një shkallë të madhe në veprat mjekësore nëpërmjet ndërtimit të spitaleve, klinikave dhe pikave të shërbesës për njerëzit në nevojë. Ata punojnë në ndërtimin e qendrave të mëdha të welfare-it për të ndihmuar ata në varfëri dhe dëshpërim. Shkollat, kolegjet dhe universitetet e tyre janë të prirura të ndihmojnë në edukimin e rinisë për pjesën më të madhe të punëve të Zotit. E natyrisht që ata ndërtojnë edhe kisha apo shërbesa nderimi. Shtëpitë e tyre Botuese veprojnë kudo nëpër botë duke shtypur libra dhe literaturë, që arrijnë deri në pikën më të largët të tokës. Punishtet e fermat e tyre ushqimore sigurojnë punë për anëtarët dhe jo anëtarët e kishës, por njëherësh edhe ushqimin që ndihmon ata të jenë qytetarë të fortë e të vetëdishëm që trupat e tyre janë tempujt të Zotit të gjallë. Gjehen fonde për misionet dhe veprat edukuese, po ashtu si dhe për spitalet, klinikat, apo evangjelizmin e çdo lloji.

Publiku është pjesëmarrës në një udhëtim viziv për të parë se si Zoti e ka bekuar punën e tij të madhe kudo nëpër botë. Adventistët sot punojnë me mbi 900 grupe gjuhësh dhe në mbi 200 vende të botës. Ata kanë qasje në 99% të popullsisë së botës. Në disa zona si Australia, Azia, anëtarësia është rritur deri në 40% çdo vit. Raportet e vitit 2010 tregojnë se secila prej divizioneve botërore të Adventistëve ka mundur të arrijë në zona të reja ku Ungjilli është shpallur me fuqi dhe entuziazëm. Në 5 vjet, deri në vitin 2010, kisha, ndërtesat, qendrat evangjelike dhe anëtarësia janë rritur kudo nëpër botë. Kjo është një arritje e pashoqe. Më shumë se 2000 misionarë janë dërguar prej bazave të tyre amtare gjatë kësaj periudhe 5 vjeçare : Kjo shifër është një rekord për rritjen misionare. Në fund të vitit 2012 janë rreth 18 milionë anëtarët e saj të pagëzuar me anketime, që e japin këtë shifër diku afër 40 milionë, në se përfshijmë fëmijët, që dëftojnë se janë Adventistë të Ditës së Shtatë.

Më shumë se 6000 shkolla punojnë për besimin me një masë të madhe, prej më shumë se 1 milionë studentësh. Kjo varion nga shkollat më të vogla, të ulta deri në nivel universitetesh me studentë të diplomuar që nga filozofia dhe mjekësia deri te fushat e tjera. Studentët e këtyre institucioneve kanë ndihmuar t'u sjellin mjaft prej kolegëve të tyre fuqinë shpëtuese të Krishtit. Po njëllor si dhe përmbushjen e mjaft nevojave, si të botës së shkolluar ashtu dhe asaj të pashkolluar.

Librat dhe literatura e tyre sot shtypen në 250 gjuhë, me më shumë se 75 libra të rinj çdo vit. Shitjet e kësaj literature nëpër 50 shtëpi botuese dhe shumë agjensi shpërndarëse, arrijnë në më shumë se 80 milionë dollarë çdo vit. Programi mbarëbotëror që po diskutojnë, përfshin ministra, edukatorë, fizikantë dentistë, infermierë, botues, ekspertë të komunikimit dhe punëtorë institucionalë. E gjithë forca punëtore numëron rreth 150 000 persona të cilët janë të përkushtuar ta mbarojnë këtë punë kudo nëpër botë.

Çdo vit Adventistët ndihmojnë në komunitetet e tyre lokale ata që janë në nevojë. Më e pakta 10 milionë njerëz ndihmohen me ushqim,

rroba, shtretër, orendi dhe ndihme fizike. Shumica e këtyre njerëzve janë viktimat të fatkeqësive natyrore të tilla, si: përmbytjet, tajfunet, uraganet, zjarret, rrëshqitjet e dheut, tërmetet, luftrat, etj. Ekziston një organizim i fortë shërbimi social, që është gati në çdo moment në ndihmë të njerëzve.

Ungjilli është përhapur me televizione e satelitë, praktikisht, në çdo vend të botës, nëpërmjet entit radiofonik “Zëri i profecisë” dhe serive televizive të tilla si “Besimi për të sotmen”. Në vitin 2000, 2400 stacione radiosho e shpërhapnin këtë mesazh nëpër shumë gjuhë dhe 1561 stacione TV me zë dhe me figurë e transmetojnë kudo Fjalën e shenjtë. Sot satelitët përdoren për të shpërndarë mesazhin e tri Engjëjve në sa më shumë njerëz kudo nëpër botë. Programet më të njohura satelitore janë: 3ABN dhe Hope Channel të cilat mund të shikohen dhe të dëgjohen në 24 orë të ditës, në shumë pjesë të botës. Ka më shumë se 1 milion aplikime çdo vit për kurse korrespondence në studimin e Biblës, që jepen falas. Kjo gjë është kryer për 70 vjet në fushën e radios dhe televizionit, që me futjen e tij në përdorim 60 vjet më parë. Kompjuterat janë mjeti më i ri për të ndarë Ungjillin, aq sa ka dhe shumë njerëz që kanë arritur të pagëzohen nëpërmjet internetit.

Për vite, Adventistët kanë qenë të spikatur në fushën e edukimit shëndetësor. Këtë vit, ashtu si çdo vit, përparime të reja janë bërë për njerëzit primitivë që kanë nevojë për të tillë edukim dhe përkujdesjeje. Guineja e Re është një vend tipik primitiv që merr një ndihmë speciale nga universiteti “Loma Linda” në Kaliforni, në mënyrë që njerëzit e saj, të mund të kuptojnë se si mund të jetojnë pa kaq shumë sëmundje dhe epidemi. Ekipet e specialistëve të zemrës kanë punuar me sukses mbi qindra pacientë në Greqi, Arabi Saudite, Pakistan, Tongo, Kinë, Nepal, Fixhi dhe shumë zona të tjera. Në mes shumë aktiviteteve të organizuara nga kishat, janë ato në fushat e punës rinore. Një punë rinore fortësisht e organizuar është ndërmarrë në të gjitha vendet, ku puna e Ungjillit është marrë përsipër të kryhet. Kampingjet, kongreset dhe aktivitetet javore janë

kryer nga secila prej kishave, bashkë me konferencat që ndihmojnë dhe inkurajojnë rininë të kuptojë nevojat e veta dhe nevojat e të tjerëve. Kurse të tilla të ngjashme me këto janë udhëhequr nga boy skaut dhe guida të organizuara me të rinj të moshës nga 5 deri në 30 vjeç. Të rinjtë e kishës e shijojnë një program të tillë kaq angazhues, që i mundëson ata të kenë kurajo në këto kohë të vështira.

Në takimet publike, në studimet e Biblës në shtëpi, në takimet kishtare derë më derë, apo nëpërmjet ajrit, Ungjilli i mbretërisë do të mbartet nëpër botë, për t'u dëshmuar tek të gjithë kombet e botës. Vetëm pas kësaj do të vijë fundi. Në qytetet e mëdha të tokës, në ishujt e vegjël të Pacifikut, sipër maleve të lartë të Amerikës së Jugut, përmes fushave të shkreta të Afrikës, mes njerëzve të kulturuar apo plazheve primitivë, Ungjilli ka arritur të mbërrijë kudo. Sot ne jemi në ditët e fundit të historisë së botës. Shpejt Jezusi do të vijë dhe vepra e Ungjilit do të përfundojë. Deri atëherë, çdo person që pranon Krishtin, ka përgjegjësi t'u tregojë fqinjëve të vet të vërtetën e Biblës. Zoti na jep të gjithëve kurajën, për të shpallur guximshëm të vërtetën e Krishtit ndaj komunitetit tonë, ndaj vendit dhe botës.

26 . Mrekullitë e Turqisë dhe shtatë kishat e saj

Turqia është një tokë e shumë kontrasteve. Mënyra moderne e të jetuarit duket të plekset aq shpesh me antikitetin. Në fakt , historia tregon se Turqia ishte një nga qytetërimet më të vjetra, për të cilën është dëgjuar shumë pak deri në fillimin e shekullit të shkuar. Qytetet e zbuluara Hittite qenë jo vetëm një dritë thelluese e këtij qytetërimi antik e këtij, por gjithashtu edhe një dritë zhvelluese e saktësisë të Shkrimeve të Shenjta. Hititët përmenden një numër herësh të shkrimit. Gjithsesi, asgjë s'njihej për ta përveç kujtesës Biblike. Pllakat e zbuluara në Tell el Amarna hedhin pak dritë mbi këto

popullsi. Anekhesemum, gruaja e Tutankhamenit i pat shkruar mbretit Hittit duke i kërkuar dorën e të birit për martesë. Tutankhameni sapo kishte vdekur dhe ajo duhej të vendoste për një lidhje të re martesore brenda 90 ditësh. Mbreti Hittit u tregua i matur dhe mori më shumë kohë se sa limiti kohor i caktuar nga oborri për të zbuluar të vërtetën e kësaj kërke. Kështu, ai u vonua dhe e shkreta Anekhesemum u detyrua të martohej me priftin plak trashalug Ay, cili ishte dhe thesarmbajtësi i tempullit të saj.

Shpejt, pasi u gjetën pllakat e El Amarnas, u zbuluan edhe qytete të tilla Hittite si Carchemish, Bogaskoy dhe Hatthussas. Në Ankara, kryeqyteti i Turqisë, Muzeu Anatolian, u bë i famshëm për relievet antike të Hittiteve dhe për disa prej orendive të tyre, të tilla si objektet e nderimit dhe shumë objekteve kulmore. Pakti i parë botëror i mos-agresionit midis kombeve, besohet të ketë qënë bërë midis Egjiptianëve dhe Hittitëve. Kjo ndodhi pak pas kërkesës së Anekhesemum-it ndaj mbretit Hittit.

Sidoqoftë, ajo çka është më interesante në Turqi, veçanërisht për studentët e Shkrimeve të Shenjta, janë shumë vende Biblike të përmendura në Dhjatën e Re. Efesi, Kolosi, Tarsus-i (ku Pali lindi dhe u rrit), Derbe, Troas, për të përmendur vetëm disa, janë qytete ku rrënojat e shquara i zhvillojnë këto vende si të ekzistueshme, duke i bërë shkrimet të besueshme.

Gjoni, Apostulli i mërguar dhe i burgosur në ishullin e Patmosit, u tregua i aftë t'u shkruante të "Shtatë kishave" të përmendura te Zbulesa. Këto kisha qënë në shtatë qytetet e njohura, si: Efesi, Smirna, Pergamos, Thiatira, Sardis, Filadelfia dhe Laodicea. Këto qytete gjenden në udhën e vjetër Romake që niset që prej bregdetit duke kryer një qark e duke shkuara në brendësi, duke u prirur kah qendrës së Turqisë e duke iu kthyer përsëri bregdetit.

Këto letra që Gjoni shkroi për shtatë kishat duket të kenë një zbatim katërplanësh:

- 1 . Ndaj kishave të krishtera brenda qyteteve.
- 2 . Ndaj vetë qyteteve.

3 . Ndaj një periudhe në historinë e kishës që shfaqet të jetë e mirë-përfaqësuar nga karakteri i kishës.

4 . Ndaj individëve anëtarë brenda kishave.

Këto letra përmbajnë mesazhe ndihme, në shumë raste qortime dhe disa urdhërime. Ato janë shkruar për secilën nga kishat e përmendura më parë: Efesi, Smirna, Pergamos, Sardis, Filadelfia dhe Laodicea. Kishte dhe qytete provinciale, përgjithësisht 50-80 km larg tyre, e secili prej tyre kishte qytetarë që ishin joshur nga Ungjilli i Jezu Krishtit. Letrat, kësisoj, ishin për t'i inkurajuar ata në besimin e tyre e për t'u dhënë këshilla besimtarëve. Letrat, sipas të gjitha gjasave janë shkruar në fund të shekullit të parë, midis viteve 92 dhe 98 p.K. Shumica e studiuesve pranojnë faktin se viti 96-të është data më e pranuar. Le të vërejmë disa detaje rreth çdo qyteti dhe letrës që i është shkruar kishës së tij.

Efesi

Emri nënkupton i dëshirueshëm. Qyteti ishte në një vend të bukur, në gojën e lumit Cayster, që është mbushur me baltë, që atëherë. Kishte një klimë të pëlqyeshme, mesdhetare, njerëzit qenë të lumtur e rronin mes muzikës, lluksit dhe zakoneve që i kapërcenin ato të mjaft qyteteve të kohës së tyre. Ishte një vend i dëshirueshëm për t'u vizituar dhe për të tërhequr turistë nga shumë vende.

Periudha e kishës shenjohej nga një periudhë ngazëllyese ungjillore, që nga koha e kryqëzimit të Jezusit, deri në vitin 100 p. K. me mijëra njerëz u pagëzuan përmes kredhjes në ujë, kudo nëpër botë, madje edhe në kishën më afër saj në Seljuk. Një pagëzimorë e shekullit të parë, mund të kundrohet sot e mbajtur në një gjendje të mirë dhe e modeluar në formën e kryqit. Pali, apostulli, shkroi një letër të tërë për kishën e Efesit. Është njera nga letrat e tij më të bukura. Efesi ishte i njohur në shfaqjen e dashurisë së tij për Krishtin dhe njerëzit e tij. Gjithsesi, Gjoni dha disa qortime për kishën, sepse ajo e kishte lënë dashurinë e saj të parë.

Le të vërejmë tërësinë e letrës së tij të parë:

Zbulesa, 2:1-7: “Ndaj engjëjve të kishës në Efes shkroi : “Këto janë fjalët e atij që mban shtatë yje në dorën e tij të djathë dhe që ecën përmes shtatë llambëmbajtësve të arta: Unë i di qëllimet tuaja, punën tuaj të vështirë dhe këmbënguljen. Unë e di se ju nuk mund t’i toleroni njerëzit e liq, se ju i keni provuar ata që e shpallin veten apostuj, por që s’janë të tillë, dhe i keni gjetur gënjeshtarë. Ju i keni ruajtur dhe u keni qëndruar mundimeve dhe vuajtjeve për emrin tim dhe nuk jeni lodhur. Po përsëri këtë gjë po e ngre kundra jush: se ju e keni harruar dashurinë tuaj të parë. Kujtoni lartësinë nga ku keni rënë! Pendohuni e bëni ato gjëra që bënit në fillim! Në se nuk qendroni, unë do të vij te ju dhe do t’ua heq llambë-mbajtësën prej vendit të vet. Ju e kishit atë gjë si ndihmesë. Po ju i urreni praktikat e Nikolaitanëve, ashtu siç u urrej edhe unë. Kush ka një vesh le të dëgjojë çfarë thotë Shpirti për kishat. Atij që do të qendrojë, unë do t’i jap të drejtë të hajë nga pema e jetës e cila është në parajsën e Zotit”.

Vëreni si Gjoni ka një mesazh nga Jezusi i cili ecën përmes shtatë qirimbajtësve të arta. Ky është portreti i Jezusit në kapitullin e parë dhe tani Gjoni na jep disa detaje më shumë rreth Krishtit. Nikolaitanët, që ai përmend, ishin njerëz që gjatë gjithë kohës e nënvlehtësonin të vërtetën e Zotit. Ata qenë të shumtë gjithashtu në Pergamos dhe aty kishin më shumë sukses, se sa në Efes. Sidoqoftë, kundërshtimi kryesor ndaj të vërtetës së Zotit, ishte besimi tashmë i stabilizuar i nderimi ndaj Dianës, tempulli në nder të së cilës, ishte katër herë më i gjerë se ai i Parthenonit në Athinë. Ai u shkatërrua nga Gotët në vitin 262 p.K. Në koncilin e Efesit, Maria nëna e Krishtit, ishte e para së cilës iu dha titulli: “Nëna e Zotit”

Vëreni qortimin që i bëhet kishës : “Ju e keni lënë dashurinë tuaj të parë”. Vitaliteti dhe ethshmëria e kishës janë tkurur dhe anëtarët e saj harruan të ndajnë dashurinë e tyre për Krishtin, e për këtë arsye ju takon kjo vërejtje. Gjithsesi ata që do të qendrojnë, mund të jenë të aftë të kenë një pjesë në Mbretërinë e Zotit.

Smirna (Zbulesa 2:8-10)

Kjo kishë u lokalizua në qendrën e qytet të njohur sot si Izmir. Ishte plot me trekëmbështa për kishën Smirna e asaj kohe, pasi kjo periudhë ishte e mbizotëruar nga një persekutim i fortë. Ashtu si Myrrh-a, kur u shkatërrua, afronte një aromë të ëmbël, po njëlloj kjo kishë e rrëzuar mund të ngrejë lart vetëm dashurinë e Zotit! (Fjala Smirna vjen nga rrënja e fjalës Myrrh). Ndaj besnikëve u premtua se ata do të fitonin kurorën e jetës. Kodrat prapa Smirnës u formësuan si të qenë një kurorë. Secila prej këtyre shtatë kishave ofronte bekime për qëndresën e këto duket të jenë karakteristikat e vërteta të qytetit ose të kishës. Si rezultat kisha arriti t'i kuptojë ofertat e bekuara.

Pergamos (Zbulesa 2:17)

Emri do të thotë lartësim. Pjesa kryesore e qytetit ishte e ngritur nbi fushë. Biblioteka e madhe që ish ngritur aty, u morr prej Mark Antonit, i cili nga ana e tij ia dhuroi Kleopatërës, për të cilën vuante nga dashuria. Ajo e mori në Aleksandri, por fatkeqësisht kjo bibliotekë, bashkë me bibliotekën e famshme të Aleksandrisë, u dogjën nga një zjarr gjithë-shkatërrues.

Mbreti i Pergamos mori titullin Pontifex Maximus, që do të thotë “ndërtuesi i urës së madhe”. Më vonë vetëm Papët e Romës e morrën një titull të tillë. Periudha e kishës ishte ajo prej vitit 313 p.K deri në vitin 538 p.K, një kohë e kompromiseve të rëndësishme, ku paganët diell-nderues e përhapën ndikimin e tyre në kishën e krishterë. Njerëzit e Pergamos nderonin Zeusin, i cili quhej gjithashtu edhe “Shpëtimtari i gjallë”. Për këtë arsye ata i ngritën një tempull edhe Euskalipit, Zotit të mjekimit. Shenja e Euskalipit përdoret sot prej profesionit të mjekut.

Rezidentët e këtij qyteti e përdornin mermerin për një numër gjërash simbolike të tilla, si gjykatat e qytetit që përfaqësoheshin nga skllëvërit për të nënkuptuar idenë se nëpërmjet tyre fitonin lirinë. Zbulesa, 2:17: “Kush ka veshë, le të dëgjojë se ç’ thotë shpirti për kishat. Atyre që qendrojnë unë do t’u japë manna-n e fshehur. Do

t'u jap gjithashtu një gur të bardhë, me një emër të ri të shkruar mbi të, të njohur vetëm për ata që e marrin". Se te Krishti ne kemi lirinë më të madhe që njerëzimi ka zotëruar ndonjëherë.

Thiatira (Zbulesa 2:18-29)

Kjo ishte kisha e mesme e Udhës Romake të Lindjes, por, po njësoj edhe në periudhën e historisë së kishës. Emri nënkupton “dorëzimin e besimit”. Prej vitit 538, p. K. deri në vitin 1517 pas Krishtit, ka pasur një kohë të persekutimit të madh të kryqit. Në Turqi ky ishte veçanërisht i njohur si fakt, kur të krishterët u arratisën në Cappadocia, në malet e vendit. Shumë shekuj më parë, Mali Erciyes, rreth 4000 metra i lartë, shpërtheu prej bulçive të tokës gurë, pluhur vullkanik, në vitin 280 p.K. Që atëherë shiu, bora dhe breshëri, nisën të formonin aty stalaktite të tipeve mjaft interesante. Me mijëra të krishterë u fshehën në zonën e Cappadocia-s për më shumë se 800 vjet. Në fund ata u shfarosën nga luftëtarët islamë. Vëreni te Zbulesa 2:27 premtimin kundra persekutorëve: “Ai do t’i sundojë ata me një skeptër të hekurt; Ai do t’i copëtojë ata, siç thyhet një vazo, pikërisht ashtu siç e mora unë autoritetin nga im Atë”. Njerëzit e Thiatirës zotëronin punishte të shumta qeramike, madje edhe sot ka mjaft vepra të mëdha qeramike pranë qytetit.

Sardis (Zbulesa 3:1-6)

E prejardhur prej një fjalë antike, kur qyteti ishte i rrethuar, Sardis nënkupton “ai që do të mbetet”. Kiri qe i pari që e pushtoi qytetin, të ngritur lart nëpër male, në vitin 549 p.K. duke dërguar një ushtar t’i ngjitej fortesës në mes të natës. Ai pati sukses dhe arriti të hapë portat e qytetit për ushtrinë persiane. Sot qeveria turke ka kryer mjaft rikonstruksiione në Sart (Sardis), që është një qytet krejt i ri, i rindërtuar në fushat rrëzë malit. Era e kishës tregoi më shumë një shpirt të ri besimi, se sa me vepra. Premtimi për këtë kishë ishte se “besimtarët do të ecin me Krishtin, veshur me të bardha”.

Filadelfia (Zbulesa 3:7-12)

Fjala greke nënkupton “dashuri vëllazërore”. Kjo ishte fryma e erës së kishës, e cila përfaqësonte etjen e jashtëzakonshme misionare të viteve 1800; Zbulesa 3:8 :”Unë i njoh qëllimet tuaja. Shikoni, unë kam vendosur përpara jush një derë të hapur, që s’ mund ta mbyllë askush. Unë e di se ju keni pak fuqi, po përsëri e mbajtet fjalën dhe nuk e mohuat emrin tim”. Tani dera u hap! S’do të ketë më asnjë pengesë për mesazhin e Ungjillit që ai të qarkullojë në glob”.

Laodicea (Zbulesa 3:13-22)

“Gjykimi i njerëzve” është kuptimi i fjalës Laodicea. Era e kësaj periudhe të kishës, nis që në fillimin e kohës së gjykimit të përmendur te Danieli 8:14, deri në fund të kohës. Në një botë materialiste, shekullare, kisha nuk ishte as e ftohtë dhe as e nxehtë, njëlloj si pranverat e Pammukale-s, jo larg nga qyteti i Laodicea-s. Ashtu si Gjoni i përshkroi ditët e fundit të kishës, ai mund të shihte ato si të vakëta, jo entuziaste. Por Krishti ende po troket në derën e zemrave të njerëzve. Ai i fton ata të hapin dyert dhe ta lënë të hyjë brenda. Doreza është nga brenda, dhe është zgjedhja juaj ta ftoni Atë të hyjë e të hani së bashku. Ç’ premtim i mrekullueshëm përmbushet çdo herë, që një person e hap derën e zemrës së vet dhe lejon Jezusin të hyjë brenda tij. S’është kjo vallë një sfidë reale për të gjithë ne?

27 . Ana tjetër e vdekjes

Përgjatë gjithë historisë ka ekzistuar një interes i madh për anën tjetër të vdekjes ose për jetën përtej vdekjes. Në varret e Faraonëve të Egjiptit, çdokush mund të shohë interesin e pamasë për këtë subjekt dhe dhembjet e vuajtjet që Egjiptianët kalonin, për të bërë më të mirën që të hynin për Faraonin në Parajsë.

Në Greqinë antike, varre në formë zgjoi, qenë ndërtuar për trupat e mbretërve të vdekur.

Bota jonë moderne është rrëqethur me përgatitjet për varret e Perandorëve kinezë të ndodhur së fundmi.

Në të moçmin Ur të Kaldeas-ve, kur vdisnin sundimtarët, stafi i tyre dhe ndihmësit shpesh kryenin vetëvrasje në masë, në mënyrë që mbreti të mos digjej i pashoqëruar.

Njerëzit modernë duan të dinë se çfarë ndodh në realitet me vdekjen? Varreza të mrekullueshme janë ndërtuar për të plotësuar nevojat e një vendi të mirë pushimi për të dashurit, siç mund të jenë p.sh. varrezat e Forest Lawn në Kaliforni. Për shekuj burra dhe gra kanë luftuar me këtë subjekt e sot ata kanë shumë ide që janë vërtet të pakënaqshme. Ato s'janë të dhëna nga Zoti ose të bazuara te Bibla.

Termi “Frymë” (Spirit)

Predikuesi 12:17: “E pluhuri iu kthye tokës prej nga erdhi e “Fryma” iu kthye Zotit që ia dha”.

Ç’ është kjo “frymë” që i kthehet Zotit. Çfarë thotë Bibla për këtë gjë? E njëjta fjalë gjendet te Jezusi 2:27: “Ashtu si trupi pa frymë është i vdekur, ashtu dhe besimi pa vepra është i shuar”.

Shumë komentatorë pranojnë se fjala “Frymë” vjen nga greqishtja pneuma. Ne sot kemi susta pneumatike, pompa pneumatike, etj, që vijnë nga po e njëta fjalë. Në një kohë që frymë do të thotë ajër ose frymëmarrje. Pra, frymë është një tjetër fjalë për frymëmarrjen në Shkrimet e Shenjta. Teksti i Jakobit atëherë mund të përkthehet kështu: “trupi pa frymëmarrje është i vdekur”. Kurse tek Libri i Predikuesit (dhjata e vjetër): “frymëmarrja i kthehet Zotit që ia dha”.

Termi “Shpirt”

Le të kthehemi tek libri i parë i Biblës (Zanafilla 2:7)

“Zoti formësoi njeriun nga pluhuri i tokës dhe i frymoi brinjët e tij me frymën e jetës, për ta bërë njeriun një qenie të gjallë”.

Ky është një përkthim korrekt nga fjala e origjinalit. Versioni i Mbretit James e përktheu fjalën anglisht “soul” pra, “qenie” me “shpirt”.

Ne kemi në këtë varg dy fjalë “shpirt” dhe “frymë”. Frymimi i jetës ose fryma e jetës dhe qenia ose shpirti. Zoti krijoi njeriun. Ai ishte veç pluhur derisa Zoti i fryu tek vrimat e hundës frymën e jetës. Atëherë ai u bë një qenie e gjallë. Ç’akt i mrekullueshëm! Libri i Predikuesit, kapitulli, 9:5-6 : “Se të gjallët e dinë se do të vdesin, por të vdekurit s’dinë asgjë; ata nuk kanë asnjë shpërblim të mëtejshëm, pasi u ka humbur edhe kujtesa. Dashuria, urrejtja dhe xhelozia e tyre kanë kohë që janë zhdukur. Ato s’do të kenë kurrë më ndonjë pjesë në gjithçka që ndodh nën diell”. Të jetuarit, personaliteti i të dashuruarit dhe vdekja rreshtin së ekzistuari, ose janë zhdukur deri kur ndodh Ringjallja.

1 Korintasve 15:51-54: “Dëgjomëni, do t’ju tregoj një mister. Ne s’do të flemë të gjithë, por do të ndryshohemi të gjithë - në një grimë, në një vezullitje syri, me rënien e trumpetës së fundit. Se kur trumbeta do të kumbojë, të vdekurit do të ngrihen të paprekur, e ne do të ndryshojmë. Se e vdekshmja duhet ta veshë veten me të pavdekshmen, mortorja me të pamortorshmen, në mënyrë që ajo çka është shkruar të bëhet realitet: “Vdekja u vorbullua e tëra në fitore”.

Me vdekjen trupi i kthehet pluhurit, po personaliteti dhe karakteri janë ende të vdekura, deri në Ringjallje. Vetëm atëhere personaliteti dhe karakteri, do të zgjohen e do t’i japin njeriut një trup të ri, të pavdekshëm, që s’do të vdesë kurrë. Jezusi foli për këtë te Gjoni 5:28-29: “Mos u habitni me një gjë të tillë, se do të vijë koha, kur të gjithë ata që janë në varr, do të dëgjojnë zërin e Tij e do të dalin; ata që kanë bërë vepra të mira do të ngrihen të jetojnë, kurse ata që kanë

bërë keq do të ngrihen për t'u dënuar". Te Gjoni 6:39-40, Ai tha se kjo ngjarje e madhe do të ndodhë në ditët e fundit. Kjo do të jetë, kur Ai vetë të kthehet e t'u japë jetë atyre që kanë vdekur.

Duhet të përmendim këtu se vdekja nuk nënkupton "zjarrin e ferrit", "purgatorin", "limbon" ose "parajsën". Nuk është një ferr përjetësisht përzhitës, siç përshkruhet nga disa. Kjo teori nuk është e pajtueshme me dashurinë e Zotit ose Psalmet e tij. Kur gjykimi të përmbushet plotësisht, atëherë do të ketë vërtet një dënim të përjetshëm për të gjithë ata që nuk e pranojnë Krishtin si shpëtimtarin e tyre. Parajsa është diçka e së ardhmes e do të ndodhë kur të vijë Krishti.

Spiritizmi

Besimet antike - edhe filozofia greke e lejoi kishën e krishterë, myslimanët, katolikët, ortodoksët dhe shumë protestantë që vijuan Mitologjitë e Lindjes - kanë probleme të mëdha me besimet Biblike. Martin Luteri ishte fortësisht kundër doktrinëve të tilla.

Gënjeshtra e Satanait në fillesë: "Ju s'do të vdisni. Do të jetoni për jetë".

Zoti e bëri të qartë te Hebrenjve 11:39-40, ku përmenden shumë nga personalitetet e famshëm të Biblës, se "askush" prej tyre s'do të marrë atë që u është premtuar. Zoti ka planifikuar diçka më të mirë për ne, në mënyrë që vetëm së bashku kjo gjë të bëhet e përsosur". Ç'ngjarje e mrekullueshme është kjo, ku shenjtët e vjetër do të ringjallen dhe të drejtët e gjallë do të bëhen përsosmërisht bashkë. Jezusi e përngjasoni vdekjen me gjumin. Kur njeriu vdes, ai mbetet i tillë deri në ringjallje. Sado larg mund të jenë vdekja me ringjalljen, personit të zgjuar do t'i ngjajë me një moment, që nga koha që ka shkuar të flerë (ose të vdesë). Sa e mrekullueshme është kjo gjë. Njeriu vdes e madje, edhe kur ai ka një mijë vjet që ka vdekur, një mijë javë apo minuta, gjëja e parë që do të njohë do të jetë pikërisht ringjallja.

Disa vite me parë, disa arkeologë në Egjipt ishin duke hapur një varr të një moshe 2000 vjeçare. Ata vërejtën se një bulb ishte varrosur së

bashku me Faraonin, ose ishte lënë nga dikush tjetër në varr. Ai qe tharë e fishkëzuar, por ata qenë kuriozë të dinin, në se kishte ende jetë në të. E mbollën në truallin më pjellor dhe e ujitën vazhdimisht. Për mrekullinë e tyre shpejt u shfaq një fletë e blertë, nga e cila u rrit një bimë që natyrisht ishte një zambak. Do të lulëzojë vallë? Shpejt çeli një syth dhe një ditë ngriti kryet një zambak i bukur ngjyrë vjollcë. Ai kishte fjetur për më shumë se 2000 vjet. E kjo është vetëm një pikturë e vogël e asj që mund të bëjë Ringjallja!

Po ju mund të pyesni: “Ç” do të ndodh me hajdutin në kryq? Ai nuk do të shkojë në parajsë nga vdekja? Le të vërejmë vargun aq shpesh të cituar te Luka, 23: 42-43. “Atëherë ai tha: “Jezus, kujtohu për mua kur të shkosh në mbretërinë tënde”. Jezusi iu përgjigj: “Do të them të vërtetën, sot ju do të jeni me mua në parajsë”. Nuk ka asnjë shenjë pikësimi në dokumentin origjinal në greqisht. Por pozicionimi ndryshe i një presjeje të vendosur pas fjalës së vërtetë, e ndryshon tërësisht kuptimin. Vërejeni këtë gjë : Unë po ju tregoj të vërtetën sot, ju do të jeni me mua në parajsë”. Ky ndryshim është i pajtueshëm me atë çfarë ndodhi.

Te Gjoni 19:31 shohim që këmbët e hajdutit u thyen të premtën mbrëma, kështu që ai të mos arratisë dot në Sabat. Krishti tashmë kishte vdekur. Të dielën në mëngjes, ditën e parë të javës, Krishti iu shfaq Marisë e i tha se Ai s’ ishte ngjitur ende në parajsë tek Ati i Tij. Natyrisht që edhe hajduti nuk kishte shkuar atë ditë në Parajsë duke pritur përfundimin e Ringjalljen e Madhe. Natyrisht që edhe hajduti nuk kishte shkuar atë ditë në Parajsë duke pritur përfundimin dhe Ringjalljen e Madhe.

Çfarë shprese u ka dhënë Krishti të gjithë atyre që vdiqën dhe që e kanë pranuar atë si Zot dhe shpëtimtar.

28. Çfarë dhe ku është ferri?

Disa nga përshkrimet e dhëna për ferrin shpesh na shkaktojnë të rrëqethura! Le të vërejmë këtë pasazh nga një predikues i famshëm rivalist Jonathan Edwards në predikimin e tij të titulluar: “Mëkatarët në dorën e një Zoti të zemëruar”, ligjëruar më 1741. “Zoti që të mban mbi humnerën e ferrit, siç mban dikush një merimangë apo një insekt çfarëdo mbi zjarr, pështiroset me ty dhe provokohet tmerrësisht; zemërimi tij kah teje digjet si zjarr; ai të sheh nga lart sikur ti s’vlen për asgjë tjetër, përveçse flakjes në zjarr...o mëkatar, ti varesh nga një fill i brishtë, me flakë e zemërimit hyjnor që shkëlqen mbi ty i gatshëm çdo çast për të të përthithur dhe djegur të tërin”.

Ky koncept është shumë i vështirë për t’u pranuar. Ne mund të pyesim: “A është vallë ky Zoti për të cilin na foli Jezusi? A s’na mësoi Jezusi se zoti na do e ka veç mendime të dashura për ne. Si mundet vallë që Ai të trajtojë qoftë edhe për pjesën më të keqe të njerëzimit, në këtë mënyrë”?

Shumë njerëz mund ta shohin konceptin e një ferri, ku digjen njerëzit e ligj, brenda flakëve në përjetësi, si përbuzës dhe totalisht të papajtueshëm me karakterin e një Zoti të dashur. Disa të tjerë janë larguar me zemërim nga besimi i krishterë duke thënë: “Në se ky është Zoti yt, unë e urrej Atë!” Pastaj vazhdojnë duke shpallur se: “Si mund të vlerësohet një Zot që merr një njeri që ka jetuar vetëm për pak vjet dhe e kredh në ferr për t’a djegur përjetë”?

Nuk ka dyshim që imazhi i një ferri përjetësisht djegës, si fati përfundimtar i njerëzve që hedhin poshtë Zotin, ka shkaktuar shumë afrime ndaj Zotit, falë frikës dhe jo dashurisë. Gjithësesi, ndërsa mund ta vlerësojnë dhe t’i frikësohen Zotit kryesisht për t’iu shmangur zjarrit të ferrit, kjo është një rrugë shumë e shkurtër për të kuptuar se çfarë kërkon Zoti prej nesh. Cila është baza e vërtetë për besimin e krishterë dhe nderimin e tij? Te Mateu 22:37 Zoti tha: “Ti duhet ta duash Zotin tënd me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me gjithë mendjen tënde”. Kjo është përgjigjia që Jezusi kërkon nga ne.

Ai nuk do që ne të frikësohemi dhe të nervozohemi në raportin tonë me Të.

Ndërsa ka njerëz që janë të neveritur nga koncepti i ferrit, ka të tjerë që priren kah kahut tjetër dhe thonë se Zoti është shumë i butë për të shpënë dikë në ferr. Përgjigjia e tyre kërkon të shpjegojë ndryshe atë çfarë Bibla mëson mbi këtë temë.

Le të zbulojmë se ç' na mëson vërtet Bibla në lidhje me ferrin.

Jezusi ka folur shumë për ferrin. (Mateu 10:28), “Mos iu frikësoni atyre që iu vrasin trupin, por nuk iu vrasin shpirtin. Frikësojuni më tepër Atij që është i aftë t’iu shkatërrojë trup e shpirt bashkë në ferr.” Vëreni gjithashtu 25:41-46: Atëherë, Ai do t’ ju thotë edhe atyre në krahun e tij të djathtë: “Largohuni nga unë të mallkuar, në zjarrin e përjetshëm të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij; unë isha i huaj e ju s’më futët brenda jush, isha lakuriq e ju s’më veshët, isha i sëmurë e në burg dhe ju s’më vizituat”.

Atëherë ata do t’i përgjigjen duke i thënë : “Zot, kur të pamë të etur e të uritur ose të huaj e lakuriq, të sëmurë ose në burg, e s’ të shërbyen vallë”? E Ai do t’ua kthejë: “Të jeni të sigurtë, po s’bëtë njerën nga këto gjëra, atëherë s’ keni bërë asgjë për mua. Të gjitha këto do të shkojnë kah dënimit të përjetshëm, por i drejti do të shkojë në jetën e përjetëshme”. Vëreni se vargu flet për një dënim të përjetshëm, jo dëmtim të përjetshëm. Dënimi është i përjetshëm, kjo është e sigurtë, por ai s’është dëmtim i njerëzve në përjetësi.

Përgjatë këtyre vargjeve ne duhet të vendosim pohime të tilla barazpeshuese si ato që gjenden te Gjoni 3:16-21. “Se Zoti aq shumë e deshi botën, sa i dha edhe Birin e Tij të vetëm, që çdokush që beson te Ai të mos shuhet, por të ketë një jetë të përjetëshme. Se Zoti nuk e dërgoi Birin e Tij në botë për ta dënuar atë, por që bota prej Tij të arrihej të shpëtohej. Ai që beson te Zoti nuk është i dënuar, por ai që nuk beson, tashmë është i dënuar, sepse ai s’ ka besuar në emrin e të vetmit Bir të dashur të Zotit.

“E ja cili është dënimi, që drita të vijë në botë, e njerëzit të duan më shumë errësirën se sa dritën, pasi qëllimet e tyre janë të liga. Kushdo

që praktikon të keqen e urren dritën, e nuk del në dritë, që të paraqesë qëllimet e tij. Por ai që dëshiron që e vërteta të dalë në dritë, që qëllimet e tij të shihen qartë, ai është i udhëhequr nga Zoti.” Këto janë fjalët e fuqishme të Jezusit për dashurinë e Tij të madhe. Ai s’ do të na dënojë, por të na shpëtojë.

Pjetri ndoqi të njëjtën temë te 2 Pjetri 3:9: “Zoti nuk është i ngadalte në mbajtjen e premtimeve të Tij, ashtu siç e kuptojnë njerëzit ngadalësinë. Ai është i duruar me ju, duke mos dashur të dëmtojë askënd, por të sjellë çdo njeri kah pendesës”.

Konsideroni pasazhin e mëposhtëm: “Zoti nuk e forcon kurrë veten ndaj nesh. Ai digjet për vlerësimin dhe miqësinë tonë. Ai dëshiron që të na i falë gabimet; por nëse zgjedhim ta refuzojmë ofertën e Tij, atëherë na duhet të paguajmë çmimin e gabimeve tona. Zoti është një Zot i drejtësisë, po njëlloj si i mëshirës. Nëse refuzojmë të pranojmë faljen lirë që Ai solli përmes vdekjes së Jezu Krishtit, atëherë duhet të vdesim për gabimet që kemi kryer. Vendimi përfundimtar na takon ne”.

Froni i madh i bardhë i gjykimit

Sipas Biblës në fund të kësaj bote të sotme do të vijë një kohë, kur çdo qenie njerëzore që ka jetuar ndonjëherë në planet, do të jetë e gjallë. Lexo Zbulesën 20:11-15: “Imagjinoje këtë skenë në mendje”. Vargjet e mëparëshme kanë portretizuar një kohë, kur njerëzit e ligj do të ngrihen nga varret dhe do të rrethojnë qytetin e quajtur Jeruzalemi i Ri. Brenda Jeruzalemit të Ri janë ata që e kanë pranuar Krishtin dhe kanë marrë dhuratën e jetesës së përjetëshme. Ata janë të qetë e të sigurtë brenda qytetit. Ata do të jetojnë e do të mbretërojnë me Krishtin në përjetësi. Atyre u është premtuar se do të trashëgojnë tokën ku jetuan në një botë që do të rrojë në përjetësi. Jashtë qytetit janë ata që kanë ardhur përpara Fronit të madh të Bardhë për të marrë gjykimin. Ata janë të shtërnguar të përballen me kujtimet e jetës së tyre, e përderisa refuzojnë të pranojnë faljen

përmes vdekjes së Jezu Krishtit, ata duhet të vdesin për gabimet e tyre. Ata do të flaken në një liqen zjarri e duhet të vuajnë “vdekjen e dytë”.

Bibla na mëson se do të ketë një vend dënimi për njerëzit e liq që hedhin poshtë ofertën e Jezusit për mëshirë. Gjithsesi, ai vend i quajtur zakonisht “ferr”, nuk ka për të ekzistuar deri në kthimin e Jezu Krishtit në këtë tokë dhe me përfundimin e njëmijë viteve.

Kur të liqtë do të ngrihen përsëri në jetë, ata portretizohen te Zbulesa 20:13, si të ardhur nga “Hadi”. Kuptimi i fjalës “Had” është thjesht të përshkruajë banesën e të vdekurve, varrin. Kjo s’ka asnjë lidhje me ndonjë aktivitet të të vdekurit. Sipas Biblës, të gjithë që vdesin, shkojnë në “Had”, qofshin të mirë apo të këqinj. Në Dhjatën e Vjetër, fjala Hebreje që barazohet me fjalën “Had” është “Sheol”. Të dyja fjalët nënkuptojnë thjesht “varri”, ku vdiq Krishti. Edhe Ai shkoi në varrin që gjendej në “Had” (Veprat 2:7)

Përkthimet priren ta lënë fjalën, siç është “Hod” ose shpesh “varr”, kur Bibla foli për ferrin si një vend dënimi, ajo përdori fjalën “Gehenna” (Dhjata e Re greke) dhe “Hinnom” (Dhjata e Vjetër Hebreje). Fjalët rrjedhin nga “Lugina e Hinnom-it” e cila është një burim në anën jugore të Jeruzalemit. Në këtë Luginë Izraeli kreu ritin e djegies së fëmijëve të vet për Molech-un. Profeti Jeremia parashikoi se për këtë arsye Zoti mund ta bëjë këtë luginë një vend për të vrarët. Kjo i ka shtyrë Hebrenjtë ta shohin zonën si një vend të gjykimit të të liqve. Një vend dënimi dhe turpi. Tradita e mëvonshme rabinike e konsideron atë një vend për djegien e karkasave dhe mbeturinave.

Jezusi i përdor zjarret e Hinnom-it, si një përfaqësim të zjarrit të ferrit. (shiko Mateu 5:22, 18:9). D.m.th. Ai i përdor zjarret e Hinnom-it, si një simbol të zjarreve të ndezura të gjykimit të fundit, për të cilat ne sapo kemi folur te Zbulesa 20:14-15.

A digjen zjarret e ferrit në përjetësi?

Në se lexoni historinë e Zbulesës, kapitulli 20 dhe kapitulli 21, do të keni ndjesinë se Zoti i përdor zjarret e ferrit për të pastruar tokën, për të siguruar një parajsë të re në një tokë të re. Në fakt ky këndvështrim bëhet akoma edhe më i qartë te 2 Pjetri 3:10-13: “Por ditët e Zotit do të vijë si një hajdut nëpër natë, qiejt do të përshkohen nga një zhurmë e fortë e të gjithë elementët do të përzihen me një nxehtësi të madhe; si toka ashtu edhe gjithçka që gjendet në të. Derisa të gjitha gjërat të shuhen, çfarë lloj personi ju do të donit të ishit nën mirësinë dhe udhëheqjen e shenjtë, duke e kërkuar dhe duke e përshpejtuar ardhjen e ditës së Zotit, falë së cilës Qiejt do të shpërndahen, ashtu të vënë në flakë dhe të gjithë elementët do të përzihen në këtë nxehtësi të ethshme? Megjithatë, në përputhje me premtimin e Tij, ne do të jetojmë nën Qiej të Rinj dhe në një Tokë të Re në të cilën do të banojë drejtësia”. Për këtë arsye, në se zjarri i ferrit i paraprin triumfit të një Qielli dhe Toke të Re, askush s’ka pse të presë ato për t’u djegur në përjetësi.

Po në se është kështu, atëherë nga vijnë mësimet për vuajtjen e përjetëshme?

Disa që kanë lexuar Biblën i kanë marrë fjalë për fjalë, fjalët e mëposhtme (Zbulesa 14: 11).

“E tymi i vuajtjes e ankthit të tyre u ngrit lartë përgjithmonë”. Kjo shprehje është huazuar nga Dhjata e Vjetër, Isaia, 34:9-10. Përrenjtë e saj do të kthehen në katran e pluhur; toka do të shndërrohet në një katran të zjarrtë e do të vlojë natë e ditë; tymi s’do të rreshtë e do të ngjitet lart përjetë. Nga brezi në brez ai do të endet i dendur. Askush nuk do të depërtojë kurrë në të”.

Po ne mund të shtrojmë pyetjen: “Është vallë, toka e Edomit (e gjetur sot në Jordani) ende në flakë? A po ngrihet vallë ende lart tymi prej zjarreve të gjykimit? Është e qartë se termi “përgjithmonë” mund të përdoret në Bibël si një shprehje idiomatike e termit “për aq sa ata të jetojnë”. Ne duhet të tregohemi të kujdesshëm kur lexojmë Biblën, sa për të kujtuar se Bibla i përket një tjetër kulture, krejtësisht të zëvendësuar nga kultura jonë. Çdo kulturë ka shprehjet

e veta idiomatike. Ato sjellin pështjellime kuptimi për ata që u përkasin kulturave të tjera. Një shembull i mirë se si idioma mund të ndikojë kuptimin tonë, shihet në rastin, kur ne lexojmë Jude 7 për shkatërrimin e Sodomës dhe Gomorës me dënimin e “zjarrit të përjetshëm”. Mund të mendojnë vallë, se zjarret që shkatërrojnë këto dy qytete, digjen ende dhe sot?

Parimi i dënimit

Vdekja është ndëshkimi i fundit për mëkatin. Si një rezultat i mëkateve të tyre, të gjithë që refuzojnë të pranojnë Krishtin do të vdesin (Romakëve 6:23).”Se pesha e mëkateve është vdekja (jeta e përjetëshme në ferr), por dhurata e Zotit është jeta e përjetëshme te Jezu Krishti, Zoti ynë.

Është gjë e keqe që Zoti urren dhe kërkon të shkatërrojë. Kur Jezu Krishti vdiq në kryq, Ai përjetoj vdekjen e dytë për ne. Ai i mbarti mbi vete gjithë mëkatet e botës. Ai vuajti një ligështim të papërshkruar fizik dhe mendor. Nëse ne s’e pranojmë atë si zëvendësuesin tonë, atëherë duhet të përballemi vetë me vdekjen e dytë.

Bibla përshkruan një kohe ardhje kur do të ketë një qiell të ri dhe një tokë të re. Lexo zbuluesin 21 dhe 22. Vëreni 24:4 dhe Zoti do t’ua fshijë çdo lot nga sytë. S’ do të ketë më vdekje, as vuatje, as lëngesë. S’do të ketë më dhembje, se gjerat ekzistuese do të jenë zhdukur”.

A s’ mendoni se këto kushte do të jenë të pranishme e përsëri disa miliona njerëz të panjoftuar do të përdridhen në dhimbjet e torturimit të përjetshëm? A mund të ekzistojë bashkë ferri dhe parajsa? Doktrina e vuajtjes së përjetëshme është e lidhur drejtpërdrejtë me mësimin e pavdekshmërisë së shpirtit. A mëson vallë Bibla se shpirti është i pavdekshëm?

Shumë studiues të Biblës i kanë konsideruar në vite mësimet tradicionale të ferrit, si një dëftuese e një vendi, ku njerëzit e këqinj tash digjen e vazhdojnë të digjen pa rreshtur. Është shkruar dhe një libër që trajton qasjet e këtyre studimeve të fundit. Ju mund të donit

ta lexonit atë. Ai quhet : “Zjarri që djeg e shkatërron” nga Eduard Uilliam Fuxh (Providental Press Teksas, USA). Ai na meson ato çka ne parashtruam më sipër dhe shpjegon njëherësh mos-pavdekësinë e shpirtit, një qëndrim ky që po duket të fitojë sot terren edhe në mes të studiuesve të tjerë.

29.Demonët në botën e sotme!Shpirtërat e Spiritualizmit

Demonët në botën e sotme

Magjepsja e njerëzimit me misterin e vdekjes e ka udhëhequr atë në shtigje interesante e të ngatërruara. Njeriu është i interesuar në tri gjëra rreth vetes së tij: nga ka ardhur, pse është këtu e ku do të shkojë. Çështja e fundit ka shpëthyer gjatë këtyre viteve një dëshirë të ethshme në botë për të kuptuar më shumë mbi “jetën e përtejme”. Në botën perëndimore kjo ka nxitur interesin ndaj spiritualizmit. Numri i madh i aksidenteve që shkaktojnë vdekje të shumëfishta, dy luftrat botërore me një numër të pamasë vdekjesh, i kanë dhënë një vrull të madh Spiritualizmit, i cili pohon se kontakti me këtë botë, mund të arrihet nëpërmjet të vdekurve.

Ka një numër fenomenesh të çuditshme që shoqërizojnë Spiritualizmin. Në vende të tilla si Guinea e re, ku gjenden zona në të cilat njeriu rron me një stil jete vërtet primitiv, Spiritualizmi ka arritur të ketë një kontroll të tmerrshëm mbi këta njerëz. Ka shumë pak interes për Krishtin dhe Ungjillin e Tij, e ka individë që vlerësojnë apo nderojnë djallin. Në fakt, kur njerëzit duan të pranojnë Krishtin, magjia e Spiritualizmit duhet të thyhet. Bota e perëndimit ka pranuar shumë nga mënyrat spiritualistike të Lindjes. Ka shumë gjera mbinjerëzore që ndodhin me Spiritualizmin, gjë që i udhëheq njerëzit, qofshin të krishterë ose jo, të arrijnë në përfundimin se këto janë gjëra të Zotit.

Spiritualizmi modern e ka zanafillën në botën perëndimore më 1848. Shtëpia e familjes Foks në Hydesville, Nju Jork, pushtohej

vazhdimisht nga zhurma të të çuditshme të dëgjuara veçanërisht nga dy motrat, Ketj dhe Margarita. Këto vajza zbuluan se ato ishin mesazhe të dërguara në formë kodi dhe prej “frymës” ose “shpirtit” të një njeriu të vdekur. Shumë gjëra të pazakonta ndodhën, për të bindur familjen në autenticitetin e këtij fenomeni, e shpejt ligjëratat dhe demonstrime të ndryshme u kryen nga motrat për njerëzit fqinjë me to. Qarqe spiritualiste u formuan dhe brenda 30 vitesh, spiritualistët numëroheshin me miliona.

Shumë vite më vonë, Margarita deklaroi më 24 shtator 1888 në “Nju York Herald” se ajo kishte gënjyer tërësisht në lidhje me Spiritualizmin. Përpara vdekjes së saj tragjike, burri i vet Dr. Elisha Kane, eksplorator i Artikut, iu lut të dorëzohej. Pasi u kthye në Europë, më 1888, ajo deklaroi: “Unë e shoh Spiritualizmin si një nga mallkimet më të mëdha që bota ka njohur ndonjëherë...”. Gjithsesi, ajo iu kthye atij përsëri dhe vdiq e alkoolizuar më 1893. Motra e saj Ketj kishte vdekur një vit më parë në po të njëjtat kushte.

Për vite me radhë, forma më popullore e Spiritualizmit ishte seanca. Drita të dobëta, duar të palosura, e pas kësaj manifestimi i shpirtit. Ngandonjëherë instrumente muzikore luajnë ose lëvizin në mënyrë të padukshme, ngandonjëherë flasin zëra shpirtrash dhe objektet lëvizin nën fuqinë e shpirtrave. Shpesh shpirti mund t’i ngjajë formës së një personi që ka vdekur. Njerëzit të spikatur në problemet njerezore flasin për Spiritualizmin në terma të favorshme. Këtu mund të përfshijmë Sër Oliver Lodge, Sër Arthur Conan Doyle, sër Uilljam Crooks dhe Lord Dowding.

Në vitet e para Spiritualizmi arriti të pushtojë shumë shtëpi dhe kisha të krishtera. Ai u bë popullor duke përdorur një qasje të fortë të krishterë. Kjo bëri që ai të mendohej si një sistem i keq, i cili mund të paraqitej me një praktikë më të pranueshme. Është fakt që Spiritualizmi i mëvonshëm u keqkuptua, e ashtu si në fushat e tjera të mendimit dhe praktikës ndodhi që ne arritëm të rehatojmë një tjetër të keqe brenda kishës së krishterë?

Përmenden edhe tatuazhet te Levitiku 19:28, NKJV. Te K.J.V. fjala tattoos do të thotë vizatim (pikturim), edhe pse tatuazh është një përkthim më i mirë. Një vështirësi i rastësishëm te njerëzit me tatuazh i zhvillon dragonjtë dhe gjarpërinjtë si më popullorët. Shumë të tjerë kanë tatuazhet e Satanait në forma të ndryshme. Kisha e Satanait dhe Darkizmi janë bërë shumë popullore, dhe të gjitha janë një formë e Spiritualizmit.

Bota u magjeps me librat dhe filmat e Harri Poterit. Harri ishte një magjistar. Edhe pse shumë njerëz këto gjëra mund t'i mendojnë si të padëmshme, gjithsesi, Satanai njihet si ndërhyrës në çështjet e magjisë. Hallouini me gjithë shtrigat e tij, është një festë që vjen drejtpërdrejt nga paganizmi në Irlandë dhe Britani, e prej andej në Amerikë. Ka dy metoda për ta ndërfutur spiritualizmin në shoqërinë tonë moderne. Shumë lojrash kompjuterike kanë të bëjnë me dragonj, monstra e magjistarë që ndihmojnë të rinjtë për të hapur dyert e okultizmit modern.

Prova e Spiritualizmit ka të bëjë me faktin nëse ai është apo jo në harmoni me fjalën e Zotit. A ka Zoti diçka për të thënë rreth Spiritualizmit? Profeti Isaia deklaroi se “kur t’ju thonë të këshilloheni me mjedise e fantazma plot me murmurime gati të pazëshme, pyetini ata pse vallë duhet të këshillohen të vdekurit për interes të të gjallëve? Konsultohuni më mirë me këshillat dhe mesazhet e Zotit” (Isaia 8:19). Është e qartë, kur dikush këshillohet me të vdekurit, kjo është e kundërta e këshillimit me Zotin. Teksti tjetër përmend mënyrën se si duhet kërkuar Zoti; “Për Ligjin dhe për Dëshminë”. Nëse ata s’flasin në pajtueshmëri me këtë fjalë (Biblën), kjo ndodhi se s’ka ende dritë mbi ta” (vargu 20). Shkrimet janë të qarta për faktin se të vdekurit nuk mund të kthehen përsëri në këtë jetë. “Kur të kalojnë disa vjet atëherë unë do të shkoj në mënyrë që të mos kthehem më...” (Jobi 16:22). “Syri i atij që më ka parë, s’do të më shohë më ...Ai s’do të kthehet më në shtëpinë e tij e as vendi i vet s’do ta njohë më” (Jobi, 7:8-10). “Por tani ai është i vdekur, pse duhet të shpejtohem vallë? A mund ta sjell përsëri në jetë? Unë do të

shkojë te ai, por ai s'do të kthehet më te unë!” (2 Samuel 12:23). Këto janë pohime shumë të qarta në lidhje me faktin që të vdekurit nuk mund të kthehen e të komunikojnë me ne në këtë jetë.

Zoti i paralajmëroi solemnisht njerëzit e Tij në lidhje me konsultimin e shpirtërave. “Mos shkoni te një medium ose magjistar, mos e ulni kurrë veten duke u konsultuar me ta”. (Levitiku 19:31). Sipas këtij teksti Spiritualizmi e përul një person. Vëreni një tekst tjetër : “Çdo personi që konsulton një medium ose magjistar, duke më braktisur mua për ta, unë do t'i vendos fytyrën time përballë e do ta bëj të jashtëligjshëm” (Levitiku 20:27). Në një formë lehtësisht të ndryshme Spiritualizmi modern është i njëjtë me formën antike të shtrigërive, dhe si e tillë është i dënuar nga Zoti. Vëreni se si e parashikojnë këtë gjë Spiritualistët. “Aspektet fenomenale të Spiritualizmit modern riprodhojnë të gjitha parimet thelbësore të zanatit të magjisë dhe shtrigërisë të së shkuarës. Janë të përfshira të njëjtat fuqi dhe vepra e vepron po e njëjta inteligjencë”. (Okultizmi praktik fq. 8 F. F. Morse). “Gjëja në vetvete në një formë ose në një tjetër është e vjetër sa historia”. (“Mesazhi jetësor”, Sër Artur Conan Doyle, fq. 30).

Po cilët janë atëherë shpirtat e Spiritualizmit? Zoti na tregoi se shpirtërat janë engjëjt. “Ai i bëri shpirta engjëjt e Tij”, (Psalmet, 104 .4). A s'janë vallë të gjithë engjëjt shpirta shërbestarë të dërguar, t'u shërbejnë atyre që do të jenë të huajturit e shpëtimit” (Hebrenjtë 1: 14). Njeriu në vdekje nuk bëhet një engjëll ose një shpirt. Njeriu u krijua në një shkallë paksa më të ulët se engjëjt. (Psalmet 8:5). Engjëjt ekzistojnë shumë kohë më parë se sa të krijohet njeriu. (Gjeneza 3:22-24). Gjithsesi ka dy klasa engjëjsh: Engjëjt e Zotit dhe engjëjt që u rrëzuan. Zoti e quan grupin e dytë “shpirtëra të përlyer”. (Marku 5-9). Ka edhe engjëj që nuk e mbajnë banesën e tyre të parë, por e lënë atë dhe për këtë arsye u rezervohet në errësirë gjykimi i ditës së madhe (Juda 6). Këta engjëj u rebeluan me Luçiferin në fillim dhe u dëbuan nga qielli. “Se Zoti as i largoi apo i ndau engjëjt që mëkatuan, por i dëboi ata në ferr dhe i shpërndau nëpër zinxhirët e errësirës,

për t'iu rezervuar një gjykim"... (2 Pjetri 2:4). "Për këtë arsye pati luftë në qiell... dhe Dragoi i madh u dëbua, ai gjarpër plak i quajtur Djall dhe Satana...u dëbua në tokë, duke bërë që të dëbohen edhe engjëjt e tij". (Zbulesa 12:7-10). Këta engjëj të rrëzuar nuk mund të ringrihen, sepse prova e lirit të tyre përfundoi, kur u dëbuan e ata tani presin asgjësimin e tyre tërësor në kohën e gjykimit të fundit. Ndërkaq ata janë në luftë me njerëzimin, duke pasur Satanain si udhëheqësin e tyre. Pali e përshkroi kështu: "Se ne nuk përleshemi kundra mishit dhe gjakut, por kundra gjërave thelbësore, kundra fuqive, kundra sundimtarëve të errësirës së kësaj bote, kundra shpirtërave të këqinj në vendin e parajsave. (Efesianëve, 6:12). Këta shpirtëra të këqinj nuk duan që njeriu të shpëtojë dhe përdorin çdo dredhi e strategji t'i shkaktojnë njeriut humbjen.

Me përshkrimin e Sër Artur Conan Doyle mbi shpirtërat, ai e përshëndeti Spiritualizmin si një revolucion të ri, por pranon se është i pabazë. Paskësaj deklaroi: "Po përtej të gjitha këtyre limiteve, ne jemi krejtësisht të palumtur të kemi marrëdhënie me një person absolutisht gjak-ftohur që rri në anën e të keqit, ose të një inteligjence të keqkuptuar. Kushdo që e ka hulumtuar këtë fushë mendoj se është ndeshur me mendime të vullnetshme që përzihen rastësisht me komunikimin e mirë e të vërtetë. Nuk ka gjë më të ngatërruar se sa fakti që dikush të mund të bëjë një përshkrim të gjatë e të lidhur me subjekte, me detaje të hollësishme, e paskësaj kjo të provohet të jetë plotësisht një gjepur" (Zbulesa e re fq 22). Ky është një rrëfim se të paktën disa nga këta shpirtëra janë të këqinj. Natyrisht që Spiritualistët do të pohonin se ka shpirtëra të mirë e të këqinj. Vëreni këtë pasazh : "Shpirtërat më të ulët kërkojnë të zhbëjnë punët e mira të atyre që janë më lart, për ti dëmtuar dhe mërëzitur... Ata duan të na mashtrojnë veç për t'u zbavitur, por shpirtërat e mençur që janë për ne zhvëlluesit dhe ekzekutuesit e vullnetit hyjnor, na mashtrojnë sipas një plani të caktuar për të mirën tonë". ("Ndalimi i dritës", 26 tetor 1864). Mund të shihet nga ky pasazh se edhe të ashtuquajturit shpirtëra të mirë mashtrojnë. Ndaj le të kujtojmë se

disa prej gjërave të mira të thëna për shpirtërat janë të vërteta. Kjo ndodh se edhe shpirtërat mund të gënjejnë. Vëreni se si i përmendin Shkrimet e Shenjta këto gjëra: “Ata e përbuzin veten si apostujt e Krishtit, ashtu si dhe Satanai e përbuz veten si engjëlli i dritës. S’është atëherë e befasishme, që edhe vetë shërbëtorët e tij e përbuzin veten si shërbëtorë të drejtësisë” (Korintasve 11:13-15). Duhet të kujtojmë këtu se Satanai i citon Shkrimet e Shenjta me qëllim që të na mashtrojë”. (Mateu 4:6). Një incident interesant zhvillohet nga Pali: “Ndërsa po shkonim të luteshim, na takoi një grua e pushtuar nga shpirti i hyjnëzimit, e cila e ndoqi Palin duke bërtitur: “Këta njerëz janë shërbëtorët e më të lartit Zot, i cili na dëfton rrugën e shpëtimit. Këtë gjë ajo e bëri për gjatë shumë ditëve. Por Pali i pikëlluar iu kthye dhe i tha shpirtit: “Unë të urdhëroj në emër të Krishtit të dalësh jashtë prej saj”. E ai doli brenda një ore”. (Veprat 16:16-18). Vëreni dhe këtë detaj: Fryma ekeqe foli të vërtetën në lidhje me Palin dhe veprën e tij. Ato ishin fjalët e bukura të Satanait, por ato u folën me qëllimin e mashtrimit. Djalli e bën këtë punë për të ngulitur në mendjet e njerëzve faktin se Spiritualizmi është i krishterë. Atëherë çfarë po ndodh?. Njerëzit janë udhëhequr të besojnë zhgënjimet e Satanait.

Zoti paralajmëron se në ditët e fundit Spiritualizmi do të shpërhapet e do të mashtrojë botën. “Tani Fryma e Shenjtë foli hapur se në ditët e mëvonshme disa do ta braktisin besimin duke u prirur kah shpirtërave joshës dhe doktrinave të djallit. (1 Timoti 4:1). Ato do t’i joshin njerëzit për të shkuar larg Zotit e Fjalës së Tij.

Shpirtërat pozicionohen si të krishterë. Ata i ndikojnë njerëzit të këndojnë himne të krishtera, ofrojnë lutje, madje lexojnë edhe Biblën, por të gjitha këto janë thjesht një maskë për t’i shpënë njerëzit në gabim. Shkrimet thonë se këto janë: “doktrinat e djallit”. “Unë pashë tre shpirtëra të papastër ... të dalin nga goja e Dragoit, nga goja e Bishës dhe nga goja e Profetit të rremë, sepse që të gjithë janë shpirtërat e Djallit që bëjnë mrekullira e që shkojnë nëpër mbretëritë e tokës dhe të gjithë botës, për t’i mbledhur ata në betejën

e asaj dite të madhe të Zotit të gjithëfuqishëm”. (Zbulesa, 16:13-14). Spiritualizmi, përmes veprës së mrekullive madhështore që është i aftë të bëjë, do t’i gënjejë të gjithë ata që nuk janë krejtësisht të Krishtit, për t’i shpënë në konfliktin përfundimtar me Zotin.

Rrëfimi i magjistares së Endorit, është një shembull klasik i Shkrimeve të Shenjta, se si shpirtërat e këqinj i çpersonalizojnë të vdekurit. Mbreti Saul kishte shkuar kundra Zotit dhe në fund arriti t’i kryejë edhe mëkatin më të pafalshëm. “Zoti s’u përgjigj as nëpërmjet ëndërrave, as nëpërmjet profetëve”. Sauli iu drejtua magjistares së Endorit, e cila ishte një mjedis shpirtërash. Sauli i tha t’i sillte Samuelin dhe predentoi që kjo të ndodhte. Mirëpo, diçka e tillë që e pamundur “sepse Zoti nuk iu përgjigj atij me anë të profetëve”. Shfaqja ishte një çpersonalizim i Samuelit, i dukur në të njëjtën formë me të, duke folur në të njëjtën mënyrë si ai. Për të zhvilluar se kjo përvojë u frymëzua nga Satanai, ne duhet të lexojmë (I Kron. 10:13-14). “Sauli vdiq për mëkatin që kishte bërë kundra fjalës së Zotit, që ai s’e mbajti e për më tepër kërkoi këshilla nga dikush që ishte familjar me shpirtërat ...” Spiritualizmi është një mashtrim i vjetër sa mëkati dhe i pranishëm si ajri që thithim. Është gënjeshtar si vetë Djalli. “Duke ofruar jetë, ai sjell vdekjen, duke ofruar dritë, ai sjellë errësirën, duke ofruar ngazëllimin, ai sjell dekadencën, duke ofruar miqësinë e Zotit, sjell ndarjen”. (Dr. L. E. Froom).

Engjëjt e Zotit janë duke iu shërbyer shpirtërave tanë sot, ashtu siç kanë bërë edhe më parë. Lërimi t’ju udhëheqin në rrugën e Zotit kah një dijeje më të madhe të së vërtetës së Tij.

30 . Shenja e Biblës dhe numri 666

Pasi kisha vizituar një mumër vendesh, disa vite më parë, po vizitoja Kaliforninë dhe po bisedoja me disa miq që qenë të rinj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Njeri nga planet e mia ishte të blija një

komplet darke, sa më të fortë, si ai që sapo qe hedhur në treg asokohe. Jetonim në Zelandën e Re dhe të blije diçka të tillë ishte e pamundur. Kur ua shpjegova miqve të mi, se ç'po kërkoja, ata nisën të kontrollonin katalogët e disa bizneseve, e gjetën imazhe të komplekseve dhe modeleve që besoja se gruaja ime do t'i pëlqente. Në një ditë të nxehtë ndalua në parkingun e një qendre të madhe dhe shkuam për në holl. Ishte lehtësuese të ndjeje ajrin e komdicionuar, ndaj ne vazhduam në holl drejt një dyqani të madh. Dëgjuam një zë të thoshte : “Ku janë kartat tuaja”? Nuk i dhamë rëndësi, se kishim para me vete, e nuk përdornim karta krediti. Por zëri u bë më i mprehtë: “Ku janë kartat tuaja”? U kthyem të shihnim se kujt po i drejtohej zëri, por pamë se ishim vetëm ne. Shkuam në banak dhe zonja na tha përsëri: “Ku janë kartat tuaja”? Çfarë kartash krediti kërkon”?-pyetëm. Ajo tha : “Ju duhet të keni karta krediti për të blerë këtu”. I shpjegova se isha nga Zelanda e Re dhe dëshiroja të blija me para në dorë një komplet darke të cilin e kisha konsultuar nëpër kataloge. Ajo na shpjegoi se nuk mund të hynim në dyqan pa karta krediti. Na tha se kjo do të kushtonte 5 \$. I zgjata 5 \$, mirëpo ajo më shpjegoi se kartën nuk mund ta merrja në më pak se një javë e problemi im ishte se unë do të isha në Zelandën e Re, në atë kohë. “Pse vallë një javë”? - e pyeta. Nevojitet të kontrollojmë mbi ju dhe në se gjithshka është në rregull, do t'ua dërgojmë kartën. Përfundimisht, s' mundëm të blejmë në atë dyqan.

Atëherë m'u kujtua ndërsa po shkonim në makinë në atë ditë të nxehtë, një tekst i Zbulesës 13:16-18: “Ai do t'i ndikojë të gjithë, të madh e të vegjël, të pasur e të varfër, të lirë e skllevër, që të marrin një shenjë në krahun e tyre të djathtë, ose në ballë, që askush mos të blejë apo të shesë, përveç atyre që kanë shenjën ose emrin e bishës, ose numrin e emrit të tij. Kjo është mënjëria. Lejojeni atë që e ka kuptuar përlllogaritjen e numrit të bishës, se ai është numri i një njeriu: ky numër është 666”. A mundet që vetë Zbulesa të qe përmbushur përpara syve të mi? Kjo mund të kish ndodhur nga mënyrat e ndalimit të atyre që nuk kanë shenjë, emër ose numër të

kishës, për të blerë apo shitur. Pasi ne nuk gjetëm dot ndonjë tjetër dyqan, për të blerë një tjetër komplet (ose model të ndryshëm) pjatash, ashtu siç i dëshironim.

Kjo profeci e tmerrshme lidhet me kohën që pritet të vijë edhe një herë përpara ardhjes së dytë të Krishtit. Bota është sot në pozitën më të mirë për të forcuar këtë parashikim, se sa kurrë më parë. Në botën Perëndimore ne keni hyrë në një epokë “high tech” (të teknologjisë së lartë) të kartave të kreditit, chip-eve, kompjuterizimit, bankave elektronike, wireless, etj, kështu që do të ishte e mundshme që ky parashikim i zbuluesit të mund të përmbushej brenda një nate. Shumë kombe mund të pëlqejnë të zhvendosen kah një shoqërie “pa para në dorë”, e cila do të reduktojë numrin e grabitësve të bankave, qendrave të mëdha, hajdutëve të xhepeve, e formave të tjera të krimeve të vjedhjeve të parave. Sidoqoftë një shoqëri “pa para në dorë”, do të që akoma më e hapur për abuzimin e folur në tekstin e mësipërm.

Ka një seri të kundërtash ne Shkrimet e Shenjta:

E vërteta dhe gabimi/Jeruzalemi dhe Babilonia.

Thjeshtësia dhe hipokrizia.

Engjëjt dhe Bishat.

Vula e Zotit dhe Shenja e Biblës.

Është ky kombinim i fundit të kundërtash që ne do të donim të diskutonim tani.

Bisha e Zbulesës 13

Ekzistojnë dy bisha, njëra që vjen nga deti dhe njëra që del nga toka. Deti përfaqëson kombet, gjuhët dhe njerëzit (Zbulesa, 17:15). Atëherë ai më tha: “Ujërat që ju patë, ku qendrojnë prostitutat, janë njerëzit, kombet dhe gjuhët”. Kështu, e dalë prej kombeve të stabilizuara, është fuqia e bishës së parë, e cila padyshim njihet si fuqia që pasoi Romën Pagane: Roma Papnore. Është një bishë e

përbërë që ka karakteristikat e fuqive të përmendura te Danieli 7, dmth të luanit, ariut, leopardit dhe fuqive të marra nga Dragoi, Satanai i Zbulesës 12. Ajo do të qeverisë gjithashtu për 1260 vjet, njëlloj si bisha e bririt të vogël të Danielit 7. Ajo sulmoi Shenjtët e Zotit që vlerësonin Jezusin, qingjin e lidhur pas themelit të botës (Zbulesa 13:8).

Fuqia e bishës së dytë vjen prej zonave të pabanuara të quajtura tokë, te Zbulesa 13:11. Këto mund të jenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse kjo bishë ka dy brirë pa kurorë. Disa e përngjasojnë atë me një bizont dhe duke qenë një fuqi, qeveriset nga partitë Republikane dhe Demokratike. Ajo vjen nga vendi ku kërkohej ndërkaq vlerësimi dhe nderimi, ashtu siç bëri bisha e parë kur krijoi kështu imazhin e vet. Ndërsa kushtetuta amerikane u formua e tillë që të mbante të ndarë kishën dhe shtetin, duket qartë se Shtetet e Bashkuara i kanë kaluar caqet duke i hequr lutjet në shkollat shtetërore dhe duke mos i lejuar 10 urdhërimet të shfaqen në ndërtesat e gjykatave qeveritare, aty ku kishin qenë më shumë se dy shekuj në disa raste.

Vula e Zotit

Vula e Zotit është e kundërta e shenjës së bishës. Do të ndodhë nën këtë vulë të Zotit, përjetimi i disa prej problemeve përfundimtare të tokës. Te Zbulesa 7:1-3, ne vërejtëm që engjëjt e Zotit do të mbartin mbi shpinë erërat e mundimit dhe sflitjes derisa njerëzit e Zotit të “vulosen” në ballët e tyre. Pohimi i këtij pasazhi gjendet në kapitullin e mëparshëm. Krishti po vjen me lavdi, fuqi dhe madhësi. Të gjithë njerëzit do ta dëshmojnë këtë ngjarje klimatike dhe shumë të tjerë do të shihen të vajtojnë për t’u hedhur nga shkëmbinjtë e për t’u fshehur prej fytyrës së Qingjit. Vetëm ata që do të marrin vulën e Zotit, do të shpëtohen.

Po kur do të ndodhë vallë, kjo gjë? Pikërisht në ditët e fundit të historisë sonë në tokë. Zoti dëshiron që njerëzit të bëhen gati për t’u takuar me Të. Po, përse vallë, teksti thotë se njerëzit e Tij do të

vulosen në ballë? Vulat kanë mveshur për mijëra vjeçarë autorësinë, pronësinë dhe autoritetin. Ato kanë siguruar thesarë, kuti, varre, dokumente dhe çertifikata, përgjatë kohëve të ndryshme. Profetët përdorën gjuhën e njerëzve, kështu që nuk duket e çuditshme që vetë Zoti zhvillon, se edhe Ai ka një vulë. “Vulose ligjin mes dishepujve të mi” (Isai , 8:16). “Vendos një shenjë në ballin e njerëzve” (Ezekieli 9:2-6). Atëherë ekziston edhe vula e Shpirtit të Shenjtë (2 Korintasve 1:22 dhe Efes 1:23). Vula e Atit është mbi Krishtin (Gjoni, 6:27).

Vula te Zbulesa është miratimi ose bekimi i Zotit. Ajo përfaqëson gjithashtu ngjashmërinë e karakterit të Krishtit si të gjetur në numrin simbolik 144.000 te Zbulesa 7 dhe 14.

Vulat janë domethënëse në tre aspekte. Ato tregojnë:

- 1 . Emrin e autoritetit prapa vulës.
- 2 . Titullin e këtij autoriteti.
- 3 . Sundimin ose territorin që mbulon ky autoritet.

Unë mbaj mend të isha i pranishëm në Kongresin e Parë Botëror të lirisë fetare në Amsterdam, kur mbërriti një mesazh nga Presidenti i Liberisë. Ishte një zarf i mbyllur dhe i vulosur me vulën presidenciale. Ai u hap përpara të gjithë delegatëve në Kongres. Vula përmbante emrin e Presidentit, titullin e tij dhe të vendit të tij.

Në muzeumet përreth botës, shihen zakonisht vulat e mbretërve dhe sundimtarëve të ndryshëm. Në muzeun Pergamum në Berlin, Gjermani, mund të shihen vulat e Nabukadonosorit dhe sundimtarëve të tjerë Babilonas. Në muzeun Britanik gjenden vulat e mbretërve Britanikë. Asnjë ligj qeveritar nuk është i vlefshëm, pa vulën e mëkëmbësit, qeverisësit apo të Presidentit.

Po cila është vula e Zotit? Mund të presim ta gjejmë atë të lidhur me Ligjin e Tij te 10 urdhërimeve. I vetmi nga këto urdhërime, që i përmban të tre elementët e një vule gjendet në zemrën e tërë ligjit, në urdhërimin e katërt.

- 1 . Emri - Zotit (YHWH)
- 2 . Titulli – krijuesi
- 3 . Territori – qiejt, toka e gjithçka që gjenden në to.

Ashtu siç lexova njëherë : “Në zemrën e botës gjendet Toka e Shenjtë; në zemrën e tokës së Shenjtë gjendet Jeruzalemi; në zemrën e Jeruzalemit ishte Shenjtorja dhe në zemrën e Shenjtores ishte Arka e Besëlidhjes; në zemër të Arkës ishte Ligji i Zotit; në zemrën e Ligjit të Zotit gjendet urdhërimi i ruajtjes së ditës së shtatë të Sabatit; dhe në zemrën e ditës së shtatë të Sabatit, gjendet vula e Zotit të gjallë”. Ju mund të pyesni : “Pse gjendet vula në urdhërimin e Sabatit”?

- 1 . Është i vetmi që na sjell ndër mend fuqinë krijuese të Zotit.
- 2 . Është shenja e shpëtimit për njerëzit e Tij speciale të të gjitha kohërave, (shpëtimi është aftësia për të sjellë mbrapsht).

Siç thotë Justin Edvards : “Sikur të gjithë njerëzit të kishin ruajtur Sabatin, të gjithë do ta kishin njohur Zotin Perëndi dhe do ta nderonin Atë, që prej krijimit, deri në kohën e sotme, idhujtaria s’do të ish praktikuar më kurrë në tokë”.

Kur njerëzit harrojnë ditën që Zoti ua kërkoi ta kujtojnë, ose kur njeriu e ndryshon ditën e nderimeve, kjo është një fitore e Satanait. Ai sfidon krijuesin, krijuesin e tij, Zotin dhe dritën e Tij. Te Eksodi, 31:13, Sabati duhet të ishte një shenjë midis Zotit dhe njerëzve të Tij. Në këtë tokë që po i afrohet fundit të vet, Sabati do të jetë përsëri një shenjë. Ajo është një shenjë e hirësisë - hirësisë së Zotit. Pika më e fortë në favor të Sabatit është se i kuptuar vërtetësisht, ai zhvillon veprimin e hirësisë së Zotit në jetën individuale të një të krishteri. Te Ezekieli 20:12 Sabati është një shenjë e shenjtërimit. Ai është një vepër e hirësisë së Zotit. Zoti na vulosi dhe na shenjtifikoi (2 Korintasve, 1:21-22). Në ditët e fundit Zoti dëshiroi të vulosej me vulën e vet. Kjo vulë, në Sabatin e Tij, mund të gjendet vetëm në

ballë (jo në dorën e djathtë). Zoti dëshiroi që kjo hirësi e Tij të pranohej në mënyrë inteligjente me gjithë zemër, mendje dhe shpirt. Në kundërshti me vulën e Zotit është shenja e bishës, e cila mund të gjendet në mendje ose në dorën e djathtë. Shumë njerëz shkojnë bashkë me turmën dhe ndjekin bishën, edhe pse ata nuk i kanë pranuar të gjitha veprimet e bishës.

Në kapitullin e mëparshëm "Beteja për të vërtetën", Danieli 7, ne treguam të vërtetën e shkrimeve mbi bishën, identitetin dhe disa prej veprave të saj. Perandoria e kësaj bishe persekutoi njerëzit e Zotit, ndryshoi ligjt e Zotit, qeverisi për 1260 vjet, blasfemoi Zotin, e do të vazhdojë të qeverisë deri sa të vijë Krishti. Shumë aspekte të Danielit 7 përsëriten te Zbulesa 13. Kjo fuqi që mendohet të ketë ndryshuar ligjin e Zotit, identifikohet me Papatin. Ajo u dihmua nga Perandorët e Romës, Konstantini dhe Justiniani në arritjen e këtyre ndryshimeve. Ndryshimi specifik i ditës së Sabatit, nga dita e shtatë e javës në ditën e parë të javës quhet vula e bishës. Vëreni: "E diela është shenja e jonë e autoritetit ... Kisha është mbi Biblën dhe ky transferim i ditës së ruajtjes së Sabatit është prova e këtij fakti" ("Catholic Record", 1 Shtator 1923) .

Vëreni gjithashtu një tjetër citim nga një katekizëm katolik: Pyetje : Si e provoni që kisha ka fuqinë të urdhërojë festimet dhe ditët e Shenjta?

Përgjigje: "Pikërisht, nëpërmjet aktit të ndryshimit të Sabatit në ditën e dielë, ashtu siç e lejonjë protestantët; për këtë arsye ata e kontradiktojnë vetveten fortësisht nëpërmjet ruajtjes në mënyrë strikte të së dielës së pushimit dhe thyerjes së shumë festimeve të tjera të urdhëruara nga e njëjta kishë".

Pyetje : A keni ju rrugë tjetër për të provuar se kisha ka fuqinë të institujë festivale të normave apo porosive?

Përgjigje : Sikur ajo të mos ishte një fuqi e tillë, do të kish mundur të zëvendësonte mbajtjen e së dielës, si ditën e parë të javës, me mbajtjen e së shtunës si ditën e shtatë, një ndryshim ky që nuk kishte

autoritetin e Shkrimeve të Shenjta. (Një shkurtesë e doktrinës së krishterë, fq 58).

E diela është vërtet shenja e epërsisë fetare papnore. Ajo i sfidoi Protestantët mbi faktin e ndryshimit të ditës dhe pyet, përse vallë, Protestantët nuk i ndjekin ata në çështjen e tyre. Një pikëpyetje e madhe, nuk mendoni?

Zoti dëshiron që vula e Tij të qe në ballë të njerëzve të vet. Sot me miliona njerëz po ndjekin Fjalën e Tij. Ai po mbart mbi vete errërat e sflitjes, të konfliktit përfundimtar, në mënyrë që njerëzit e Tij të mund të vulosen. Ai nuk i shtrëngon njerëzit të vijnë në mbretërinë e vet, por as edhe i fton ata të jenë me Të.

Miku im, i dashur lexues, pranoje planin që Zoti ka për ty. Pse nuk del përpara dhe i shërben Atij me të gjithë fuqinë e zemrës që meriton, e ta lini Atë të mbretërojë suprem në jetën tuaj? Rruga alternative është të marrim shenjën e bishës dhe ndarjen e përjetshme me Zotin. Me vuajtjen aq të gjatë të Zotit dhe ringjalljen e Tij të madhe, nuk ka asnjë arsye pse ndokush të kërkonte një tjetër alternativë dhe të dëshmonte të ndahej përjetësisht nga Krishti. Ju lutem, lëreni Krishtin të marrë kontrollin e plotë të jetës suaj dhe merrni vulën e Zotit të gjallë.

31. Origjina e çuditshme e Krishtlindjeve, Pashkëve të mëdha dhe Pashkëve të vogla

Në vitin 1644, Oliver Kromuell nxori një dekret në Angli që ndalonte kremtimin e Krishtlindjeve më 25 dhjetor. Martin Luteri, një vit më parë u përpoq ta shfuqizonte datën 25 si ditën e ditëlindjes së Krishtit, por një gjë e tillë s'ndodhi kurrë. Pse vallë, këto përpjekje për të hequr nga historia një ditë të tillë kaq të shquar? Mos ajo nuk është vërtet ditëlindja e Zotiti tonë?

Mund të befasojë shumë njerëz fakti se krishtlindjet nuk janë me origjinë ose autoritet hyjnor, as nuk zënë vend në Dhjatën e Re. Shkrimet e Shenjta heshtin në lidhje me datën e lindjes së Zotit tonë. Emri vjen nga termi “mesha e krishtit“, e cila u shndërrua në një institucion Papnor. Ajo kremtohej nga disa të krishterë, që në shekullin e tretë, pas Krishtit. Gjithësesi, në vitet afër kohës së Krishtit, ditëlindja e tij nuk u kremtua në datën 25 dhjetor.

Përlllogaritjet e Biblës për lindjen e Krishtit dhe ngjarjet që lidhen me të, tregojnë se bëhet fjalë për një tjetër periudhë të vitit, dhe jo 25 dhjetorin, ditën që duhet të dëshmojë hyrja e Jezusit në botë. Vëreni disa tekste të ndryshme: Mateu 2:1-2: “Kur Jezusi lindi ne Bethalem të Judeas, në ditët e mbretit Herod, erdhën njerëz të mençur që prej lindjes së Jeruzalemit duke thënë: “Ku është ai që ka lindur si Mbret i Hebrenjve? Ne kundruam yllin e tij në lindje dhe erdhëm ta përshëndesni”. Edhe vetë Qielli e lajmëroi këtë ngjarje, kështu që ”njerëzit e mençur” të lindjes kërkuan ta përshëndesin Zotin. Luka 2:8: “E do të ketë në po atë vend barinj që flenë nëpër fusha për të ruajtur natën bagëtisë e tyre”. Pra, ka njerëz që rrinë jashtë nëpër fusha për të ruajtur tufat, në një kohë që kjo nuk është diçka e zakonit në Bethlehem në kohë dimri. Barinjtë i mbyllin delet natën, pasi bie borë në atë kohë të vitit. Në pjesën e parë të këtij libri ne jemi njohur me dekretin e Augustit për taksimin e të gjithë botës. Në kohën e lindjes së Krishtit, Jozefi dhe Maria përshkuan gjithë atë rrugë nga Nazareti në Bethalem për t’u rregjistruar dhe për të paguar taksat. Asnjë perandor s’do të mund të mblidhte masivisht taksa në dimër, kur njerëzit do të kishin arsye të vlefshme për të mos udhëtuar drejt vendit të tyre të lindjes.

Janë caktuar rreth 100 data të ndryshme për ditëlindjen aktuale të Krishtit dhe të paktën 14 prej tyre kremtohen çdo vit në Bethlehem, por ne mund të jemi të sigurtë se data korrekte nuk është 25 dhjetori, ashtu siç e dëfton edhe dëshmia e më poshtme:

Është e rëndësishme të vërehet se kjo datë, 25 dhjetori, është kremtuar në Hemisferën Veriore për shekuj, dhe në disa vende

përpara Krishtit. Kur njerëzit u kthyen kundra Zotit në vitet që vijuan përmbytjen mbarë-botërore të ditëve të Noe-së. Ata iu drejtuan diellit, si burim i dritës, ngrohtësisë dhe ushqimit, por edhe si një objekt special nderimi. Dielli u bë objekti i frikës së tmerrshme dhe respektit të madh për miliona njerëz. Ndërsa shfaqeshin netët e ftohta, bryma dhe akulli nëpër shumë zona, njerëzit frikësoheshin se Dielli mund të mos dilte përsëri. Pastaj ata shihnin se pak ditë më vonë ai ngjitej gjithnjë e më lart në horizont. Pra, "Zoti i Diellit kish rilindur edhe njëherë, e ditët qenë bërë më të ngrohta e më të gjata. Për këtë arsye Egjiptianët dhe Babilonasit antikë e shumë zotanderues, e ndjenin ditën e lindjes së Zotit të Diellit si të ndodhur menjëherë pas ditës më të shkurtër të vitit, datës 21 dhjetor, për ta caktuar këtë ditëlindje më 25 dhjetor. Enciklopedia Britanike, botim i 11-të, vëllimi 13-të, faqja 622-624, mbi Krishtlindjet thotë: "25 dhjetori u kremtua si dita e lindjes së Zotit antik të Diellit, Mithras", besimi i të cilit ishte rival me Krishtërimin përgjatë shekujve të hershëm kristianë.

Zanafilla 10:8: "E Cush-i kundër Nimrod-it" (vargu 9). "Ai ishte një gjahtar madhështor përpara Zotit". Disa përkthime thonë: "Ai ishte një gjahtar madhështor kundra Zotit". Emri i tij nënkupton "rebelim" çka do të thotë që ai ishte vërtet kundra zotit të Qiejve. Vargu 10 thotë se fillesa e mbretërisë së tij ishte Babeli. Nimrodi ndërtoi një sistem të kundërt dhe fals nderimi nga ai që Zoti kishte vendosur të ndiqej nga njerëzit. Shem nënkuptonte të vërtetën e Zotit, por Nimrodi u rebelua kundra Zotit. Ai u bë një rebel tmerrësisht i devotshëm, duke projektuar dhe ngritur Kullën e Babelit dhe duke e nderuar atë. Kjo kullë u ndërtua për qëllime fetare, për të dëftyer një mbrojtje kundra Besëlidhjes së Zotit, në mënyrë që Ai të mos e shkatërronte më gjithë tokën me një përmbytje mbarë-botërore.

Nderimi fals filloi me nderimin e diellit, kur në Babel njerëzit u mblodhën së bashku në një qytet me një kullë që lartësohej kah qiellit, kah qiellit të diellit. Nuk ishte plani i Zotit që njerëzit të

mbledheshin nëpër qytete, ku e keqja mund të shpërhapej në përmasa ekstreme. Korrupsioni ka qënë gjithmonë më i madh nëpër qytete. Babeli u kthye në fillesën reale të idhujtarisë post-përmytjes. Ligësia e kësaj periudhe dhe e kohëve të mëvonshme shënohet te Psalmi, 106:35-38: “Ata u përzierën me egjëren dhe mësuan të vepronin”. E nisën t’u shërbenin idhujve të tyre që qenë si gjarpërinj. Po, vërtet, ata i sakrifikonin edhe bijtë e bijat e tyre për djajtë, duke derdhur gjak të pafajshëm, madje dhe gjakun e bijëve dhe bijave të tyre, që ia sakrifikuan idhujve të Canan-it: e toka u pllengos me gjak”.

Pas vdekjes së Nimrodit, mbretëresha e tij Semiramida (e quajtur ndryshe Ishtar) vazhdoi me format false të nderimit. Nën mbretërimin e saj famëkeq, “misteret” e nderimit të diellit u zhvilluan akoma edhe më shumë. Këto rite sekrete vlerësimi ishin një “mbulesë” për imoralitetin. Ajo thërriste e nderonte shpirtin e Nimrodit që ngjitej për te Dielli. Kjo i dha më shumë fuqi e impuls “nderimit të diellit”. Njerëzit udhëhiqeshin ta nderonin Diellin si jetëdhënësin e madh, autorin e frutshmërisë dhe ripodhimit tokësor. Nderimi për Diellin, shpejt solli nderimin për seksin, e në shumë mënyra gjëra të ngjashme ndodhin edhe në ditët e sotme. Ndaj s’ ka dyshim që Zoti e deklaroi nderimin e diellit dhe çdo gjë që lidhet me të si një përçmim të Zotit (shiko Levitiku 18:25-30).

Përpara se Nimrodi dhe Semiramida të qenë martuar, ata lindën një djalë më emrin Tammuz. Kur Nimrodi u bë simboli i nderimit të Diellit, Tammuzi, natyrisht u bë djali i Zotit. Satanai, atëherë ndërftoi një Messia të rremë. Emrat e tjerë që iu dhanë Tammuzit, qenë Zoti, Ndërmjetësi, Shpëtimtari, Zoti i Besëlidhjes. Këta emra në të vërtetë i përkisnin Jezu Krishtit, Messias së vërtetë. Nga këto fakte, duket më se e natyrshme që Semiramida të bëhej “Nëna e Zotit”. Ky emër u bart edhe nga Papati në kohët më moderne.

Gërma e parë e emrit Tamuz, “T”, u bë shenja që përdorej për lutjet dhe çdo formë tjetër nderimi. Më pas, një unazë përfaqësoi këtë kryqi përfaqësonte rreth-rrotullimin e diellit. Ndoshta, nisur nga këto mendime ne mund të mendojmë më mirë, pse Satanai i frymëzoi

Hebrenjtë të kryqëzonin Krishtin, kur dimë se Paganët sakrifikonin qenie njerëzore ndaj Diellit, duke i gozhduar nëpër kryqe përgjatë lindjes së diellit. Satanai ishte “Ylli i ditës” - Luçiferi - dhe kur Krishti u gozhdua në kryq, ai shpresoi të tregojë se edhe vetë Krishti u sakrifikua për të, mirëpo Zoti e errësoi diellin në skenën e kryqëzimit. Në besimin e nderimit të Diellit, gjendet një datë speciale, 25 dhjetori. Kjo është dita e lindjes së Tammuzit dhe u shndërrua në datë që kremtohej në festime, dehje, imoralitet e gara mizore, zakoni i të cilave nuk arriti të rreshte kurrë. Shumë më përpara Krishtit Britanët e hershëm kremtonin “Ditën e Yule-s” ose Ditën e Foshnjave. Si pjesë të vlerësimit fetar, antikët përdornin një pemë dhe e zbukuronin atë me argjend, etj. Vëreni Jeremia 10:2-5: “Se zakonet e njerëzve janë të kota; për të nderuar ata presin një pemë në pyll, që kushton vetëm punën e duarve me sopatë. Pastaj ata e dekorojnë me ar e argjend, e mbërthejnë me gozhdë e me çekiç, që të mos lëviz dot”...

40 ditë para Ekuinoksit Vernal që shenjon ardhjen e pranverës, ekzistonte një periudhë kohe që i përkushtohej vajtimit dhe gëzimit. Profeti Ezekiel në kapitullin 8:13-14, zhvillon se gratë vajtonin në portën e shtëpisë së Zotit për Tammuzin. Zoti e quajti këtë gjë të pështirë. Kjo periudhë prej 40 ditësh përkoi me Pashkët e vogla dhe ishte pararendsja e 40 ditëve përpara Pashkëve, emri i të cilave vjen nga Ishtar-i i Babilonisë ose Easter siç ajo quhej në gjuhën e vjetër Anglo-Saksone.

Ishtar u bë e njohur si Hyjnesha e Pranverës ose e Pjellshmërisë, e ngjajshme me Venusin e Romakëve. Fryma e Ishtar-it ngjitej deri në hënë dhe çdo vit një festival i madh mbahej në nderim të kësaj hyjneshe. Kjo ditë e madhe festimesh u kremtua të dielën e parë të hënës së parë të plotë, pas Ekuinoksit Vernal. Kështu, hëna e parë e plotë pas 12 marsit fillon me Pashkët. Kjo është arsyeja pse Pashkët festohen në një datë të lëvizshme. Një tjetër pjesë e nderimeve e diellit, ishte nderimi i mbretëreshës së Babilonisë që ishte një përçmim ndaj Zotit”.

Jeremia 7:18: “Fëmijët mbledhnin dru dhe baballarët ndiznin zjarr, kurse gratë gatuanin kekë për mbretëreshën e qiejve, duke pikuar pijet e afuara ndaj zotave të tjerë, në mënyrë që ata të mos zemëroheshin. Sendet e gjetura e kishin origjinën e tyre në Babiloni. Në fakt, në shekullin XXI, bukëpjekësit anglezë e kishin të ndaluar të vinin kryqe mbi bukë, pasi ky rit konsiderohej të qe pagan. Kjo është një tjetër mënyrë, për të mbartur kujtimin e shenjës së Tamuzit.

Vezët e Pashkëve, simbolikë e breznive të jetës dhe ardhjes së pranverës, u trashëguan prej traditave pagane. Po kështu lepujt, të njohur për riprodhimin e tyre pjellor, u përdorën gjithashtu si simbole të pjellshmërisë. Këto gjëra tradicionale vijnë të gjitha prej Babilonisë.

Shumë njerëz pyesin mbi tradita e ngrënies së peshkut të Premten dhe përgjatë Pashkëve të Vogla. Ky nuk është një zakon Babilonas, por vjen që prej vitit 1563. Industria e peshkut, e drejtuar nga kisha, po kalonte kohë të vështira, dhe traditës së ngrënies së peshkut, të Premten dhe gjatë Pashkëve, duke përjashtuar mishin, u duk se e ndihmoi këtë industri. Së fundi, ky përjashtim është hequr.

Shembujt e dhënë na ndihmojnë të kuptojmë se ne nuk mund t'i japim besim shpirtëror qëllimit zanafillor të disa gjërave që janë pranuar si pjesë e jetës së përditshme. Veprimet brenda një zone specifike, mund të mos jenë të gabuara në një nivel sipërfaqësor, duke na sugjeruar se domethënia fetare nuk mvishet te veprimi. Le të vërejmë një shembull tjetër.

Dita më e madhe e Pashkëve është e diela. Ajo është dita që u përkushtohet nderuesve lindorë të diellit. Njeri nga termat e përdorur për diellin ishte “Zot”, përderisa e diela quhet “Dita e Zotit”. Ajo s’ishte kurrë dita e Krishtit, djalit të Zotit, por ishte dita e Tammuzit, zotit të Babilonasve. Periudha kulmore ishte lindja e diellit të dielën, kur njerëzit kryenin nderime duke u drejtuar kah Lindjes. Pa dyshim edhe Zoti kishte faltoren e vet, të ndërtuar në mënyrë të tillë që gjatë nderimeve priftërinjtë dhe prifti i lartë t’i drejtoheshin perëndimit. Madje dhe te Ezekieli, 8:15-16, Zoti kujton se sa idhujtarë ia kthejnë

shpinën Tempullit të Zotit, për t'i kthyer fytyrat kah lindjes dhe për të nderuar diellin. Zoti iu dha mjaft paralajmërime njerëzve të vet, kundra praktikave të diell-nderimit. Ju duhet t'i mbani Sabatet e mi dhe t'i përuleni me respekt Shenjtërores sime, se unë jam Zoti; (Levitikius 19:16-30). Shumë nga ato gjëra që ne shkruam më sipër u bënë pjesë e rëndësishme e shoqërisë moderne. Traditat i kanë zënë vendin nderimeve fetare. Nëse njerëzit do të dëshironin të kishin një pemë krishtlindjeje dhe të vendosnin aty dhuratat në kohë të vitit, pa kryer ceremoni fetare shoqëruese, atëhere kjo mund të jetë një traditë e pranueshme për t'u vazhduar. Gjithësesi, vlera e vërtetë e dhuratës mund të jetë në dhënien e dhuratës ndaj atyre që janë me më pak fat ose pa fat fare. Do të qe diçka e mirë që kjo ditë e vitit të shndërrohej në një bekim të vërtetë e në një kohë lumturie jo vetëm për miqtë dhe familjen, por edhe për ata që kanë më shumë nevojë. Zoti na ndihmoftë që t'i vlerësojmë sa më lart urdhëresat e Tij pozitive e të mendojmë më pak për traditat që na largojnë nga plani i Tij fillestari për ne.

32 . Dhuntia e profecisë dhe rëndësia e saj

Pa dyshim që Dhuntia e Profecisë ka qënë njëra nga dhuratat më fuqimisht ndikuese dhe të thella që i është dhënë njeriut. Prania e saj ka përulur kombe dhe mbretër të mëdhenj. Ajo ka qënë më e lakmuara e të gjitha dhuratave.

Danieli i tha mbretit Nebukadnezar: “Është një zot në qiell që arrin të zhvellojë sekretet”. Më tej, Amos 3:7 : “Natyrisht që vetë Zoti nuk bën asgjë, por Ai ua zhvillon sekretet profetëve të tij shërbëtorë”.

Përmes mesazheve të profetëve, Zoti i jep korrigjim, shpresë dhe dukje të gjitha ngjarjeve që do të vijnë. Kjo, kryesorja në mes të gjithë dhuratave”, ishte parësisht një ndihmë ndaj njerëzve për t’i shpëtuar. 2 Kronikat 36:15-16. “E Zoti iu dërgoi paralajmërime, përmes lajmëtarëve të Tij duke u ngritur që herët e duke i shpërhapur kudo, sepse Ai kishte mëshirë për njerëzit e vet dhe për vendin e Tij të banimit. Por ata i shpotitën lajmëtarët e Zotit, e përçmuan Fjalën e Tij, i qesëndisën profetët, derisa zemërimi i Zotit u ngrit kundra njerëzve të vet, që ata të mos kishin asnjë shpëtim. Këto mesazhe nuk u pranuan gjithmonë”.

1.Pjetër 1:19-21: “Ne kemi gjithashtu një fjalë akoma dhe më të sigurtë profecie ... nëse pranojmë së pari, se asnjë profeci e Shkrimeve të Shenjta i përket një interpretimi privat. Sepse profecia nuk erdhi në kohët e shkuara nga vullneti i njerëzve, por njerëz të Shenjtë të Zotit folën të frymëzuar nga Fryma e Shenjtë”.

Këta njerëz të zgjedhur të Zotit u frymëzuan nga mjetet dhe mënyrat e dhëna nga Zoti. Jo të gjithë profetët shkruan Shkrime të Shenjta. Abraham, Miriam, Dobrah, Nathan dhe Huldah, së bashku me shumë të tjerë, nuk lanë shkrime për t’u trashëguar breznive të tjera. Gjithësesi, mjaft të tjerë shkruan shkrime, mesazhi i të cilave kujtohet në fjalën e Zotit.

Numrat 12:6 kujtojnë se profetëve iu dhanë prej Zotit mesazhe në formën e vizioneve. Më tej, shkrimet japin 9 teste që duhet të përdoren për të provuar vizionin e një profeti. Krishti paralajmëroi ardhjen e profetëve të rremë, ndaj dhe dha teste në Bibël për t’u përdorur mbi profetët.

Përmenden pesë teste fizike dhe katër teste morale dhe shpirtërore, që Fjala e Zotit zhvillon për profetët. Disa prej këtyre kujtohen te Danieli 10:7,8,16-19. Danieli kujton disa nga ndikimet fizike që vizionet patën mbi të.

1 . Ai humbi fuqinë e tij natyrale.

2 . Në po të njëjtën kohë frymëmarria i ndali.

3 . Atij iu dha një fuqi super natyrale.

4 . Moisiu kujton se në një vizion sytë e profetit mbetën të hapura, (Numrat 24:2-4).

5 . Pali kujton se gjatë një vizioni ai ishte i padërgjegjshëm për gjërat dhe njerëzit që e rrethonin. Vëreni 2 Korintasve 12:1-4, për këtë vizion. Ai nuk ishte i sigurtë, nëse ishte apo jo brenda apo jashtë trupit, por nuk e njohte vizionin.

Më të rëndësishme se testet fizike, janë testet morale. (1 Gjoni, 4:1-3): “...çdo shpirt (profet) që rrëfen se Jezu Krishti erdhi si njeri i gjallë është i Zotit”. Shumë të ashtuquajtur profetë, nuk e pranonin faktin se Krishti erdhi “si njeri i gjallë”. Në greqisht kjo nënkupton se Krishti jo vetëm erdhi si njeri i gjallë, por nëse është ende njeri i gjallë. Ka pasur shumë njerëz që janë shpallur profetë, e që nuk kanë pranuar të vërtetën se Shpëtimtari ynë erdhi si njeri i gjallë. Ky fakt është testi i parë moral ose shpirtëror.

Testi i dytë moral. Isaia 8:19-20: “...Nëse nuk flasin për ligjin dhe dëshminë, sipas kësaj fjale, atëherë nuk ka dritë në ta”. A besojnë vallë profetët te fjala e Zotit, si një e tërë apo veç një pjesë e saj? A e pranon ai Krijimin, Përmbytjen e Noe-s, rënien e njeriut përmes mëkatit? A beson dhe mëson ai në harmoni me profetët e Zotit që janë provuar dhe dëshmuar si të tillë? Disa, madje shpallin edhe epërsinë e profetëve antikë ndaj Zotit.

Testi i tretë moral gjendet te Ligji i Pertërirë (8:22). “Parashikimi i një profeti duhet të përmbushet”. Çdokush duhet të presë në mënyrë të arsyeshme që parashikimi i një profeti të bëhet i vërtetë. Nëse ato nuk plotësohen, atëherë profeti do të provohet si i rremë. Përmbushja e parashikimeve është një test i rëndësishëm.

Testin e katërt, vetë Krishti e dha te Mateu, 7:15-20: “Ju do t’i njihni ata prej fruteve. Padyshim që testi i një profeti duhet të gjendet

në jetën e tij. Si ai vepron apo jeton në shtëpi, dëshmia e familjarëve, miqve dhe komunitetit të vet. Jeta dhe mësimet e tyre duhet të provohen për vërtetësinë dhe qasjen e tyre profetike. Ato, pa dyshim duhet të jenë të pafaj në çdo fushë, në përvojë e në predikim. Falë tyre njerëzit duhet të ndikohen për t'u prirur kah Zotit e për të pranuar Fjalën e Udhëheqjen e Tij.

Përmes profetit të vet Gjon, Zoti zhvelloi se kisha e ditëve të Tij të fundit, do të qe një kishë urdhërim-mbrojtëse e do të zotëronte dëshminë e Jezusit (Zbulesa, 2:17). Ndaj ne mund të presim që kisha e Tij në ditët e fundit të ketë dhuntinë e profecisë. Efes 4:8, 11-13: Ligji dëshmon se Ai iu dha shpirtin njerëzve. I.Korintasve 1:4-7, pohon se kishës që do të presë për kthimin e Krishtit, nuk do t'i mungojë asnjë nga këto dhunti të dhuruara nga Shpirti. Nëse kisha e Zotit do të ketë dhuntinë e profecisë, atëherë përse vallë, nuk pati më profetë pas apostujve?

Edhe kjo pyetje e arsyeshme gjen përgjigje te Shkrimet e Shenjta. Ezekiel 7:26 thotë se: “Aty ku nuk mbahet ligji, nuk mund të ekzistojë asnjë vizion nga Zoti”. Fjalët e Urta 29:18 thonë: “Aty ku nuk ekziston asnjë vizion, njerëzit shuhen, por ai që mban ligjin e Zotit, i lumtur do të jetë”. Vajtimet 2:9 “...Ligji s'ekziston më, profetët e tij nuk provojnë më vizione prej Zotit”. Në kishën e ditëve të fundit të Zotit, njerëzit e tij do t'i mbajnë edhe Ligjin, edhe Urdhërimet. Ata do ta mbajnë duke pasur gjithashtu edhe dëshminë e Jezusit, i cili është Fryma e Profecisë.

Deri këtu ne pohuam se Dhuntia e Profecisë është dhënë nga Zoti. Herë pas here nga mos-bindja dhe thyerja e ligjit, dhuntia i mungoi kishës. Por në ditët e fundit dhuntia do të jetë përsëri e pranishme. Çdo njeri që shpall dhuntinë e profecisë duhet të testohet në nëntë pika Biblike.

Fizike

Humbje të fuqive natyrore.

Ndalimi i ftrymëmarrjes.
Fitimi i fuqive mbinatyrore.
Sytë mbeten të hapura.
Profeti nuk i njeh gjërat që e rrethojnë ndërsa gjendet në vizion.

Morale

Një besim i fortë se “Krishti erdhi si njeri i gjallë”.
Një profet duhet të flasë në përputhje me “Ligjin dhe Dëshminë”.
Parashikimet duhet të përmbushen.
Ata do të njihen nga frutet e tyre.

Po si zbatohen këto teste në Kishën e sotme? Ndërsa Lëvizja e Ngjarjes së Madhe do të ngrihet fuqishëm në pjesën e parë të shekullit XIX, ku do t’i vihet theksi edhe një herë mbi rëndësinë e Ligjit të Zotit, si një përfundim i natyrshëm i bindjes së njeriut ndaj Krishtit, dhuntia e Profecisë do të rivendoset përsëri. Ajo iu dha së pari Uilliam Foy-it të besimit baptist, një njeri i mirë-shkolluar e i kulturuar dhe një folës gjuhë-rrjedhshëm. Në vitin 1842 atij iu dhanë dy vizione. Ato sjellin deshmi të qarta të të qenit zbulesa të shpirtit të Zotit. Turma të mëdha e ndiqnin dhe e dëgjonin nga vendi në vend. Ai banonte në dashurinë e pasionuar të Krishtit dhe nxiste njerëzit të pranonin hirësinë shpëtuese të Krishtit. Më pas ai pati një vizion të tretë, të cilin nuk arriti ta kuptojë, e për pasojë nuk e ndau me njerëzit. Shpejt u sëmur dhe vdiq.

Dhuntia në po të njëjtën mënyrë iu dha në vijim Hazen Foss, edhe ky një njeri i mirë-shkolluar e që vishej shumë këndshëm. Edhe ai nuk pranoi të ndante ndjenjat e vizionit të tretë me njerëzit, pasi s’arrinte t’i kuptonte ato. Vëreni në këtë aspekt faktin se edhe profeti Daniel nuk arriti t’i kuptojë të gjitha ato që i pat thënë Zoti nëpër vizione, (Daniel 8:27). Zoti në fund e hoqi vizionin e Tij prej Foss-it. Ndodhi atëherë që ai u përpoq të mbledhë disa njerëz së bashku, me shpresën se vizioni do t’i kthehej e ai mund ta përdorte atë. Mori me qera një ndërtesë shkolle për ta bërë një gjë të tillë, por kur qendroi

përpara njëqind e ca njerëzve që kish arritur të mblidhte, u gjend në vështirësi e siklet, pasi nuk iu shfaq asnjë lloj vizioni. Zoti e kish hequr prej tij. Ai u dëshpërua dhe në fund hoqi dorë nga kjo përvojë. Më vonë ai e dëgjoi këtë vizion nga një vajzë e thjeshtë, duke shpallur se ish Zoti Ai që e kish thirrur atë dhe se të gjithë duhet ta besojnë vajzën si të shenjuarën e Zotit. Pasi padyshim që mbi të kish rënë manteli profetik.

Ellen Harmon (e martuar më pas me Xhejms Uajt [White]) ishte vajza, së cilës iu dhanë dy vizionet e para e pastaj vizioni i tretë. Solemne qenë rastet e marrjes së shumë prej vizioneve të saj. Njerëzit që qenë dëshmitarë të çastit të marrjes së këtyre vizioneve, ishin të bindur në fuqinë e tyre të mbinatyrshme. Ndërsa ajo dhe prindërit e saj vinin prej një tradite Metodiste, dhe i respektonin ato besnikërisht, që të gjithë iu bashkuan lëvizjes Adventiste, që aso kohe kish shpërthyer kudo nëpër botë. Ajo që një vajzë e thjeshtë dhe e pashkolluar, që dëgjonte ethshmërisht zërin e Zotit. Kjo e forcoi atë për të gjitha detyrat madhore që e prisnin duke i dhuruar shumë vizione, për më shumë se 70 vjet. Vdiq në vitin 1915, në moshën 87 vjeçare. Mësimet e saj janë të konsultueshme ende edhe sot dhe nuk e humbasin kurrë buçimën e frymëzimit.

A zbatohen vallë, testet e mësipërme të Biblës ndaj Ellen White?

1 . **Humbja e fuqive natyrore.** Kur ajo kapej nga vizionet, fytyra e saj zbehej e venitej, çka tregon se humbte shumë nga fuqitë e veta natyrore.

2 . **Fuqitë e mbinatyrshme.** Menjëherë sapo dukej se fuqitë e saj natyrore qenë humbur, asaj i jepeshin fuqi të mbinatyrshme. Kjo provohet nga një rast, kur mbajti një Bibël 19 paund (1 paund = 454 gr) të rëndë në largësinë e një krahu, për t'i inkurajuar studentët e pranishëm që ta lexonin. Ajo e mbajti atë në largësinë e një krahu për plot 30 minuta. Ndërsa që në vizion askush s'mund ta lëvizte dorën apo trupin e saj.

3 . **Mungesa e frymëmarrjes.** Në shumë raste frymimi i saj u testua prej pasqyrave dhe flakëve të qiririt. Nuk bëri kurrë mjergull në

pasqyrë apo lëkundi flakën e një qiriri. Doktorët e kontrollonin dhe shihnin se pulsën e kishte të rregullt, shprehjen e kuptueshme dhe gjendjen e përgjithshme natyrale, veçse vizioni ishte tërësisht i ndryshëm nga të gjitha ëndërrat normale, pasi fuqia e frymëmarrjes së saj bëhej aq të ndryshme.

4 . **Sytë mbeten hapur.** Ashtu siç ndodhte me profetët e vjetër, sytë e saj mbeteshin të hapur, për të kundruar me vëmendje dhe përqendrim vizionin që i jepte Zoti. Ajo nuk i kapsalliste sytë, as mundej t’u bënte një gjë të tillë, pasi koka e saj mbetej në një shikim të prirur së larti.

5 . **Të painteresuar për gjërat që e rrethonin.** Ajo s’ e dinte kurrë se ç’ndodhte përrreth saj, kur gjendej në vizion e sipër. Vizioni i saj më i gjatë zgjati katër orë, ndërkohë që shumë të tillë merrnin vetëm pak sekonda.

6 . **Krishti erdhi si njeri i gjallë.** Ajo besonte fortësisht në përçmimin që iu krye Zotit tonë, duke shkruar gjerësisht për shpëtimtarin dhe ardhjen e Tij si njeri i gjallë. Për librin e saj “Dëshira e epokave”, libraria e kongresit shkroi njëherë se “ Midis më shumë se 10 mijë librave mbi jetën e Krishtit për mprehtësinë depërtuese shpirtërore dhe zbatimin praktik, ai do të qe i pari”. Libri saj: “Hapa përkah Krishtit” ka arritur të fitojë zemrat e qindra, mijëra njerëzve për Krishtin. Ai është botuar në mbi 100 gjuhë. Ajo shkroi edhe për edukimin dhe një projekt i zbatuar i këtij libri ndiqet sot nga qeveritë e Iranit dhe Serbisë, po ashtu, si dhe nga kisha Adventiste e ditës së shtatë. Libri “Edukimi” njihet si një nga librat udhëheqës në këtë fushë.

7 . **Besimi ndaj Ligjit dhe Dëshmisë.** Ajo besonte në tërësinë e Biblës pa përjashtim. Shkrimet e saj nuk duhet të shikohen si një shtojcë e shkrimeve ose si një zëvendësim i tyre, por siç ka shpjeguar ajo, “si një dritë më e vogël që udhëheq kah një dritë më të madhe”. Shkrimet e saj janë plot me pasazhe të Biblës. Mijërat e artikujve të saj kurrë nuk shpunë tej Shkrimeve të Shenjta, por gjithmonë udhëheqin kah tyre dhe kah kuptimit të tyre sa më të madh.

8 . **Përmbushja e parashikimeve.** Edhe përpara Luftës Civile Amerikane, ajo parashikoi se fitorja do t'i takonte Veriut. Në ditët, kur Spiritualizmi shpallte vetëm pak mijëra ndjekës, ajo parashikoi se ai do të përhapej në të gjithë botën. Sot ai shpall me miliona pasues. Ajo parashikoi se veprat botuese të Adventistëve do të shkonin në të gjithë botën. Kjo ndodhi kur u botua trakti i parë. Sot Adventistët kanë më shumë se 50 Shtëpi Botuese mbarëbotërore dhe botojnë në to më shumë literaturë, libra dhe revista, se sa çdo kishë tjetër.

9 . Frutet e jetës së saj. Dëshmia e atyre që qendruan me të, familja e saj, të tjerët dhe të gjithë ata që patën kontakt, nuk ndryshuan asnjëherë. Qeveritë, veçanërisht ato skandinave, e ftonin të fliste shpesh mbi subjektin e luftës kundra alkolizmit. Në një rast ajo foli përpara 20. 000 personave. Ajo vetë ishte e matur në pije dhe, kur vdiq, gazetatat kryesore kudo nëpër Amerikë shkruan editorialë të famshëm në nder të saj. "...Vdekja e saj shënjoi fundin e një tjetër udhëheqësi të njohur të mendimit fetar e të dikujt, që gati 90-të vitet e jetës së saj i pati të nbushura plot e përplot me qëllime të mira, fjalë të këndshme e lutje të zellshme për gjithë njerëzimin". (Editorial, St. Helena Star, 25 korrik 1915).

Zoti tha : "Besoni në Zot, që të ndërtohet mbretëria e Tij; besojini profetët e vet, që të ketë përparim" (2 Kronikave 20:20).

33. Rikthim i profetit Elija

“Shikoni unë do të sjellë profetin Elija (ose Elijah), përpara ardhjes së ditës së madhe e të tmerrshme Të Zotit. E Ai do të kthejë zemrat e etërve kah fëmijëve, dhe zemrat e fëmijëve, dhe zemrat e fëmijëve kah etërve të tyre, që unë të vij e ta godas tokën me një mallkim”. (Malahi 4:5-6)

Këtu përshkruhet një profeci dramatike e rikthimit të profetit Elija përpara ardhjes së Krishtit. I spikatur në pamjen e vet, Elija ishte një profet interesant dhe Biblik, i cili jetoi rreth 850 vjet përpara Krishtit. Pamja e tij me një veshje prej pëlhere thesi, binte në kundërshti me atë të mbretit Ahab, mbretërisë së ligësisë, të cilës duhej t’i vinte fudi. Sipas Shkrimeve të Shenjta ai ishte më i keqi i mbretërve të tjerë, të Izraelit të marrë së bashku. Ky fakt i mvishej në pjesën më të madhe martesës së tij të paligjshme me të bijën e Ethbalit, mbretit të Sidonit. Jezebeli, mbretëresha e re e Izraelit, u bë e njohur për mbretërimin e vet famëkeq të terrorit, kundra njerëzve të Zotit dhe profetëve të Tij. Ajo përkoji me kohën e perëndimit moral të Izraelit. Nga provinca e saj Baal-nderuese e Libanit, ajo solli traditën e nderimit të diellit, bashkë me format e tij shoqëruese të nderimit e idhujtarisë, duke i shkaktuar Izraelit një periudhë të madhe të humbjes së besimit apo fe-lëshimit. Imazhi i vërtetë i Zotit, pothuajse kishte humbur.

Elija u thirr nga Zoti për të shpërndarë mesazhin e ardhjes së një fatkeqesie. “Përderisa Zoti i Izraelit jeton e unë do të qendroj përpara Tij, nuk do të bjerë as vesë e as shi gjatë këtyre viteve, përveçse me urdhërin tim”. (Mbretërit 17:18). Dëshmia e drejtëpërdrejtë e Elijas nuk njohu asnjë shtrembërim të faktit apo së vërtetës dhe u shpërhap me shumë fuqi, zell dhe besim. Kjo profeci për tre vjet e gjysëm zi buke dhe thatësi u dha në një kohë, kur lumenjte nuk kishin rrjedhur kurrë ndonjëherë kaq të harbuar. Dielli që njerëzit nderonin, do t’i përzhiste ato me një nxehtësi të pashtershme, derisa shkatërrimi i tmerrshëm do të përjetohej nga e gjithë toka.

Kur thatësira mbërriti, Jezbeli i vrau profetët e Zotit. Megjithatë, njeri nga shërbëtorët më besnikë të Zotit, Obadiah, fshehu njëqind prej

tyre në një shpellë, ku ata u ushqyen me bukë dhe ujë. Ç'dallim kish mes këtyre njerëzve dhe profetëve që hanin në tryezën e Jezebelit e që mbështeteshin nga shteti. Mësimet e predikimet e tyre ishin veç për para dhe popullaritet. Ata s'arritën në asnjë lloj mënyre të ndalnin shkretimin që i erdhi tokës. Për tre vjet e gjysëm Ahabi ishte i dëshpëruar, ndaj dërgoi shërbëtorin e tij besnik Obadiahun (i cili ishte besim-plotë ndaj Zotit) ta ndihmonte të gjente Elijan. Zoti e lejoi Obadiahun ta gjente e ta sillte Elijan te mbreti.

1. Mbretërit 18:17,18 shpjegon se atëherë ndodhi që kur Ahabi pa Elijan dhe i tha: "A je ti vallë, trazimtari i Izraelit?". Ai u përgjigj: "Unë s'e kam trazuar e s'i kam sjellë telashe Izraelit, por ti dhe shtëpia e atit tënd e kanë bërë një gjë të tillë, duke harruar urdhërimet e Zotit e duke ndjekur ato të Baal-it." Pas tre vjet e gjysëm thatësirë dhe zi buke, Elija i cili kish ngelur fshehur në Liban, u rishfaq dhe kërkoi një mbledhje të njerëzve të Izraelit dhe profetëve të Baal-it, në Malin Karmel. Aty Elija doli përpara të gjithë njerëzve dhe tha: "Për sa gjatë ju do të luhateni midis dy opinioneve? Ne se Ati ynë është Zoti, atëherë ndiqeni Atë: por në se është Baal-i, atëherë shkoni pas tij". (1 Mbretërit, 18:21). Mirëpo njerëzit, si thanë asnjë fjalë (1 Mbretërit 18:21). Prova më e madhe për të provuar Zotin e vërtetë do të qe nëpërmjet djegies së dhurimeve. Zjarri duhej të vinte prej Zotit të vërtetë dhe të digjte një dem të ofruar e të coptuar në altar. Demi i Baal-it u përgatit shpejt dhe përgjatë gjithë mëngjesit me lutje e deri me thikë-prerje të vetvetes, profetët e Baal-it arritën të pranojnë se Zoti i tyre nuk i ishte përgjigjur këtyre peticioneve për të ndezur zjarrin e altarit. Atëherë u përgatit demi i tredhur i Eljas. Me një lutje te thjeshtë që dallohej aq shumë nga frenezia e profetëve të Baal-it, Elija ftoi YHWH (emri i Zotit të Izraelit në hebraisht, që ka gjasa të jetë shqiptuar "*Jahveh*") , që t'u provonte njerëzve se Ai ishte Zoti i vetëm. Nëse Zoti do ta sillte zjarrin në altar, Elija besonte se zemrat e njerëzve do të ktheheshin përsëri ndaj Zotit. Zjarri arriti e nuk dogji vetëm flijën që ishte përgatitur për t'iu sakrifikuar Zotit, por edhe gurët e 12 fuçitë me ujë

që Elija kish derdhur mbi flijën dhe altarin. Kjo shërbeu si një pikë kthese në jetën e mijëra njerëzve. Ata nisën t'i përkushtoheshin me dëshirë Zotit, që iu përgjigj lutjes në këtë mënyrë dramatike. Për shkak të dekadencës dhe imoralitetit, profetët e Baal-it u shkatërruan. Thatësira mbaroi dhe Zoti zhvelloi fuqinë e Tij mbi elementët përbërës të botës. Mbretërimi i nderimit të Baal-it përfundoi, kur Elija vrau të gjithë profetët e rremë.

Jezebeli u tërbua nga humbja e profetëve të vet dhe kërcënoi se do ta vriste Elijan. Kjo shkaktoi një krizë të vërtetë në jetën e tij dhe nga pikëllimi ai u arratis në shkretëtirë. Edhe pse pikëllimi i Elijas zbuloi një mungesë besimi, përsëri Zoti e mbrojti atë duke e ushqyer me engjëjt e vet. Jo shumë kohë pas kësaj ngjarjeje, si Jezebeli ashtu dhe mbreti Ahab u vranë. Mbretëria e tyre kish qenë një diskretitim i vërtetë për Izraelin.

Kulmi më i lavdishëm në jetën e Elijas ishte kalimi i tij në qiell, pa provuar vdekjen. (2 Mbretërve 2:11) : “Atëherë, ndërsa ata po ecnin e po bisedonin, ndodhi që papritmas u shfaq një karrocë flake me kuaj, zjarri që i ndau nga njeri-tjetri. Dhe Elija nëpërmjet një shtjelle ere u ngjit lart në qiell. Zoti e bekoi aq shumë në jetë, deri aty sa ta merrte në parajsë ende pa vdekur. Më parë, vetëm Enohu e pati këtë privilegj, pasi ai ecte e bisedonte me Zotin. Elija kish qenë një profet i madh. Mezazhi, fuqia dhe zhvillimi i marrëdhënieve të tij me Zotin, ishte një shembull për gjithçka që do të ndodhte në vitet e mëvonshme.

Ky nuk është përfundimi i historisë së Elijas, pasi profeti Malakia zbulon rikthimin e tij përpara ardhjes së dytë të Krishtit. *“Shikoni, unë do të sjellë profetin Elija, përpara ardhjes së ditës së madhe e të tmerrshme Të Zotit. E Ai do të kthejë zemrat e etërve kah fëmijëve, dhe zemrat e fëmijëve, dhe zemrat e fëmijëve kah etërve të tyre, që unë të vij e ta godas tokën me një mallkim”.* (Malakia 4:5-6)

A ishte Elija Gjon Pagëzori?

Luka 1:17 : “Ai do të gjendet përpara Zotit me frymën dhe fuqinë e Elias, për të kthyer zemrat e etërve kah fëmijëve dhe të pabindurit kah mençurisë së të drejtëve, për t’i bërë gati e për t’i përgatitur njerëzit për Zotin”. Elija u kthye në mesazhin dhe fuqinë e Gjon Pagëzorit. Nuk ishte vetë Elija si person që do të rikthehej, por lloji i atij mesazhi që do të arrinte t’i kthente zemrat e prindërve kah fëmijëve dhe ato të fëmijëve kah prindërve. Një mesazh vërtet i fuqishëm, qëllim-plotë i dhënë nga Zoti. Gjoni ishte profeti përpara ardhjes së parë të Krishtit, e ndonëse i shpërhapte mesazhet e Elias për kohën e tij, nuk ishte pa dyshim po ai profet. Gjoni: 1:21: “Dhe ata e pyetën: “A je ti Elija?”. Ai tha: “Jo”. A je ti profeti”? Ai u përgjigj: “Jo”.

I njëjti lloj mesazhi, që do t’i ktheje zemrat e njerëzve përsëri te Krishti, larg prej nderimit të diellit, traditave fetare dhe materiale të botës, do të bëhet i dukshëm në ditët e fundit të kthimit të Krishtit. Gjon Pagëzori ishte një tip i Elias e në të njëjtën mënyrë përpara ardhjes së dytë të Krishtit, profeti Elija do të vijë përsëri, jo si person, por në mesazhin përfundimtar që do t’i jepet botës.

Në erën e Ungjillit, ekziston një ngjajshmëri e madhe me ngjarjet e ditëve të Elias. Zbulesa 2:20 parathotë se kisha e Zotit, e përfaqësuar nga kisha e Thiatirës, do t’i kthehet Jezebelit si burim frymëzimi. Ashtu si ajo ndërfiti në Izrael nderimin e diellit, po kështu ky nderim i diellit, arriti ta korruptojë kishën e hershme të krishterë. Shteti filloi pagesat ndaj kishës, ashtu siç profetët e Baal-it, paguheshin prej Jezebelit nga thesari i shtetit – ata hanin në tryezën e saj. Ndërsa shprishja e së vërtetës rritej, shumë objekte e simbole të paganizmit nisën të ndërfiteshin në kishë. Naforat e rrumbullakta që përdoren gjatë kungimeve, përfaqësojnë diskun e diellit. Edhe disqet e gjerë të diellit nisën të vendosen prapa altarëve të kishave. Ne mund të flasim gjatë në lidhje me sendet fetare, që pengojnë përparimin e shpërhapjes së Ungjillit të Krishtit. Elija u shfaq me paralajmërimet e njerëzve të tillë, si Pali, Gjoni apo apostujt e tjerë, e më pas me njerëz

të tillë si Injaci i Antiohut, e të tjerë në rrangjet e Albigjenezëve, Valdenezëve dhe Huguenotëve.

Thatësira shpirtërore zuri vend në historinë e kishës për 3 vjet e gjysëm ose 1260 vjet. Përgjatë kësaj periudhe kohe fëmijët e Zotit u ndoqën dhe shumë prej tyre u vranë. Ata u ndoqën nëpër male dhe luginat nga “Ahabët” dhe “Jezebelët” e periudhës Papnore. Më shumë se 100 milionë njerëz u masakruan për besimin e tyre, por e vërteta nuk mundi të çrrënjosej. Pas kësaj mbretërie të terrorit, mesazhi i Zotit të Elijas erdhi që prej shkretëtirës. Ky mesazh i paralajmëroi njerëzit kundra mësymjes së paganizmit dhe çdo lloj forme të nderimit të diellit që ish zhvilluar në kishë gjatë atyre viteve. Kisha e krishterë kishte vite tashmë që e kish pranuar ditën e diellit si ditën e nderimit. Njerëzit nuk e kuptonin se e diela nuk ishte Sabati i Zotit tonë dhe se sendet fetare që përdorreshin nga shumica, nuk qenë të asaj forme të thjeshtë të nderimit, që Zoti kish urdhëruar për njeriun.

Mesazhi i tre engjëjve – mesazhi i Elijas për këto ditë

Dëshmia e drejtpërdrejtë e Elijas jepet në fund të mesazhit të “tre engjëjve” te Zbulesa 14. Mesazhi i kthen zemrat e njerëzve te Krishti dhe Hirësia e Tij shpëtimtare, duke i bërë thirrje edhe njerëzve të Babilonisë, t’i shërbejnë Krishtit, Zotit të gjallë, e t’i binden urdhërimeve të Tij. Ashtu si Jezebeli u zemërua me Elijan dhe u orvat ta vriste atë, po kështu “dragoi u zemërua me vashën (kishën) dhe u nis të bëjë luftë më të gjallë-mbeturit e farës së saj, që mbanin 10 Urdhërimet e Zotit dhe kishin besimin e Jezusit” (Zbulesa, 12 :17).

Po do të ketë gjyqe për njerëzit e vërtetë të Zotit dhe prova e madhe së ardhmes do të vendoset mbi çështjen e së dielës dhe Sabatit. Kjo po fillon të ndodhë në disa vende që tani. Gjithësesi, kulmi i lavdishëm do të vijë kur njerëzit e Zotit do të zhvendosen në qiell, ashtu siç ndodhi me Elijan në të shkuarën.

“Sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin. (1 Selanikasve 4:16, 17)

Ji i gatshëm ta provosh mesazhin që do të vijë me fuqinë dhe shpirtin e Elias e që do t’i shpjerë njerëzit larg, nga çdo aspekt i nderimit të diellit për kah nderimit të Zotit.

34 . Mëkati i pafalshëm

Fryma e Shenjtë dhe mëkati i pafalshëm

Unë po lexoja së fundi mbi një guvernator të njerit prej shteteve të Amerikës, i cili fali dhe liroi 56 të burgosur të dënuar me vdekje. Ata që ishin kundërshtarë të dënimit me vdekje, u kënaqën nga ky rezultat, ndërsa në po të njëjtën kohë, familjarët e viktimave të këtyre vrasjeve u tërbuan nga zemërimi.

Falja e guvernatorit për kriminelët shkaktoi reagime të ndryshme. Fjala “falje” sjell menjëherë në mendje idenë e faljes. Në kuptimin e krishterë ajo sjell idenë e mëshirës që jepet lirisht dhe është e pamerituar, pasi ne jemi të ushqyer me dënimin e mëkat-kryerjes. Nëse do të ishit gjykatës, a mund ta dinit se sa i keq mund të jetë mëkati, që ju nuk mund ta falnit? Kur dikush ka kryer vrasje të shumfishtë, siç ka patur së fundmi disa raste në Shetet e Bashkuara, ku shumë nxënës shkolle, u vranë bashkë me mësuesit e tyre? Kur ka pasur

njerëz të vrarë nga bomba të komanduara nga celulari, apo nga pajisje të tjera elektronike? Në ç'fazë të shkatërrimit, ose sa i tmerrshëm duhet të jetë një krim që ju si gjykatës ta ndalonit faljen e kriminelëve që kanë kryer këtë krim mizor?

Kjo na shpie në tekstin e Shkrimeve të Shenjta, ku Zoti zbulon mëkatën që nuk mund të falet e që shpesh termësohet si “mëkati i pafalshëm”. Vëreni Mateu 12:31-32: “Ndaj unë po ju them, se do t’i falet njeriut çdo mëkat e çdo blasfemi, përveç blasfemisë kundra Shpirtit të Shenjtë që s’do t’i falet kurrë. Çdo njeri që flet një fjalë kundra Birit të Zotit do të falet, por kushdo që flet kundra Shpirtit të Shenjtë, nuk do të falet as në këtë kohë e as në kohët që do të vijnë”. Unë kam njohur shumë njerëz që më pyesin, nëse mendoj se ata e kanë kryer këtë mëkat! Në se njerëzit janë të interesuar në lidhje me përfshirjen e tyre në “mëkatën e pafalshëm”, kjo është një shenjë e sigurtë që ata s’e kanë kryer këtë mëkat.

Shkrimet e Shenjta janë shumë të qarta mbi faljen e Zotit. Le të kujtojmë disa tekste. Ndoshta më i famshmi është Gjoni 3:16. “Se Zoti aq shumë e dashuroi botën, sa dha edhe Birin e Vet të dashur, që kushdo që beson te Ai të mos shuhet, por të ketë një jetë të përjetëshme”.

Është e qartë se Zoti na do e dëshiron që ne të jemi përfitues të jetës së përjetëshme me ardhjen e dytë të Jezusit. Një tjetër tekst i mrekullueshëm gjendet te 1 Gjoni 1:9: “Nëse i rrëfejme mëkatet, Ai është besnik dhe i drejtë në faljen e tyre dhe në pastrimin tonë prej të gjitha padrejtësive”. Ashtu siç tregojnë tekstet, Zoti është plot mëshirë dhe i gatshëm t’i falë mëkatet tona.

Unë e pëlqej aq shumë atë pasazh të Dhjatës së Vjetër që gjendet në librin e Micahut 7:18, i cili thotë: “Ku ka një Zot të tillë që fal ligësinë e anashkalon mëkatet e të gjallë-mbeturve të trashëgimisë së Tij? Ai s’e mban përjetë inatin, sepse është i ngazëllyer nga mëshira”. Një tjetër pasazh i imi, i parapëlqyer gjendet te Hebrenjëve 8:12: “Se unë do të jem i mëshirshëm për padrejtësinë e tyre, dhe s’do t’ua kujtoj mëkatet dhe ligësitë”.

Një ose dy personalitete të Shkrimeve të Shenjta sjellin në mend faljen e Zotit. Mendoni për një moment Jakobin në Dhjatën e Vjetër. Ai u bë një hajdut dhe një gënjeshtar. Por, kur u pendua për mëkatet e tij, Zoti e fali. Vëreni premtimin e Zotit për të : “Shikoni, unë jam me ju e do t’ju mbroj kudo që të shkoni, për t’u kthyer përsëri këtu në këtë tokë; se s’ kam për t’ju lënë deri sa të bëjë gjithçka që kam premtuar”. (Zanafilla, 29:15). Pjetri është një tjetër personalitet i mirënjohur të Dhjata e Vjetër. Ai është njeri nga dishepujt udhëheqës që i premtoi Krishtit se nuk kishte për ta harruar kurrë, edhe sikur këtë gjë ta bënte gjithë bota. Nuk zgjati shumë dhe ai mohoi ta njohte Krishtin, duke u maskuar dhe duke u përбетuar se nuk e njohte Atë. E megjithatë Zoti e fali, aq sa në kapitullin e dytë të Akteve ne shohim një Pjetër të falur e të rigjallëruar që qendron drejt përpara Krishtit. Ai s’ do ta mohonte më kurrë Shpëtimtarin e vet!

Një tjetër personalitet i Shkrimeve ishte Pali. Ai s’ ishte i panjohur për udhëheqësit hebrenjë, pasi që kur qe djalë i ri, ishte mësuar t’i urrente të krishterët. Në gur-përdhosjen e Stefanit, ai ishte mu prapa atyre që hodhën gurë mbi martirin e parë të Krishtit. Me kete vrull rinor ai filloi t’i persekutojë të krishterët, duke i ndjekur deri edhe në qytetet më të largëta, për t’i sjellë në Jeruzalem e për t’i gjykuar publikisht. Ndodhi atëherë që kur po udhëtonte për në Damask me shpurën e vet, që ai ndjeu t’i fliste Jezusi. Ndihej i verbuar e dëgjoi Jezusin t’i thoshte: “Pal, Pal, pse vallë po më persekuton kaq shumë”? Ky njeri që ish i përgjegjshëm për persekutimin e aq shumë të krishterëve, u fal e pastaj u bë një predikues i madh dhe një evangjelist i kishës së hershme kristiane. Me mijëra janë konvertuar prej predikimeve të tij dhe prej letrave që ai u dërgoi kishave të Efesit, Korinthit, Galateas, Romës dhe Filipit, për të përmendur vetëm disa emra.

Ka tre shembuj, nga të shumtët, që tregojnë hirësinë dhe faljen e mrekullueshme që ofron Zoti. Po atëherë, si mund të ndodhë që ne të keni një mëkat që Zoti nuk mund ta falë? Ne kemi theksuar tashmë se “në se i rrëfejnë mëkatete tona, atëherë Zoti na i fal ato

dhe na pastron nga të gjitha padrejtësitë”. Mëkati që Zoti nuk fal është mëkati që ne nuk e rrëfejmë. Unë mendoj se kjo është thënë e shkruar shumë qartë. Njerëzit shpesh më pyesin : “Po sikur të mos e kujtoj një mëkat, e kështu të mos e rrëfej dot”? Zoti është i ndershëm. Ai do të dijë të ta sjellë në mendje. Ai do që ne të shpëtohem, jo të humbasim. Mëkatet që na vijnë në mendje se i kemi kryer, duhet të rrëfehen. Por gjithmonë kujton se, ndërsa ne jemi mëkatarë të mëdhenj, ne kemi edhe një shpëtimtar të madh!

Vëreni një pasazh të një teksti që ne e cituam edhe më sipër në këtë kapitull. Blesfamia kundër Shpirtit të Shenjtë nuk falet. “ Po a është ky vallë, një lloj mëkati i veçantë? Jo! Mund të jetë çfarëdo lloj mëkati i parrëfyer. Bibla na thotë se të gjitha llojet e mëkateve do të falen. Në këtë kuptim nuk ekziston një mëkat i veçantë që nuk mund të falet. Zoti do të falë çdo mëkat që është i rrëfyer. Mëkati i pafalshëm është mohimi i vazhdueshëm i Shpirtit të Shenjtë që na gatit për mëkatin apo mëkatet tona. Kur Fryma e Shenjtë sjell në ndërgjegjen tonë një mëkat të vecantë që ne kemi kryer, është koha të pendohemi dhe të rrëfemi. Fryma e Shenjtë do të vazhdojë të na kujtojë mbi gjërat e ndodhura në të shkuarën. Nëse ne i hedhim poshtë këto kujtesa, atëherë do të vijë koha kur Fryma e Shenjtë s’ ka për të na bindur dot më. E nëse na lë Fryma e Shenjtë, atëherë nuk do të jemi aspak të interesuar, në se e kemi kryer apo jo mëkatin e pafalshëm. Kështu, s’do të kemi asnjë ndërgjegjie rreth mëkateve. Kjo është gjendja në të cilën do të gjendemi paskësaj. Zoti na do në mbretërinë e Tij, por nuk do të na shtrëngoje. Zgjidhja mbetet vetëm e jona!

Në kapitujt 12-të dhe 13-të të këtij libri, ne kemi ndarë me ju veprat e Satanait. Ai dëshiron që të gjithë të shuhen bashkë me të. Krejtësisht i ndryshëm me dashurinë dhe mëshirimin e Zotit që kërkon të na shpëtojë të gjithëve! Satanai kërkon të veprojë te çdo mendje për ta larguar nga rrëfimi i mëkateve. Ai na inkurajon që ta lëmë mënjanë një gjë të tillë; prit për një herë tjetër, pendohu më vonë, ka plot kohë në të ardhmen për t’u shpëtuar. Por, nëse

shmangim ose nuk e dëgjojmë ankimin apo paralajmërimin e Shpirtit të Shenjtë, Satanai në fund do të dalë fitimtar.

Një shembull i mirë i kësaj qasjeje ishte rasti kur Noe-ja ishte gjallë dhe predikonte për fundin e botës. Gjendja e njerëzimit që alarmonte, pasi ai i shtonte mëkat pas mëkati vetes së vet. Zoti tha: “Fryma e Shenjtë nuk do të luftojë gjithmonë me njeriun”. Për vite të tëra Zoti u kish kërkuar njerëzve të pendoheshin e të vendosnin raporte të drejta me krijuesin. Njerëzimi e refuzoi dhe e hodhi poshtë veprën e Shpirtit të Shenjtë. Kur Noeja filloi të ndërtojë arkën, ai u tall, u përqesh dhe mesazhi i tyre i shpresës dhe shpëtimit u hodh poshtë. Në fund, vetën tetë persona u shpëtuan në arkë. U deshën 120 vjet për ta ndërtuar atë. Shkencëtarët janë gati të thonë se kjo varkë nuk mund të lundronte, edhe sikur të binte gjithë ai shi që predikonte Noeja. Psikologët u bënë të mërzitshëm duke shpjeguar se një njeri i tillë si Noeja kishte dëmtime nervore. Metereologët dëftojnë se një shi i tillë nuk ka rënë kurrë dhe se toka e ka të pamundur të mbajë kaq shunë ujë. Zoologët thonë se kafshët dhe zogjtë nuk mund të inkurajohen të futen në një vend të tillë të bërë nga njeriu, por edhe nëse e bëjnë një gjë të tillë që është krejt e pazakontë për ta, si do të mund të ushqeheshin më pas?

Mirëpo shiu ra dhe përmbytja ndodhi. Zogjtë dhe kafshët të udhëhequra nga Zoti, jetuan të sigurtë në arkë. Fryma e Shenjtë veproi mbi zemrat e njerëzve, por ata nuk dëgjuan. Shumë besimtarë vdiqën gjatë kohës që Noeja predikonte dhe ndërtonte arkën. Por në fund, vetëm 8 vetë patën besim të hynin në varkë, përpara se shiu të nxinte qiellin. Të gjithë të tjerët kishin kryer një mëkat të pafalshëm. Në arkë kishte vend për të gjithë, por s’kishte vend në zemrat e tyre për veprën e Shpirtit të Shenjtë.

Jezusi i kujton dëgjuesit e Tij te Gjoni 16:8 se “Fryma e Shenjtë do ta bindë botën e mëkatit”. Kur Shpirti të arrijë të na bindë, atëherë është koha për të vepruar. Pendohuni, rrëfëhuni, me ndihmën e Jezusit dhe ribëhuni. Fryma e Shenjtë do të na bindë për shumë gjëra në jetët tona shpirtërore. “Ju lutem pranojeni Zotin, shpëtimtarin tuaj

personal! E ndërsa bëni këtë, përgjigjiuni pozitivisht, në mënyrë që të ndani edhe hapin tjetër. Ndoshta ai do të jetë: “Mbani urdhërimet edhe duke përfshirë Sabatin”! Kur t’i përgjigjeni kësaj thirrjeje, një tjetër do të jetë. “Pagëzohuni! Çdo përgjigjie pozitive që ne japim do të thotë se po ndjekim Shpirtin e Zotit. Nëse e hedhim poshtë herë pas here, atëherë ne po e pengojmë rritjen tonë shpirtërore dhe në se këmbëngulim, atëherë kemi kryer një mëkat të pafalshëm”.

Kështu, Fryma e Shenjtë është dërguar të na bindë, nëse ne i përgjigjemi thirrjes së Tij, po në të njëjtën kohë, Ai do të na forcojë zemrat dhe jetët tona, kundra tundimeve të së ardhmes. Ç’ fuqi të së mirës na dërgon Fryma e Shenjtë në këto ditë të mbushura me aq shumë tundime për të na shpënë larg nga Krishti dhe e vërteta e Tij. Kjo është koha për t’iu përgjigjur Shpirtit të Shenjtë. Ai na ka dhënë Fjalën e Zotit në mënyrë që të priremi kah drejtimit të vërtetë të jetës sonë. Nëse nuk jemi duke jetuar në përputhje me Fjalën e Zotit, kur të arrijmë të bindemi, atëherë Fryma e Shenjtë do të vazhdojë të përpiqet e të na udhëheqë kah ndjekjes së kësaj Fjale. Është e rrezikshme ta mohosh atë dhe një bekim ta ndjekësh. Lejojeni ëmbëlsinë dhe fuqinë e Shpirtit të Shenjtë të vijë në jetën tuaj, menjëherë! Mos e shtyni më tej kohën për të kujtuar se Zoti tha: “Shpirti im nuk do të luftojë gjithmonë me njeriun”.

35 . Parajsa më në fund

Premtimi i fillimeve të reja

Në disa nga kapitujt e mëparshëm, kemi trajtuar disa nga imazhet më pasionante nga Zbulesa e cila na sjell në mend që ne po jetojmë në fundin e kohës. Në këtë kapitull të këtij libri, unë do të doja të

vizitoja fundin e kohës që ne njohim, të parë përmes syve të apostullit Gjon, ashtu siç ai shkroi në librin e Zbulesës.

Bibla hapet në dy kapitujt e saj të parë me një krijim të përkryer të planetit tokë. Pjesa tjetër e shkrimeve dëfton se çfarë ndodh me nisjen e mëkatit. Sidoqoftë, dy kapitujt përfundimtarë flasin për një tokë të rikrijuar dhe planin origjinal të Zotit për ta bërë atë realitet.

“ Dhe bëri be për atë që rron në shekuj të shekujve, që krijoi qiellin dhe gjërat që janë në të, tokën dhe gjërat që janë në të, detin dhe gjërat që janë në të, se nuk do të vonohet më. Por në ditët kur engjëlli i shtatë të bëjë të dëgjohet zëri i tij, kur ai t’i bjerë borisë do të zbatohet misteri i Perëndisë, ashtu si ai e ua shpalli shërbëtorëve të tij, profetëve. Dhe zëri që kisha dëgjuar nga qielli më foli përsëri dhe tha: "Shko, merr libërthin e hapur që ndodhet në dorën e engjëllit që rri mbi det e mbi dhe" Dhe shkova tek engjëlli dhe i thashë: “Më jep libërthin.” Dhe ai më tha: “Merre dhe gllabëroje atë dhe ai do ta hidhërojë të brëndëshmet e tua, por në gojën tënde do të jetë i ëmbël si mjaltë.” Dhe e mora libërthin nga dora e engjëllit, dhe si e gllabërova; dhe ishte në gojën time i ëmbël si mjaltë; dhe, mbasi e gllabërova, barku im u hidhërua. Dhe ai më tha: “Të duhet përsëri të profetizosh mbi shumë popuj, kombe, gjuhë dhe mbretër.” (**Zbulesa 10:6-11**)

Darkat e martesave janë një motiv Biblik për ardhjen e Mbretërisë së Krishtit. Martesa e djalit të mbretit. Mateu 22:1-14, 10 virgjëreshat që presin dhëndërin dhe darkat e planifikuara të martesës, janë veç disa nga shembujt.

Disa vite më parë, gruaja ime dhe unë morëm pjesë në dasmën e disa miqve të veçantë. Ua njihnim familjet për më shumë se 40 vjet. Çifti i ri vendosi t’i mbante miqtë në një resort të veçantë për 4 ditë. Nuk nevojitej absolutisht asnjë kosto për miqtë që do të qendronin aty për 4 ditë. Ne u çlodhëm vërtet, bëmë shëtitje me varkë, patëm vahte të shijshme deri ditën e katërt: ditën e kremtimit të martesës. Në atë ditë ne u veshëm me rrobat formale për këtë rast. Ishte e mrekullueshme të kuptoje se sado e madhe të qe garderoba dhe sado

e gjerë të qe mundësia e zgjedhjes së veshjeve, tashmë të disponueshme, përsëri një tjetër vizitë nëpër qendrat e veshjeve, për të gjetur diçka speciale, ishte e pashmangshme. Unë isha me fat, sepse gruaja ime sapo kishte festuar ditëlindjen dhe vajzat tona i kishin dhuruar diçka me këtë rast!

Po martesë e Qingjit të Zotit! Qendrat e veshjeve nuk kanë asgjë të veçantë, të mirë e të mjaftueshme për të. Martesa do të bëhet në resortin më të mirë që mund të imagjinohet.

Vargu 8 : “E nuses do t’i dhurohen rroba me pëlhura të imta liri, të pastra e të bardha”. Miqtë e kësaj martese mund të kenë vetëm një lloj veshje, si burrat ashtu edhe gratë, vajzat ashtu edhe djemtë: pëlhura liri të imta, të shndritshme (bardhësisht vezulluese), të pastra. Kjo u bë e mundur përmes gjakut të Jezusit. Kur njerezit e pranojnë Jezusin si Zot dhe shpëtimtar, ata gjykohen si të drejtë dhe u jepet mundësia të kenë veshjen e drejtë: veshjen e Tij të drejtësisë. Veprimet e drejta janë rezultati i bukur i një karakteri të drejtë që na është dhuruar nga Jezusi. Gjykimi para ardhjes përcakton listën e miqve dhe të atyre që nuk do të jenë në listën e miqve. Por në fund të 1000 viteve ose të Mijëvjeçarit, do të bëhet gjykimi përfundimtar.

“Pastaj pashë një fron të madh të bardhë dhe atë që ulej mbi të, nga prania e të cilit iku dheu dhe qielli, dhe nuk u gjet vënd për ata. Dhe pashë të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin në këmbë përpara Perëndisë, edhe librat u hapën; dhe u hap një libër tjetër, që është libri i jetës; dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre. Dhe deti i dorëzoi të vdekurit që ishin në të, dhe vdekja dhe Hadesi dorëzuan të vdekurit që ishin në ta; dhe ata u gjykuan secili sipas veprave të veta. Pastaj vdekja dhe Hadesi u flakën në liqenin e zjarrit. Kjo është vdekja e dytë. Dhe, nëse ndokush nuk u gjet i shkruar në librin e jetës, u flak në liqenin e zjarrit. **(Zbulesa 20:11-15)**

Asnjë njeri, që ka jetuar ndonjëherë, s’do t’i shpëtojë kësaj dite. Shkrimet e Shenjta e quajnë këtë ngjarje aktin e çuditshëm të Zotit.

Zoti është përpjekur t'i bindë njerëzit përgjatë shekujve. Ai dëshiron që ne të gjithë të jemi në mbretërinë e Tij. Është mjaftueshëm e madhe për të gjithë, por emrat tanë duhet të shkruhen në Librin e Jetës. Ju hyni në këtë libër duke pranuar Jezusin, si shpëtimtarin tonë, që ua mundëson jetën në përputhje me vullnetin dhe qëllimin e Tij. Liqeni i zjarrit nuk është një ferr që digjet përjetësisht, por një simbol i shkatërrimit përfundimtar dhe tërësor. Ekziston një zjarr, por ai është epokë-përfundues. Ai do të digjet deri sa të mos ketë asgjë tjetër për të djegur.

Le të kthejmë vëmendjen tonë kah shpëtimit:

Dhe pashë një qiell të ri dhe një dhe të ri; sepse qielli i parë dhe dheu i parë kishin shkuar, dhe deti nuk ishte më. Dhe unë, Gjoni, pashë qytetin e shenjtë, Jeruzalemin e ri, që zbriste nga qielli, nga Perëndia, që ishte bërë gati si nuse e stolisur për burrin e vet. (Zbulesa 21: 1-2)

S'do të ketë më det! Gjoni është duke i shkruar kolonisë së ndëshkuar në Patmos. Kishte një det midis tij dhe njerëzve të Zotit. Për të deti nënkupton "nuk ka më ndarje".

"Nuses së stolisur për burrin e saj". Zoti i dha më të mirët e pranishëm në dasëm. Gjoni dha disa detaje të asaj që pritet të ndodhë:

"Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: "Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre." (Zbulesa 21:3)

Vargu 9: Pastaj erdhi drejt meje një nga të shtatë engjëjt që kishin të shtatë kupat plot me shtatë plagët e fundit, dhe foli me mua, duke thënë: "Eja, do të të tregoj nusen, gruan e Qengjit."

"Dhe qyteti nuk ka nevojë për diell, as për hënë që të ndriçojnë në të, sepse lavdia e Perëndisë e ndriçon atë, dhe llamba e tij është Qengji. Dhe kombet e të shpëtuarve do të ecin në dritën e tij; dhe mbretërit e dheut do të sjellin lavdinë dhe nderin e tyre në të. Dhe portat e tij nuk do të mbyllen asnjëherë gjatë ditës, sepse nuk do të ketë asnjëherë natë. (Zbulesa 21:23-25)

Ne njohim shumë gjera mbi nxehtësinë apo dritën diellore. Jezusi është drita e tij.

Çdokush mund t'i vizitojë kopshtet Butchart në ishullin e Vankuverit. Njeherë e një kohë ato ishin gurore për të nxjerrë zhavorr për rrugët dhe fabrikat e çimentove. Vendi ishte një shëmtim për ishullin e bukur. Por kur shfrytëzimi i gurores mbaroi, Butchartët vendosën ta kthenin atë në një kopsht të klasit botëror. E kësaj ia arritën. Në se e vizitoni atë vend në dimër, pranverë, verë apo vjeshtë, ai është gjithmonë një spektakël. Ne jemi magjepsur me bukurinë e tij, në çdo kohë që kemi qenë aty. Ai gjithmonë ngjan me një parashikim të parajsës. Le të lexojmë më poshtë Zbulesën 22:3-5.

"Dhe asnjë mallkim nuk do të ketë më; dhe në të do të jetë froni i Perëndisë dhe i Qengjit, dhe shërbëtorët e tij do t'i shërbejnë; ata do të shohin fytyrën e tij; dhe emri i tij do të jetë mbi ballin e tyre. Dhe atje natë nuk do të ketë; edhe nuk kanë nevojë për llambë, as

për dritë dielli, sepse Zoti Perëndi i ndriçon; dhe ata do të mbretërojnë në shekuj të shekujve.” (Zbulesa 22: 3-5)
Oh, të shohësh fytyrën e tij!

Por në fund le t’i kujtojmë këto tri vargje:

22:7: “Do ta shihni... unë do të vij shumë shpejt! Bekuar qoftë ai që mban fjalët e profecisë së këtij libri”.

Vargu 12: “Do ta shihni, unë do të vij shumë shpejt! Dhe shpërblimi im është bashkë me mua, për t’ ia dhënë çdokujt në përputhje me veprimet e tij”.

Vargu 20: “Ai që dëshmon këto gjëra thotë : “Sigurisht, që unë do vij shpejt! Amen, e në qoftë kështu, mirese të vish, o Zot!”

Çfarë pikturë e mrekullueshme dhe e detajuar e shpresës! Ja, se ç’ përfaqëson Jezusi: shpëtimin tënd dhe timin. Ai na do që të jemi në Të. Të shijojmë përjetësinë me fuqinë rinore të përjetësisë. Është më shpejt sot se sa atëherë, kur besonim për herë të parë. Ashtu siç thotë edhe kënga: “Ne po jetojmë në një kohë të madhe dhe të frikëshme”.

Ne kemi hedhur një vështrim të shpejtë për të ardhmen në kapitujt e këtij libri. Prej tij na është hapur dera e së ardhmes. Ne kemi hapur disa perde profecish duke parë se çfarë di Shpëtimtari ynë për atë çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Shumë gjëra nga ato që Ai shkroi kanë ndodhur në të shkuarën. Tani Jezusi do të vijë shpejt, shumë shpejt. Ai i tha vetes : “Sigurisht që unë do të vij shpejt...”.

Në se iu thotë të pushoni sonte – a do të ishit gati të takoheshit me të? Në fakt, në se Jezusi vjen që sonte – ju a do të ishit gati. Le të lutemi përditë, që të jemi gati kur Ai të vijë. Zoti ynë i madh e i mëshirshëm ju bekoftë e iu dhëntë paqen e Tij.